UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË
DEPARTAMENTI I MANAXHIMIT

DISERTACION

SFIDAT TREGTARE TË INTEGRIMIT TË SHQIPËRISE NË BASHKIMIN EVROPIAN

një qasje e kombinuar e ndikimit të proceseve integruese në politikën dhe flukset tregtare të Shqipërisë

Në kërkim të gradës shkencore "**DOKTOR"**

Punoi:
Pranvera Kastrati

Udhëheqës Shkencor:
Prof. Dr. Suzana Panariti

Tiranë, 2015

MIRËNJOHJE

Ky punim ka qenë një sfidë për mua jo vetëm për të përfunduar me sukses përpjekjen time drejt ngritjes akademike, por edhe një investim për të ardhmen. Transformimi i politikës tregtare të Shqipërisë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian kërkon një ri-orientim të përpjekjeve dhe aftësive personale të gjithkujt, që është i angazhuar sot në politikën tregtare, përfshirë mua.

Përfundimi i këtij punimi nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen dhe inkurajimin e vazhdueshëm të miqve dhe kolegëve të mi që dëshiroj t'i falenderoj pa masë.

Mirënjohja ime e pakursyer, shumë e sinqertë dhe e pafund shkon për udhëheqësen time shkencore Prof. Dr. Suzana Panariti. Kam patur fatin të bashkëpunoj me Profesoreshën prej shumë vitesh, por puna për këtë tezë më mësoi se cila është shëmbëlltyra e integritetit akademik, profesionalizmit dhe drejtimit shkencor, mirësisë dhe durimit, por mbi të gjitha modelit që dëshiron të bëhet çdo kandidat për një titull akademik.

Falenderime për miken time Nevin Omuri, që nuk u lodh kurrë së dëgjuari dhe diskutuari me mua tezat, dyshimet dhe pikëpyetjet pas çdo kapitulli.

Familja ime është forca dhe nxitja më e madhe e këtij punimi. Pa kontributin, durimin dhe mbështetjen e saj ky punim nuk do të mund të përfundonte.

Ua dedikoj këtë studim prindërve të mi, të cilët u ndanë nga jeta pak kohë përpara se ai të përfundonte. Ata nuk mundën të ndiejnë krenarinë, që vajza e tyre e përfundoi me sukses këtë rrugëtim drejt dijes dhe rritjes akademike.

Mami, Babi,

Ia dola!

ABSTRAKT

Ky punim përbën një përpjekje për të hulumtuar rreth ndikimit që sjell integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë kërkim fokusi ka qenë shumë i balancuar midis ndikimit në kuadrin e politikave dhe atë të flukseve tregtare. Kombinimi i analizave sasiore me ato cilësore kanë lejuar vlerësimin tërësor të ndikimit në politikën tregtare shqiptare. Ndikimi i marrëveshjeve tregtare në flukset tregtare të Shqipërisë, i hulumtuar edhe nga autorë të tjerë, është thelluar më tej nëpërmjet përfshirjes në modelin teorik të gravitetit të një variabli të papërdorur më parë në vlerësimet e Shqipërisë, indeksin e komplementaritetit të tregtisë (TCI). Kërkimi i ka kushtuar vëmendje edhe ndikimit të kuadrit të politikave nga kuadri i politikave të Bashkimit Evropian, hulumtim i cili nuk është bërë më parë për Shqipërinë. Përfitimi nga eksperienca e ngjashme e rrugëtimit drejt Bashkimit Evropian të vendeve të ngjashme për nga karakteristikat e zhvillimit ekonomik dhe tregtar, si Bullgaria dhe Rumani, ka ndihmuar në thellimin e mëtejshëm të pyetjeve kërkimore.

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian, edhe pse nuk është quajtur i tillë në fillimet e viteve 90’, ka qenë një rrugë e gjatë transformimi dhe modernizimi për Shqipërinë, rrugë e cila nuk ka përfunduar akoma. Rezultatet e analizës empirike si dhe analizat cilësore tregojnë se integrimi në Bashkimin Evropian është një mekanizëm nxitës për zhvillimin ekonomik dhe social të Shqipërisë, edhe pse ky ndikim nuk duket të ketë njohur kulmime pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, por ka ndjekur ritmin dhe kurbën normale të zhvillimit.

Ky punim ofron një tërësi rekomandimesh për politikë-bërësit dhe ofron edhe drejtime të tjera për kërkime të mëtejshme në këtë fushë.

LISTA E SHKURTIMEVE

ACP	Afrika, Karaibet dhe Vendet e Paqësorit
APEC	Forumi për Bashkëpunimin Ekonomik Azi-Paqësor
ASEAN	Organizata e Kombeve të Azisë Juglindore
BE	Bashkimi Evropian
CEE	Vendet e Evropës Qëndrore
CEFTA	Marreveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
CIS	Komonuelthi i Shteteve të Pavarura
CLRM	Modeli linear klasik i regresionit
DFBIS	Departamenti për Biznesin, Novacionin dhe Aftësitë
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar
EC Treaty	Traktati i krijimit të Komunitetit Evropian
EEA	Zonë Ekonomike Evropiane
EFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shteteve EFTA
EMU	Bashkimi Ekonomik dhe Monetar
WIPO	Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GATS	Marrëveshja e Përgjithshme mbi Tregtinë në Shërbimet
GATT	Marrëveshja e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë
PBB/GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GDPPF	Prodhimi i Brendshëm Bruto për Frymë
GMM	Metoda e Momenteve të Përgjithësuar
GPA	Marrëveshja për Prokurimin Publik
SPP	Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPR	Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale
KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
KTJ	Komiteti për Tregtinë e Jashtme
LSDV	Least Square Dummy Variables
MERCOSOUR	Tregu i Përbashkët Jugor
MFN	Parimi i Kombit më të Favorizuar
MSA	Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit
MTL	Marrëveshje e Tregtisë së Lirë
NAFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut
NK	Nomenklatura e Kombinuar
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OLS	Ordinary Least Squares
PAPs	Produkte të Përpunuara Bujqësore

GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PPT	Politika e Përbashkët Tregtare
PTA	Marrëveshje Tregtare Preferenciale
RTA	Marrëveshje Tregtare Rajonale
SPP	Sistem i Përgjithshëm i Preferencave
TCI	Indeksi i Komplementaritetit të Tregtisë
TDP	Tarifa Doganore e Përbashkët
TFBE	Traktati i Funksionit të Bashkimit Evropian
TRIMS	Marrëveshje për Masat e Investimeve që lidhen me Tregtinë
TRIPS	Marreveshje mbi Aspektet e së Drejtës së Pronësisë Intelektuale që lidhet me Tregtinë

PËRMBAJTJA

Kapitulli I: HYRJE....1
1.1 Hyrje....2
1.2 Qëllimi dhe objektivat e punimit....2
1.3 Rishikimi i literaturës....5
1.4 Metodologjia e punimit....8
1.5 Konteksti dhe motivimi i punimit....9
1.6 Struktura e punimit....11
Kapitulli II: RISHIKIM I LITERATURËS - MODELI I GRAVITETIT....13
2.1 Hyrje....14
2.2 Themelet teorike të Modelit të Gravitetit....14
2.3 Bazat Mikroekonomike të Modelit të Gravitetit....17
2.4 Zhvillimet ekonometrike mbi vlerësimin e modelit të gravitetit....21
2.5 Rishikim Literature....23
2.6 Përfundime....44
Kapitulli III: METODOLOGJIA....46
3.1 Hyrje....47
3.2 Metodat për vlerësimin e modelit të gravitetit....47
3.2.1 OLS....47
3.2.2 Metodat e vlerësimit të të dhënave panel....52
3.3 Përfundime....55
Kapitulli IV: Analiza e politikës tregtare shqiptare dhe ndikimi i Politikës së Përbashkët Tregtare (PPT) të BE-së....56
4.1 Hyrje....57
4.2 Ecuria e tregtisë së jashtme të Shqipërisë....58
4.2.1 Karakteristikat e volumit tregtar....58
4.2.2 Karakteristika e eksportit....62
4.2.3 Karakteristika e importit....66
4.3 Stadi aktual i politikës tregtare....69
4.3.1 Politika tregtare para dhe pas anëtarësimit në OBT....70
4.3.2 Instrumentat e politikës tregtare shqiptare....72
4.3.3 Kordinimi i politikës tregtare shqiptare....75

4.4. Politika e Përbashkët Tregtare e Bashkimit Evropian (PPT) 76
4.4.1 Qëllimet dhe kompetencat e Politikës së Përbashkët Tregtare të BE-së 76
4.4.2 Parimet e politikës së përbashkët tregtare 80
4.4.3 Instrumentat e Politikës së Përbashkët Tregtare 84
4.4.4 Traktati i Lisbonës 2009 dhe ndryshimet e politikës së përbashkët tregtare 87
4.4.5 Kordinimi i Politikës së Përbashkët Tregtare 94
4.5 Ndikimi i PPT në politikën tregtare shqiptare 95
4.6 Përfundime 97
Kapitulli V: VLERËSIMI I FLUKSEVE TREGTARE PAS ANËTARËSIMIT NË BE: Analiza empirike 100
5.1 Hyrje 101
5.2 Statistika përshkruese 101
5.3 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të eksporteve 106
5.3.1 Vlerësimi i modelit të eksporteve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues 111
5.4 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të eksporteve 113
5.4.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI 113
5.4.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI 118
5.5 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të importeve 124
5.5.1 Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues 129
5.6 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të importeve 130
5.6.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI 130
5.6.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI 134
5.7 Analiza e Avantazhit Krahasues 139
5.7.1 Modeli teorik 140
5.7.2 Qasja e analizës së avantazhit krahasues 142
5.7.3 Rezultatet e indeksit të avantazhit konkurrues (BI): 144
5.8 Përfundime 153
Kapitulli VI: NDIKIMI I ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN: Rrugë e njohur 157
6.1 Hyrje 158
6.2 Përzgjedhja e shteteve të marra në analizë 158
6.3 Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Rumanisë 164

6.3.1 Zhvillimi ekonomik 164
6.3.2 Tregtia e jashtme e Rumanisë.....168
6.3.3 Politika tregtare.....170
6.4. Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Bullgarisë.....172
6.4.1 Zhvillimi ekonomik 172
6.4.2 Tregtia e jashtme e Bullgarisë 174
6.4.3 Politika tregtare.....176
6.5 Bullgaria dhe Rumania para dhe pas anëtarësimit, 2002-2013.....177
6.5.1 Karakteristikat e volumit tregtar.....177
6.5.2 Karakteristikat e eksportit.....180
6.5.3 Karakteristikat e importit.....183
6.6 Përfundime 186
Kapitulli VII: PËRFUNDIME.....188
7.1 Hyrje.....189
7.2 Gjetjet kryesore 190
7.3 Kontributet kryesore në njohuritë e fushës 197
7.4 Rekomandime.....199
7.5 Mundësi për kërkime të mëtejshme 202
Bibliografia.....204
Aneksi I 219
Aneksi II.....232
Aneksi III.....241

Lista e tabelave

TABELA 4.1 ECURIA E TREGTISË 2006-11 MUJOR 2014 (NË MILION LEKË), ... 58

TABELA 4.2 RAPORTI I IMPORTIT DHE EKSPORTIT NDAJ VOLUMIT TREGTAR 60

TABELA 4.3 EKSPORTI SIPAS GRUP-MALLRAVE (NË MILIARDË LEKË) 62

TABELA 4.4 RAPORTI I EKSPORTIT PREFERENCIAL NDAJ ATIJ NORMAL 65

TABELA 4.5 IMPORTI SIPAS GRUP-MALLRAVE (NË MILIARDË LEKË) 66

TABELA 4.6 RAPORTI I IMPORTIT PREFERENCIAL NDAJ ATIJ NORMAL 69

TABELA 4.7 NDARJA E NIVELEVE TARIFORE, 2014 70

TABELA 5.1 STATISTIKAT PËRSHKRUESE 105

TABELA 5.2. REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE 107

TABELA 5.3 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TREGUES TË VITEVE 108

TABELA 5.4 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE TË RASTIT 109

TABELA 5.5 REZULTATET E TESTIT TË HAUSMAN PËR PËRZGJEDHJEN MES MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TË RASTIT 110

TABELA 5.6 REZULTATET E VLERËSIMEVE ME KORRIGJIM TË GABIMEVE STANDARDE 112

TABELA 5.7 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE ME KOSOVËN NË PANEL 114

TABELA 5.8 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TREGUES TË VITEVE ME KOSOVËN NË PANEL 115

TABELA 5.9 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE TË RASTIT ME KOSOVËN NË PANEL 116

TABELA 5.10 REZULTATET E TESTIT TË HAUSMAN PËR PËRZGJEDHJEN MES MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TË RASTIT 116

TABELA 5.11 VLERËSIMI I KORRIGJUAR PËR VARËSINË NDËRSEKSIONALE, AUTOKORRELACIONIN DHE HETEROSKEDASTICITETIN 117

TABELA 5.12 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE ME KOSOVËN NË PANEL 119

TABELA 5.13. REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TREGUES TË VITEVE ME KOSOVËN NË PANEL 120

TABELA 5.14 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE TË RASTIT ME KOSOVËN NË PANEL 121

TABELA 5.15 REZULTATET E TESTIT HAUSMAN PËR PËRZGJEDHJEN MES MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TË RASTIT 121

TABELA 5.16 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT ME EFEKTE TË RASTIT ME KOSOVËN NË PANEL DHE VARIABLAT E PANDRYSHUESHËM NË KOHË ... 122

TABELA 5.17 REZULTATET E TESTIT HAUSMAN PËR PËRZGJEDHJEN MES MODELIT ME EFEKTE FIKSE DHE TË RASTIT (KUR NË MODEL PËRFSHIHEN VARIABLAT E PANDRYSHUAR NË KOHË) 123

TABELA 5.18 REZULTATET E VLERËSIMIT TË PANELIT ME KOSOVËN DHE ME TCI TË KORRIGJUAR PËR VARËSI NDËRSEKSIONALE, AUTOKORRELACION DHE HETEROSKEDASTICITET. 123

TABELA 5.19 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE FIKSE 126

TABELA 5.20 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT 127

TABELA 5.21 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT PËRFSHIRË VARIABLAT E PANDRYSHUESHËM NË KOHË..... 128

TABELA 5.22 VLERËSIMI I MODELIT TË IMPORTEVE TË KORRIGJUAR PËR HETEROSKEDASTICITET DHE AUTOKORRELACION 130

TABELA 5.23 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE FIKSE 131

TABELA 5.24 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT 132

TABELA 5.25 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT PËRFSHIRË VARIABLAT E PANDRYSHUESHËM NË KOHË..... 133

TABELA 5.26 VLERËSIMI I MODELIT TË IMPORTEVE TË KORRIGJUAR PËR HETEROSKEDASTICITET DHE AUTOKORRELACION 134

TABELA 5.27 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE FIKSE 135

TABELA 5.28 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT 136

TABELA 5.29 REZULTATET E VLERËSIMIT TË MODELIT TË IMPORTEVE ME EFEKTE TË RASTIT PËRFSHIRË VARIABLAT E PANDRYSHUESHËM NË KOHË DHE VARIABLAT DUMMY PËR KOHËN 137

TABELA 5.30 VLERËSIMI I MODELIT TË IMPORTEVE TË KORRIGJUAR PËR HETEROSKEDASTICITET DHE AUTOKORRELACION 138

TABELA 5.31 PARTNERËT KRYESORË TË EKSPORTIT PËR SHQIPËRINË 143

TABELA 5.32 SJELLJA E KAPITUJVE ME AVANTAZH KRAHASUES PARA DHE PAS NËNSHKRIMIT TË MSA-SË 150

TABELA 5.33 AVANTAZHI KRAHASUES DHE EKSPORTI FAKTIK 152

TABELA 5.34 RAPORTI I EKSPORTIT ME AVANTAZH KRAHASUES NDAJ EKSPORTIT TOTAL ME BE-NË 152

TABELA 6.1 RENDITJA SIPAS RAPORTIT TË KONKURRUESHMËRISË GLOBALE 162

TABELA 6.2 LEHTËSIA E TË BËRIT BIZNES 162

TABELA 6.3 INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT 164

TABELA 6.4 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË RUMANISË 166

TABELA 6.5 TË DHËNAT E PËRGJITHSHME TË BULLGARISË 173

Lista e grafikëve

GRAFIK 4.1 FLUKSI I SHKËMBIMEVE TREGTARE PËR VITET 2007-2013 (NË MILIARDË LEKË) 59

GRAFIK 4.2 RAPORTI I IMPORTIT DHE EKSPORTIT NDAJ VOLUMIT TREGTAR, 2006-11 MUJORI 2014 (NË PËRQINDJE) 60

GRAFIK 4.3 SHKALLA E HAPJES SË SHQIPËRISË SI RAPORT NDAJ GDP-SË (NË PËRQINDJE) 61

GRAFIK 4.4 EKSPORTI SIPAS GRUP-MALLRAVE (NË MILIARDË LEKË) 63

GRAFIK 4.5 RAPORTI I EKSPORTEVE NË BE DHE VENDET E TJERA TË BOTËS NDAJ EKSPORTIT TOTAL 64

GRAFIK 4.6 PARTNERËT KRYESORË TË EKSPORTIT PËR VITIN 2013, (NË PËRQINDJE) 64

GRAFIK 4.7 IMPORTI SIPAS GRUP-MALLRAVE (NË MILIARDË LEKË) 67

GRAFIK 4.8 RAPORTI I IMPORTEVE NGA BE DHE VENDET E TJERA TË BOTËS NDAJ IMPORTIT TOTAL 68

GRAFIK 4.9 PARTNERËT KRYESORË TË IMPORTIT PËR VITIN 2013 (NË PËRQINDJE) 68

GRAFIK 4.10 PARAQITJA E KOMPETENCAVE NË POLITIKË-BËRJE NË BASHKIMIN EVROPIAN 79

GRAFIK 5.1 INDEKSI I KOMPLEMENTARITETIT TË TREGTISË 106

GRAFIK 5.2 INDEKSI I AVANTAZHIT KRAHASUES PARA DHE PAS NËNSHKRIMIT TË MSA-SË 147

GRAFIK 6.1 PROCESI I INTEGRIMIT TË KROACISË NË BASHKIMIN EVROPIAN 159

GRAFIK 6.2 PRODHIMI I PËRGJITHSHËM BRUTO, (NË MILIARDË USD) 160

GRAFIK 6.3 PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO PËR FRYMË, (NË DOLLARË) 161

GRAFIK 6.4 RRITJA EKONOMIKE 2000-2012, (NË PËRQINDJE) 161

GRAFIK 6.5 INDEKSI I LIRISË EKONOMIKE 163

GRAFIK 6.6 RRITJA EKONOMIKE E RUMANISË KRAHASUAR ME MESATAREN E BASHKIMIT EVROPIAN 166

GRAFIK 6.7 RRITJA E TË ARDHURAVE VJETORE PËR FRYMË, (NË PËRQINDJE) 167

GRAFIK 6.8 QARKULLIMI I MALLRAVE PËR VITET 2008-2013, (NË MILION EURO) 169

GRAFIK 6.9 EKSPORTI DHE IMPORTI I RUMANISË, SIPAS GRUPMALLRAVE, VITI 2013 169

GRAFIK 6.10 PROCESI I INTEGRIMIT TË RUMANISË DHE BULLGARISË NË BASHKIMIN EVROPIAN 171

GRAFIK 6.11 RRITJA EKONOMIKE E BULLGARISË KRAHASUAR ME MESATAREN E BASHKIMIT EVROPIAN 174

GRAFIK 6.12 RRITJA E TË ARDHURAVE VJETORE PËR FRYMË, NË PËRQIND 174

GRAFIK 6.13 QARKULLIMI I MALLRAVE PËR VITET 2008-2013, (NË MILION EURO) 175

GRAFIKU 6.14 EKSPORTI DHE IMPORTI I RUMANISË, SIPAS GRUP-MALLRAVE, VITI 2013 176

GRAFIK 6.15 VOLUMI TREGTAR I BULLGARISË DHE RUMANISË 2002-2013, (NË MILION EURO) 178

GRAFIK 6.16 QARKULLIMI I MALLRAVE PËR BULLGARINË DHE RUMANINË, (NË MILION EURO) 179

GRAFIK 6.17 SHKALLA E HAPJES SË BULLGARISË DHE RUMANISË NË VITE 180

GRAFIK 6.18 ECURIA E EKSPORTIT TË BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË MIJË EURO) .. 180

GRAFIK 6.19 RITMET E RRITJET SË EKSPORTIT TË BULLGARISË DHE RUMANISË 181

GRAFIK 6.20 EKSPORTI I BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË MILION EURO) 181

GRAFIK 6.21 ROLI I VENDEVE TË BE PËR EKSPORTET E BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË PËRQINDJE) 182

GRAFIK 6.22 ECURIA E IMPORTIT TË BULLGARISË DHE RUMANISË (NË MILION EURO). 183

GRAFIK 6.23 RITMET E RRITJET SË IMPORTIT TË BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË PËRQINDJE) 184

GRAFIK 6.24 IMPORTI BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË MILION EURO) 185

GRAFIK 6.25 ROLI I VENDEVE TË BE PËR IMPORTET E BULLGARISË DHE RUMANISË, (NË PËRQINDJE) 185

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Hyrje.....2
1.2 Qëllimi dhe objektivat e punimit.....2
1.3 Rishikimi i literaturës.....5
1.4 Metodologjia e punimit.....8
1.5 Konteksti dhe motivimi i punimit.....9
1.6 Struktura e punimit.....11

1.1 Hyrje

Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (SZHBI) 2014-2020 synon transformimin e Shqipërisë në një Shqipëri konkurruese, të hapur drejt tregut rajonal, evropian dhe global. Për këtë synohet rritja dhe diversifikimi i eksporteve, për të ofruar më shumë hapësira dhe mundësi për prodhuesit shqiptarë për të zgjeruar aktivitetin prodhues. Shqipëria ka marrë statusin e vendit kandidat dhe do të jetë në një të ardhme afatmesme pjesë e Tregut të Vetëm Evropian, e aftë të përballojë forcat e tregut të përbashkët dhe të marrë të gjitha përfitimet që vijnë prej tij.

Bashkimi Evropian është tradicionalisht partneri kryesor tregtar i Shqipërisë dhe kjo në shumicën e rasteve është vlerësuar si fuqi dhe jo dobësi. Presioni në rritje i forcave të tregut si dhe rritja e konkurrencës në treg, si rezultat i hapjes dhe de-rregullimit, ka bërë që ekonomia shqiptare të përballet me sfida strukturore, institucionale dhe politike. Edhe pse Strategjia e BE 2020 nuk ofron ndonjë perspektivë të qartë për anëtarësimet e reja brenda periudhës 2020, Shqipëria synon të bëhet anëtare e Bashkimit Evropian brenda vitit 2020. Ky synim do të arrihet pas një procesi negociatash tregtare për të garantuar që të drejtat themelore të ekonomisë dhe shoqërisë të mishëruara në Traktatet e Bashkimit Evropian të përfshihen plotësisht në legjislacionin kombëtar shqiptar, në pjesën më të madhe përpara datës efektive të anëtarësimit. Kjo kërkon domosdoshmërisht që *acquis* e Bashkimit Evropian të zbatohet nga institucionet shqiptare dhe të pranohet nga shoqëria shqiptare.

1.2 Qëllimi dhe objektivat e punimit

Shqipëria renditet si një vend me të ardhura mesatare dhe ka bërë hapa të mëdha për të vendosur demokracinë dhe ekonominë e tregut pas viteve 90'. Sipas Bankës Botërore, përpara krizës financiare botërore, Shqipëria njohu rritje ekonomike të konsiderueshme, mesatarisht 6 përqind, e shoqëruar kjo dhe me uljen e varfërisë[1]. Shqipëria është i vetmi vend në rajonin e Ballkanit Perëndimor që e kaloi krizën financiare pa hyrë në recension. Megjithatë kriza botërore ndikoi në ekonominë shqiptare duke lëkundur faktorët dhe ekuilibrat, të cilët kishin mbështetur rritjen ekonomike. Recesioni ekonomik që përfshiu Greqinë dhe Italinë u shoqërua me uljen e shkëmbimeve tregtare dhe të hyrave valutore (Banka e Shqipërisë, 2010). Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, që nga viti 2009 rritja

[1] http://www.worldbank.org/en/country/albania

ekonomike ka patur vetëm rënie, respektivisht 3.3 përqind, 3.8 përqind, 3.1 përqind, 1.3 përqind dhe 1.4 përqind në 2013. Për vitin 2014 rritja ekonomike është 2 përqind (FMN, 2014)[2].

Tregtia e jashtme i është nënshtruar proceseve të thella dhe intensive liberalizuese, procese të cilat rezultuan me politika dhe reforma që ndikuan ndjeshëm në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë dhe Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me vendet e EFTA-s, kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e mundësive për eksportet shqiptare për zgjerim dhe diversifikim. Kështu, volumi i përgjithshëm i tregtisë gjatë viteve 2007-2013 është rritur me një rritje mesatare vjetore 11 përqind. Volumi i përgjithshëm tregtar me Bashkimin Evropian për vitin 2013 ishte 514 miliardë lekë ose 67 përqind e volumit total tregtar të Shqipërisë. Volumi tregtar me Bashkimin Evropian është rritur vazhdimisht në vlerë absolute, ndërkohë që pesha e tij në tregtinë e Shqipërisë ka rënë në vite.

Ky punim synon të vlerësojë ndikimin që anëtarësimi në Bashkimin Evropian ka në politikën tregtare shqiptare, flukset tregtare dhe transformimin e rolit të institucioneve. Me gjithë proceset radikale të hapjes së tregut dhe të liberalizimit tregtar, vlerësimi teorik, kontekstual dhe empirik i sfidave që rrjedhin nga integrimi në tregun e vetëm të Bashkimit Evropian dhe përshtatja e plotë me Politikën e Përbashkët Tregtare të Bashkimit Evropian, në mënyrë të veçantë pas Traktatit të Lisbonës, përbëjnë qëllimin kryesor të këtij punimi. Për këtë, analiza e detajuar e stadit të politikës tregtare aktuale do të shërbejë si bazë për analizën e strukturës së import-eksporteve si dhe dhënien e rekomandimeve. Hipoteza kryesore që do të analizohet është se anëtarësimi në Bashkimin Evropian pritet të ndikojë në politikën tregtare shqiptare dhe në strukturën e import-eksportit.

Objektivat kryesorë të punimit janë:

1. Rishikimi i literaturës për vlerësimin e flukseve tregtare me anë të modelit të gravitetit, me qëllim identifikimin e variablave shpjegues dhe të varur, si dhe zgjedhjen e metodës më të mirë të vlerësimit për të dhënat e flukseve tregtare të Shqipërisë.

[2] Deklara e FMN; "Review Mission to Albania", deklarat për shtyp Nr. 14/539, 25 Nëntor 2014

2. Bazuar në këtë rishikim, vlerësimi i modelit të gravitetit për flukset tregtare të vendit, dhe nxjerrja e përfundimeve mbi efektin sasior që kanë variablat e pavarur të përzgjedhur, e në veçanti efektin e marrëveshjeve tregtare mbi eksportet dhe importet drejt partnerëve kryesorë.

3. Analiza e stadit aktual të politikës tregtare shqiptare, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në karakteristikat, dallimet dhe të përbashkëtat me politikën e përbashkët tregtare evropiane.

4. Analiza e lirive dhe kufizimeve që ka politika tregtare shqiptare në momentin që duhet të ndjekë plotësisht politikën e përbashkët tregtare evropiane. Fokus i veçantë do t'i kushtohet ndryshimeve që sjell Traktati i Lisbonës së vitit 2009 për politikën tregtare.

5. Analiza e qasjes së re të institucioneve shqiptare në lidhje me politikën tregtare.

6. Analiza e efekteve potenciale të tregtisë së jashtme të Shqipërisë në momentin e unifikimit të politikës së vet tregtare me Bashkimin Evropian. Analiza e avantazhit krahasues të Shqipërisë para dhe pas anëtarësimit dhe orientimi që kjo analizë jep për eksportet shqiptare.

7. Analiza krahasuese e eksperiencave të ngjashme të vendeve më të reja anëtare të Bashkimit Evropian dhe ndikimi që procesi i anëtarësimit pati në strukturën e tregtisë së tyre. Konkluzione analoge për Shqipërinë do të mund të nxirren nga kjo analizë.

8. Bazuar në përfundimet e këtyre analizave, ky punim synon të japë rekomandime mbi politikat tregtare dhe qasjen e re të institucioneve shqiptare pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, përfundimet ofrojnë një perspektivë të re për institucionet shqiptare në koordinimin dhe konsultimin e politikës tregtare me të gjitha grupet e interesit.

Për arritjen e këtyre objektivave, ky punim synon t'i japë përgjigje disa pyetjeve kërkimore të cilat mund të përmblidhen:

1. Cilat janë problematikat në vlerësimin e modelit të gravitetit dhe si janë matur variablat kryesorë të përdorur dhe sugjeruar në punime të ndryshme në vite.

2. Si është ecuria dhe zhvillimet e politikës tregtare shqiptare në vite. Sa dhe si e ka ndikuar Traktati i Lisbonës PPT-në. Cili është ndikimi i PPT-së në politikën tregtare shqiptare pas anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

3. Sa i efektshëm është zbatimi i modelit të gravitetit në parashikimin e flukseve të ardhshme tregtare dhe çfarë tregojnë analizat dhe kërkimet e bëra në dy dekadat e fundit për zbatimin e modelit të gravitetit.

4. Si mund të aplikohet modeli i gravitetit në rastin e Shqipërisë dhe cilat janë rezultatet lidhur me ndikimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, në termat e tregtisë dhe strukturën e import-eksportit.

5. Sa ndikojnë marrëveshjet e tregtisë së lirë në flukset e ardhshme tregtare të Shqipërisë dhe a janë ato faktori i vetëm që ndikon në to.

6. A do të kenë ndryshime strukturat përgjegjëse për politikën tregtare pas anëtarësimit dhe si do të transformohet ajo për t'iu përgjigjur kërkesave të politikës së përbashkët tregtare të BE.

7. Cili është avantazhi krahasues i Shqipërisë në tregun e Bashkimit Evropian dhe si duhet të përqaset politika tregtare shqiptare në procesin e anëtarësimit në BE, parë nga këndvështrimi i politikave dhe institucioneve.

8. Cilat janë eksperiencat e vendeve të anëtarësuara së fundmi në BE dhe cilat janë mësimet e nxjerra nga proceset e ngjashme të anëtarësimit.

1.3 Rishikimi i literaturës

Modelimi i shkëmbimeve tregtare është përdorur gjerësisht në dekadat e fundit. Fokusi kryesor i modelimit është përqëndruar në (i) simulimin e modeleve për të kuptuar efekte potenciale në tregtinë midis partnerëve, bilaterale apo edhe më gjerë, (ii) përdorimin e modeleve ekonometrike për të bërë parashikime mbi bazën e performancës së mëparshme në tregtinë e një vendi. Gjysëm shekullin e fundit modeli i gravitetit është përdorur gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare për identifikimin e efekteve që kanë në tregti faktorë si: gjuha e

përbashkët, besimi, kufiri doganor, liberalizimi i tregtisë, distanca gjeografike, marrëveshjet tregtare mes vendeve partnere, etj. Modeli është shumë i ngjashëm me ligjin e Njutonit sipas të cilit tërheqja midis dy trupave varet nga masat e trupave dhe distanca midis tyre. Në ngjashmëri me ligjin e Njutonit, modeli i gravitetit tregon se tregtia bilaterale midis dy vendeve është në përpjesëtim të drejtë me të ardhurat e tyre (GDP ose GNP) dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me distancat midis tyre.

Në studimet e fundit empirike, modeli i gravitetit është përdorur për të identifikuar efektet e marrëveshjeve tregtare rajonale, bashkimeve monetare, tregjeve të përbashkëta dhe nëse këto efekte rezultojnë në krijimin apo devijimin e flukseve tregtare. Përveç efekteve të politikave tregtare me anë të modelit të gravitetit vlerësohen edhe efektet e një sërë faktorësh të tjerë që ndikojnë në flukset tregtare, të tillë si: efektet e kufijve natyrorë mes vendeve partnere tregtare, efektet domino, investimet e huaja direkte, rregullat e origjinës, kostot e transportit, teoria e partnerit asnjanës, të drejtat e bashkimeve tregtare, efektet e demokracisë, lehtësitë tregtare, cilësitë rregulluese, etj.

Modeli i gravitetit formulohet duke supozuar preferenca identike të llojit Cobb-Douglass të konsumatorëve në të gjitha vendet partnere në tregti. Ai u aplikua fillimisht nga Tinbergen (1962) dhe u zgjerua më tej nga Linnemann (1966) dhe Isard (1975). Ai bazohet në modelet kryesore teorike të tregtisë ndërkombëtare: 1) Modeli i Rikardos – i cili bazohet në diferencat teknologjike midis vendeve partnere në tregti; 2) Modeli Hecksher-Ohlin, i cili bazohet në ndryshimet mbi zotërimin e faktorëve mes vendeve partnere në tregti; 3) teoritë moderne të tregtisë, të cilat marrin në konsideratë të ardhurat rritëse të shkallës në nivel firme. Anderson (1979) e zhvilloi më tej modelin duke supozuar specializim të plotë në prodhim dhe preferenca identike të konsumatorëve të vendeve partnere në tregti. Anderson dhe van Wincoop (2003) zhvilluan një model të ekuilibrit të përgjithshëm ndërkombëtar, i cili merr në konsideratë kostot ekzogjene të tregtisë së dyanshme, të tilla si kostot e transaksionit dhe kostot doganore, të cilat ndikojnë negativisht në flukset e dyanshme tregtare, duke zgjeruar më tej modelin e thjeshtë të gravitetit.

Matja e variablit të rezistencës së shumanshme ndaj tregtisë dhe vlerësimit empirik të saj përbëjnë një prej sfidave të teorisë së modelit të gravitetit. Distanca është konsideruar përgjithësisht një variabël i mirë *proxy* për rezistencën e shumëanshme ndaj tregtisë duke qenë se përcakton kohën që mallrat kalojnë në tranzit, dhe kostot e transaksionit. Gjithashtu,

në model konsiderohen kufijtë doganorë, kostot e transportit, diferencat kulturore, përdorimi i së njëjtës gjuhë ose jo, kultura e negocimit, diferencat kulturore, etj. Deardorff (1998) dhe Anderson dhe van Wincoop (2003) argumentojnë se ekuacioni i gravitetit nuk provon vlefshmërinë e një teorie apo të një tjetre, por përbën një mjet të miratuar gjerësisht dhe të testuar empirikisht për testimin formal të teorive të tregtisë. Perceptimi, që globalizimi duhet të kishte gjeneruar një zgjerim të aktivitetit ekonomik botëror, i cili do të reflektohej në uljen e kostove të transaksionit, në mënyrë të veçantë, kostove të transportit, nuk duket të jetë vërtetuar. Sipas këtij perceptimi, distanca duhet të ishte më pak e rëndësishme në tregtinë midis vendeve. Efekti i distancës në tregti do të ishte minimizuar, por realiteti tregon se bota nuk po bëhet më e vogël dhe efekti i kufijve vazhdon të ekzistojë (Brun et al. 2005). Gjithashtu, në shumë raste, kostot e transportit nuk lidhen vetëm me distancën, por edhe me cilësinë e infrastrukturës së transportit publik (Martinez-Zarzoso and Nowak-Lehmann D. 2003).

Në dy dekadat e fundit një numër i madh autorësh kanë përdorur modelin e gravitetit për të vlerësuar potencialin tregtar, sidomos mes vendeve të Europës Qëndrore e Lindore (CEE) me atë Perëndimore, Bashkimin Europian, mes vendeve të EFTA-s, dhe vendeve Balltike (Wang dhe Winters, 1991; Iversen, 1998; Paas, 1998, 2000; Chen dhe Wall, 1999; Egger, 2000; van Beers dhe Biessen, 1996). Më vonë, Paas (2000) përdori modelin e gravitetit me të dhëna të vitit 1997 për tregtinë mes Estonisë dhe 46 vendeve me të cilat Estonia kryen 95 përqind të volumit të tregtisë së saj të jashtme; Christie (2002) përdori modelin e gravitetit për të analizuar faktorët përcaktues të flukseve tregtare mes vendeve të OECD dhe atyre në tranzicion; Martínez-Zarzoso dhe Nowak-Lehmann (2003) aplikuan modelin e gravitetit për të vlerësuar potencialet tregtare mes vendeve të Mercosur dhe BE dhe efektet e marrëveshjeve mes tyre, etj. Gjithashtu, nga rishikimi i literaturës është gjetur se modeli i gravitetit është përdorur edhe nga kërkues shqiptarë (Xhepa dhe Agolli, 2003; Pllaha, 2011; Kraja dhe Sejdini, 2014) për të matur flukset tregtare të Shqipërisë.

Një drejtim tjetër kërkimor, që ka kontribuar në evoluimin e modelit të gravitetit dhe aplikimit të tij empirik, ka qenë interesi për matjen e efekteve për diversifikimin apo ndryshimet në flukset tregtare, që mund të ketë për një vend anëtarësimi në institucione tregtare apo nënshkrimi i marrëveshjeve të ndryshme tregtare, si për shembull marrëveshjet preferenciale (PTA) apo rajonale (RTA). Studime të tjera janë bazuar në përmirësimet e modelit të gravitetit dhe përfshirjes në të të variablave indikatorë të ngjarjeve të ndryshme,

dhe pothuajse çdo aplikim përfshin variabla të tillë. Modeli i gravitetit është vlerësuar fillimisht me anë të Metodës së Katrorëve më të Vegjël (Ordinary Least Squares – OLS), ndërkohë që zhvillimet e fundit ekonometrike mbështesin vlerësimin me metodat e vlerësimit të të dhënave panel. Nga rishikimi i literaturës rezultoi se vendet që janë më të pasura, që flasin të njëjtën gjuhë, që lidhen me kufij doganorë, që kanë histori të ngjashme kolonizimi, që bëjnë pjesë në blloqe tregtare, që janë pjesë e bashkimeve monetare, që kanë nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë, priren të tregtojnë më shumë me njëri-tjetrin. Ka patur përpjekje për aplikimin e modelit të gravitetit edhe për vlerësimin e flukseve tregtare për rastin e Shqipërisë, edhe pse këto kanë qenë të limituara në numër (Xhepa dhe Agolli, 2002; Pllaha, 2011; Kraja dhe Sejdini, 2014).

1.4 Metodologjia e punimit

Për zbatimin e modelit të gravitetit do të përdoren të dhënat panel, të cilat kanë përparësi ndaj përdorimit të të dhënave ndërseksionale, pasi të dhënat panel shfrytëzojnë informacionin e të dhënave në periudha të ndryshme kohore, duke e konsideruar këtë informacion si të tillë, ndryshe nga vlerësimi me OLS i të dhënave ndërseksionale i cili nuk merr në konsideratë varësinë e të dhënave të një vendi në kohë të ndryshme. Vlerësimi i të dhënave panel me metodat e efekteve fikse dhe atyre të rastit do të përdoren në vlerësimin e modelit të gravitetit. Në modelin e gravitetit si variabla të varur do të përdoren eksportet dhe importet ndërsa, ndër variablat e pavarur, janë përdorur disa prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në kërkesën dhe ofertën e vendeve tregtuese, si produkti i përgjithshëm bruto, popullsia dhe distanca. Gjithashtu, në vlerësimin e modelit janë përdorur edhe disa variabla dummy si të paturit e një kufiri ndarës, ekzistenca e një marrëveshjeje të tregtisë së lirë dhe indeksi i komplementaritetit të tregtisë (TCI). Vlerësimi i modelit të gravitetit është i rëndësishëm në rastin e Shqipërisë duke qenë se një ndër sfidat për krijimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme është edhe diversifikimi i eksporteve.

Ky punim përfshin në analizë 22 vende, Bosnjë-Hercegovinën, Bullgarinë, Kroacinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Poloninë, Rumaninë, Serbinë, Spanjën, Austrinë, Francën, Anglinë, Kinën, Maltën, Holandën, Rusinë, Zvicrën, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqinë, për periudhën 2001-2013. Në krijimin e bazës së të dhënave për vlerësimin e modelit të gravitetit janë përdorur disa burime, si Instituti i Statistikave të Shqipërisë, Banka Botërore, United Nation Statistical Division (UNSD),

Commodity Trade (COMTRADE), ndërsa distancat midis kryeqyteteve janë marrë në http//www.mapcrow.info.

1.5 Konteksti dhe motivimi i punimit

Pengesat tradicionale të tregtisë kanë rënë ndjeshëm si rezultat i presionit në rritje brenda sistemit multilateral të tregtisë (OBT), shtimit të vrullshëm të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe politikave globale liberale. Edhe pse nuk mund të thuhet me po kaq bindje se pengesat jo-tarifore dhe administrative janë ulur në tregtinë ndërkombëtare, ajo që është krejtësisht e sigurt është që pengesat tarifore janë ulur ndjeshëm.

Shqipëria, pasi u bë pjesë e OBT në 2000, u angazhua në reduktimin e tarifave dhe barrierave të tjera tregtare, duke ofruar tregtimin e mallrave dhe shërbimeve me kushte të njëjta tregtare për kompanitë e huaja si dhe ato shqiptare. Regjimi tregtar i Shqipërisë është krejtësisht liberal, transparent dhe ofron trajtim jo diskriminues midis bizneseve vendase dhe të huaja. Regjimi tarifor i Shqipërisë është shumë i hapur. Me nënshkrimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë regjimi tarifor i Shqipërisë është bërë edhe më i hapur duke ofruar më shumë hapësira dhe lehtësi për investitorët e huaj dhe duke e bërë vendin më tërheqës në këndvështrimin investues.

Integrimi në Bashkimin Evropian është një objektiv strategjik për Shqipërinë dhe është konfirmuar si i tillë në vite. Bashkimi Evropian është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, Vendet e Bashkimit Evropian janë destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare. Në vitin 2013, eksportet me këto vende ishin rreth 76.6 përqind të eksporteve totale dhe 62.2 përqind të importeve totale. Partnerët kryesorë tregtarë brenda bllokut të Bashkimin Evropian janë Italia, Greqia, Gjermania dhe Spanja.

Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Asociim Stabilizimit (MSA) me Bashkimin Evropian në qershor 2006. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 1 Prill 2009. Pjesa tregtare e MSA–së ka hyrë në fuqi më 1 Dhjetor 2006 duke shënuar kështu edhe fillimin e detyrimeve për përafrimin e legjislacionit për pjesën tregtare. Gjithashtu, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me vendet e Evropës Qëndrore (CEFTA), në fuqi prej 26 korrik 2007, Marrëveshjen e Tregtisë të lirë me Turqinë, në fuqi prej 1 maj 2008 dhe Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA-s, në fuqi që nga janari i vitit 2012.

Marrëveshjet e tregtisë së lirë mundësojnë: 1) plotësimin e nevojave të tregut për mallra dhe shërbime, 2) reduktimin e çmimit, 3) rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, 4) që zhvillimet teknologjike të rrisin konkurrueshmërinë e mallrave vendase në tregjet ndërkombëtare, 5) reduktimin e kontrabandës, 6) ndikim të përbashkët në tregje të ndryshme dhe në kushte tarifore të ndryshme, 7) rritjen e investimeve të huaja. Marrëveshjet e tregtisë së lirë synojnë orientimin e tregtisë dhe marrëdhënieve ekonomike në drejtim të rritjes së standardit të jetesës, rritjes së punësimit, rritjes së të ardhurave reale dhe kërkesës efektive, rritjes së prodhimit dhe tregtisë së mallrave, shërbimeve dhe kapitalit, shfrytëzimit optimal të të ardhurave të brendshme dhe të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Teorikisht tregtia ndikohet nga inflacioni, niveli i të ardhurave kombëtare, kufizimet qeveritare dhe kursi i këmbimit. Një rritje e inflacionit do të thellonte deficitin e llogarisë korente duke qenë se do të rriteshin importet dhe do të zvogëloheshin eksportet. Kur niveli i të ardhurave të një vendi rritet me një normë më të lartë se sa ajo e vendeve të tjera, defiçiti i llogarisë korente pritet të thellohet duke qenë se rritja e të ardhurave nënkupton rritjen e konsumit për mallra, rrjedhimisht edhe për mallra importi. Ndërsa, një rritje e kursit të këmbimit (zhvlerësim i monedhës vendase) bën që eksportet tona të bëhen më të lira dhe importet më të shtrenjta dhe për pasojë kemi përmirësim të llogarisë korente. Për më tepër, qeveritë mund të pengojnë tregtinë duke vendosur kufizime mbi importe të llojit tarifa apo kuota. Përgjithësisht, kufizimet tregtare ndihmojnë prodhimin e një industrie në kurriz të një industrie tjetër.

Nënshkrimi i marrëveshjeve të tregtisë së lirë pati ndikim në tregtinë e Shqipërisë. Gjithsesi, roli i Bashkimit Evropian në tregtinë e Shqipërisë ka rënë në vite. Kështu, në vitet 2002-2005 vendet e Bashkimit Evropian ishin destinacioni i rreth 90 përqind të eksporteve shqiptare dhe 70-75 përqind të importeve (Ministria Ekonomisë, 2003). Me nënshkrimin e marrëveshjeve, kryesisht ato me vendet CEFTA dhe Turqinë, roli i Bashkimit Evropian në import dhe eksport ndryshoi.

Shqipëria është duke iu nënshtruar transformimeve të rëndësishme të kuadrit të saj të politikave, rregullatore dhe institucionale (Bashkimi Evropian 2010, 2011, 2012, 2013, 2014). Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, si një objektiv madhor i Shqipërisë, vendos shumë detyrime përballë Shqipërisë si dhe kërkon angazhim të madh në çdo fushë. Në përputhje me parashikimet e MSA Shqipëria është në procesin e përshtatjes së politikës

tregtare me Politikën e Përbashkët Tregtare (PPT) të Bashkimit Evropian. Ndërkohë, sipas raportit të progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2014, ka pak progres në fushën e politikës tregtare[3]. Ky konkluzion i raportit të progresit kërkon një vlerësim të kujdesshëm të ndikimit që anëtarësimi do të sjellë në politikën tregtare në periudhën afat-mesme.

Traktati i Lisbonës, 2009, e ka vendosur Politikën e Përbashkët Tregtare në një stad të ri zhvillimi, duke sjellë rritje të fushës së mbulimit të PPT. Kjo politikë në BE është kompetencë ekskluzive e Komisionit Evropian (neni 3, pika 1, e Traktati i Funksionit të Bashkimit Evropian (TFBE) dhe pritet të sjellë transformim filozofik, institucional, politikë-bërës dhe tregtar për Shqipërinë. Përshtatja me këtë politikë do të kërkojë nga Shqipëria respektimin e parimeve dhe rregullave të tregut të vetëm, përfshirë këtu ato të bashkimit doganor. Kjo përshtatje do të sjellë ndryshim në nivelin tarifor bazë dhe atë detyrues në OBT, ndryshim të koncesioneve në tregtinë e shërbimeve, marrëveshjet preferenciale të tregtisë së lirë, zbatimin e skemave preferenciale autonome, rregullave të import-eksportit etj. Të gjitha këto ndryshime mund të sjellin ndikim në strukturën e import-eksportit, ndikim i cili duhet analizuar/parashikuar. Kjo përshtatje, në kontekstin tregtar, do të thotë (i) më shumë mundësi për eksportet tona në vendet e treta[4], vende drejt të cilave Shqipëria aktualisht ka barriera tregtare, (ii) presion më i madh në importin prej këtyre vendeve, (iii) presion më i madh për administratën publike për të ndjekur ritmin dhe thellësinë e diskutimit të politikës tregtare në strukturat e BE-së.

1.6 Struktura e punimit

Ky punim përbëhet nga shtatë kapituj ku do të paraqiten vlerësime sasiore dhe cilësore për arritjen e qëllimit të përgjithshëm të këtij punimi. Ai fillon me rishikimin e literaturës (Kapitulli II) dhe variablave që janë përdorur në punime dhe kërkime të ngjashme, të cilat do të përdoren më tej në specifikimet e modelit. Rishikimi i literaturës shërben si një bazë e mirë për paraqitjen e teorisë bazë dhe metodologjisë së kërkimit (Kapitulli III). Metodologjia e kërkimit paraqet metodat më të mira të përdorura në vlerësimin e modelit të gravitetit si dhe parashtron kufizimet e tyre. Në këtë kapitull sugjerohet edhe metoda më e përshtatshme për vlerësimin e modelit të gravitetit në rastin e Shqipërisë. Analiza thellohet më pas me një

[3] Raporti i progresit të Shqipërisë, Komisioni Evropian; COM(2014)700 final; 8.10.2014, fq 60
[4] Për Bashkimin Evropian vende të treta janë të gjitha vendet jashtë bllokut prej 28 vendesh.

paraqitje të detajuar të politikës tregtare shqiptare (Kapitulli IV) duke përfshirë në të edhe analizën e import-eksportit. Ky kapitull paraqet një analizë të thelluar të ndikimit që politika tregtare shqiptare do të ketë në momentin e anëtarësimit në BE si rezultat i përputhshmërisë së plotë me PPT e BE-së. Në këtë kapitull sugjerohen edhe të gjithë hapat që duhet të ndërmarrë Shqipëria në këtë kontekst.

Modeli i gravitetit do të aplikohet në rastin e Shqipërisë duke përfshirë në këtë simulim partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, duke analizuar rezultatet e ofruara nga modeli (Kapitulli V). Kjo analizë përfshin edhe variabla të papërfshira më parë në rastin e aplikimit të modelit të gravitetit për Shqipërinë, siç është rasti i indeksit të komplementaritetit të tregtisë (TCI). Ky punim mbështetet edhe në analiza dhe vlerësime të tjera, të cilat ofrojnë rekomandime për politikën tregtare. Kapitulli vijon më tej me një analizë të detajuar të avantazhit krahasues të Shqipërisë duke synuar përfshirjen e partnerëve kryesorë tregtarë nga blloku i vendeve të Bashkimit Evropian. Kjo analizë ofron edhe konkluzione të rëndësishme për rolin e Bashkimit Evropian në tregtinë e Shqipërisë dhe shkallën e ndikimit të MSA në përmirësimin e avantazhit krahasues.

Zgjerimi i bllokut të Bashkimit Evropian me anëtarësime të vazhdueshme në vite përbën një mundësi të mirë për analiza krahasuese dhe analoge me rastin e marrë në studim. Shqipëria nuk përshkon një rrugë të panjohur, pasi Bashkimi Evropian ka patur zgjerime të vazhdueshme. Kapitulli VI jep një paraqitje të procesit të anëtarësimit të disa prej anëtarëve të fundit të BE-së, me fokus të veçantë tek Bullgaria dhe Rumania, duke inspiruar në këtë mënyrë përfundime analoge sa i takon procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ky punim përmbyllet me kapitullin VII, kapitull i cili paraqet një sintezë të gjetjeve dhe të rekomandimeve të ofruara në kapituj të veçantë të këtij punimi.

KAPITULLI II: RISHIKIM I LITERATURËS - MODELI I GRAVITETIT

2.1 Hyrje.....14
2.2 Themelet teorike të Modelit të Gravitetit.....14
2.3 Bazat Mikroekonomike të Modelit të Gravitetit.....17
2.4 Zhvillimet ekonometrike mbi vlerësimin e modelit të gravitetit.....21
2.5 Rishikim Literature.....23
2.6 Përfundime.....44

2.1 Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është analiza e flukseve tregtare të Shqipërisë dhe investigimi i efekteve që hyrja e Shqipërisë në Bashkimin Evropian do të ketë në strukturën e importeve dhe eksporteve të vendit. Një analizë e karakteristikave të tregtisë së vendit gjatë dy dekadave të fundit jepet në kapitullin V, jo vetëm për të identifikuar partnerët kryesorë tregtarë të vendit por edhe për të ngritur pritshmëri mbi potencialin tregtar të vendit dhe implikimet e mundshme që mund të ketë hyrja në BE. Për të arritur në përfundime sasiore në lidhje me këto pritshmëri, nevojitet një analizë ekonometrike, detajet teorike dhe aplikative të së cilës diskutohen në rishikimin e literaturës në këtë kapitull. Analiza e aplikimeve të modelit të gravitetit të studimeve të tjera do të përdoret për specifikimin e modelit dhe për përzgjedhjen e metodave ekonometrike të vlerësimit si dhe atë të variablave të varur e të pavarur, për këtë arsye do të fokusohemi në studime që vlerësojnë flukset tregtare të një vendi të caktuar ose të një blloku vendesh, siç është edhe rasti i këtij studimi.

Struktura e këtij kapitulli është si më poshtë. Themelet teorike të modelit të gravitetit shtrohen në seksionin 2.2. Më tej, në seksionin 2.3 diskutohen vlerësuesit e ndryshëm të këtij modeli që janë përdorur në studime të ngjashme dhe evoluimi i tyre me synim përmirësimin e performancës së modelit në aplikimet për flukset tregtare bilaterale dhe multilaterale. Aplikime nga autorë të ndryshëm të modelit të gravitetit në tregti, vlerësuesit, të dhënat, variablat e përfshirë në modele, format funksionale dhe rezultatet kryesore të vlerësimeve të tyre, diskutohen në seksionin 2.5. Seksioni 2.6 përmbledh përfundimet e këtij kapitulli.

2.2 Themelet teorike të Modelit të Gravitetit

Modeli i Gravitetit i ka rrënjët në Ligjin e Gravitetit të Isak Njutonit, sipas të cilit tërheqja midis dy trupave lidhet në mënyrë të drejtë me produktin e masës së trupave dhe të zhdrejtë me distancën midis tyre. Modeli i gravitetit është përdorur në ekonomi për të shpjeguar karakteristikat e flukseve tregtare mes një ose më shumë vendesh partnere në tregti. Në mënyrë specifike, ai paraqet marrëdhënien mes flukseve të eksportit apo të importit, masës së ekonomive së dy vendeve partnere dhe distancën midis tyre. Modeli u aplikua fillimisht nga Tinbergen (1962), Linnemann (1966) dhe zgjeruar më tej nga Isard (1975). Gjysmë shekullin e fundit modeli i gravitetit është përdorur gjerësisht në tregtinë ndërkombëtare për identifikimin e efekteve që kanë në tregti faktorë, si: gjuha e përbashkët, besimi, kufiri

doganor, liberalizimi i tregtisë, distanca gjeografike, marrëveshjet tregtare mes vendeve partnere, etj. Megjithatë, aplikimet e këtij modeli janë realizuar përgjithësisht si një analizë statike, duke mos marrë në konsideratë ndryshimet strukturore, të cilat ndikojnë në përcaktuesit e tregtisë, të tilla si: trendi i flukseve tregtare, çmimet, roli i teknologjisë, zotërimet e faktorëve, etj. Për pasojë, modeli i gravitetit është kritikuar vazhdimisht për mungesën e një baze të qëndrueshme teorike dhe mirë specifikimit ekonometrik.

Modeli i gravitetit bazohet në modelet kryesore teorike të tregtisë ndërkombëtare të cilat janë: 1) Modeli i Rikardos – i cili bazohet në diferencat teknologjike midis vendeve partnere në tregti; 2) Modeli Hecksher-Ohlin, i cili bazohet në ndryshimet mbi zotërimin e faktorëve mes vendeve partnere në tregti; 3) Teoritë moderne të tregtisë të cilat marrin në konsideratë të ardhurat rritëse të shkallës në nivel firme.

Linnemann (1966), formuloi modelin e gravitetit duke përdorur teorinë e ekuilibrit të përgjithshëm Walrasian. Për këtë, fillimisht u identifikuan faktorët që ndikojnë në tregtinë ndërkombëtare, të cilat klasifikohen në tre grupe: 1) faktorët që identifikojnë efektin total të ofertës potenciale të vendit eksportues; 2) faktorët që identifikojnë efektin total të kërkesës potenciale të vendit importues; 3) faktorët që identifikojnë rezistencën kundrejt flukseve tregtare nga një ofrues potencial drejt një blerësi potencial. Përcaktimi i efekteve nga ana e ofertës dhe kërkesës potenciale në tregtinë e një vendi lidhet në mënyrë të vazhdueshme me: 1) masën e prodhimit kombëtar të një vendi, 2) numrin e banorëve/popullsinë e një vendi; 3) nivelin e të ardhurave për frymë të vendit. Ndërsa për sa i përket faktorëve të rezistencës ndaj tregtisë, ata ndahen në dy kategori: 1) Rezistenca natyrore ndaj tregtisë e cila konsiston në tre elementë të tillë si kostot e transportit, koha e transportimit dhe horizonti ekonomik (nënkupton faktin që një vend është më shumë i informuar, më i ngjashëm në kërkesë në lidhje me një vend që e ka më afër) dhe 2) rezistenca artificiale ndaj tregtisë, e cila identifikohet kur produkte të caktuara nuk lejohen të kalojnë doganën lirisht që vërehet në formën e tarifave, burokracive në procedura etj.

Linnemann (1966) i kombinoi tre faktorët e mësipërm në një ekuacion si më poshtë:

$$X_{ij} = \beta_0 \frac{(E_i^P)^{\beta_1}(M_j^P)^{\beta_2}}{(R_{ij})^{\beta_2}} \tag{2.1}$$

Ku X_{ij} përfaqëson flukset tregtare mes vendit i dhe j, E_i^P përfaqëson totalin e ofertës potenciale, M_j^P përfaqëson totalin e kërkesës potenciale dhe R rezistencën. Nga ana tjetër E_i^P është funksion i Y – GDP, N – madhësisë së popullsisë, y – të ardhurave kombëtare për frymë.

$$E^P = \gamma_0 Y^{\gamma_1} N^{\gamma_2} y^{\gamma_3} \tag{2.2}$$

Duke qenë se y = Y/N nuk përfshihet si variabël i pavarur, ai përfshihet automatikisht në eksponentët e dy variablave të tjerë. Rrjedhimisht, ekuacioni 2.2 do të merrte formën:

$$E^P = \gamma_0' Y^{\gamma_1'} N^{\gamma_2'} \tag{2.3}$$

Po njësoj do të shprehej edhe ekuacioni i M^P:

$$M^P = \gamma_4' Y^{\gamma_3'} N^{\gamma_4'} \tag{2.4}$$

Ndërsa variabli R është zëvendësuar nga variabli D i distancës gjeografike (me pritshmëri për koeficient negativ duke qenë se rritja e distancës sjell zvogëlimin e flukseve tregtare) dhe nga variabli P i faktorit të tregtisë preferenciale (me eksponent pozitiv duke qenë se ndikon pozitivisht në rritjen e flukseve tregtare). Në përfundim ekuacioni 2.1 do të merrte formën:

$$X_{ij} = \delta_0 Y_i^{\delta_1} N_i^{-\delta_2} Y_j^{\delta_3} N_j^{-\delta_4} D_{ij}^{-\delta_5} P_{ij}^{\delta_6} \tag{2.5}$$

Ekuacioni i mësipërm tregon që eksportet kanë një elasticitet konstant në lidhje me gjithë variablat e pavarur, që do të thotë se një rritje me një përqind në GDP e vendit j do të rezultojë në një rritje prej δ_3 përqind në eksportet e vendit i. Duke logaritmuar ekuacionin (2.5) marrim formën e përgjithshme dhe tradicionale të modelit të gravitetit.

$$lnX_{ij} = \delta_0 + \delta_1 \ln(Y_i) + \delta_2 \ln(Y_j) + \delta_3 \ln(POP_i) + \delta_4 \ln(POP_j) + \delta_5 \ln(D_{ij}) + \sum \gamma_k P_{kij} + \mu_{ij} \tag{2.6}$$

Ku X_{ij} – përfaqësojnë eksportet e vendit i drejt vendit j; Y_i – GDP e vendit eksportues i; Y_j – GDP e vendit importues j; POP_i – popullsia e vendit eksportues i; POP_j – popullsia e vendit importues j; D_{ij} – distanca gjeografike midis vendit i dhe j; $\sum \gamma_k P_{kij}$ – është bashkësia e variablave dummy për barrierat tregtare artificiale ose marrëveshjet tregtare rajonale. Ato marrin vlerën 1 kur të dy vendet janë në të njëjtin bllok tregtar, k dhe 0 në të kundërt.

Variablat e të ardhurave pritet të kenë një efekt pozitiv në flukset tregtare. Në anën e ofertës një rritje në të ardhura nënkupton nivel më të lartë prodhimi të gatshëm për t'u eksportuar. Në

anën e kërkesës një rritje në të ardhura do të çojë në një rritje të importeve, duke i konsideruar gjithë faktorët e tjerë konstantë. Efekti i popullsisë në flukset tregtare është i papërcaktuar. Në njërën anë një popullsi e madhe mund të tregojë për zotërime të mëdha të burimeve, vetëplotësim të kërkesave të brendshme, më pak mbështetje në tregti dhe për pasojë efekt negativ në flukset tregtare. Nga ana tjetër një popullsi e madhe mund të promovojë ndarjen e punës dhe të krijojë mundësi për tregtimin e një varieteti të madh produktesh. Distanca pritet të ketë një efekt negativ në flukset tregtare, pasi sa më larg të ndodhen vendet nga njëra-tjetra aq më të larta janë kostot e transaksionit. Për më tepër kur merren në konsideratë të dhëna të paagreguara, sigurisht që koefiçenti i distancës do të jetë negativ dhe madhësia e tij do të rritet me rritjen e vështirësisë për të transportuar një produkt të caktuar. Efekt negativ do të kishin edhe forma të tjera të kufizimit të tregtisë, si tarifat, masat kufizuese në import, etj. Ndërsa koefiçentët para variablave binarë, që përfaqësojnë faktorë që lehtësojnë tregtimin e mallrave të tillë si lidhja e dy vendeve me anë të një kufiri doganor, apo pjesëmarrja e dy vendeve në një marrëveshje tregtare do të pritej të kishin vlerë pozitive.

Në studimet e fundit modeli i gravitetit është përdorur për të identifikuar efektet e marrëveshjeve tregtare rajonale, bashkimeve monetare, tregjeve të përbashkëta edhe nëse këto efekte rezultojnë në krijimin apo devijimin e flukseve tregtare. Përveç efekteve të politikave tregtare, me anë të modelit të gravitetit identifikohen efektet edhe të një sërë faktorëve që ndikojnë në flukset tregtare, të tillë si: efektet e kufijve natyrorë mes vendeve partnere tregtare, efektet domino, investimet e huaja direkte, rregullat e origjinës, kostot e transportit, teoria e partnerit asnjanës, të drejtat e bashkimeve tregtare dhe efektet e demokracisë, lehtësitë tregtare, cilësitë rregulluese, performanca e eksporteve si dhe efektet e veriut (pozicioni gjeografik verior përfaqëson një term që në literaturë shpesh i bashkëngjitet një zone të zhvilluar) kundrejt jugut (zona të pazhvilluara).

2.3 Bazat Mikroekonomike të Modelit të Gravitetit

Modeli i gravitetit është formuluar duke supozuar preferenca identike të llojit Cobb-Douglass të konsumatorëve në të gjitha vendet partnere në tregti, të cilat nënkuptojnë përqindje të njëjtë shpenzimesh, elasticitet të ardhurash njësi, çmime konstante dhe të njëjta mes gjithë vendeve dhe qëndron vetëm kur kemi të bëjmë me specializim të plotë në nivelin ekuilibër. Këto lloj preferencash nuk marrin në konsideratë intensitetin e përdorimit të faktorëve në

prodhimin e mallrave, barazimin e çmimit të faktorëve në të gjitha vendet si dhe ndryshimet në zotërimin e faktorëve midis vendeve, si motivet bazë të krijimit të tregtisë. Megjithatë, nëse diferencat në zotërimin e faktorëve janë në mënyrë të mjaftueshme të mëdha mund të kemi specializim të plotë në prodhim.

Anderson (1979) supozoi specializim të plotë në prodhim dhe se mallrat finale të tregtuara ndërkombëtarisht diferencohen në vendin e origjinës dhe supozohen zëvendësues të plotë të njëri-tjetrit, gjë që nënkupton se konsumi total i secilit vend përbëhet nga një pjesë e mallrave të importuara (pra të prodhuara nga vendet e tjera) dhe një pjesë e mallrave të prodhuara në vend. Gjithashtu, supozohet se konsumatorët e vendeve partnere në tregti kanë preferenca identike dhe homotetike, ndërkohë që tregtia midis këtyre vendeve nuk ka barriera tregtare. Modeli ndërtohet duke marrë në konsideratë dy vende i dhe j dhe dy produkte të diferencuara në prodhim në vendin e origjinës. Preferencat e konsumatorëve për mallra vendase apo të importit paraqiten nëpërmjet funksionit të dobisë me elasticitet konstant të zëvendësimit (CES), i cili është një formë e funksionit Cobb-Douglass.

$$U(X_{ij}, X_{jj}) = \{[(\sum_{i=1}^{n} X_{ij}^{\rho_j})^{1/\rho_j}]^{\sigma_j} + X_{jj}^{\sigma_j}\}^{1/\sigma_j} \qquad \text{për } i = 1...n \text{ dhe } i \neq j \qquad (2.7)$$

Ku: X_{jj} përfaqëson sasinë e mallrave të prodhuar në vendin j dhe të kërkuara prej konsumatorëve të vendit j; X_{ij} përfaqëson sasinë e mallrave të prodhuara në vendin i dhe të kërkuara prej konsumatorëve të vendit j; $\sigma_j = (\mu_j - 1)/\mu_j$ dhe μ_j përfaqëson elasticitetin konstant të zëvendësimit mes mallrave vendase dhe atyre të importuara në vendin j; $\rho_j = (\delta_j - 1)/\delta_j$ dhe δ_j përfaqëson elasticitetin konstant të zëvendësimit mes importeve në vendin j.

Duke supozuar se çmimet janë të normalizuara në 1 (P_i, P_j=1 për i, j dy të mirat e prodhuara) dhe se të ardhurat e vendit i janë Y_i dhe të vendit j Y_j, zgjidhet problemi i maksimizimit të dobisë konsumatore në mënyrë që të identifikohet kërkesa për eksporte (ose importe) për një rang të gjerë mallrash vendase dhe të huaja. Kështu eksportet e vendit i mund të llogariten si $X_{ij}=\alpha_i Y_j$, ku α_i përfaqëson prirje marxhinale të vendit j për të importuar mallra nga vendi i; Y_j përfaqëson nivelin e të ardhurave në vendin j. Duke supozuar se gjithë të ardhurat do të shkojnë për blerjen e mallrave, të ardhurat do të barazojnë shitjet, pra do të jemi në nivel ekuilibër. Për pasojë, nëse $X_{ij}=\alpha_i Y_j$,të ardhurat e vendit i do të barazojnë shumën e blerjeve të konsumatorëve vendas dhe blerjeve të konsumatorëve të vendit j. Kështu:

$$Y_i = \alpha_i Y_i + \alpha_i Y_j = \alpha_i Y_b \quad (2.8)$$

ku Y_b përfaqëson të ardhurat në nivel botëror, përftuar si shumë e të ardhurave të vendit i dhe vendit j.

Duke qenë se kemi të bëjmë me preferenca identike dhe homotetike, pritet që prirja marxhinale për importe dhe konsum mallrash të vendit i të barazojë pjesën e të ardhurave të vendit i në të ardhurat botërore:

$$X_{ij} = \frac{Y_i Y_j}{Y_b} \quad (2.9)$$

Ekuacioni i mësipërm shpreh formën më të thjeshtë të modelit të gravitetit sipas të cilit flusket tregtare të dyanshme ndikohen pozitivisht prej të ardhurave të vendeve partnere dhe negativisht prej nivelit të të ardhurave botërore. Duke logaritmuar ekuacionin (2.9) marrim:

$$\ln(X_{ij}) = -\ln(Y_b) + \ln(Y_j) + \ln(Y_i) \quad (2.10)$$

Megjithatë, pjesa më e madhe këtyre supozimeve nuk janë realiste në kushtet kur globalizimi imponon që prodhuesit të mos synojnë vetëm konsumatorët vendas, por edhe më gjerë në nivel botëror. Për pasojë kostot e tregtisë nuk janë më të neglizhueshme. Nën këtë kontekst Anderson dhe van Wincoop (2003) zhvilluan një model të ekuilibrit të përgjithshëm ndërkombëtar, i cili merr në konsideratë kostot ekzogjene të tregtisë së dyanshme, të tilla si kostot e transaksionit dhe kostot doganore, duke zgjeruar modelin e thjeshtë të gravitetit. Duke qenë se teorikisht kostot e transaksionit ndikojnë negativisht në flukset e dyanshme tregtare ato shtohen në ekuacionin (2.9) si kosto të transaksionit, T_{ij}. Për më tepër:

$$X_{ij} = \frac{Y_i Y_j}{Y_b} [\frac{T_{ij}}{P_i P_j}]^{1-\delta} \quad (2.11)$$

Ku δ >1 përfaqëson elasticitetin e zëvendësimit midis mallrave; P_i dhe P_j janë indekset e çmimit për vendin i dhe j përkatësisht.

$$P_i^{1-\delta} = \sum_i P_j^{1-\delta} \theta_j T_{ij}^{1-\delta} C_i \quad (2.12)$$

$$P_j^{1-\delta} = \sum_j P_i^{1-\delta} \theta_i T_{ij}^{1-\delta} C_j \quad (2.13)$$

ku θ_j dhe θ_i përfaqësojnë pjesën që zënë të ardhurat e vendit j dhe i në të ardhurat botërore, përkatësisht; P_i përfaqëson rezistencën e shumanshme nga jashtë, e cila konsiston në shumatoren e të gjithë kostove të dyanshme tregtare (T_{ij}) të peshuara prej vendit të destinacionit j; P_j përfaqëson rezistencën e shumanshme nga brenda, e cila konsiston në

shumatoren e të gjitha kostove të dyanshme tregtare (T_{ji}) të peshuara prej vendit të origjinës i. Më tej supozohet se kostot e tregtisë janë simetrike, që do të thotë se $T_{ij}= T_{ji}$, duke në nënkuptuar që edhe indekset e çmimeve për secilin prej vendeve partnere në tregti do të jenë të barabarta. Si variabla *proxy* për kostot tregtare T_{ij} përdoren barrierat doganore dhe distanca fizike mes vendeve partnere në tregti.

$$T_{ij} = b_{ij}\beta d_{ij} \tag{2.14}$$

ku b_{ij} përfaqëson variablat që lidhen me barrierat doganore; d_{ij} përfaqëson distancën fizike mes vendit i dhe j, dhe β përfaqëson elasticitetin e distancës fizike mes vendit i dhe j.

Matja e variablit të rezistencës së shumanshme ndaj tregtisë përbën një prej sfidave të teorisë së modelit të gravitetit, por edhe të vlerësimit empirik. Kjo vjen si pasojë e specifikimit jo të plotë të funksionit të kostove të tregtisë, mospërfshirjes së kostove të pavëzhguara, por të rëndësishme, si dhe faktit që kostot tregtare të dyanshme në realitet janë përgjithësisht jo-simetrike (duke qenë se jo gjithmonë partnerët tregtarë vendosin të njëjtat tarifa tregtare). Distanca është konsideruar përgjithësisht një variabël i mirë *proxy* për rezistencën e shumanshme ndaj tregtisë duke qenë se përcakton kohën që mallrat kalojnë në tranzit, kostot e transaksionit. Sa më e madhe të jetë distanca, aq më i gjatë pritet të jetë tranziti, aq më shumë kufij doganorë kalohen, aq më të larta kostot e transaksionit, aq më të mëdha diferencat kulturore (për shembull të shprehura në përdorimin e së njëjtës gjuhë ose jo, kulturën e negocimit mbi blerjet, etj.).

Anderson dhe van Wincoop (2004) i përkufizuan kostot tregtare si kostot që lidhen me bërjen disponibël të një produkti tek përdoruesi final, pa përfshirë këtu kostot marxhinale të prodhimit. Ato përfshijnë kostot e transportit, barrierat politike, kostot që lidhen me zbatimin e kushteve kontraktore, kostot e shpërndarjes lokale, kostot që derivojnë nga përdorimi i monedhave të ndryshme, etj. Ato gjithashtu përfshijnë kostot e brendshme dhe kostot kur produkti kalon kufijtë. Këto të fundit lidhen ngushtësisht me politikën tregtare (për shembull: tarifat, kuotat, kufizimet në import apo eksport, etj.) janë shpesh më shumë se 10 përqind e të ardhurave kombëtare (Anderson dhe van Wincoop, 2004, faqe. 691). Megjithëse globalizmi solli indirekt zhdukjen e kufijve kombëtarë, në mënyrë të veçantë e vërtetuar kjo për vendet që krijojnë një bllok tregtar si p.sh NAFTA, CEFTA, etj., John Mccallum (1995) në një analizë të ndikimit të Kanadasë me SHBA në tregtinë midis tyre tregon se kufijtë kombëtarë vazhdojnë të jenë të rëndësishëm për tregtinë.

Kostot e kufijve, si një ndër kostot më të analizuara nga studjuesit, janë kosto që nuk sjellin asnjë përfitim. Megjithatë, efekti negativ që ato sjellin në tregti dhe mirëqenie është më i vogël se sa efekti që sjellin kostot e tjera që nuk lidhen me kufijtë (Anderson dhe van Wincoop, 2001). Ndërkohë, kostot tregtare që lidhen me kufijtë në tregtinë e shërbimeve janë më pak të vlerësuara dhe kanë vështirësi më të mëdha në matje (Riker, 2014).

Deardorff (1998) dhe Anderson dhe van Wincoop (2003) bien dakord mbi argumentin se ekuacioni i gravitetit nuk provon vlefshmërinë e një teorie apo të një tjetre, por konfirmon fakte të jetës, dhe në ditët e sotme përbën një mjet të aprovuar gjerësisht dhe të testuar empirikisht për testimin formal të teorive të tregtisë dhe vënien e tyre përballë realitetit.

2.4 Zhvillimet ekonometrike mbi vlerësimin e modelit të gravitetit

Flukset tregtare janë analizuar duke përdorur kryesisht modele simulimi, të cilat ri-aplikojnë fenomenin dhe efektet e tij, apo modele ekonometrike, të cilat tentojnë të parashikojnë duke u bazuar në performancën e shkuar dhe aktuale. Modelet e simulimit marrin në konsideratë strukturën bazë të flukseve tregtare, i përgjigjen inputeve dhe vlerësojnë efektet potenciale të flukseve tregtare. Modelet e input/outputit dhe modelet e ekuilibrit të përgjithshëm, bëjnë të mundur llogaritjen e prurjeve tregtare në mënyrë endogjene, si dhe përfshirjen në model të kostove të transportit. Kritikat ndaj këtyre modeleve qëndrojnë në faktin se modeli kërkon përzgjedhjen e një sërë parametrave dhe jo vlerësimin e tyre dhe në këtë rast karakteristikat statistikore të rezultateve janë të panjohura. Për më tepër, këto kritika lidhen me bazën e dobët ekonometrike të modeleve të ekuilibrit të përgjithshëm. Megjithatë, kombinimi i këtyre modeleve me modele ekonometrike do të çonte në rezultate më të mira. Modelet ekonometrike përqëndrohen në specifikimet e modelit të gravitetit, sipas të cilit flukset tregtare varen nga madhësia e ekonomive të cilat tregtojnë dhe distanca midis tyre. Në mënyrë më specifike, tregtimi i mallrave midis dy vendeve shprehet si funksion i karakteristikave të vendit origjinë dhe vendit të huaj si dhe të disa treguesve të rezistencës kundrejt njëri-tjetrit. Këto modele vlerësohen të kenë shpjegueshmëri të lartë statistikore dhe të jenë robuste.

Tradicionalisht, për të vlerësuar modelin e gravitetit janë përdorur të dhëna ndërseksionale dhe metoda OLS, e cila nuk merr parasysh dimensionin hapsinor dhe kohor të të dhënave. Për këtë dhe të tjera kufizime të këtij vlerësuesi, studimet e fundit tregojnë se supozimet e

implementimit të tij nuk janë konsistente me modelin teorik të gravitetit. Sipas Gomez-Herrera (2012), vlerësimi me OLS i modelit të gravitetit bën të pamundur përdorimin e logaritmit të eksporteve në rastin kur flukset e eksporteve janë zero. Në këto raste është përdorur gjerësisht censurimi apo rregullimi i të dhënave, gjë që çon në humbje të informacionit, në variabla të matur me gabime, e për pasojë zvogëlim të efiçencës dhe përftimin e koefiçentëve të zhvendosur.

Studime të mëtejshme marrin në konsideratë endogjenitetin e kostove të transportit dhe barrierave institucionale. Kostot e tregtisë së dyanshme midis dy vendeve, përveç se varen nga kostot e tregtisë mes njëri-tjetrit, varen edhe nga kostot e tregtisë me pjesën tjetër të partnerëve tregtarë në rajon. Këto lloj kostosh konsiderohen si rezistenca e shumanshme ndaj tregtisë. Për të zgjidhur problemet e endogjenitetit apo rezistencës së shumanshme, përgjithësisht modeli i gravitetit është vlerësuar duke përdorur të dhëna panel për periudha të paktën 5 vjeçare. Vlerësimet me anë të të dhënave panel, supozojnë në rastin e efekteve fikse ekzistencën e një komponenti të heterogjenitetit të pavëzhguar, i cili është konstant në lidhje me kohën, por që ndikon në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme. Ndërsa në rastin e efekteve të rastit supozohet se komponenti i heterogjenitetit të pavëzhguar është ekzogjen. Modeli i efekteve të rastit është më efiçent krahasuar me atë të efekteve fikse nëse mes efekteve individuale dhe variablit të varur nuk ka korrelacion, pra kur supozimi i ekzogjenetit është i vlefshëm.

Vlerësimi me të dhëna panel me efekte fikse bën të mundur futjen e një numri të madh variablash dummy, gjë që përveç pasurimit të modelit shkakton humbjen e shkallëve të lirisë. Ndërsa vlerësimi i paneleve me efekte të rastit mund të japë vlerësime jokonsistente nëse variablat shpjegues janë të korreluar me heterogjenitetin e pavëzhguar. Rrjedhimisht, Metoda e Momenteve e Përgjithësuar (GMM) konsiderohet si metoda më e mirë për vlerësimin e modelit të gravitetit. Metoda GMM paraqitet të ketë përparësi kundrejt të tjerave duke qenë se adreson problemet që dalin në vlerësimin me panel me efekte fikse, të tilla si humbja e shkallëve të lirisë, identifikimi i efekteve të të gjithë variablave të pavarur, vlerësimi për një rang të gjerë të dhënash. Mbi të gjitha GMM jep vlerësues konsistentë në kushtet e endogjenitetit, për aq kohë sa kushtet e momenteve janë të vlefshme (Chan et al. 2014).

2.5 Rishikim Literature

Qëllimi kryesor i aplikimit të modeleve të gravitetit për vende të caktuara është analizimi i tregtisë me partnerët kryesorë të një vendi të caktuar, gjë që përbënte edhe pikënisjen e modelit teorik të gravitetit të Bergstrand (1985). Mbështetur në këtë model, studime të tjera e vunë theksin mbi importet dhe eksportet e vendit. Në këndvështrimin e dizenjimit të kampionit për indiferencë statistikore, modelet e gravitetit për një vend të caktuar përzgjedhin vetëm një vend dhe partnerët e tij tregtarë si kampion, ndërkohë që jashtë këtij kampioni mbeten vendet e tjera dhe partnerët e tyre. Për pasojë, këto modele përfaqësojnë vetëm një pjesë të modelit të plotë të gravitetit, meqë vlerësohen mbi një bazë të kufizuar të dhënash.

Në dy dekadat e fundit një numër i madh autorësh kanë përdorur modelin e gravitetit për të vlerësuar potencialin tregtar, sidomos mes vendeve të Evropës Qëndrore e Lindore (CEE) me atë Perëndimore, Bashkimin Evropian, mes vendeve të EFTAs, dhe vendeve Balltike (Wang dhe Winters, 1991; Iversen, 1998; Paas, 1998, 2000; Chen dhe Wall, 1999; Egger, 2000; van Beers dhe Biessen, 1996). Ky numër i madh studimesh ka kontribuar në përmirësimin e performancës së modelit të gravitetit për analizimin e flukseve tregtare. Për shembull, Wang dhe Winters (1991) vlerësuan modele graviteti duke përdorur të dhëna mbi 76 vende që nuk bëjnë pjesë në CEE për vitet 1984-1986. Më pas Baldwin (1994) shtoi edhe vendet e CEE. Në të dy studimet qëllimi ishte analizimi i marrëdhënieve të tregtisë së jashtme mes vendeve të EFTAs dhe CEE. Autorët vlerësuan dy modele të ndryshme: afatmesëm dhe afatgjatë. Në të dy rastet ata vlerësuan potencialet tregtare të vendeve si Shqipëria, Kroacia, Çekia, Bullgaria, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Estonia, Hungaria, Lituania, Letonia, Rusia, Ukraina, Moldavia e Bjellorusia. Rezultatet e vlerësimit treguan se si vendet e CEE dhe ato Balltike, do të integroheshin në tregtinë botërore njësoj si edhe vendet e tjera (jo të CEE) dhe se në afatgjatë të ardhurat e këtyre vendeve do të afroheshin me të ardhurat e vendeve me të ardhura të ulëta të Bashkimit Evropian. Marrëdhëniet e tyre tregtare me vendet e EFTAs do të fuqizoheshin dhe madje disa prej tyre do të bëheshin partnerë kryesorë apo të rëndësishëm të këtyre vendeve. Për periudhën në shqyrtim, potenciali tregtar mes këtyre vendeve ishte në një masë të madhe i pashfrytëzuar. Hendeku luhatej mes 30 dhe 650 përqind, por modeli parashikon që në afatmesëm tregtia do të përmirësohet dhe vendet e CEE mund të arrijnë të zënë rreth 17 përqind të eksporteve të EFTA-s në gjithë Evropën. Në lidhje me faktorët përcaktues të flukseve tregtare të përfshira në model, autorët arritën në përfundimin se GDP i të dy vendeve, popullatat e tyre përkatëse, distanca e tyre dhe një

numër i madh indikatorësh të kushteve të vendeve dhe të marrëveshjeve tregtare mes tyre kanë rezultuar si të rëndësishëm.

Me qëllim analizimin e karakteristikave të tregtisë së Estonisë, Paas (2000) përdori modelin e gravitetit me të dhëna të vitit 1997 për tregtinë mes Estonisë dhe 46 vendeve me të cilat Estonia kryen 95 përqind të volumit të tregtisë së saj së jashtme. Autori vlerësoi një ekuacion për importet dhe një për eksportet. Në të dy modelet u përfshinë GDP-të e vendeve dhe distancat e tyre me Estoninë, si dhe një numër variablash binarë tregues të vendit kandidat për në BE, nëse vendi është anëtar i BE, nëse është në CIS, dhe nëse i përket Gjirit Balltik. Të dy modelet u vlerësuan me të gjithë bashkësinë e të dhënave dhe u përdor për vlerësim Metoda e Katrorëve të Peshuar (Weighted Least Squares). Rezultatet treguan se koeficienti i GDP ishte pozitiv dhe i rëndësishëm statistikisht, ndërkohë që ai i distancës është negativ dhe i rëndësishëm, siç pritej. Variablat dummy për përkatësinë në CIS dhe Balltik kanë shenjën dhe rëndësinë e pritur statistikore, por të qenit anëtar i Bashkimit Europian apo vend kandidat për të janë dy variabla dummy që nuk kanë rezultuar statistikisht të rëndësishëm. Ky rezultat interpretohet nga autori si një mundësi që vendet me të cilat Estonia ka marrëdhëniet më të mira tregtare, do të vazhdojnë të mbeten të tilla, madje do të jetë pikërisht tregtia me këto vende që do të zhvillojë tregtinë e jashtme të Estonisë. Autori argumenton se Estonia nuk është një vend me karakteristika unike dhe përfundimet e tij mund të aplikohen edhe në analiza për vende të tjera në tranzicion.

Christie (2002) përdori modelin e gravitetit për të analizuar faktorët përcaktues të flukseve tregtare mes vendeve të OECD dhe atyre në tranzicion. Autori jo vetëm vlerësoi efektet e faktorëve të përzgjedhur si shpjegues, por projektoi edhe flukset hyrëse dhe dalëse të vendeve të Europës Juglindore bazuar në vlera të parashikuara për GDP dhe anëtarësinë e këtyre vendeve në institucione të ndryshme. Veç flukseve tregtare që u përdorën si variabla të varur, bashkësia e variablave të pavarur përmbante GDP në terma të PPP ose GDP nominale, distancën gjeografike ose kohën e transportit si një variabël *proxy* për këtë distancë, si dhe variabla binarë për përkatësinë në institucione të ndryshme. Ndryshe nga studimet e tjera, rezultatet e këtij studimi vunë në pah karakteristika të pazakonta të flukseve të tregtisë së vendeve të Evropës Juglindore, të cilët karakterizohen nga flukse në vlera ekstremisht të larta ose të ulëta. Bazuar në këto përfundime, autori rekomandon që Evropa Juglindore në këndvështrimin e flukseve agregate të tregtisë të mos konsiderohet si një rajon.

Martínez-Zarzoso dhe Nowak-Lehmann (2003) aplikuan modelin e gravitetit për të vlerësuar potencialet tregtare mes vendeve të Mercosur dhe BE dhe efektet e marrëveshjeve mes tyre. Të dhënat e tyre i përkasin 20 vendeve, 15 prej të cilave janë vende të BE, 4 vende të Mercosur dhe Kilin, për periudhën 1988 – 1996. Të dhënat përbëjnë një panel të pabalancuar që përfshin në total 3,048 vëzhgime. Egger (2000) argumenton se një model me efekte të rastit do të ishte më i përshtatshëm për vlerësimin e flukseve tregtare për zgjedhje të rastësishme të partnerëve nga gjithë popullata e partnerëve, por nga ana tjeter një model me efekte fikse pritet të jetë më i përshtatshëm kur përzgjedhja e vendeve që do të përfshihen në analizë është bërë jo rastësisht. Megjithëse argumenti i Egger favorizon modelin me efekte fikse për rastin e Martínez-Zarzoso dhe Nowak-Lehmann, autorët kanë ndjekur rigorozisht proçedurën ekonometrike dhe kanë testuar se cili prej modeleve u përshtatet më mirë të dhënave të tyre. Për qëllime krahasimi, autorët vlerësojnë disa modele dhe përdorin disa vlerësues duke nisur që nga OLS, regresionin mbi mesataret ndërseksionale për të dhënat e bashkuara, si dhe efektet fikse, efektet e rastit dhe modelin dinamik për të dhënat panel. Rezultatet e testeve japin evidenca në favor të vlerësimit panel si një proçedurë superiore krahasuar me OLS, dhe në veçanti për vlerësimin me efekte fikse, siç pritej.

Rezultatet tregojnë se të ardhurat e të dy partnerëve kanë efekt pozitiv dhe të rëndësishëm, madje elasticiteti i të ardhurave është shumë pranë njëshit. Popullsia e vendit eksportues ka efekt të madh negativ në eksporte, ndërsa popullsia e importuesit ka efekt të madh pozitiv mbi eksportet. Autorët kontribuojnë në përmirësimin e ekuacionit të gravitetit duke përfshirë në të një sërë variablash të tjerë që lidhen me infrastrukturën, diferencat në të ardhura dhe kursin e këmbimit. Rezultatet tregojnë se variablat kanë shenjat dhe rëndësinë e pritur statistikore, me përjashtim të infrastrukturës së vendit importues.

Një drejtim tjetër kërkimor, që ka kontribuar në evoluimin e modelit të gravitetit dhe aplikimit të tij empirik, ka qenë interesi për matjen e efekteve për diversifikimin apo ndryshimet në flukset tregtare që mund të ketë për një vend anëtarësimi në institucione tregtare apo nënshkrimi i marrëveshjeve të ndryshme tregtare si për shembull marrëveshjet preferenciale (PTA) apo rajonale (RTA). Efektet e këtyre anëtarësimeve janë vlerësuar nëpërmjet përfshirjes në model të variablave dummy. Për shembull, Soloaga dhe Winters (2001) vlerësuan efektet e anëtarësimit në PTA në flukset tregtare bilaterale në tregtinë brenda bllokut, importet dhe eksportet totale me anë të aplikimit të një modeli graviteti të modifikuar, i cili shton shumën e tri termave në ekuacionin standart të gravitetit. Termi i parë

është prodhimi i variablave dummy që tregojnë anëtarësi në PTA të dy vendeve partnere dhe përfaqëson anëtarësinë e përbashkët në PTA dhe modeli i Soloaga dhe Winterns merr në konsideratë 9 marrëveshje të tilla. Koeficienti përballë këtij termi mat efektin e të qenit në të njëjtin bllok/marrëveshje dhe pritet, që këto marrëveshje të nxisin tregtinë mes vendeve anëtare, pra të ketë shenjë pozitive.

Variabli i dytë merr vlerën 1 nëse vendi është anëtar i njërës prej marrëveshjeve dhe parametri para tij bën dallimin mes efekteve të liberalizimit jo-preferencial të tregtisë kundrejt efektit të liberalizimit preferencial, sipas marrëveshjes preferenciale në të cilën bën pjesë vendi. Nën të njëjtin arsyetim, variabli i fundit dummy merr vlerën 1 nëse vendi partner është në bllokun preferencial. Shuma e të tri koeficientëve të këtyre variablave mat efektin në tregti nëse të dy vendet janë pjesë e të njëjtit bllok. Soloaga dhe Winters përdorën të dhëna vjetore mbi importet për 58 vende për periudhën 1980-96. Rezultatet treguan se PTA nuk ndikon në mënyrë statistikisht të rëndësishme në rritjen e flukseve tregtare dhe ka evidencë për diversifikimin e tregtisë së BE dhe EFTA dhe të anëtarëve të tyre.

Adams et al. (2003) aplikuan një model të ngjashëm me atë të Soloaga dhe Winters (2001) mbi të dhëna të përditësuara me qëllim analizimin e impaktit të provizioneve jo-tregtare në PTA. Zgjedhja e tyre përfshinte 116 vende për një periudhë kohore prej 28 vitesh nga 1970 deri në 1997. Autorët arritën në përfundimin se nga bashkësia prej 18 PTA që u morën në shqyrtim, 12 prej tyre, përfshirë EU, NAFTA dhe MERCOSOUR, kanë ndikuar pozitivisht në shkëmbimet tregtare të vendeve jo-anëtare, ndërsa efekti që ato kanë patur në tregtinë mes anëtarëve është më i ulët. De Rosa (2007) analizoi gjetjet e studimit të mësipërm dhe, me qëllim gjetjen e evidencave pro apo kundër tyre, përdori një version tjetër të modelit të gravitetit të propozuar nga Rose (2002), në të cilin u përfshinë variablat binarë të përdorur në studimin e Soloaga dhe Winters (2001) për anëtarësinë në PTA. Të dhënat e këtij studimi përfshinë edhe vitet 1998 e 1999 dhe 20 PTA. Në lidhje me përfundimet e këtij studimi është e rëndësishme të theksohet se megjithëse aplikimi i metodologjisë empirike të studimit të Adams et al. u konsiderua të ishte korrekt, rezultatet treguan se shumica e PTA-ve nxitnin tregtinë, një përfundim i kundërt me ato të studimit të Adams et al. (2003).

Bazuar në specifikimet dhe aplikimet e mësipërme të modelit të gravitetit, Srinivasan dhe Archana (2009) aplikuan modelin e gravitetit për të analizuar importet dhe eksportet e Indisë me partnerët e saj tregtarë në botë dhe për të investiguar impaktin që marrëveshjet tregtare të

Indisë dhe partnerëve të saj kanë në to. Të dhënat e tyre përmbanin flukset tregtare bilaterale mes Indisë dhe 189 vendeve partnere të saj për periudhën 1981-2006 dhe 21 PTA. Modeli i vlerësuar për eksportet ishte si më poshtë:

$$lnX_{jt} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln(GDP_{jt}) + \alpha_2 \ln(POP_{jt}) + \alpha_3 \ln(DIST_j) + \alpha_4 \ln(TR_{jt}) + \alpha_5 \mathrm{RER}_{jt} + \alpha_6 \mathrm{Lang}_{ij} + \alpha_7 \mathrm{D(t)} + \sum \beta_k P_{kjt} + \sum m_k P_{kit} + \varepsilon_{jt} \quad (2.15)$$

ku GDP_{jt} është GDP e vendit *j* në vitin *t*; Pop_{jt} është popullata e vendit *j* në vitin *t*; $Distance_j$ është distanca mesatare mes porteve më të mëdhenj të Indisë dhe vendit *j*; TR_{jt} është tarifa mesatare efektive e importit e vendit *j;* RER_{jt} është kursi real i këmbimit të vendit *j*, $Lang_j$ është një masë e ngjashmërisë së gjuhës mes Indisë dhe vendit *j*; *D(t)* është variabël dummy për kohën, që merr vlerën 1 për të gjithë vëzhgimet në vitin t; Pk_{jt} është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi *j* është anëtar i PTA-së së *k*-të në vitin *t*; P_{kit} është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse India është anëtare e PTA-së së *k*-të në vitin *t*; dhe ε_{jt} është termi i gabimit të rastit me shpërndarje normale identike dhe të pavarur me mesatare zero dhe variancë konstante.

Modeli u vlerësua me OLS, efekte fikse, efekte të rastit dhe Tobit. Testi i Hausmanit u përdor për të zgjedhur mes modelit me efekte fikse dhe të rastit dhe rezultatet e testit japin evidencë në favor të modelit me efekte të rastit. Modelet u vlerësuan me variabël të varur importet, eksportet dhe tregtinë totale dhe shenjat dhe rëndësia statistikore e koeficientëve përputhen me pritshmëritë. Distanca, GDP, popullata, tarifat dhe kursi i këmbimit kanë shenjat e pritura dhe janë statistikisht të rëndësishëm, ndërsa variabli i ngjashmërisë së gjuhës është i rëndësishëmvetëm në modelin OLS. Variabli dummy për kohën është gjithashtu i rëndësishëm.

Në lidhje me efektet e PTA-ve mbi tregtinë, rezultatet tregojnë se në modelet e eksportit tri prej PTA-ve në të cilat vendet partnere janë anëtare, dy ndikojnë në diversifikimin e tregtisë. Koeficientët e tregtisë brenda bllokut janë negative dhe statistikisht të rëndësishëm për marrëveshjen SAFTA dhe marrëveshjen e Bangkokut në regresionin OLS, ndërsa koeficienti i BIMSTEC është negativ dhe i rëndësishëm në modelin me efekte fikse, të rastit dhe Tobit, gjë që po ashtu tregon efekt në diversifikimin e tregtisë. Rëndësia e përbashkët e këtyre koeficientëve të PTA-ve tregon se India do të përfitonte më shumë prej marrëveshjeve multilaterale jo-preferenciale. Në modelin për flukset tregtare totale, vetëm BIMSTEC ka

efekt nxitës në tregtinë brenda bllokut ndërsa SAFTA dhe Marrëveshja e Bangkokut kanë efekt diversifikues në tregti. Nga studimet e mësipërme mund të arrihet në përfundimin se modelet e gravitetit të aplikuar në vende të ndryshme kanë dhënë rezultate të paqarta mbi efektin e marrëveshjeve tregtare në flukset tregtare bilaterale. Meqë shumica e modeleve kanë specifikim të ngjashëm dhe vlerësuesit e përdorur janë të njëjtë, kjo mungesë uniformiteti mund t'i atribuohet kontekstit të vendeve dhe të arrihet në përfundimin se janë faktorët kontekstualë ata që ndikojnë në efektet që priten të kenë PTA-të.

Studime të tjera janë bazuar në zgjerime e përmirësime të modelit të gravitetit me anë të përfshirjes në të të variablave indikatorë të ngjarjeve të ndryshme, dhe pothuajse çdo aplikim përfshin variabla të tillë. Një tjetër aplikim i modelit të gravitetit është aplikimi i tij për të dhëna të disagreguara. Hemkamon (2007) nëpërmjet modelit të gravitetit analizoi përcaktuesit e prurjeve tregtare të dyanshme mes vendeve të ASEAN[5], në mënyrë që të identifikohet nëse ky bllok tregtar ka qenë i suksesshëm. Ai përcaktoi efektin e bllokut tregtar si për tregtinë në total ashtu edhe për sektorë të veçantë të pa agreguar duke përdorur modelin tradicional të gravitetit si dhe atë të zgjeruar, përcaktuar në ekuacionet (2.16) dhe (2.17). Për vlerësimin e modeleve është përdorur metoda OLS. Zgjedhja është relativisht e madhe, kështu që mund të merren rezultate të qëndrueshme. Regresionet me të dhëna ndërseksionale janë vlerësuar individualisht për vitin 1982, 1987, 1992, 1997, 2002 dhe 2005 për rastin e modelit të agreguar dhe 1987, 1992 dhe 1997 për rastin e modelit të paagreguar. Në mënyrë që të identifikohet rëndësia e kostove të transaksionit për secilën industri më vete modeli disagregohet për 34 sektorë manifakture dhe jo-manifakture.

$$lnX_{ij} = \alpha + \beta_1 \ln(GDP_i) + \beta_2 \ln(GDP_j) + \beta_3 \ln(POP_i) + \beta_4 \ln(POP_j) + \beta_5 \ln(DIST_{ij}) + \beta_6 \ln\left(D_{ADJACENT_{ij}}\right) + \sum \gamma_k D_{kij} + \mu_{ij} \quad (2.16)$$

Ku X_{ij} – përfaqësojnë eksportet e vendit i drejt vendit j; GDP_i – GDP e vendit eksportues i; GDP_j – GDP e vendit importues j; POP_i – popullsia e vendit eksportues i; POP_j – popullsia e vendit importues j; $DIST_{ij}$ – distanca gjeografike midis vendit i dhe j; $D_{ADJACENT_{ij}}$ – variablat dummy, të cilat marrin vlerën 1 ku vendi i dhe j janë fqinjë me njërit tjetrin dhe 0 në të kundërt; $\sum \gamma_k D_{kij}$ është bashkësia e variablave dummy për barrierat tregtare artificiale ose

[5] Brunei, Darussalam, Cambodia, Indonesia, Laos, Malaysia, Myanmar, Filipinet, Singapori, Tailanda dhe Vietnami

marrëveshjet tregtare rajonale. Ato marrin vlerën 1 kur të dy vendet janë në të njëjtin bllok tregtar k dhe 0 në të kundërt.

Modeli i zgjeruar përfshin "ngjashmërinë" e vendit importues dhe eksportues nga bota dhe paraqitet në ekuacionin (2.17). Ky variabël matet si mesatare e distancave të peshuara midis partnerëve tregtarë, ku pesha është niveli i të ardhurave. Ky variabël ka rëndësi pasi mat alternativat e çdo vendi për importe.

$$lnX_{ij} = \alpha + \beta_1 \ln(GDP_i) + \beta_2 \ln(GDP_j) + \beta_3 \ln(POP_i) + \beta_4 \ln(POP_j) + \beta_5 \ln(DIST_{ij}) + \beta_6 \ln(REM_i) + \beta_7 \ln(REM_j) + \beta_8 \ln\left(D_{ADJACENT_{ij}}\right) + \beta_9 \ln\left(D_{LANG_j}\right) + \beta_{10} \ln\left(D_{COLONIAL_{ij}}\right) + \sum \gamma D_{ijr} + \sum \gamma^{EX} D_{ijr}^{EX} + \sum \gamma^{IM} D_{ijr}^{IM} + \mu_{ij} \quad (2.17)$$

ku $REM_i = \sum_j w_j D_{ij}$ dhe $w_j = \frac{GDP_j}{\sum_j Y_i}$ për çdo i≠j, dhe REM_i – përfaqëson largësinë e vendit i dhe REM_j – përfaqëson largësinë e vendit importues j; D_{ijr} – merr vlerën 1 nëse të dy vendet janë anëtarë të rajonit r dhe është variabël që mbështet krijimin e tregtisë, D_{ijr}^{EX} – merr vlerën 1 nëse vetëm vendi eksportues i është anëtar i rajonit r dhe D_{ijr}^{IM} - merr vlerën 1 nëse vetëm vendi importues j është anëtar i rajonit r. Dy variablat e fundit identifikojnë nëse pjesëmarrja në një bllok tregtar ka mundësuar devijim të tregtisë apo zgjerim tregtar brenda bllokut; D_{LANG_j} – merr vlerën 1 për vendet që kanë të njëjtën gjuhë zyrtare dhe 0 për të anasjelltën; $D_{COLONIAL_{ij}}$ – merr vlerën 1 në rastin kur vendi i ka qënë i kolonizuar nga vendi j.

Efekti i GDP-së së vendit eksportues dhe atij importues rezultoi pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm. Koefiçenti negativ i popullsisë mbështet idenë se sa më e madhe popullsia aq më e lehtë është për një vend që të arrijë efiçencën dhe për pasojë është më pak i motivuar të shkojë drejt angazhimit në marrëdhënie tregtare. Distanca u vlerësua të ketë efekt negativ dhe statistikisht të rëndësishëm. Ekzistenca e një kufiri të përbashkët rrit në mënyrë statistikisht të rëndësishme flukset tregtare. Pjesëmarrja në ASEAN, EU dhe NAFTA rrit flukset tregtare brenda bllokut. Ngjashmëria e eksportuesve dhe importuesve ka efekt pozitiv në flukset tregtare bilaterale. Vlera pozitive e variablit intra-ASEAN tregon se tregtia brenda vendeve të ASEAN është e lartë dhe mundëson krijimin e tregtisë. Variabli i eksporteve extra-ASEAN (tregtia me vendet jashtë ASEAN) është pozitiv dhe statistikisht i rëndësishëm duke treguar se ekziston efekt ekspansionist. Ndërsa koefiçentët e importeve të extra-ASEAN janë

negativë dhe të rëndësishëm vetëm për periudhat 1997, 2002 dhe 2005 gjë që tregon se vendet e kanë zhvendosur aktivitetin e tyre importues nga vendet jashtë ASEAN me vendet anëtare të ASEAN. Rezultoi se të paturit të një gjuhe të përbashkët zyrtare si dhe ekzistenca e marrëdhënieve koloniale mundëson rritjen e flukseve tregtare në mënyrë statistikisht të rëndësishme.

Sohn (2005) vlerësoi ekuacionin e gravitetit me synim shpjegimin e flukseve tregtare të Koresë së Jugut duke përdorur të dhëna të disagreguara në 23 sektorë mbi flukset bilaterale mes saj dhe 30 prej partnerëve kryesorë për vitin 1995. Modeli i aplikuar u bazua në modelin e Frankel (1997), dhe përmban faktorët bazë gjeopolitikë, si distanca, kufiri i përbashkët dhe afërsia gjeografike, gjuha e përbashkët, lidhjet historike dhe blloqet tregtare rajonale, edhe pse autori argumenton se shumë prej këtyre faktorëve nuk i përshtaten rastit të Koresë dhe mund të vlejnë vetëm për dy prej partnerëve të saj tregtarë, si Japonia dhe Kina. Për këtë arsye, modeli i tyre përfundimtar përmban prodhimin e GDP-ve, prodhimin e GDP-ve për frymë, distancën si dhe një variabël për strukturën e tregtisë, TCI, dhe një variabël për APEC.

Prodhimi i GDP-ve mendohet të shërbejë si një masë e përafërt e madhësisë së ekonomive të të dy vendeve, si në lidhje me kapacitetet prodhuese edhe në lidhje me madhësinë e tregut. Prodhimi i GDP-ve për frymë është futur në model me supozimin që efekti i të ardhurave koreane në tregti varet nga niveli i të ardhurave të partnerëve tregtarë siç parashikohej nga modeli i Bergstrand (1989). Një risi e këtij studimi është përfshirja e variablit të strukturës së tregtisë i matur me anë të indeksit të komplementaritetit të tregtisë (TCI), që mat shkallën e komplementaritetit të tregtisë mes dy vendeve e që llogaritet si më poshtë:

$$TCI_{ij} = \sum_{k=1}^{K}[X_{ki} \times M_{kj}] \Big/ \sqrt{\sum_{k=1}^{K} X_{ki}^2 \times \sum_{k=1}^{K} M_{kj}^2} \qquad (2.18)$$

ku i dhe j qëndrojnë për vendin dhe partnerin e tij tregtar, i dhe $j = 1, 2, \ldots, N$; k është grupi i komoditetit, $k = 1, 2, \ldots, K$; X_{ki} përfaqëson pjesën e grupit të komoditetit k në eksportet e vendit i; dhe M_{kj} është pjesa e grupit të komoditetit k në importet e vendit j. Vlerat e këtij koeficienti variojnë nga 0 në 1, ku 0 përfaqëson një strukturë tregtie me kompetitivitet perfekt mes vendeve i dhe j, ndërsa 1 përfaqëson një strukturë tregtie me komplementaritet perfekt. Koeficienti i TCI pritet të jetë pozitiv kur volumi tregtar rritet me rritjen e komplementaritetit

të strukturës tregtare. Prania e këtij variabli në model lejon që të testohen tri hipotezat e mëposhtme:

$\beta_4 > 0$: modeli i tregtisë i Heckscher–Ohlin me tregti dominante atë ndër-industriale;

$\beta_4 < 0$: modeli me kthime rritëse me tregti dominante atë intra-industriale;

$\beta_4 = 0$: model i papërcaktuar.

Autori vlerësoi me OLS dy modele, atë bazik dhe modelin e zgjeruar me variablat TCI dhe APEC. Prodhimi i GDP-ve është variabël i rëndësishëm statistikisht dhe me shenjë pozitive në të dy modelet, ndërsa prodhimi i GDP-ve për frymë është i parëndësishëm statistikisht. Distanca ka shenjën e pritur negative dhe është e rëndësishme në të dy modelet. Madhësia e efektit të saj është më e vogël në modelin e dytë. Së fundi, të dy variablat e shtuar në modelin e dytë, TCI dhe APEC, janë të rëndësishëm dhe kanë shenjë pozitive, përfundim që konfirmon strukturën tregtare sipas modelit Heckscher–Ohlin të vendit.

Papazoglou et al. (2006) kanë vlerësuar modelin e gravitetit për periudhën 1993-2003 si dhe kanë bërë parashikime për vitin 2006 në mënyrë që të identifikohet efekti i anëtarësimit në Bashkimin Europian në tregtinë mes vendeve të anëtarësuara rishtazi dhe vendeve të tjera të BE. Modeli i gravitetit është bazuar në punimin e Bergstrand (1985) që paraqitet më poshtë:

$$X_{ij} = A_0(Y_i)^{\alpha_1}(Y_j)^{\alpha_2}(N_i)^{\alpha_3}(N_j)^{\alpha_4}(D_{ij})^{\alpha_5}(R_{ij})^{\alpha_6}u_{ij} \tag{2.19}$$

i cili duke u logaritmuar në të dy anët transformohet si më poshtë.

$$logX_{ij} = \alpha_0 + \alpha_1 logY_i + \alpha_2 logY_j + \alpha_3 logN_i + \alpha_4 logN_j + \alpha_5 logD_{ij} + \alpha_{61} ADJDM_{ij} + \alpha_{62} INTDM_{ij} + logu_{ij} \tag{2.20}$$

Modeli është vlerësuar për dy skenarë: rasti i anëtarësimit të 10 vendeve në BE dhe rasti i mos anëtarësimit të 10 vendeve në BE. Këto 10 vende janë anëtarësuar në BE në dy faza: 1) Sllloveni, Republika Çeke, Hungari dhe Poloni dhe 2) Sllovaki, Bullgari, Lituani, Sllloveni, Letoni dhe Rumani. Diferencat në parashikimet, që merren nga dy modelet, i atribuohen

anëtarësimit në BE. Në rastin e parë është vlerësuar modeli i gravitetit për 15 vendet e BE dhe partnerët kryesorë tregtarë të tyre, 26 vende[6].

Në këto modele X_{ij} përfaqëson vlerën e eksporteve nga vendi i drejt vendit j; *Yi/j* përfaqësojnë vlerën e GDP-së në vendin i dhe j përkatësisht; *Ni/j* përfaqësojnë popullatën në vendin i dhe j përkatësisht; D_{ij} përfaqëson distancën midis vendit i dhe j; *Rij* përfaqëson variablat binarë ose dummy, që tregojnë mbi kufizimet apo nxitjet e tregtisë midis vendit i dhe j; dhe u_{ij} termin e gabimit. Variabli R_{ij} i ekuacionit (2.19) përfaqësohet në ekuacionin (2.20) nga dy variabla dummy: *ADJDM* në vlerën 1 nëse vendi i lidhet me kufi doganor me vendin j dhe anasjelltas; *INTDM* merr vlerën 1 nëse vendi është anëtar i BE-së dhe anasjelltas. α_1 (rritja e GDP krijon mundësi për rritje të eksporteve), α_2 (rritja e të ardhurave rrit kërkesën për importe), α_4 (rritja e popullsisë sjell rritjen e kërkesës së brendshme për importe, pra për mallrat e vendit j), α_{61}(afërsia gjeografike dhe lidhja me një kufi doganor rrit mundësitë për flukse tregtare mes vendit i dhe j) dhe α_{62} (pjesëmarrja në bashkime tregtare rrit prirjet për tregtim) pritet të kenë shenjë pozitive. Përkundrazi, α_3 (rritja e popullsisë rrit kërkesën e brendshme dhe për pasojë zvogëlon volumin e mundshëm për eksport) dhe α_5 (rritja e distancës midis qendrave tregtare të i dhe j zvogëlon mundësitë për tregti) pritet të kenë shenjë negative.

Modeli është vlerësuar nëpërmjet *GLS me efekte të rastit me AR(1) të përbashkët* dhe *Prais-Winsten me Panel-corrected Standard Errors dhe Country-specific AR(1).* Metoda e dytë paraqitet e avantazhuar kundrejt metodës së parë pasi nuk supozon që të dhënat për çdo dy vende partnere përballen me të njëjtin nivel autokorrelacioni si dhe korrigjon për korrelacion gabimi të njëkohshëm midis vendeve partnere.

Efekti i të ardhurave dhe popullsisë është më i lartë për vendet eksportuese se sa ato importuese. 10 vendet e anëtarësuara në BE tregojnë për një rritje të gjerë të eksporteve drejt BE. Pas anëtarësimit në BE vendet në zhvillim përjetojnë shmangie të flukseve tregtare, duke u përballur me një fluks më të lartë importesh se sa eksportesh e për pasojë me rritje të defiçiteve tregtare. Thellimi i defiçitit tregtar vlerësohet të varet edhe nga fakti se sa i përafërt është niveli i të ardhurave të vendeve në zhvillim me vendet e zhvilluara të BE-së. Vendet në zhvillim të cilat kanë qenë më konkurruese në treg para anëtarësimit kanë mundur të rritin më

[6] Kanada, Kinë, Republika Çeke, Hungari, Japoni, Kore, Norvegji, Poloni, Rusi, Zvicër, Turqi dhe SHBA

shumë flukset tregtare ndaj vendeve anëtare të BE-së. Për më tepër, me anëtarësimin në BE pesha e flukseve të këtyre 10 vendeve ndaj pjesës tjetër të botës, si Amerikës së Veriut, Rusisë dhe Turqisë, si partnerë të rëndësishëm tregtarë, vjen duke rënë.

Camarero et al. (2013) përdorën modelin e gravitetit për të analizuar efektin e monedhës euro në nivel agregat dhe për secilin vend pjesëtar të EMU, si në tregtinë midis tyre ashtu edhe me vendet e tjera, duke identifikuar ekzistencën e efekteve potenciale devijuese të tregtisë. Modeli i vlerësuar paraqitet në ekuacionin (2.21):

$$EXPORTS_{ijt} = \beta_1 GDP_{it} + \beta_2 GDP_{jt} + \delta_1 RTA_{ijt} + \delta_2 EMU_{ijt} + \vartheta_{ij} + \tau_{ij} \cdot t + \varepsilon_{ijt} \quad (2.21)$$

Ku $EXPORTS_{ijt}$ përfaqëson logaritmin e flukseve të eksporteve nga vendi i drejt vendit j në terma nominalë; GDP_{it} dhe GDP_{jt} janë logaritmi i GDP-së natyror marrë nga baza e të dhënave CHELEM-CEPII; RTA_{ijt}- është 1 nëse të dyja vendet partnere në tregti kanë një marrëveshje të tregtisë së lirë në periudhën t dhe 0 në të kundërt; EMU_{ijt} është 1 nëse të dy vendet partnere në tregti janë anëtare të zonës euro në periudhën t dhe 0 në të kundërt. Kur analizohet efekti i euro në vendet e treta variabli EMU_{ijt} merr vlerën 1 nëse njëri prej vendeve të përfshira në tregti përdor euro. ϑ_{ij} përfaqëson bashkësinë e variablave dummy që marrin në konsideratë specifikat e çdo dy vendeve të përfshira në tregti si dhe karakteristikat e dyanshme të pavëzhguara dhe që janë të pandryshueshme me kalimin e kohës. Në këtë variabël përfshihet edhe distanca mes qendrave ekonomike të çdo dy vendeve të përfshira në tregti. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme që distanca të përcaktohet më vete në ekuacion. Së fundi, $\tau_{ij} \cdot t$ përfaqëson trendin kohor, i cili varion për çdo dy vende në zgjedhje.

Modeli është vlerësuar për dy panele të dhënash. Në rastin e parë, të dhënat panel janë marrë për 11 vende si Austria, Belgjika dhe Luksemburgu, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Hollanda, Portugalia dhe Spanja për periudhën 1967-2008. Kështu, formohet një panel i balancuar me 110 vëzhgime ndër-seksionale dhe 42 seri kohore duke formuar numrin total të vëzhgimeve prej 4,620. Ndërsa në rastin e dytë, krijohet një tjetër panel duke përfshirë eksportet prej vendeve të EMU drejt 15 vendeve të OECD, të cilat nuk bëjnë pjesë në EMU, dhe Kinën. Përmasat e panelit në këtë rast janë 176 vëzhgime ndër-seksionale dhe 42 seri kohore.

Duke qenë se vendet e marra në studim janë pjesë e një zone shumë të integruar, siç është Bashkimi Europian, ka probabilitet të lartë që seritë të jenë të korreluara midis tyre. Për pasojë, Camarero et al. (2013) testuan me anë të testit Pesaran mbi varësinë e të dhënave ndër-seksionale (cross-section dependence test – CD), i cili teston nën hipotezën bazë se statistika CD konvergjon drejt shpërndarjes normale. Gjithashtu, u testua për rrënjë unitare, me anë të testit të Pesaran Augmented Dickey-Fuller për të dhënat ndër-seksionale (CADF), në mënyrë që të kontrollohet njëkohësisht për rrënjë unitare dhe varësi ndër seksionale. Duke qenë se të dhënat e përdorura për të vlerësuar modelin e gravitetit shoqërohen me korrelacion mes tyre kontrollohet për varësinë midis ndër-seksioneve të prejardhur nga marrëdhënia kointegruese mes të dhënave ndër seksionale. Më tej, është testuar nëse GDP_{it}, GDP_{jt} dhe $EXPORTS_{ijt}$ janë të kointegruara duke përdorur testin Banerjee dhe Carrion-i-Silvestre. Ky test merr në konsideratë thyerjet strukturore si në përbërësin deterministik ashtu edhe në vektorin kointegrues.

Metoda OLS dhe LSDV (Least Square Dummy Variables) paraqesin vlerësime të zhvendosura dhe inkosistente në prezencën e variablave jo stacionarë dhe marrëdhënieve kointegruese. Metodat FM dhe DOLS vlerësojnë parametra për periudhën afatgjatë dhe korrigjojnë për autokorrelacion dhe endogjenitet, por nuk marrin në konsideratë varësinë ndër-seksionale të variablave. Për këtë arsye, u përdor metoda CUP duke përdorur metodologjinë e Bai et al. (2009) dhe rezultatet e Bai FM me qëllim krahasimi. Përpara se të vlerësonin koefiçentët e periudhës afatgjatë, filtruan të gjithë variablat duke nxjerrë komponentin deterministik, konstanten, trendin, thyerjen strukturore të përbashkët në konstante dhe thyerjen strukturore të përbashkët në trend. Për të identifikuar se cili prej anëtarëve të EMU ka përfituar më shumë prej adaptimit të monedhës euro dhe për të identifikuar asimetritë e mundshme, krijuan 11 nën-panele, për secilin anëtar të EMU, ku proçedura për secilin nën-panel është e njëjtë si dhe për panelin e përgjithshëm.

Rezultoi se GDP e eksportuesit dhe importuesit, marrëveshjet e tregtisë së lirë dhe adoptimi i monedhës euro ka ndikuar në rritjen e flukseve të eksporteve. GDP e importuesit ka efekt më të madh se sa GDP e eksportuesit, gjë që tregon se kërkesa ka ndikim më të madh se sa oferta në eksporte. Nuk rezultuan evidenca për ekzistencën e devijimeve të tregtisë, gjë që tregoi se adaptimi i euro nuk ka sjellë efekte negative, përveç rastit të Greqisë.

Chan et al. (2014), vlerësuan modelin e gravitetit për vendet e OECD me anë të metodës GMM, si një ndër metodat që jep koefiçentë konsistentë në kushtet e heterogjenitetit të pavëzhguar dhe endogjenitetit. Për këtë, merren në konsideratë 1,056 partnerë tregtarë dhe 33,514 vëzhgime të vendeve të OECD përgjatë viteve 1960-2005. Modeli i vlerësuar paraqitet në ekuacionin (2.22):

$$LnX_{ij} = \beta_0 + \beta_1 OneIn + \beta_2 BothIn + \beta_3 lnGDP_{it} + \beta_4 lnGDP_{jt} + \beta_5 lnGDPPOP_{it} + \beta_6 lnGDPPOP_{jt} + \beta_7 lnDist_{ij} + \beta_8 lnLand_i + \beta_9 lnLand_j + \beta_{10} CLang_{ij} + \beta_{11} CBord_{ij} + \beta_{12} Llock_i + \beta_{13} Island_i + \beta_{14} Island_j + \beta_{15} EvCol_{ij} + \beta_{16} ComCol_{ij} + \beta_{17} Muni_{ijt} + \beta_{18} Ta_{ijt} + u_{ijt} \quad (2.22)$$

OneIn – variabël dummy që merr 1 nëse njëri prej dy vendeve partnere është anëtar i OBT apo GATT; *BothIn* – variabël dummy që merr 1 nëse të dy vendet janë anëtare të OBT/GATT; $LnGDP_{it}$, $LnGDP_{jt}$ – përfaqësojnë logaritmet natyrore të GDP së vendit i dhe j përkatësisht; $LnGDPPOP_{it}$, $LnGDPPOP_{jt}$ – përfaqëson logaritmin natyror të GDP për frymë; $LnDist_{ij}$ – përfaqëson logaritmin natyror të distancës midis vendeve partnere në tregti; $LnLand_i$, $LnLand_j$ – përfaqëson logaritmin natyror të sipërfaqes së tokës së vendit i dhe j përkatësisht; $CLang_{ij}$ – vendet flasin të njëjtën gjuhë; $CBord_{ij}$ – vendet ndajnë të njëjtin kufi doganor; $Llock_i$ – variabël dummy për vende që lidhen në rrugë tokësore me njëri-tjetrin; $Island_i$, $Island_j$ – variabël dummy që merr vlerën 1 kur vendi i apo j respektivisht është një ishull; $EvCol_{ij}$ – variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi i ka kolonizuar vendin j në të shkuarën; $ComCol_{ij}$ – variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendet partnere në tregti dikur kanë patur të njëjtin kolonizues; $Muni_{ijt}$ – variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendet marrin pjesë në bashkime monetare; Ta_{ijt} – variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendet partnere në tregti kanë nënshkruar marrëveshje rajonale tregtare. Nëse pjesëmarrja në OBT/GATT do të kishte efekt pozitiv në tregti atëhere shenjat e *OneIn* dhe *BothIn* do të ishin pozitive dhe se efekti i *BothIn* do të dominonte atë të *OneIn*. Ndërsa, nëse dy variablat e sipërpërmendur do të paraqesnin efektet e krijimit të tregtisë apo devijimit të tregtisë atëherë koefiçenti para *OneIn* mund të pritej të ishte negativ dhe koefiçenti para *BothIn* sërish pozitiv.

Cruz dhe Deluna (2014) analizuan karakteristikat e tregtisë dhe vlerësuan nivelin potencial të tregtisë në Filipine duke përdorur modelin *e kufirit stokastit të gravitetit.* Për këtë përdorën të

dhëna panel për 69 partnerë tregtarë (vende nga Afrika, Azia, Europa, Amerika e Veriut dhe e Jugut dhe Oqeania) në eksportin e mallrave për periudhën 2009-2012. Nëse do të vlerësohej me OLS, potenciali i tregtisë do të matej si diferencë mes vlerave të vëzhguara dhe atyre të vlerësuara dhe OLS nxjerr vlera të qendërzuara. Ndërkohë, potenciali tregtar kërkon një proçedurë që të identifikojë vlerën maksimale të mundshme të tregtisë. Modeli i kufirit stokastit të gravitetit është një kombinim mes modelit të gravitetit dhe Modelit Stokastik të Kufirit të Funksionit të Prodhimit, i cili adreson problemet e zhvendosjes në koefiçentët e vlerësuar të modelit të gravitetit si dhe vlerëson flukset tregtare potenciale. Modeli i gravitetit i vlerësuar paraqitet në ekuacionin (2.23):

$$lnX_{ijt} = \beta_0 + \beta_1 \ln(GDP_{jt}) + \beta_2 \ln(POP_{jt}) + \beta_3 \ln(DIST_{ijt}) - u_{ijt} + \mu_{ij} \qquad (2.23)$$

X_{ijt}- përfaqëson eksportet e Filipineve (i) ndaj partnerit *j*; GDP_{jt}- GDP e vendit *j* në periudhën t si proxy për nivelin e të ardhurave; POP_{jt}- popullsia e vendit j si proxy për madhësinë e tregut; $DIST_{ijt}$- distanca gjeografike mes kryeqyteteve të vendit i dhe j matur në kilometra; u_{ijt}- term gabimi i njëanshëm që merr në konsideratë efektin e kombinuar të zhvendosjes që vjen si pasojë e kufizimeve të trashëguara në tregtinë bilaterale, i cili shkakton diferencën mes tregtisë aktuale dhe asaj potenciale; μ_{ij}- term gabimi i dyanshëm i cili përfshin efektin e variablave të papërfshirë në model si dhe kap gabimet të shpërndara në mënyrë rastësore midis vëzhgimeve; $\varepsilon_{ijt} = \mu_{ij} - u_{ijt}$ - termi i gabimit.

Modeli i efekteve të inefiçencës:

$$u_{ijt} = \delta_0 + \delta_1 APEC + \delta_2 ASEAN + \delta_3 WTO + \delta_4 Lang_j + \delta_5 Landlocked + \delta_6 CI_j + \delta_7 TF_j + \delta_8 BF_j + \delta_9 IF_j + \delta_{10} FC_j + \delta_{11} FiscalF_j + \delta_{12} LF_J + \delta_{13} MC_j + \delta_{14} FF_j + w_{ijt} \qquad (2.24)$$

ku APEC është variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi j është pjesëtar i APEC dhe 0 në të kundërt; ASEAN - variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi *j* është pjesëtar i ASEAN dhe 0 në të kundërt; OBT - variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi *j* është pjesëtar i OBT dhe 0 në të kundërt; $Lang_j$- variabël dummy që merr vlerën 1 nëse gjuha e vendit j është anglisht dhe 0 në të kundërt; $Landlocked$- variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi kufizohet me tokë dhe 0 në të kundërt; CI_j- përfaqëson kostot e importeve; TF_j- përfaqëson indeksin e lirisë për tregti të vendit *j*; BF_j- përfaqëson indeksin e lirisë për të bërë biznes të vendit j; IF_j- përfaqëson indeksin e lirisë për investime të vendit j; FC_j- përfaqëson indeksin e

lirisë prej korrupsionit të vendit j; $FiscalF_j$- përfaqëson indeksin e lirisë fiskale të vendit j; LF_J- përfaqëson indeksin e lirisë për punë të vendit j; MC_j- përfaqëson indeksin e lirisë monetare të vendit j; FF_j- përfaqëson indeksin e lirisë financiare të vendit j.

Koefiçentët e vlerësuar janë përdorur për të vlerësuar eksportet potenciale të mallrave dhe efiçencën teknike për secilin vend. Eksportet potenciale vlerësohen si niveli maksimal i eksporteve që do të arrihej në kushtet e vlerave aktuale të tregtisë dhe minimumit të mundshëm të kufizimeve ndaj tregtisë. Në këtë rast, eksportet potenciale maten duke përdorur koefiçentët e vlerësuar (u_{ijt}) në modelin e gravitetit si dhe vlerën e të dhënave aktuale të tregtisë për 4 vitet e marra në studim. Në nivelin potencial të eksporteve konsiderohet se arrihet efiçenca ekonomike. Efiçenca ekonomike ndahet në efiçencë teknike dhe efiçencë alokative. Efiçenca teknike është matur nëpërmjet formulës së performancës së eksporteve paraqitur si më poshtë:

$$TEX_{ijt} = \frac{f(Y_{ijt};\beta)\exp(\mu_{ijt}-u_{ijt})}{f(T;\beta)\exp(\mu_{ijt})} = \exp(-u_{ijt}) \qquad (2.25)$$

Nga vlerësimi i modelit të gravitetit rezultoi se flukset e eksporteve të Filipineve varen në mënyrë statistikisht të rëndësishme prej të ardhurave (pozitivisht) dhe popullsisë (pozitivisht) së vendit importues dhe distancës (negativisht) midis saj dhe vendeve partnere në tregti. Nga ana tjetër vlerësimi i modelit të efekteve të inefiçencës teknike tregon se pjesëmarrja në ASEAN, APEC dhe OBT rrit efiçencën teknike të flukseve të eksporteve filipinase. Lidhja me kufij tokësorë me partnerët tregtarë si dhe ndarja e një gjuhe të përbashkët (anglisht në këtë rast) ndikojnë pozitivisht dhe në mënyrë të rëndësishme në flukset e eksporteve. Gjithashtu, rezultoi se vetëm liria ndaj korrupsionit dhe liria për punë ndikuan në mënyrë të rëndësishme efiçencën tregtare.

Gomez-Herrera (2012) është përpjekur të identifikojë metodën më të mirë për vlerësimin empirik të modelit të gravitetit duke përdorur një zgjedhje prej 80 vendesh për periudhën 1980-2008 dhe ekuacionin (2.26):

$$lnX_{ijt} = a_1 lny_{it} + a_2 lny_{jt} + a_3 contig_{ij} + a_4 comla_{ij} + a_5 smctry_{ij} + a_6 lnd_{ij} + \gamma_{ij} + \gamma_{it} + \gamma_{jt} + ln\varepsilon_{ijt} \qquad (2.26)$$

lnX_{ijt} – përfaqëson logaritmin e volumit të eksporteve në dollarë nga vendi j në i; lny_{it} dhe lny_{jt} përfaqëson logaritmin e GDP nominale për secilin vend; $contig_{ij}$ merr vlerën 1 kur vendet lidhen me kufi doganor; $comla_{ij}$ merr vlerën 1 kur vendet flasin të njëjtën gjuhë; $smctry_{ij}$ merr vlerën 1 kur vendet në të shkuarën kanë qënë brenda të njëjtit shtet; lnd_{ij} përfaqëson distancën gjeodezike midis vendit *i* dhe *j*; γ_{ij} përfaqëson efektet fikse midis çdo dy vendeve; $\gamma_{it}\ dhe\ \gamma_{jt}$ përfaqëson karakteristikat që ndryshojnë me kalimin e kohës për importuesin dhe eksportuesin përkatësisht.

Modeli u vlerësua si me metodat lineare ashtu edhe me ato jolineare. Nga metodat lineare është përdorur OLS. U identifikua heterogjenitet i pavëzhguar tek të dhënat si dhe prezencë heteroskedasticiteti, të cilat i bëjnë vlerësuesit e OLS të zhvendosur dhe inkosistentë. Midis metodave jolineare përdorën Tobit, Probit, Heckman, Panel me Efekte Fikse, Panel me Efekte të Rastit, dhe PPML. Për të krahasuar modelet përdorën tre funksione të përshtatshmërisë, të tilla si *zhvendosjen,* MSE (*mean squared error*) dhe humbjen e gabimit absolut (*absolute error loss)*. Rezultatet e Tobit dhe OLS rezultuan të mbivlerësuara për shkak të mosmarrjes në analizë të vlerave 0 të flukseve të eksporteve për çdo dy vende. Rezultatet e marra nga metoda Heckman[7] dhe vlerësuesit panel paraqesin vlerësime që janë konsistente me literaturën si dhe korrigjojnë për vlerat zero të eksporteve. Sipas Gomez-Herrera (2012), modeli i Heckman performon më mirë në specifikimin e modelit të gravitetit në kushtet e pranisë së heteroskedasticitetit dhe pranisë së një numri të rëndësishëm të vlerave 0 të vëzhguara për flukset e eksporteve.

Rahman (2003) aplikoi modelin e gravitetit për të analizuar tregtinë bilaterale të Bangladeshit me partnerët tregtarë kryesorë të tij duke përdorur teknikat e vlerësimit të të dhënave panel. Ndryshe nga modelet e mësipërme, variabli i varur ishte shuma e importeve dhe eksporteve, ndërkohë, sa i përket variablave të pavarur u përdorën ata klasikë: GDP si një masë e madhësisë së ekonomive, diferenca në GDP për frymë të vendeve në shqyrtim dhe indekset e hapjes tregtare të vendeve, të cilët rezultuan si faktorë statistikisht të rëndësishëm. Përveç këtyre, u përfshinë faktorë shtesë që gjithashtu rezultuan të rëndësishëm dhe me efekt pozitiv si kurset e këmbimit, kërkesa totale e vendeve partnere për import dhe indeksi i hapjes së ekonomisë së vetë Bangladeshit. Në lidhje me faktorët përcaktues të importeve, autori arrin

[7] Metoda Heckman konsiston në vlerësimin me dy hapa. Fillimisht, vlerësohet me anë të Probit për të identifikuar nëse vendet tregtojnë midis tyre ose jo dhe më pas vlerat e pritura të tregtisë të kushtëzuara nga fakti që ato tregtojnë vlerësohen me anë të OLS.

në përfundimin se importet nuk ndikohen nga kursi i këmbimit, por ndikohen nga norma e inflacionit, diferencat në të ardhurat për frymë dhe hapja e vendeve që kryejnë shkëmbime tregtare mes tyre. Kostot e transportit, kufijtë dhe faktorët multilateralë të rezistencës u vlerësuan të kenë impakt negativ në tregtinë e Bangladeshit.

Më vonë, Alam et al. (2009) ngushtuan fokusin e kërkimit të mësipërm dhe përdorën modelin e gravitetit për të përshkruar flukset e importeve mes Bangladeshit dhe tetë prej vendeve partnere në tregti, me qëllim ripozicionimin e importeve në kushte më të favorshme. Për këtë, u morën në konsideratë të dhëna vjetore prej 1985-2003 për tetë prej vendeve me të cilat Bangladeshi ka marrëdhëniet tregtare më intensive, si: Kina, India, Singapori, Japonia, Hong-Kong, Kore Jugore, SHBA si dhe Malajzi. Për vlerësimin e modelit u përdorën të dhëna panel si me efekte fikse ashtu edhe me efekte të rastit, duke qënë se vlerësimi me panel identifikon marrëdhëniet individuale përgjatë kohës si dhe efektet individuale të pavëzhguara midis çdo çifti partnerësh tregtarë. Janë vlerësuar dy modele të gravitetit si më poshtë:

$$lnM_{ij} = \beta_0 + \beta_1 lnY_i + \beta_2 lnY_j + \beta_3 lnD_{ij} + \beta_4 lnPOP_i + \beta_5 lnPOP_j + u_{it} \quad (2.27)$$

$$lnM_{ij} = \beta_0 + \beta_1 lnY_i + \beta_2 lnY_j + \beta_3 lnD_{ij} + u_{it} \quad (2.28)$$

Ku M_{ij} përfaqëson flukset e importeve të Bangladeshit (i) dhe vendit partner *j*; Y_i – përfaqëson GDP e Bangladeshit; Y_j- përfaqëson GDP e vendit partner j; D_{ij} – përfaqëson distancën gjeografike midis kryeqytetit të vendit *i* dhe kryeqytetit të vendit *j*.; POP_i- përfaqëson popullsinë e Bangladeshit shprehur në milion; POP_j - përfaqëson popullsinë e vendit j shprehur në milion. Nëpërmjet testit Hausman specifikohet se modeli me efekte të rastit është më i përshtatshëm për vlerësimin e modelit të gravitetit. Si në modelin e efekteve fikse ashtu edhe atë të rastit për modelin e parë GDP e Bangladeshit nuk kishte efekt statistikisht të rëndësishëm. Ndërkohë që, në modelin e dytë ka një efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm për të dyja rastet. Ndërsa GDP e vendit partner j kishte efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në importet e Bangladeshit. Për më tepër, prej modelit të parë rezultoi se popullsia e Bangladeshit ndikonte pozitivisht dhe në mënyrë statistikisht të rëndësishme në rritjen e flukseve të importeve. Ndërsa ajo e vendit partner paraqitet me efekte të dyfishta. Së fundmi, distanca ndikon në të dyja modelet negativisht dhe efekti i saj është statistikisht i rëndësishëm.

Apostolov dhe Josheski (2013) analizuan performancën e eksporteve të Maqedonisë ndaj partnerëve të saj tregtarë. Për këtë, përdorën të dhëna për vendet e Ballkanit si Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Rumania, Sllovenia, Turqia, Serbia dhe Mali i Zi për periudhën 1993-2006. Modeli i gravitetit paraqitet në ekuacionin (2.29):

$$X_{ijt} = \beta_0 + \beta_1 X_{ijt-1} + \beta_2 Y_{it} + \beta_3 Y_{jt} + \beta_4 POP_{it} + \beta_5 POP_{jt} + \beta_6 ER_{ijt} + \gamma_j + \rho_t + u_{it} \quad (2.29)$$

Ku X_{ijt}- përfaqëson volumin e eksporteve nga vendi Maqedonia (i) () drejt vendit *j* (vendet e tjera të Ballkanit) në vitin t; X_{ijt-1}- përfaqëson volumin e eksporteve nga vendi i drejt vendit j, në vitin t-1; Y_{it}- përfaqëson GDP e vendit i në vitin t; Y_{jt}- përfaqëson GDP e vendit j në vitin t; POP_{it}- përfaqëson popullsinë e vendit i në vitin t; POP_{jt}- përfaqëson popullsinë e vendit j në vitin t; ER_{ijt}- përfaqëson kursin real të këmbimit mes vendit i dhe vendit j në vitin t; γ_j- përfaqëson efektet e vendit *j*, të cilat lejojnë për prirje të ndryshme ndaj importeve; ρ_t- përfaqëson efektet në kohë të ciklit të biznesit. Modeli është vlerësuar me anë të të dhënave panel me efekte fikse si dhe me efekte të rastit. Sa i përket vlerësimit të të dhënave panel me efekte fikse u morën në konsideratë dy modele: në rastin e parë nuk përfshihen variablat dummy, që kapin diferencat në kohë dhe midis vendeve, si dhe katër variablat instrumentalë, që marrin në konsideratë efektet e ciklit të biznesit. Në rastin e dytë përfshihen variablat dummy dhe ato instrumentalë. Të dhënat panel me efekte të rastit janë vlerësuar gjithashtu me dy metoda: 1) FGLS, duke përfshirë dhe katër variablat instrumentalë dhe 2) modeli dinamik Arellano-Bond, i cili kap inkosistencat e OLS. Nga vlerësimi i të dhënave panel me efekte fikse rezultoi se nuk kishte probleme të endogjenitetit. Nga vlerësimi i katër modeleve rezultoi se ciklet e biznesit të periudhës 1995-2006 nuk kanë qenë në favor të eksporteve të Maqedonisë. GDP e Maqedonisë ndikon negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme në eksportet maqedonase, ndërkohë që GDP e vendeve partnere ndikon pozitivisht dhe në mënyrë statistikisht të rëndësishme në eksportet maqedonase. Ndërsa, popullsia e vendeve partnere ndikon negativisht e në mënyrë statistikisht të rëndësishme në eksportet maqedonase. Kursi i këmbimit rezultoi statistikisht i parëndësishëm. Eksportet maqedonase janë të realizuara kryesisht brenda Ballkanit, duke qenë se distanca nuk është e konsiderueshme dhe ekzistojnë ngjashmëri kulturore.

Ka patur përpjekje për aplikimin e modelit të gravitetit edhe për vlerësimin e flukseve tregtare për rastin e Shqipërisë, edhe pse këto kanë qenë të limituara në numër. Për shembull, Xhepa dhe Agolli (2003) përdorën modelin e zgjeruar të gravitetit për të vlerësuar flukset tregtare hyrëse dhe dalëse mes Shqipërisë dhe 21 partnerëve tregtarë të saj për periudhën 1994 – 2002. Funksionet e specifikuar prej tyre për eksportet dhe importet janë paraqitur në ekuacionet (2.30) dhe (2.31), përkatësisht.

$$Log(X_{ijt}) = \alpha_0 + \alpha_1 \log(X_{ij,t-1}) + \alpha_2 \log(Y_{it}Y_{jt}) + \alpha_3 SIM_{ijt} + \alpha_4 logD_{ij} + \alpha_5 logN_{ijt} + \alpha_6 ER_{ijt} + \alpha_7 CMBR + \alpha_8 RBAL + \alpha_9 EU + u_{ijt} \quad (2.30)$$

$$Log(M_{ijt}) = \alpha_0 + \alpha_1 \log(M_{ij,t-1}) + \alpha_2 \log(Y_{it}Y_{jt}) + \alpha_3 SIM_{ijt} + \alpha_4 logD_{ij} + \alpha_5 logN_{ijt} + \alpha_6 ER_{ijt} + \alpha_7 CMBR + \alpha_8 RBAL + \alpha_9 EU + u_{ijt} \quad (2.31)$$

ku M_{ijt} shënon importet shqiptare nga vendi *j* në vitin t; X_{ijt} përfaqëson eksportet shqiptare drejt vendit *j* në vitin t; Y_{it} është GDP e Shqipërisë (i) në vitin t; Y_{jt} është GDP e vendit *j* në vitin t; D_{ij} është distanca në kilometra mes Shqipërisë dhe vendit j; N_{jt} është popullsia e vendit *j* në vitin t; ER_{ijt} është kursi nominal i këmbimit mes Shqipërisë dhe vendit *j* në vitin t; *CMBR* është një variabël dummy që tregon kufi të përbashkët dhe merr vlerën 1 nëse ka një kufi të përbashkët dhe 0 anasjelltas; *RBAL* është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi ndodhet në Ballkan dhe 0 anasjelltas; *EU* është një variabël dummy që merr vlerën 1 nëse vendi është anëtar i Bashkimit Europian dhe 0 anasjelltas; dhe SIM_{ijt} është një variabël që tregon ngjashmërinë në lidhje me madhësinë ekonomike (GDP) mes Shqipërisë dhe vendit j në vitin t, i llogaritur si vijon:

$$SIM_{ijt} = \log\left[1 - \left(\frac{GDP_{it}}{GDP_{it}+GDP_{jt}}\right)^2 - \left(\frac{GDP_{jt}}{GDP_{it}+GDP_{jt}}\right)^2\right] \quad (2.32)$$

Vlerat e indeksit variojnë nga 0, që interpretohet si divergjencë absolute, në 0.5, që tregon masa të njëjta të vendeve. Sa më i lartë të jetë ky indeks, aq më të ngjashëm janë vendet, dhe aq më e lartë do të jetë tregtia mes tyre. Autorët vlerësuan të dhënat e tyre me anë të tri vlerësuesve: OLS me të dhëna të bashkuara, dhe me efektet fikse e ato të rastit, dhe gjetën evidencë në favor të modelit me efekte të rastit si për ekuacionin e importeve dhe atë të eksporteve.

Rezultatet e modelit të eksporteve tregojnë se masa ekonomike ndikon pozitivisht dhe në mënyrë statistikisht të rëndësishme në volumin e eksporteve, dhe se efekti i këtij variabli zvogëlohet me kontrollin në model për variabla dummy për marrëveshjet e tregtisë së lirë. Variabli i ngjashmërisë ka shenjë negative në ekuacionin e eksportit, gjë që tregon se ulja e divergjencës shkakton ulje të eksporteve, por ky variabël nuk është gjithnjë i rëndësishëm statistikisht. Ai bëhet i parëndësishëm kur në model shtohen variablat dummy, sidomos me futjen në model të BE-së. Distanca ka efekt negativ dhe të rëndësishëm statistikisht. Megjithatë, ky efekt zvogëlohet me futjen në model të variablit që kontrollon për kufi të përbashkët.

Kursi nominal i këmbimit ka efekt negativ, por si madhësia e tij ashtu dhe rëndësia statistikore janë vetëm marxhinalisht të rëndësishme. Madhësia e popullatës ka efekt negativ dhe statistikisht të rëndësishëm në pothuajse të gjithë specifikimet e modeleve. Nga variablat dummy të përfshirë në modelet e eksportit, vetëm ai i kufirit të përbashkët tregon rëndësi statistikore dhe është pozitiv në të gjithë specifikimet.

Si eksportet dhe importet tregojnë lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme me përformancën e një viti më parë. Në ekuacionin e importeve, rezultatet tregojnë se madhësia ekonomike është variabël statistikisht i rëndësishëm dhe me efekt pozitiv në importe. Ndryshe nga eksportet, ngjashmëria është pozitivisht e lidhur me importet, pra divergjencat në madhësinë e tregjeve janë faktor nxitës i importeve, gjë që autorët e shpjegojnë me mundësinë, që reduktimi i divergjencave mes vendeve të rajonit, të ulë prirjen për import për shkak të ngjashmërive në strukturën dhe kapacitetin e prodhimit/ofertës. Distanca është përsëri një faktor që ndikon negativisht dhe është i rëndësishëm statistikisht. Variablat e tjerë janë të parëndësishëm statistikisht e ekonomikisht në modelin e importit.

Pllaha (2011) analizon flukset tregtare të Shqipërisë me partnerët kryesorë tregtarë (Gjermania, Greqia, Italia, Bosnje–Hercegovina, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia) për periudhën 2004-2008 duke përdorur modelin e gravitetit. Për më tepër ka krahasuar flukset aktuale me ato potenciale për të identifikuar mundësitë e intensifikimit të tregtisë së Shqipërisë me vendet partnere. Për këtë Pllaha (2011) vlerësoi ekuacionin (2.33).

$$logT_{ij} = 0.7\log\left(PBB_i * PBB_j\right) + 0.3\log\left(PBBPF_i * PBBPF_j\right) - 0.7\log(Distanca_{ij}) \quad (2.33)$$

ku: T_{ij} përfaqëson flukset tregtare ndërmjet vendit *i* dhe *j*; *GDP* përfaqëson totalin e prodhimit të brendshëm bruto; *GDPPF* përfaqëson prodhimin e brendshëm bruto për frymë; $Distanca_{ij}$ tregon distancën ndërmjet kryeqyteteve të partnerëve tregtarë.

Pllaha (2011) vë në dukje riskun e raportimit të një vlere më të madhe të flukseve tregtare krahasuar me realitetin. Pra, përballemi me cilësi të dobët të të dhënave dhe mungesës së raportimeve në vend, gjë që bën të vështirë vlerësimin e këtij modeli. Për më tepër, ekuacioni i mësipërm tenton të zmadhojë flukset tregtare potenciale pasi variabli distancë nuk merr në konsideratë kosto transporti të tilla si kostot e kohëvonesave, kostot e adaptimit të dokumentacionit etj., të cilat evidentohen problematike në rastin e Shqipërisë.

Po kështu, Kraja dhe Sejdini (2014), analizuan faktorët që ndikojnë mbi tregtinë në Shqipëri duke përdorur modelin e gravitetit. Ata testuan nëse vende me një nivel të ardhurash të përafërt tregtojnë me njëri-tjetrin (Hipoteza Linder) dhe nëse vende me nivel të ndryshëm të ardhurash tregtojnë me njëri-tjetrin (Hipoteza Heckscher-Ohlin). Morën në konsideratë flukset tregtare mes Shqipërisë dhe 27 vendeve partnere në tregti për periudhën 1993-2012. Me anë të metodës OLS vlerësuan ekuacionin (2.34).

$$lnx_{ij} = \alpha_0 + \alpha_1 \ln y_i + \alpha_2 lny_j + \sum_{n=1}^{N} \alpha_n lnz_{ij}^n + \varepsilon_{ij} \qquad (2.34)$$

Ku x_{ij} përfaqëson prurjet tregtare midis Shqipërisë (i) dhe vendit j, y_i, y_j përfaqësojnë nivelin e të ardhurave për vendin *i* dhe *j* përkatësisht dhe $\sum_{n=1}^{N} \alpha_n lnz_{ij}^n$ tërësinë e faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë në prurjet tregtare të të dy vendeve të tillë si: ekzistenca e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, ekzistenca e një pike kufitare, popullsia e vendeve të marra në analizë, variabli i distancës i cili merr në konsideratë distancën midis vendeve dhe kostot e transportit, GDP për frymë, diferenca e GDP-së për frymë mes vendit dhe vendeve partnere (variabël i përdorur për të testuar hipotezën Linder dhe Hipotezën Heckscher-Ohlin).

Rezultatet treguan se në rastin e importeve, hipoteza Linder nuk mund të hidhej poshtë duke qenë se marrëdhënia mes diferencës së GDP-ve të vendeve dhe importeve është negative në rastin kur përfshihej ky variabël. Në rastin e eksporteve, hipoteza Heckscher-Ohlin nuk mund të hidhet poshtë duke qenë se marrëdhënia mes diferencës së GDP-ve të vendeve dhe eksporteve është pozitive. Gjithsesi, rezultatet e këtij studimi duhen konsideruar me rezerva, për shkak të metodës së vlerësimit të përdorur në të, OLS, e cila siç është treguar në seksionet

e mësipërme, nuk merr parasysh dimensionin kohor dhe hapësinor. Në këtë rast, vlerësuesit e të dhënave panel mund të çonin në një model me performancë më të mirë dhe me rezultate më të besueshme.

2.6 Përfundime

Modeli i gravitetit është përdorur gjerësisht pesë dekadat e fundit për të analizuar flukset tregtare dhe efektet e faktorëve që ndikojnë në tregtinë midis vendeve partnere. Modeli i gravitetit është vlerësuar fillimisht me anë të metodës OLS ndërkohë që zhvillimet e fundit ekonometrike mbështetin vlerësimin me anë të të dhënave panel dhe metodën GMM, si dhe përdorimin e testeve të ndryshëm, që disponohen sot, për të përzgjedhur modelin ekonometrik që më shumë u përshtatet të dhënave që merren në konsideratë në modelin në fjalë.

Në modelin e gravitetit si variabël i varur përgjithësisht janë përdorur eksportet, importet apo flukset tregtare totale të dyanshme mes vendeve partnere. Ndërsa, ndër variablat e pavarur, janë përdorur faktorët që ndikojnë në kërkesën dhe ofertën e vendeve tregtuese, midis të cilave mund të përmenden: treguesit e madhësisë së tregut dhe ekonomisë, niveli i të ardhurave, popullsia, sipërfaqja e zonës, të ardhurat për frymë, volumi i importeve/eksporteve në vitet paraardhëse apo defiçitit tregtar si dhe faktorët që përfaqësojnë rezistencën që vendet bëjnë ndaj tregtisë, midis të cilëve përmenden kostot e transportit të mallrave, tarifat, cilësia e transportit, distanca midis qendrave tregtare të dy vendeve, largësia gjeografike e vendeve ndaj tregjeve, kursi i këmbimit midis vendeve partnere, performanca dhe cilësia e shërbimeve të pikave kufitare të cilat në mënyrë direkte ndikojnë kostot e transportit, efiçenca e shërbimeve në portet detare, ekzistenca e e-biznes, mjedisi rregullator në vend, distanca teknologjike (indeks i cili mat krijimin e teknologjisë, zhvillimin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore tek çdo vend partner), gjuha e përbashkët mes vendeve partnere, pjesëmarrja në bashkime doganore dhe marrëveshje tregtare/rajonale si variabla binarë. Disa studime kanë përfshirë në listën e variablave shpjegues, jo GDP edhe GDP/frymë, ku e fundit përfaqëson normën e zotërimit të kapitalit, por prodhimin e GDP (për frymë) të vendit nën konsideratë me GDP (për frymë) të vendit partner si një variabël që mat madhësinë ekonomike të dy vendeve. Më pak studime kanë përdorur indekse të ngjashmërisë mes vendeve në terma të madhësisë ekonomike dhe fuqisë prodhuese dhe indeksin e komplementaritetit të tregtisë; ky i fundit si një masë e strukturës së tregtisë së një vendi, që

varion nga konkurrueshmëri perfekte në komplementaritet perfekt. Nga rishikimi i literaturës rezultoi se vendet që janë të pasura, që flasin të njëjtën gjuhë, që lidhen me kufij doganorë, që kanë histori të ngjashme kolonizimi, që bëjnë pjesë në blloqe tregtare, që janë pjesë e bashkimeve monetare, që kanë nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë, priren të tregtojnë më shumë me njëri tjetrin.

Vlerësimi i modelit të gravitetit është i rëndësishëm në rastin e Shqipërisë duke qenë se një ndër sfidat për krijimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme është edhe diversifikimi i eksporteve. Rrjedhimisht, interes të veçantë përbën analizimi i karakteristikave të flukseve tregtare të Shqipërisë me partnerët kryesorë tregtarë të saj, që do të bëhet në kapitullin V, bazuar në njohuritë dhe praktikat e identifikuara në këtë kapitull.

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

3.1 Hyrje.....47
3.2 Metodat për vlerësimin e modelit të gravitetit 47
3.2.1 OLS.....47
3.2.2 Metodat e vlerësimit të të dhënave panel 52
3.3 Përfundime 55
3.3 Përfundime 55

3.1 Hyrje

Siç paraqitet në kapitullin II qëllimi i këtij studimi është analiza e flukseve tregtare të Shqipërisë dhe investigimi i efekteve që do të ketë hyrja e Shqipërisë në Bashkimin Evropian në strukturën e importeve dhe eksporteve të vendit. Bazuar në rishikimin e literaturës së kapitullit II dhe të dhënat e disponueshme që do të përdoren në analizën empirike, janë identifikuar metodat që do të përdoren për vlerësimin e modelit të gravitetit për rastin e Shqipërisë. Modeli i gravitetit është vlerësuar gjerësisht nëpërmjet metodës OLS (Cruz dhe Deluna, 2014; Apostolov, 2013; Hemkamon, 2007; Kraja dhe Sejdini, 2014). Të dhënat e përdorura janë të dhëna panel, dhe metoda më efiçente vlerësimi për këtë lloj të dhënash janë metoda e efekteve fikse dhe atyre të rastit të aplikuara nga të tjerë kërkues (Chan, 2004; Gomez-Herrera, 2012; Alam dhe Taufique, 2009; Kepaptsoglou, 2010). Këto metoda përshkruhen në detaje në këtë kapitull.

Ky kapitull është organizuar si më poshtë. Në seksionin 3.2 do të jepet një paraqitje e përmbledhur e metodave të vlerësimit të modelit të gravitetit duke u fokusuar tek OLS. Nëseksioni 3.2.1 paraqet supozimet dhe karakteristikat e vlerësuesve të modelit për të vijuar më tej në nënseksionin 3.2.2 me metodat e vlerësimit të të dhënave panel, me efekte rasti dhe efekte fikse. Kapitulli do të përmbyllet me seksionin 3.3 me përfundimet.

3.2 Metodat për vlerësimin e modelit të gravitetit

3.2.1 OLS

Modeli linear klasik i regresionit (CLRM) lejon ekzaminimin e natyrës dhe të formës së marrëdhënies midis dy variablave. Ndryshe ai shpjegon se si një variabël, variabli i varur (Y_t) ndikohet nga variabli i pavarur, ose i njohur ndryshe si variabli shpjegues (X_t). Kështu, marrëdhënia midis një variabli të varur Y_t dhe një variabli të pavarur X_t do të shpreheshin në një ekuacion të thjeshtë linear si më poshtë:

$$E(Y_t) = a + \beta X_t \qquad (3.1)$$

ku E(Yt) është pritja matematike e Y_t për një vlerë të dhënë të X_t; $a\ dhe\ \beta$ parametrat e popullatës, që janë të panjohur për një seri kohore *t*. Vlera aktuale Y_t nuk është gjithmonë e

barabartë me $E(Y_t)$ sepse ka edhe faktorë të tjerë që varen nga sjelljet aktuale që e ndikojnë ekuacionin. Kështu Y_t në ekuacionin (3.1) shprehet:

$$Y_t = E(Y_t) + u_t \qquad \text{ose} \qquad Y_t = \alpha + \beta X_t + u_t \qquad (3.2)$$

ku u_t është termi i gabimit. Ky faktor ekziston sepse mungojnë variabla shpjegues, ekzistojnë specifikime jo të sakta të modelit apo specifikime jo të sakta të formës funksionale, forma lineare është vetëm një përafrim i realitetit, si dhe matjet e variablave bëhen me gabime. Ekuacioni (3.4) nuk është lehtësisht i vëzhgueshëm, por nëpërmjet tërësisë së të dhënave mund të merren vlerësuesit α dhe β duke na dhënë ekuacionin e një drejtëze (3.3) me konstante $\hat{\alpha}$ dhe pjerrësi $\hat{\beta}$:

$$\widehat{Y_t} = \hat{a} + \hat{\beta} X_t \qquad (3.3)$$

Ekuacioni (3.3) është ekuacioni i regresionit të thjeshtë, në të cilin $\hat{\alpha}$ dhe $\hat{\beta}$ janë vlerësues të α dhe β (koefiçentëve të popullatës) dhe ku $\widehat{Y_t}$ jep vlerën e parashikuar të Y. Sa i përket përshtatjes së kësaj drejtëze në shpërndarjen e pikave, do të ishte e dëshirueshme të zgjidhej një drejtëz e tillë që të ishte sa më pranë vlerës së vëzhguar të Y, thënë ndryshe, të jetë e tillë që të ofrojë vlerat më të vogla të mbetjeve. Kjo metodë vlerësimi është më e dëshirueshmja si rezultat i disa tipareve që e bëjnë atë teknikën më popullore dhe jo të komplikuar. Kështu, duke përdorur katrorët e mbetjeve eliminohet shenja e mbetjes e cila do të sillte eliminimin e tyre (vlerat pozitive nuk "shuhen" prej vlerave negative) dhe i jepet peshë më e madhe mbetjeve më të mëdha që përkthehet në një përpjekje më të madhe për të reduktuar variancën e gabimit. Metoda OLS zgjedh vlerësuesit $\hat{a}$ dhe $\hat{\beta}$ që kanë karakteristika numerike dhe statistikore të pëlqyeshme.

Llogaritja e vlerësuesve të OLS niset prej shumës së katrorëve të mbetjeve (RSS), e cila shprehet në ekuacionin (3.4):

$$\text{RSS} = \hat{u}_1^2 + \hat{u}_{21}^2 + \cdots + \hat{u}_n^2 = \sum_{t=1}^{n} \hat{u}_t^2 \qquad (3.4)$$

Duke ditur që $\hat{u}_t = (Y_t - \widehat{Y_t}) = Y_t - \hat{a} - \hat{\beta} X_t$ dhe duke zëvendësuar në (3.4) marrim:

$$\text{RSS} = \sum_{t=1}^{n} \widehat{u_t^2} = \sum_{t=1}^{n} (Y_t - \widehat{Y_t})^2 = \sum_{t=1}^{n} (Y_t - \hat{a} - \hat{\beta} \hat{X}_t)^2 \qquad (3.5)$$

Minimumi i RSS arrihet kur derivati i parë në lidhje me $\hat{a}\ dhe\ \hat{\beta}$ barazohen me zero. Derivati i dytë në lidhje me $\hat{a}\ dhe\ \hat{\beta}$ tregon se kushtet minimale plotësohen.

CLRM e paraqitur më lart me një variabël aplikohet edhe për shumë variabla k dhe modeli klasik i regresionit linear merr formën:

$$Y_t = \beta_1 X_{1t} + \beta_2 X_{2t} + \beta_3 X_{3t} + \cdots \beta_k X_{kt} + u_t \qquad (3.6)$$

Të gjitha sa prezantuam më lart për CLRM me një variabël aplikohet për çdo numër variablash k që mund të përfshihen në vlerësim.

$$\text{RSS} = \sum_{t=1}^{n} \hat{u}_t^2 \qquad (3.7)$$

Në rastin e një modeli me tri variabla ku një variabël është konstant dhe dy variabla të tjerë shpjegues X_2, X_3 termi i gabimit merr formën:

$$\hat{u}_t = Y_t - \hat{Y}_t = Y_t - \hat{\beta}_1 - \hat{\beta}_2 X_{2t} - \hat{\beta}_3 X_{3t} \qquad (3.8)$$

Modeli CLRM ka 8 supozime të cilët shpjegojnë se si janë gjeneruar vëzhgimet. Ato janë:

1. <u>Lineariteti</u>: ky supozim përcakton që variabli i varur mund të llogaritet si funksion linear i një tërësie variablash të pavarura, shtuar edhe termin e gabimit. Modeli i regresionit është linear në koeficientet α dhe β në mënyrë të tillë që $Y_t = \alpha + \beta X_t + u_t$

2. <u>X_t ka variacion</u>: ky supozim nënkupton që jo të gjithë vëzhgimet e X_t janë të njëjta. Të paktën një nga vlerat e X_t duhet të jetë e ndryshme në mënyrë që Var (X) të mos jetë 0.

3. <u>X_t nuk është variabël rasti dhe është i fiksuar në zgjedhje të përsëritura</u>. Ky supozim shpjegohet në dy mënyra: (i) X_t është një variabël i cili nuk përcaktohet me procese të rastit por nga një investigues ose eksperimentues dhe (ii) zgjedhja mund të përsëritet me të njëjtat vlera të variablave të pavarur.

4. <u>Vlera e pritur e termit të gabimit është zero</u>. Kjo do të thotë që me përsëritjen e zgjedhjeve një numër të madh herësh, shuma e gabimeve do të jetë zero.

5. Homoskedasticiteti, sipas të cilit varianca e termit të gabimit është konstante për çdo t; Var(u_t) = σ^2

6. Pavarësia seriale, kërkon që termat e gabimit të jenë shpërndarë në mënyrë të pavarur, ose të mos jenë të korreluara me njëri-tjetrin në mënyrë që Cov(u_s, u_t) = E($u_t - Eu_t$)($u_s - Eu_s$) = E(u_s, u_t) $= 0$ për çdo t ≠ s. Kjo do të thotë që termi i gabimit të një periudhe nuk është i lidhur me termin e gabimit të një periudhe të mëparshme ose të mëvonshme.

7. Normaliteti i mbetjeve; mbetjet u_1, u_2, ... u_n, kanë shpërndarje identike dhe të pavarur, me mesatare zero dhe variancë σ^2.

8. n > 2 dhe multikolinariteti; Sipas këtij supozimi numri i vëzhgimeve duhet të jetë më i madh se 2, e në përgjithësi më i madh se numri i variablave të pavarur dhe nuk duhet të ketë lidhje lineare perfekte mes variablave shpjegues.

Karakteristikat e vlerësuesve

Mbështetur në supozimet e paraqitura më lart, provohet se vlerësuesit e OLS janë vlerësuesit më të mirë linearë të pazhvendosur (BLUE). Y_t ka një komponent jo rastësor ($\alpha + \beta X_t$) dhe një komponent të rastësishëm, mbuluar nga termi i gabimit.

- *Lineariteti*: Mbështetur në supozimin 3 më lart X është jo-stokastik dhe fiks në zgjedhje të përsëritura. Në këtë mënyrë, vlera e X trajtohet si një konstante dhe përqëndrimi duhet të jetë tek vlerat e Y. Nëse vlerësuesit e OLS janë funksione lineare të vlerave të Y atëherë ata janë vlerësues linearë.

- *Pazhvendosshmëria*: vlerësuesi $\hat{\beta}$ është vlerësues i pazhvendosur i β dhe $\hat{\alpha}$ është vlerësues i pazhvendosur i α.

- *Vlerësuesi më i mirë linear i pazhvendosur (BLUEness)*: në mbështetje të supozimeve 5 dhe 6 vlerësuesit e OLS janë vlerësuesit më efiçentë në grupin e vlerësuesve linearë të pazhvendosur. Kështu, nëse supozimet qëndrojnë, procedura e OLS ofron vlerësues BLUE.

- *Konsistenca*: në kushtet kur mostra bëhet shumë e madhe, vlerësimi i parametrave sipas procedurës OLS konvergon me vlerat e vërteta të parametrave. Kjo është e vërtetë kur

vlerësuesi është i pazhvendosur, për më tepër kur është e qartë së konsistenca është pika e dobët e pazhvendosshmërisë.

- *Mirësia e përshtatjes*: vija e regresionit e përftuar nga metoda OLS përshtatet me afërsi të konsiderueshme me pikat e vëzhguara. Gjithsesi, kërkohet të llogaritet një masë e cila përshkruan më mirë afërsinë. Kjo masë do të shpjegojë se sa ekuacioni i përftuar merr në konsideratë sjelljen e variablave të varur. Masa e përshtatshme e variacionit total të Y_t quhet shuma totale e katrorëve (TSS) ndërsa shuma e katrorëve e përftuar nga OLS quhet ESS (shuma e katrorëve e shpjeguar).

Shuma totale e katrorëve shprehet si: TSS = ESS +RSS ku TSS dhe ESS shprehen si njësi të katrorit të Y. Duke bërë raportin e ESS me TSS marrim një numër të thjeshtë, të njohur si koeficienti i përcaktueshmërisë (R^2).

Vlerat e R^2 janë mes 0 dhe 1 dhe tregojnë përputhshmërinë e ekuacionit me të dhënat. $R^2 = 0$ është në nivelin më të ulët kur RSS=TSS; $R^2 = 1$ është në nivelin më të lartë kur TSS=ESS. P.sh $R^2 = 0.4$ tregon se 40% e variacionit të Y_t shpjegohet nga ekuacioni i regresionit të zgjedhjes.

<u>Problemet e koeficientit R^2</u>

Koeficienti R^2 ka disa probleme serioze në lidhje me aftësinë për të gjykuar performancën e një ekuacioni të thjeshtë apo krahasimi midis ekuacioneve të ndryshme.

1. *Probleme të regresionit spurioz*: Në rastet kur dy variabla janë të palidhur, por shfaqin një tendencë të njëjtë sjelljeje, R^2 merr vlera të larta (0.9) duke orientuar kërkuesit drejt konkluzionit të gabuar se këta variabla kanë lidhje të forta.

2. *Korrelacion i lartë i X_t me një variabël tjetër Z_t:* Nëse variabli Z_t është përcaktues i sjelljes së variablit Y_t dhe ka korrelacion të lartë me X_t atëherë edhe pse R^2 merr vlerë të lartë duke përcaktuar rëndësinë e X_t në përcaktimin e sjelljes së Y_t, mungesa e variablit Z_t mund të jetë shkaku kryesor i rezultatit.

3. *Korelacioni nuk do të thotë domosdoshmërisht rastësi*: Pavarësisht nësë R^2 merr vlera të larta kjo nuk mund të sugjerojë që midis Y_t dhe X_t ka lidhje shkakësore sepse ky koefiçient mat korrelacionin midis vlerës së vëzhguar Y_t dhe asaj të pritur $\hat{Y}_t$.

4. *Ekuacionet e serive kohore ndaj ekuacioneve me të dhëna ndërseksionale*: Ekuacionet e serive kohore japin gjithmonë R^2 më të lartë se sa ekuacionet me të dhëna ndërseksionale, sepse të dhënat e këtyre të fundit përmbajnë variacione rastësore të mëdha duke e bërë ESS relativisht më të vogël se TSS.

5. *Vlerat e ulëta të R^2 nuk duhet kuptuar si zgjedhje e gabuar e X_t:* vlerat e ulëta të R^2 nuk janë domosdoshmërisht rezultat i përdorimit të variablave shpjegues të gabuar.

6. *R^2 që dalin nga ekuacione me forma të ndryshme të Y_t nuk janë të krahasueshme:* në përgjithësi, sa herë që një variabël i varur ndryshon, R^2 nuk duhet të përdoret për të krahasuar modelet.

3.2.2 Metodat e vlerësimit të të dhënave panel

Vlerësimi i të dhënave panel konsiderohet të jetë një metodë analitike efiçente për trajtimin e të dhënave ekonometrike. Ato lejojnë përfshirjen e N të dhënave ndërseksionale në T periudha kohe. Të dhënat ndërseksionale konsistojnë në observimet e N individëve në një moment kohe. Disa të dhëna ndërseksionale gjithashtu mund të merren në disa momente kohore. Kjo tërësi të dhënash nuk përbën të dhënat panel sepse këto të dhëna nuk lejojnë të ndjekësh të njëjtin vëzhgim (individ brenda panelit të të dhënave) në kohë të ndryshme. Ndërkohë, të dhënat e vërteta panel lejojnë ndjekjen e sjelljes së një individi të popullatës në një tërësi periudhash kohore. Matrica e kombinuar e të dhënave panel konsiston në seri kohore për çdo të dhënë ndër-seksionale dhe ofron një tërësi metodash vlerësimi.

Të dhënat panel mund të jenë të balancuara ose të pabalancuara. Të dhënat panel të balancuara lejojnë të njëjtin numër vëzhgimesh kohore për çdo variabël apo të dhënë të veçantë. Kërkuesit punojnë shpesh me të dhëna panel të pabalancuara duke mos krijuar probleme të mëdha konceptuale, por duke krijuar kompleksitet në trajtimin kompjuterik të të dhënave. Ideja kryesore pas të dhënave panel lidhet me konceptin që lidhjet individuale do të kenë të gjitha parametra të njëjtë. Kjo njihet ndryshe edhe si supozimi "pooling" sipas të cilit të gjithë individët e popullatës në bazën e të dhënave i nënshtrohen parametrave të njëjtë. Nëse supozimi "pooling" është korrekt atëherë të dhënat panel ofrojnë disa avantazhe: (a) madhësia e zgjedhjes së të dhënave mund të rritet konsiderueshëm duke përmirësuar vlerësimet e marra, (b) mungesa e një variabli në të dhënat panel, ndryshe nga një regresion ndër-seksional, në rrethana të caktuara, nuk jep vlerësime të zhvendosura. Ndërkohë, nëse

supozimi “pooling” nuk është korrekt, të dhënat panel krijojnë probleme i cili njihet ndryshe si panel heterogjen (d.m.th. parametrat janë të ndryshëm midis individëve të popullatës).

Të dhënat panel lineare; të dhënat panel lineare formohen nga një bashkësi të dhënash që përmban N njësi cross-section që observohen në periudha të ndryshme kohore. Rasti i modelit të të dhënave panel linear me një variabël shprehet:

$$Y_{it} = \alpha + \beta X_{it} + u_{it} \qquad (3.10)$$

ku, variablat X dhe Y kanë indeksin *i* dhe *t* për *i* = 1, 2, ...N dhe *t* = 1, 2, ...T. Me një model të tillë, kur merren të dhëna të plota ndërmjet vendeve në kohë, kemi të dhëna panel të balancuara. Kur vëzhgimet mungojnë në periudha të ndryshme kemi të dhëna panel të pabalancuara. Ndërkohë, koeficientet α dhe β nuk kanë indeks, gjë që tregon se ato janë të njëjtë për çdo njësi dhe për të gjithë vitet. Ndërkohë, ky model mund të zgjerohet edhe duke e diferencuar njërin nga koefiçientet, pra duke e bërë të ndryshëm për çdo të dhënë.

Metoda e të dhënave panel lineare mund të vlerësohet me (a) një konstante të përbashkët si në ekuacionin (3.10), (b) duke lejuar efekte fikse, (c) duke lejuar efekte të rastit.

Metoda me efekte fikse: Metoda lejon që konstantja t’i përkasë grupit, pra të jetë e veçantë për çdo grup. Vlerësuesi i efektit fiks njihet si LSDV (least square dummy variable) sepse që të lejojë konstante të ndryshme për çdo grup, në model përfshihet një variabël binar për çdo grup. Modeli shprehet:

$$Y_{it} = \alpha_1 + \beta_1 X_{1it} + \beta_1 X_{2it} + \cdots + \beta_k X_{kit} + u_{it} \qquad (3.11)$$

dhe mund të rishkruhet në formë matricore, në të cilën variablat dummy na lejojnë të marrim vlerësues specifikë sipas grupeve për çdo konstante të secilit seksion. Për të vlerësuar vlefshmërinë e metodës me efekte fikse duhet që fillimisht të testohet nëse efektet fikse duhet të përfshihen ose jo në model. Për këtë përdoret testi standard F i cili vlerëson efektet fikse kundrejt metodës së thjeshtë OLS. Metoda me efekte fikse ka këto tipare:

1. Kap të gjitha efektet që janë specifike për një individ të caktuar të popullatës dhe nuk ndryshojnë në kohë. Kështu, nëse do të kishim një panel të dhënash vendesh, efektet

fikse do të merrnin në konsideratë të gjithë faktorët si gjeografikë, natyrorë apo bazikë të cilët ndryshojnë midis vendeve por nuk ndryshojnë në kohë.

2. Në disa raste modeli mund të përfshijë një numër të madh të variablave dummy. Zgjerimi i modelit me efekte fikse bëhet me anë të përfshirjes së një bashkësie konstantesh dummy. Kjo bën që të përdoren N variabla të tillë, pra të përdoren N shkallë lirie shtesë, gjë që e bën procedurën e llogaritjes së koeficientëve intensive.

Metoda me efekte të rastit: Kjo metodë ndryshon nga metoda me të dhëna fikse në lidhje me trajtimin që modeli i bën konstanteve, të cilat në modelin me të dhëna të rastit për çdo seksion trajtohen si parametra të rastit. Ndryshueshmëria e konstanteve të çdo seksioni vjen nga:

$$\alpha_1 = \alpha + v_1 \qquad (3.12)$$

ku v_1 është variabël rasti me mesatare zero. Një nga disavantazhet më të dukshme të këtij modeli lidhet me nevojën për të bërë supozime specifike në lidhje me shpërndarjen e komponentit të rastit. Gjithashtu, nëse efektet e pavëzhguara të grupeve specifike janë të korreluar me variablat shpjegues, vlerësimi do të jetë i zhvendosur dhe jo konsistent. Ndër avantazhet mund të përmenden: (1) ka më pak parametra për të vlerësuar, krahasuar me metodën me efekte fikse, (2) lejon futjen në model të variablave shpjegues shtesë që kanë vlerë të njëjtë për të gjithë vëzhgimet brenda një grupi. Përdorimi i këtij modeli duhet kontrolluar nëse është zgjedhja më e mirë e vlerësimit të të dhënave panel.

Duke i krahasuar këto dy modele, me efekte fikse dhe efekte të rastit, ky i fundit konsiderohet më superior. Gjithsesi, modeli me efekte të rastit mbështetet në supozimin se efektet fikse janë të pakorreluar me variablat shpjeguese, supozim i cili krijon kufizime strikte në trajtimin e të dhënave panel. Gjithashtu, diferenca midis dy modeleve në vlerësimin e të dhënave panel është se modeli me efekte fikse supozon që çdo vend dallon në termin e prerjes ndërsa modeli me efekte të rastit supozon që çdo vend dallon nga termi i gabimit. Në përgjithësi, në rastin e të dhënave panel të balancuara, pritshmëritë janë që modeli me efekte fikse të funksionojë më mirë.

Testi Hausman; Ky test është formuluar për të ndihmuar në zgjedhjen midis dy modeleve të parashtruara më lart. Hausman (1978) e ndërtoi testin i mbështetur në idenë që nën hipotezën

e mungesës së korrelacionit, OLS dhe GLS janë konsistentë por OLS është jo efiçent. Hausman supozoi se ka dy vlerësues $\hat{\beta}_0$ dhe $\hat{\beta}_1$ të vektorit të parametrave β kështu që ai ngriti dy proçedura të testimit të hipotezës. Nën hipotezën zero, të dy vlerësuesit janë konsistentë por $\hat{\beta}_0$ nuk është efiçent dhe nën H_1, $\hat{\beta}_0$ është konsistent dhe efiçent por $\hat{\beta}_1$ nuk është konsistent. Për të dhënat panel zgjedhja më e mirë midis modeleve bëhet duke investiguar nëse regresorët janë të korreluar me efektin individual (të pavëzhguar në shumicën e rasteve). Avantazhi i përdorimit të modelit me efekte fikse është që ai është konsistent edhe kur vlerësuesit janë të korreluar me efektin individual. Thënë ndryshe, për të dhënat panel për të cilat modeli me efekte fikse është i përshtatshëm, testi Hausman investigon nëse modeli me efekte të rastit do të ishte po kaq i mirë.

3.3 Përfundime

Në këtë kapitull u trajtuan metodat më të mira për vlerësimin e modelit të gravitetit dhe u listuan karakteristikat e vlerësuesve të ndryshëm të të dhënave panel, supozimet e modeleve të ndryshëm, avantazhet dhe disavantazhet e përdorimit të këtyre metodave, duke filluar nga Modeli Linear Klasik i Regresionit (CLRM), i cili anashkalon faktin që të dhënat kanë edhe një dimension kohor, veç atij ndër-seksional. Më pas u shtjelluan metoda të tjera të vlerësimit të të dhënave panel, që e tejkalojnë këtë kufizim, duke u ndalur tek metodat me efekte fikse dhe ato me efekte të rastit. Iu kushtua vëmendje gjithashtu edhe testeve për zgjedhjen midis metodave të vlerësimit e të dhënave panel.

Përdorimi i të dhënave panel ka përparësi ndaj vlerësuesve të të dhënave ndër-seksionale, pasi të dhënat panel lejojnë vlerësimin e të dhënave në periudha të ndryshme kohore. Gjithashtu, pavarësisht kompleksitetit në trajtimin kompjuterik të tyre, të dhënat panel japin rezultate më konsistente për vlerësimin e modelit të gravitetit sesa OLS. Të dhënat panel me efekte fikse dhe efekte të rastit janë përdorur gjithashtu gjerësisht në vlerësimin e modelit të gravitetit. Gjithsesi, përdorimi i njërës apo tjetrës metodë duhet të zgjidhet me kujdes pasi të jenë vlerësuar kufizimet dhe përparësitë e secilës në lidhje më konsistencën dhe efiçencën e vlerësuesve. Këto metoda dhe teste do të përdoren në kapitullin V për vlerësimin e modelit të gravitetit për një panel vendesh, përfshirë Shqipërinë.

KAPITULLI IV: ANALIZA E POLITIKËS TREGTARE SHQIPTARE DHE NDIKIMI I POLITIKËS SË PËRBASHKËT TREGTARE (PPT) TË BE-SË

4.1 Hyrje 57
4.2 Ecuria e tregtisë së jashtme të Shqipërisë 58
4.2.1 Karakteristikat e volumit tregtar 58
4.2.2 Karakteristika e eksportit 62
4.2.3 Karakteristika e importit 66
4.3 Stadi aktual i politikës tregtare 69
4.3.1 Politika tregtare para dhe pas anëtarësimit në OBT 70
4.3.2 Instrumentat e politikës tregtare shqiptare 72
4.3.3 Kordinimi i politikës tregtare shqiptare 75
4.4. Politika e Përbashkët Tregtare e Bashkimit Evropian (PPT) 76
4.4.1 Qëllimet dhe kompetencat e Politikës së Përbashkët Tregtare të BE-së 76
4.4.2 Parimet e politikës së përbashkët tregtare 80
4.4.3 Instrumentat e Politikës së Përbashkët Tregtare 84
4.4.4 Traktati i Lisbonës 2009 dhe ndryshimet e politikës së përbashkët tregtare 87
4.4.5 Kordinimi i Politikës së Përbashkët Tregtare 94
4.5 Ndikimi i PPT në politikën tregtare shqiptare 95
4.6 Përfundime 97

4.1 Hyrje

Kalimi nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, menjëherë pas vitit 1990, solli domosdoshmërinë e transformimeve në politikën tregtare të Shqipërisë. Nga një ekonomi e drejtuar dhe e kontrolluar nga shteti u kalua në ekonominë e lirë ku forcat e tregut dhe kërkesë-oferta ishin shtysat kryesore në fomulimin e politikës tregtare dhe në zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Natyrisht, zhvillimet në politikën tregtare shqiptare kanë kaluar në disa stade, një nga më të rëndësishmit prej të cilëve është anëtarësimi në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT). Analiza e flukseve tregtare, me fokus parësor në flukset tregtare me partnerët kryesorë brenda bllokut të vendeve të BE-së, dhe jo vetëm, dhe karakteristikat e politikës tregtare në vite janë gjithashtu në fokus të këtij kapitulli.

Politika tregtare shqiptare është e ndikuar ndjeshëm nga proçesi i anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe procesi i harmonizimit të politikave dhe ai legjislativ me *acquis*. Zhvillimet në Politikën e Përbashkët Tregtare (PPT) të Bashkimit Evropian kanë pësuar një transformim të rëndësishëm me Traktatin e Lisbonës (2009) duke shtuar kompetencat e politikës tregtare si dhe mekanizmat e vendim-marrjes. Në vlerësimin e zhvillimeve në Politikën e Përbashkët Tregtare të Bashkimit Evropian pas Traktatit të Lisbonës paraqitet në këtë kapitull edhe ndikimi që do të ketë politika tregtare shqiptare pas anëtarësimit. Në këtë kapitull do të bëhet gjithashtu edhe analiza e stadit aktual të politikës tregtare.

Për të kryer analizat e mësipërme, ky kapitull është organizuar në seksione, si vijon. Fillimisht, në seksionin 4.2 paraqitet analiza e import-eksportit për periudhën 2007-2013, duke vijuar në seksionin 4.3 me analizën e detajuar të stadeve të politikës tregtare në Shqipëri. Në këtë seksion parashtrohen në mënyrë analitike karakteristikat e politikës tregtare para dhe pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë dhe zhvillimet e politikës tregtare në vite, duke u ndalur tek parimet instrumentat e politikës tregtare të Shqipërisë. Më tej, analiza vijon në seksionin 4.4 me paraqitjen e Politikës së Përbashkët Tregtare të Bashkimit Evropian, përfshirë objektivat dhe qëllimet, parimet dhe instrumentat rregullatorë specifikë të saj. Një pjesë të rëndësishme në këtë analizë e zë edhe vleresimi i ndryshimeve të PPT si rezultat i Traktatit të Lisbonës 2009, nga e cila rrjedh edhe paraqitja e detajuar e ndikimit që do të ketë politika tregtare shqiptare në momentin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, që paraqitet në seksionin 4.5. Përfundimet kryesore që arrihen nga analizat e mësipërme përmblidhen në seksionin 4.6

4.2 Ecuria e tregtisë së jashtme të Shqipërisë

4.2.1 Karakteristikat e volumit tregtar

Tregtia e jashtme e Shqipërisë i është nënshtruar proçeseve të thella dhe intensive liberalizuese, proçese të cilat rezultuan me politika dhe reforma që ndikuan ndjeshëm në shkëmbimet tregtare të Shqipërisë. Politika tregtare u liberalizua ndjeshëm sidomos pas vitit 2006, kohë kur u nënshkrua MSA, CEFTA, marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë dhe marrëveshja e tregtisë së lirë me vendet EFTA. Kjo politike liberalizuese pati reflektime pozitive në shkëmbimet tregtare dhe në orientimin e eksporteve shqiptare. Gjatë viteve 2007-2013 volumi i përgjithshëm i tregtisë është rritur në terma absolutë dhe relativë (shih tabelën 4.1), megjithëse kjo rritje është shoqëruar me luhatje. Rritja mesatare vjetore e volumit tregtar për periudhën 2006-2013 është 11 përqind[8].

Tabela 4.1 Ecuria e tregtisë 2006-11 mujor 2014 (në milion lekë)

Viti	Eksporti, në miliardë lekë	Importi, në miliardë lekë	Volumi tregtar, në miliardë lekë	Bilanci tregtar, në miliardë lekë	Përqindja e mbulimit
2006	77.4	299.1	376.5	-221.7	25.9
2007	97.1	376.1	473.3	-279	25.8
2008	112.5	439.8	552.4	-327.3	25.6
2009	104.5	428.8	533.3	-324.3	24.4
2010	16.8	477.7	639.3	-316.2	33.8
2011	196.8	544	740.9	-347.1	36.2
2012	213	528.4	741.4	-315.4	40.3
2013	246.3	517.3	763.7	-270.9	47.6
11 mujori 2014	236.3	497.7	734.1	-261.3	47.5%

Burimi: INSTAT

Luhatja e parë e ndjeshme është ajo e vitit 2009, vit në të cilin volumi tregtar u reduktua me 3 përqind. Këto ishin shenjat që treguan se kriza ekonomike botërore edhe pse nuk arriti të na ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë dha ndikimet e veta negative në tregti. Kjo rënie, përveç tkurrjes së konsumit të brendshëm, lidhet edhe me faktin se partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, Italia dhe Greqia ishin në krizë të thellë. Greqia kishte shpallur zyrtarisht rënien në reçesion ndërsa Italia edhe pse nuk kishte deklarata zyrtare për hyrjen në reçesion dha shenja të tkurrjes së tregtisë me Shqipërinë.

[8] Nëse përjashtojmë nga analiza vitin 2009 rritja mesatare vjetore do të ishte 14 për qind.

Vitet 2010-2011 dhanë shenja shumë optimiste dhe shënuan një rritje të volumit tregtar në nivelet 20 përqind dhe 16 përqind respektivisht. Viti 2012 dhe 2013 tregojnë përsëri shenja dobësie dhe rënie të ritmit të rritjes, duke arritur nivele shumë modeste rritje deri në 3 përqind. 11 mujori i vitit 2014 gjithashtu jep shenja dobësie ku rritja e volumit tregtar krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2013 është vetëm 7.4 përqind. Viti 2013 ka qenë një vit elektoral dhe rënia e volumit tregtar është e pritshme, por performanca e vitit 2012 si dhe 11 mujori i vitit 2014 tregojnë se performanca tregtare e Shqipërisë është jo shumë optimiste dhe nuk mund të jetë ndikuar vetëm nga fakti që viti 2013 ishte vit elektoral. Kjo performancë e dobët lidhet edhe me faktorë të tjerë ekonomikë si dhe me stabilitetin e përgjithshëm politik në vend.

Gjithësesi, gjatë kësaj periudhe bilanci tregtar është përmirësuar. Megjithëse Shqipëria vazhdon të ketë një bilanc negativ tregtar, bilanc i cili ka qenë i tillë që pas vitit 90', ritmet e thellimit të tij kanë rënë. Kjo lidhet dukshëm me përmirësimin e performancës së eksportit dhe rritjes së eksportit me ritme më të shpejta se importi gjatë kësaj periudhe (Grafik 4.1). Edhe përmirësimi i raportit të importit dhe eksportit ndaj volumit tregtar janë gjithashtu një tregues i këtij ndikimi. Përqindja e mbulimit të eksportit ndaj importit ka shënuar rritje në favor të eksportit në vitet e fundit. Përqindja e mbulimit të eksportit ndaj importit për vitin 2011 është 36 përqind ose 1 me 3, raporti i cili deri në vitin 2008 ka qenë në shifrat 1 me 4. Ndërkohë, raporti i mbulimit në vitin 2013 është 47.6 pothuajse në raportin 1 me 2, raport historik për Shqipërinë pas vitit 90'.

Grafik 4.1 Fluksi i shkëmbimeve tregtare për vitet 2007-2013 (në miliardë lekë)



Burimi: INSTAT

Kontributi i importit dhe eksportit në volumin e përgjithshëm tregtar, matur si raport i importit dhe eksportit ndaj volumit të tregtisë, ka pësuar ndryshime në vite. Ky raport ka qenë në nivelet 80 përqind import dhe 20 përqind eksport për shumë vite. Për herë të parë ky raport filloi të përmirësohej në favor të eksportit në vitin 2010 dhe ka vijuar kështu në vitet në vijim (Tabela 4.2 dhe grafiku 4.2)

Tabela 4.2 Raporti i importit dhe eksportit ndaj volumit tregtar

Viti	Eksport/Volumi tregtar (X/(X+M))	Import/Volumi tregtar (M/(X+M))
2010	25.3 përqind	74.7 përqind
2011	26.6 përqind	73.4 përqind
2012	28.7 përqind	71.3 përqind
2013	32.0 përqind	68.0 përqind
11 mujori 2014	32.2 përqind	67.8 përqind

Burimi: Llogaritur nga Autori

Grafik 4.2 Raporti i importit dhe eksportit ndaj volumit tregtar, 2006-11 mujori 2014 (në përqindje)



Burimi: INSTAT

Shkalla e hapjes së ekonomisë si raport i volumit tregtar ndaj Produktit të Përgjithshëm Bruto (X+M/GDP) ka qenë në rritje të vazhdueshme. Shkalla e hapjes zakonisht shprehet si raport i eksportit ndaj Produktit të Përgjithshëm Bruto (X/GDP). Por në vendet në zhvillim, me bilanc tregtar negativ dhe me liberalizim të shpejtë tarifor, në këtë raport përfshihet edhe importi, (M/GDP) pasi ai ka një kontribut të rëndësishëm në prezantimin e përformancës së përgjithshme tregtare. Kështu, nga analiza e këtij treguesi, për periudhën 2007-2013, shihet se në vitin 2009 indeksi i shkallës së hapjes pësoi një rënie të lehtë. Që nga 2010, raporti i

volumit tregtar ndaj Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (X+M/GDP) është rritur vazhdimisht duke arritur në vitin 2013 në 57.7 përqind. Performanca pozitive e eksportit reflektohet edhe në rritjen e konsiderueshme të raportit të eksportit ndaj Prodhimit të Përgjithshëm Bruto **(**X/GDP), raport i cili është rritur nga 9.1 përqind në 2009 në 18 përqind në 2013. Ndërkohë, raporti i importit ndaj Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (M/GDP) ka një rritje shumë të lehtë nga 37.8 përqind në 39 përqind. Grafiku 4.3 jep ecurinë dhe vlerat në vite të shkallës së hapjes.

Grafik 4.3 Shkalla e hapjes së Shqipërisë si raport ndaj GDP-së (në përqindje)



Burimi: INSTAT

4.2.2 Karakteristika e eksportit

Eksportet janë rritur ndjeshëm gjatë periudhës 2007-2013 (tabela 4.1). Me përjashtim të vitit 2009, eksportet janë rritur vazhdimisht. Në vitin 2013 ato janë rritur në masën 2.5 herë krahasuar me vitin 2007 (në vlerë, nga 97.1 miliardë lekë në 2007 në 246.4 miliardë lekë në vitin 2013). Viti 2010 është viti në të cilin rritja e eksportit arriti vlerën rekord prej 55 përqind, rritje që nuk është shënuar në asnjë vit pas viteve 90'. Rritja mesatare e eksportit ka qenë 19 përqind (24 përqind nëse do të përjashtojmë vitin 2009 nga analiza). Ritmi i rritjes së eksporteve në vite është një tregues i rëndësishëm, ecuria e të cilit na lejon të gjykojmë për stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë në përgjithësi, si dhe aftësinë e saj për të konkuruar në tregjet ndërkombëtare. Gjithësesi, nuk duhet neglizhuar fakti që rritja e eksportit reflekton në mënyrë direkte dhe shumë të ngushtë edhe kërkesën e partnerëve të huaj për produktet shqiptare.

Grupi i produkteve ushqimore (Kapitujt 1-24 të NK) për vitin 2013 zë 5.9 % të totalit të eksportit duke arritur një vlerë prej 14.6 miliardë lekë. Ndërsa grupi i produkteve jo-ushqimore (Kapitujt 25-99 të NK) zë 94.1% të totalit të eksporteve, me një vlerë prej 231.7 miliardë lekë dhe përbën grupimin me peshën më të madhe në eksport. Produktet tradicionale të eksportit deri në vitin 2010 ishin tekstilet dhe veshjet e këmbës. Mineralet, hidrokarburet dhe materialet e ndërtimit kanë pësuar rritje të ndjeshme që nga viti 2011 duke u kthyer në produktet kryesore të eksportit për Shqipërinë. (tabela 4.3 dhe grafiku 4.4)

Tabela 4.3 Eksporti sipas grup-mallrave (në miliardë lekë)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Rritja mesatare vjetore
Ushqim, pije duhan	7	7.2	7.5	9.4	11.2	12.8	14.6	13%
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	14.9	20.3	20.6	44.8	58.7	76.1	99.4	41%
Produkte kimike dhe plastike	0.8	1,1	1.7	1.7	2.8	2	2.8	29%
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2	1.7	1.5	2.5	2.9	2.7	3.1	11%
Prodhime druri dhe letre	3	3.6	3.4	4.8	4.5	5.3	8	19%
Tekstile dhe këpucë	47	48.8	48.3	55.6	64.1	62.1	69.3	7%
Materiale ndërtimi dhe metale	15.3	22.4	12.9	32.3	41.3	40.2	36.1	28%
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	4	4.5	5.5	6.7	7.7	7.6	8.2	13%
Të tjera	2.8	2.6	2.8	3.4	3.4	3.9	4.4	8%

Burimi: INSTAT

Mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike janë që nga viti 2012 grup-malli me peshën më të lartë të eksportit (36 përqind të totalit në 2012 dhe 41 përqind në 2013) dhe me rritje të konsiderueshme në vlerë që nga 2010. Ato kanë rritjen mesatare vjetore më të lartë për periudhën 2007-2013 (41 përqind). Tekstilet dhe këpucët janë grup-malli me rritjen më të qëndrueshme në vite por kjo rritje është e ulët nga viti në vit. Rritja mesatare vjetore për këtë grup malli është 7 përqind. Produktet kimike dhe plastike janë grup malli i dytë me rritjen mesatare vjetore më të lartë (29 përqind), i ndjekur nga materialet e ndërtimit dhe metalet (28 përqind).

Grafik 4.4 Eksporti sipas grup-mallrave (në miliardë lekë)



Burimi: INSTAT

Vendet e Bashkimit Evropian janë destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare. Eksportet drejt vendeve të BE-së për vitin 2013 janë 76.6 përqind e eksporteve totale. Pesha që vendet e BE-së kanë për eksportet shqiptare ka rënë në vite. Deri në vitin 2006 vendet e BE-së ishin destinacioni i 89 përqind të eksporteve shqiptare. Pas këtij viti, periudhë në të cilën filloi zbatimi i marrëveshjes CEFTA dhe marrëveshjes së tregtisë së lirë me Turqinë, dhe në 2011 edhe me vendet EFTA, pesha e vendeve të BE-së për eksportet shqiptare ra dhe arriti nivelin më të ulët në vitin 2011 me 71 përqind. Gjatë tri viteve të fundit pesha e vendeve të BE-së është rritur lehtë, por gjithsesi ajo nuk ka arritur nivelin e viteve 2005-2006, (Grafiku 4.5)

Grafik 4.5 Raporti i eksporteve në BE dhe vendet e tjera të botës ndaj eksportit total



Burimi: INSTAT

Eksportet kryesore të vendit shkojnë në: Itali, Spanjë, Kosovë, Turqi, Greqi, Gjermani, Maltë, etj. Italia është partneri kryesor i eksporteve tona me 46% përqind, ndjekur nga Spanja me 10 përqind, Kosova me 6.9 përqind etj. (Grafiku 4.6) Italia mbetet partneri kryesor por pesha e tij ka rënë në vite nga 68 përqind në 2007, në 41 përqind në 2013. Një tjetër zhvillim i rëndësishëm lidhur me partnerët kryesorë të eksportit është dalja e Greqisë nga lista e vendeve kryesore për eksportet shqiptare. Që nga viti 2010, Greqia nuk është më vendi i dytë më i rëndësishëm i eksporteve tona, vend të cilin e ka mbajtur tradicionalisht që pas viteve 90'. Këtë vend e zuri Kosova dhe Turqia në vitin 2010 si rezultat i fillimit të zbatimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe mundësisë për të eksportuar në këto vende pa tarifa doganore. Megjithatë, duhet theksuar se edhe këto vende nuk e ruajtën gjatë këtë pozicion, pasi që nga vitit 2012 këtë vend e zuri Spanja, pozicion të cilin vijon ta ruajë.

Grafik 4.6 Partnerët kryesorë të eksportit për vitin 2013, (në përqindje)



Burimi: INSTAT

Marrëveshjet e tregtisë së lirë janë një instrument i rëndësishëm i politikës tregtare për të krijuar lehtësi për eksportet e vendeve nënshkruese. Shqipëria ka 4 marrëveshje tregtare preferenciale me vendet e BE (MSA) CEFTA, EFTA dhe Turqinë por ekzistenca e tyre nuk krijon automatikisht mundësi për të përfituar tarifa preferenciale më të ulta se ato të kombit më të favorizuar. Për të përfituar nga tarifat preferenciale, krahas plotësimit të kushteve dhe standardeve të produktit duhet që të plotësohet edhe rregulli i origjinës. Tabela 4.4 tregon se jo të gjitha eksportet shqiptare plotësojnë rregullin e origjinës[9] dhe shkalla e përfitimit nga marrëveshjet e tregtisë së lirë është e ndryshme. Shkalla e përfitimit nga MTL-të në vitin 2012 ishte 42 përqind e eksportit total e cila ka një ulje në 39 përqind në vitin 2013.

Tabela 4.4 Raporti i eksportit preferencial[10] ndaj atij normal

		2012				2013		
	Eksporti preferencial, në miliardë lekë	Eksporti total, në miliardë lekë	Raporti ndaj eksportit total, në përqindje	Shkalla e shfrytëzimit preferencial	Eksporti preferencial, në miliardë lekë	Eksporti total, në miliardë lekë	Raporti ndaj eksportit total, në përqindje	Shkalla e shfrytëzimit preferencial
BE	68.8	160.7	75.5%	43%	77.7	188.7	76.6%	41%
CEFTA	12.1	25.6	12.0%	47%	10.3	26.6	10.8%	39%
EFTA	3	2.1	1.0%	0%	1	4.3	1.8%	0%
TURQI	9.1	13.4	6.3%	67%	7.9	9.2	3.7%	86%
Të tjera	n.a	11.1	5.2%	n.a	n.a	17.3	7.1%	n.a
Total	89.9	213	100.0%	42%	95.9	246.3	100.0%	39%

Burimi: Llogaritur nga autori

Përfitimet nga eksportet preferenciale në BE dhe CEFTA për vitin 2013 janë 41 përqind dhe 39 përqind respektivisht ndërkohë që, përfitimi nga eksporti preferencial me EFTA është 0 përqind. (tabela 4.5). Vetëm eksportet në Turqi arrijnë të përfitojnë konsiderueshëm nga MTL-ja, përfitim i cili është rritur ndjeshëm nga 67 përqind në 2012 në 86 përqind në 2013. Kjo tregon për një organizim më të mirë të sektorit privat dhe përdorimin e rregullit të origjinës. Gjithashtu tregon shkallë më të ulët varësie nga parimi i kumulimit diagonal[11].

[9] Sipas rregullit të origjinës inputet e përdorura në prodhimin e një produkti final duhet të kenë një shkallë përpunimi të caktuar, e shprehur si përqindje e inputeve në produktin final, për të fituar status origjinues. Ky rregull varion sipas produkteve.

[10] Eksport preferencial është eksporti i mallrave i cili arrin të përfitojë reduktimin tarifor sipas parashikimeve të një marrëveshje të tregtisë së lirë.

[11] Parimi i kumulimit diagonal përcakton që inputet mund të merren nga vende të ndryshme por me kushte që të kenë MTL dhe zbatojnë rregulla të njëjta origjine. Pas përpunimit të inputeve në njërin prej vendeve të origjinës ato eksportohen me regjim preferencial tarifor.

4.2.3 Karakteristika e importit

Ecuria e importeve është më e paqëndrueshme krahasuar me eksportet, (tabela 4.1). Ato janë ulur jo vetëm në vitin 2009 por edhe në vitet 2012-2013. Në vitin 2013 ato janë rritur në masën 1.4 herë krahasuar me vitin 2007 (në vlerë, nga 376.2 miliardë lekë në 2007 në 517,3 miliardë lekë në vitin 2013). Pas rënies së vitit 2009 importi dha shenja pozitive duke u rritur në dy vitet në vijim me 11 përqind dhe 14 përqind respektivisht, por pas kësaj importi ra përsëri me -3 përqind dhe -2 përqind. Rritja mesatare e importit për periudhën 2007-2013 ka qenë 9 përqind.

Grupi i produkteve ushqimore (Kapitujt 1-24 të NK) për vitin 2013 zë 18 përqind ndaj totalit të importit duke arritur një vlerë prej 93.4 miliardë lekë. Ndërsa grupi i produkteve jo-ushqimore (Kapitujt 25-99 të NK) zë 82 përqind të totalit të importeve, me një vlerë prej 423.8 miliardë lekë. Ky grupim, ashtu si dhe në eksport, vijon të zërë peshën më të madhe të importeve. Tabela 4.5 dhe grafiku 4.7 paraqesin situatën e importit sipas grup-mallrave. Shpërndarja midis grupimeve është më e madhe se në eksport dhe pesha e grup-mallrave është më e vogël (grafik 4.7)

Tabela 4.5 Importi sipas grup-mallrave (në miliardë lekë)

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Ushqim, pije duhan	60.8	73.1	74.5	87.1	91.9	93.2	93.4
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	62.9	78.7	61.9	73.5	102.2	110.4	92.6
Produkte kimike dhe plastike	39.5	45.4	50.8	56.3	60.9	66	68.2
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	7.8	6.9	6.8	8.3	9.4	9.7	11.4
Prodhime druri dhe letre	13.3	15	17.4	20.4	20.4	18.1	20.3
Tekstile dhe këpucë	39.3	39.5	39.2	45.7	50.5	48.3	54.1
Materiale ndërtimi dhe metale	59.5	67.8	65.8	76.4	82.1	68.1	63.3
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	78.7	97	97.7	92.6	109.7	97.7	98.5
Të tjera	14	16.1	14.4	17.2	16.6	16.8	15.3

Burimi: INSTAT

Grupimi ushqim, pije, duhan është i vetmi grupim i vetëm me ulje gjatë periudhës 2007-2013. Të gjitha grupimet e tjera ndjekin të njëjtën tendencë që paraqet importi total me ulje dhe ngritje gjatë kësaj periudhe.

Grafik 4.7 Importi sipas grup-mallrave (në miliardë lekë)



Burimi: INSTAT

Për vitin 2013 në pjesën më të madhe importet janë realizuar nga vendet e BE-së me vlerën 327.8 miliardë lekë ose 62.2 përqind të totalit. Brenda këtij grupimi vendet kryesore të importit janë Italia, Greqia, Gjermania, Spanja, Franca, Polonia, Austria, Bullgaria etj. Importet nga vendet e Bashkimit Evropian janë dominuar në pjesën më të madhe nga makineri e pajisje, pjesë këmbimi e lëndë të para e ndihmëse për përpunimin aktiv, pra nga artikuj që kanë si destinacion investimet në njësitë prodhuese, të shërbimit, riprodhimit, etj. Kina, Turqia, vendet CEFTA[12] (grafiku 4.9) janë partnerë të rëndësishëm gjithashtu. Grafiku 4.8 tregon se raporti i importeve nga vendet e BE-së dhe jashtë BE-së është 65 përqind kundrejt 35 përqind respektivisht. Gjithashtu, ndryshe nga eksporti ky raport është i qëndrueshëm në kohë si për bllokun e BE-së ashtu edhe bllokun jashtë BE-së.

[12] Vendet e CEFTA të përfshira në grafikun 4.9 janë Serbia, Kosova, Maqedonia.

Grafik 4.8 Raporti i importeve nga BE dhe vendet e tjera të botës ndaj importit total



Burimi: INSTAT

Grafik 4.9 Partnerët kryesorë të importit për vitin 2013 (në përqindje)



Burimi: INSTAT

Nga llogaritjet e paraqitura në tabelën 4.6 shihet se jo të gjitha importet plotësojnë rregullin origjinues dhe shkalla e përfitimit nga marrëveshjet e tregtisë së lirë është e ndryshme. Gjithsesi, shkalla e përfitimit të importeve për grupimet e ndryshme tregtare është më e lartë sesa ajo e eksporteve, për të njëjtat grupime tregtare, çka tregon se marrëveshjet e tregtisë së lirë funksionojnë më mirë për importet se për eksportet. Kjo mund të tregojë gjithashtu që bizneset nga vendet tona partnere i shfrytëzojnë më mirë hapësirat që i ofrojnë marrëveshjet e tregtisë së lirë. Shkalla e përftimit për vitin 2012 ishte 39 përqind importit total dhe 40 përqind në vitin 2013. Shkalla totale e përftimit është pothuaj e njëjtë me atë të eksporteve

dhe në këtë vlerë ndikon edhe përfitimi prej 5 përqind i vendeve EFTA. Edhe në importe vendi i cili përfiton më shumë është Turqia.

Tabela 4.6 Raporti i importit preferencial ndaj atij normal

	2012				2013			
	Importi preferencial, në miliardë lekë	Importi total, në miliardë lekë	Raporti ndaj importit total, në përqindje	Shkalla e shfrytëzimit preferencial	Importi preferencial, në miliardë lekë	Importi total, në miliardë lekë	Raporti ndaj importit total, në përqindje	Shkalla e shfrytëzimit preferencial
BE	159.8	327.9	62%	49%	154.7	325.7	63%	48%
CEFTA	23.4	44.9	9%	52%	23.5	38.3	7%	61%
EFTA	0.2	1.,7	3%	1%	0.4	8.3	2%	5%
Turqi	22.7	30.4	6%	75%	27.1	33.2	6%	82%
Të tjera	n.a	109.4	21%	0%	n.a	111.6	22%	0%
Total	206.2	528.4	100%	39%	205.8	517.3	100%	49%

Burimi: Llogaritur nga autori

4.3 Stadi aktual i politikës tregtare

Ky seksion analizon ecurinë e politikave që nga viti 1991, vit kur regjimi tregtar i Shqipërisë iu nënshtrua transformimeve të para thelbësore liberalizuese. E drejta e import-eksportit u mbështet në parimet e ekonomisë së tregut duke bërë që monopoli shtetëror mbi tregtinë e jashtme të mos ishte më një atribut dhe e drejtë e shtetit. Ligji "Për ndërmarrjet shtetërore" i vitit 1991 transformoi ndërmarrjet shtetërore në shoqëri tregtare ose aksionare, duke u dhënë kështu edhe të drejtën të importonin, eksportonin, blinin dhe shisnin mallra në tregun ndërkombëtar.

Investimet e huaja u lejuan dhe në mbështetje të ligjit Nr. 7764, datë 2.11.1993 "Për investimet e huaja" u garantua trajtimi i barabartë midis të huajve dhe vendasve gjatë ushtrimit të aktivitetit ekonomik, në përputhje me përjashtimet e lejuara në legjislacionin sektorial. Një ndër përjashtimet më të diskutueshme është e drejta për të blerë tokë bujqësore nga të huajt, të drejtë që akoma e gëzojnë vetëm shqiptarët ndërsa të huajt mund ta marrin vetëm me qera deri në 99 vjet.

4.3.1 Politika tregtare para dhe pas anëtarësimit në OBT

Regjimi tregtar i Shqipërisë deri në vitin 2000, karakterizohej nga një strukturë e thjeshtë tarifash importi me katër nivele *ad valorem* 5 përqind, 10 përqind, 20 dhe 40 përqind. Regjimi tarifor i Shqipërisë është i thjeshtë, *ad valorem*, me 6 nivele (0 përqind, 2 përqind, 5 përqind, 10 përqind dhe 15 përqind). Tabela 4.1 jep ndarjen e tarifave sipas peshës së tyre.

Tabela 4.7 Ndarja e niveleve tarifore, 2014

Kategorirë e tarifave ([1])	**Si % e linjave totale te tarifave**
0 %	49 %
2%	17.7%
5%	0.3%
6%	2.4%
10%	19.3%
15%	12%
Tarifa mesatare, 2014	4.2%[1]
Tarifa mesatare e ponderuar, 2014	1.33%[*]
Numri total i linjave tarifore	9707[1]

Burimi: (1) Llogaritur nga autori
(*) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Shqipëria, përveç tarifës *ad valorem*, nuk aplikon tarifa të veçanta, kuota dhe apo tarifa të kombinuara. Në momentin e anëtarësimit në OBT Shqipëria nuk aplikonte asnjë mbitaksë për importet, asnjë kufizim sasior mbi importet apo eksportet, përveç se në rastet e mbrojtjes së mjedisit apo të ndihmës për industritë delikate, asnjë subvencion për eksportet, asnjë kufizim në transaksionet rrjedhëse, asnjë masë për investimet tregtare, asnjë taksë të brendshme apo taksë tjetër më të lartë për importet sesa për prodhimet e brendshme; asnjë taksë në eksport si adhe asnjë kuotë tarifore. Transformimet më të mëdha të politikës tregtare filluan të ndihen gjatë procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT), proces i cili përfundoi në shtator 2000 me anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në këtë organizatë. Gjatë periudhës së negociatave për anëtarësim, Shqipëria ndërmori një sërë ndryshimesh ligjore të cilat kushtëzonin përfundimin e negociatave të anëtarësimit. Gjithashtu, grupi negociator u shndërrua në grupin e përhershëm të politikës tregtare, misioni i të cilit ishte vlerësimi i përputhshmërisë së akteve të reja ligjore me marrëveshjet e OBT-së si dhe me angazhimet e raportit të anëtarësimit.

Qysh prej anëtarësimit të Shqipërisë në OBT, politika tregtare është frymëzuar nga parimet orientuese dhe qasjet e OBT-së. E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në një dokument strategjik, i cili është Raporti i Anëtarësimit të Shqipërisë në këtë organizatë, i ratifikuar me ligjin nr. 8648, datë 28.06.2000 si dhe ligji nr. 8649, datë 28.07.2000, me të cilin u ratifikuan edhe të gjitha marrëveshjet dhe rezultatet e Raundit të Uruguajit, raund i cili themeloi OBT-në. Kjo qasje plotësohet nga marrëveshjet e tregtisë së lirë, specifikisht nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Komunitetin Evropian dhe shtetet anëtare të tij (MSA), e cila është në fuqi prej muajit prill 2009[13], Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me vendet e Evropës Qëndrore (CEFTA 2006) në fuqi prej muajit korrik 2007, Marrëveshja e Tregtisë të Lirë me Turqinë, në fuqi prej datës 1 maj 2008 dhe Marrëveshja e Tregtisë të Lirë me shtetet e EFTAs, në fuqi që nga janari 2012. Krahas këtyre, ligji nr 9501, datë 03.04.2006, "Për ratifikimin e traktatit të krijimit të Komunitetit të Energjisë" dhe ligji nr 9560, datë 12.06.2006 "Për ratifikimin e amendamentit të dispozitave, që lidhen me tregtinë të Traktatit të Kartës së Energjisë", si dhe legjislacioni sektorial që prek tregtinë plotësojnë kuadrin ligjor të politikës tregtare.

Shqipëria liberalizoi plotësisht regjimin e import-eksportit të mallrave me anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë. Orientimi i politikës tregtare gjatë procesit të anëtarësimit ishte ai i liberalizimit të mëtejshëm të tregtisë si dhe eleminimi i të gjitha pengesave jo tarifore me efekte shtrembëruese për tregtinë. Shqipëria zbaton aktualisht tarifa të ulëta për importet, në nivelet 0 përqind, 2 përqind, 5 përqind, 10 përqind dhe 15 përqind. Tarifa maksimale e kombit më të favorizuar është 15 përqind ndërsa tarifa detyruese (bound rate) mesatare është 6.6 përqind (OBT, 2010). Liberalizimi i vrullshëm tarifor e ka ulur ndjeshëm tarifën mesatare të ponderuar nga 1.76 përqind në 2010 në 1.33 përqind në 2014[14]. Sfida kryesore e një politike tregtare proaktive, që garanton zbatimin e angazhimeve të veta dhe ndjek zhvillimet dhe kërkesat e sektorit privat vendas, është balanca midis thellimit të liberalizimit në përgjithësi, dhe atij tarifor në veçanti, me reduktimin e pengesave të panevojshme administrative dhe teknike në tregti.

Shqipëria ka zbatuar të gjitha angazhimet e veta për politikën tregtare që rrjedhin nga anëtarësimi i saj në OBT. Ajo zbaton gjerësisht parimet e OBT-së duke u mbështetur në

[13] Pjesa tregtare e MSA e njohur si marrëveshja e ndërmjetme ka hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2006.
[14] Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, http://www.dogana.gov.al/sites/default/files/statistika/Buletini%20Fiskal%20%20Janar-Dhjetor%202014.htm

zbatimin e parimit të mos-diskriminimit, transparencës dhe proporcionalitetit në politikat e veta. Aneksi I, Tabela 1 jep analizën e autorit për statusin e angazhimeve të Shqipërisë në OBT si dhe shkallën e zbatimit të tyre në momentin e përfundimit të periudhës tranzitore, viti 2009.

Ecuria e politikës tregtare shqiptare për periudhën 2000-2009 është vlerësuar nga Komiteti i Rishikimit të Politikës Tregtare në OBT, në 28 - 30 prill 2010. Në konkluzionet e rishikimit të parë të politikës tregtare, politika tregtare shqiptare mori vlerësim shumë pozitiv. Mr. Bozkurt Aran (2010, përkthimi im) ka deklaruar "….Ne jemi dëshmitarë të një faze interesante të zhvillimit të Shqipërisë, që fillon nga anëtarësimi në OBT në vitin 2000 dhe përshkallëzohet gjatë proçeseve transformuese të integrimit evropian. Ndryshimet e mëdha të ndërmarra në Shqipëri janë një demonstrim i qartë i reformave shumë të mira në kohë, të fokusuara në hapjen e tregut, liberalizimin e tregtisë dhe investimeve, reformave në mbështetje të sektorit privat, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen ekonomike dhe standarte më të larta jetese....."[15].

4.3.2 Instrumentat e politikës tregtare shqiptare

Marrëveshjet e tregtisë së lirë janë një ndër instrumentat më të rëndësishëm të politikës tregtare, të cilat mundësojnë hapje graduale dypalëshe të tregut dhe krijojnë hapësira tregtare për eksportet shqiptare si dhe marrëveshjet autonome tregtare, të cilat janë unilaterale. Shqipëria ka aktualisht disa marrëveshje të tregtisë së lirë në fuqi dhe nuk zbaton asnjë skemë preferenciale autonome. Marrëveshjet e tregtisë së lirë, megjithëse me parime liberalizimi të ndryshme nga regjimet autonome tregtare, kanë në themel të tyre parimet e marrëveshjeve tregtare të OBT-së dhe janë në zbatim të plotë të nenit XXIV të Marrëveshjes së Përgjithshhme për Tregtinë dhe Tarifat (GATT). Këto marrëveshje janë listuar e komentuar më poshtë.

[15] Trade Policy Review Body, 30 Prill 2010: Trade Policy Review of Albania, *Concluding Remarks by the Chairperson; page 2;* http://www.wto.org/english/tratop_e/tpr_e/tp329_crc_e.htm

a) *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Komunitetin Evropian dhe shtetet e tij anëtare nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë nga ana tjetër.*

Pavarësisht se MSA ka hyrë në fuqi më 1 prill 2009, detyrimet e Shqipërisë për pjesën tregtare kanë filluar më herët. Pjesa tregtare e kësaj marrëveshjeje është në fuqi që nga 1 dhjetori i vitit 2006.

Periudha pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është shoqëruar edhe me një proçes tjetër të përqasjes së politikës tregtare, që lidhet me përshtatjen e politikës tregtare me *acquis communittaire*, duke sjellë si rezultat një presion të vazhdueshëm për përshtatje të politikës tregtare me politikën e përbashkët tregtare (PPT) të BE-së. Ky proçes kërkon ndër të tjera edhe një përafrim të regjimit tregtar të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian. Regjimi tregtar i Shqipërisë, krahasimisht ndaj atij të Bashkimit Evropian, ka tiparet kryesore të mëposhtme:

- Tarifat doganore të zbatuara në Shqipëri janë vetëm "*ad valorem*", në dallim nga Bashkimi Evropian, ku tarifat doganore aplikohen në disa forma, ku përfshihen tarifa "*ad valorem*", tarifa fikse ose tarifa të kombinuara.

- Shqipëria nuk zbaton asnjë kuotë të kombit më të favorizuar, ndërsa BE-ja përdor kuota në regjimin e saj të kombit më të favorizuar.

- Shqipëria nuk ofron sistem të përgjithshëm të preferencave (SPP), ndërsa Bashkimi Evropian ofron SPP për shumë vende në zhvillim.

- Shqipëria nuk bën pjesë në asnjë bashkim doganor, ndërsa Bashkimi Evropian është një bashkim doganor, në të cilin përfshihet edhe Turqia për produktet industriale, si dhe është pjesë e zonës ekonomike evropiane (EEA) ku përveç anëtarëve të saj përfshin edhe vendet e EFTA-s.

Statusi i zbatimit të detyrimeve tregtare që rrjedhin nga MSA jepen në Ankesin I, Tabela 2.

b) *Marrëveshja për ndryshimin dhe pranimin e marrëveshjes së tregtisë së lirë të Evropës Qëndrore (CEFTA 2006)*, në fuqi për Shqipërinë që nga 27 korrik 2007.

CEFTA 2006 përfshin Shqipërinë, Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë, Kroacinë[16], Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Moldavinë. Marrëveshja CEFTA është marrëveshje e gjeneratës së re, e cila përfshin, përveç liberalizimit të tregtisë së mallrave, edhe angazhimin për të liberalizuar tregtinë në shërbime dhe investime dhe liberalizimin e prokurimit publik që nga maji 2010.

Detyrimet e marrëveshjes CEFTA 2006 dhe statusi i zbatimit të tyre jepen në Aneksin I, Tabela 3.

c) *Marrëveshja e tregtisë së lirë me Turqinë* në fuqi më 1 maj 2008.

Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe Turqisë, parashikon hyrje në tregun turk pa taksa për produktet industriale me origjinë nga Shqipëria. Për më tepër, Turqia merr pjesë në bashkimin doganor të Bashkimit Evropian për produkte industriale. Shqipëria ka tregti të lirë për produktet industriale duke filluar që prej 1 janarit të vitit 2013. Hyrja e disa produkteve bazë bujqësore, produkteve të përpunuara bujqësore (PAPs) në tregun shqiptar bazohet në konçesione tregtare, ndërsa për produktet e peshkut janë hequr tarifat doganore (d.m.th. MFN-ja është 0). Hyrja e produkteve bujqësore bazë, PAPs dhe produkteve të peshkut me origjinë nga Shqipëria në tregun turk bazohet gjithashtu në konçesione tregtare.

d) *Marrëveshja e tregtisë së lirë me shtetet e EFTA-s*, në fuqi më 1 nëntor 2010 për Shqipërinë[17] dhe Zvicrën, 1 gusht 2011 për Norvegjinë dhe 1 tetor 2011 për Islandën.

Marrëveshja e tregtisë së lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Shqipërisë përbëhet nga marrëveshja kryesore shumëpalëshe, e cila përfshin parimet kryesore tregtare, masat mbrojtëse dhe rregullat e përgjithshme të tregtisë me vendet EFTA, tregtinë e produkteve industriale, tregtinë e Produkteve të Përpunuara Bujqësore (PAPs) dhe peshkun, dhe tri marrëveshje dypalëshe për tregtinë e produkteve bazë bujqësore, me secilin shtet[18]. Produktet industriale shkëmbehen në mënyrë të ndërsjellë pa tarifa doganore për Shqipërinë dhe shtetet e EFTA-s. Shqipëria dhe shtetet e EFTA-s kanë dhënë konçesione me tarifa reciproke për produktet bazë bujqësore dhe kuotave tarifore për PAPs. Marrëveshja ndërmjet Shqipërisë

[16] Që nga 1 korrik 2013 Kroacia nuk është më pjesë e CEFTA.
[17] Të gjitha preferencat midis Shqipërisë, Norvegjisë dhe Islandës kanë hyrë në fuqi në ditën që marrëveshja ka hyrë në fuqi edhe për këto vende, pavarësisht se për Shqipërinë marrëveshja hyri në fuqi më 1 nëntor 2010.
[18] Shtetet EFTA me te cila Shqipëria ka marrëveshje dypalëshe janë Zvicra, Norvegjia dhe Islanda

dhe shteteve të EFTA-s është një marrëveshje e gjeneratës së re, e cila përfshin edhe tregtinë e shërbimeve dhe investimet (me përjashtim të Norvegjisë). Zbatimi i masave antidumping nuk është pjesë e saj, në ndryshim nga marrëveshjet e tjera të tregtisë së lirë që ka Shqipëria.

4.3.3 Kordinimi i politikës tregtare shqiptare

Politika tregtare në Shqipëri kordinohet mbi baza ad-hoc. Raportet e progresit të Bashkimit Evropian (2010, 2011, 2012, 2013, 2014) theksojnë nevojën për forcimin e kapaciteteve administrative për politikën tregtare. Në vite janë krijuar mekanizma për kordinimin e politikës tregtare në të gjitha dimensionet e saj, hartuese, zbatuese, vlerësuese dhe monitoruese. Urdhri i Kryeministrit, nr 102, datë 06.08.2009, krijon grupin ndërministror të punës për vlerësimin e politikës tregtare në Republikën e Shqipërisë, grup i kryesuar nga zëvendësministri përgjegjës për tregtinë dhe me përfaqësues nga të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo e ndikojnë procesin e politikë-bërjës në fushën e tregtisë.

Objekti i grupit ndërministror të punës ishte përgatitja e raportit të arritjeve në politikat tregtare të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të anëtarësimit të saj në Organizatën Botërore të Tregtisë, duke përfshirë: (i) të dhënat për tarifat dhe tregtinë; (ii) funksionimin dhe bashkëpunimin institucional; (iii) masat në politikat tregtare, përfshirë importet, eksportet, masat për pengesat teknike ndaj tregtisë, masat sanitare dhe fitosanitare, lehtësimin e tregtisë, konkurrencën, ndihmën shtetërore, prokurimin publik, etj; (iv) çështjet e lidhura me pronën industriale dhe intelektuale, politikat e konkurrencës, reformat e të bërit biznes, etj.; dhe (v) të gjitha çështjet e tjera të lidhura me tregtinë. Qëllimi parësor i krijimit të këtij grupi ishte vlerësimi i politikës tregtare për peridhën 2000-2010. Krijimi i tij ishte gjithashtu një përgjigje e kërkesave në rritje për koordinim dhe monitorim të politikës tregtare. Nuk ka evidenca konkrete publike të cilat vërtetojnë shpeshtësinë e mbledhjeve të këtij grupi si dhe nuk gjendet ndonjë raport publik në lidhje me të.

Në përgjigje të kërkesave të vazhdueshme të Bashkimit Evropian (raportet e progresit 2010, 2011, 2012, 2013, 2014) për fuqizim të kapaciteteve administrative për politikën tregtare, ky grup u kthye në një grup të përhershëm nëpërmjet urdhërit të Kryeministrit Nr.133, datë 28.06.2010 duke synuar përgatitjen e raporteve vjetore për zhvillimin e politikave tregtare në

Shqipëri, si një instrument i monitorimit të vazhdueshëm të tyre. Edhe pas këtij ndryshimi nuk gjenden evidenca apo raporte publike që të mund të paraqesin punën e këtij grupi dhe rezultatet e arritura prej tij.

4.4. Politika e Përbashkët Tregtare e Bashkimit Evropian (PPT)

4.4.1 Qëllimet dhe kompetencat e Politikës së Përbashkët Tregtare të BE-së

Bashkimi Evropian vepron në përputhje me parimet dhe rregullat ndërkombëtare të tregtisë, në mënyre të veçantë parimeve të OBT. Mbështetur në marrëveshjen GATT, e cila ka vendosur zbatimin e dy prej parimeve më të rëndësishme: atë të mos-diskriminimit[19] dhe trajtimit kombëtar[20], Bashkimi Evropian zhvillon tregtinë me vendet e treta. Sipas nenit XXIV të GATT lejohen përjashtime ndaj parimit të mos-diskriminimit në rastin e bashkimit doganor, marrëveshjeve të tregtisë së lirë dhe skemave autonome preferenciale. Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE), në përputhje me parashikimet e Traktatit të Romës (1957)[21], vendosi krijimin e bashkimit doganor, si forma më e lartë e integrimit tregtar me synim krijimin e tregut të përbashkët, dhe lejimin e lëvizjes së lirë të forcave të prodhimit.

Si i tillë Bashkimi Evropian është një bashkim doganor[22] krijuar në përputhje të plotë me parashikimet dhe kërkesat e nenit XXIV të GATT 1994, si një nga politikat e para të zbatuara nga Bashkimi Evropian (më parë Komuniteti Evropian) së bashku me Politikën e Përbashkët Bujqësore (PPB). Traktati i Romës vendosi krijimin e bashkimit doganor dhe si rrjedhojë krijimin e tarifës së përbashkët doganore të BE-së, instrumenti më thelbësor i PPT, duke eliminuar krejtësisht çdo tarifë doganore midis anëtarëve të saj. Sipas përcaktimeve të Traktatit të Romës, brenda periudhës tranzitore e cila duhet të përfundonte më 1 janar 1970 (Piet Eeckhout, 2011), do të eliminoheshin të gjitha taksat doganore, kufizimet në import dhe barrierat e tjera tregtare me efekt të njëjtë me to. Po sipas këtij autori, qëllimet e PPT kanë evoluar me Traktatet e Amsterdamit, Nicës dhe Lisbonës.

[19] Parimi i mos-diskriminimit garanton që politika tregtare e një vendi anëtar të OBT-së të mos diskriminojë në regjimin tregtar që i ofron vendeve të treta, anëtare të OBT. (GATT)
[20] Parimi i trajtimit kombëtar nuk lejon trajtim më favorizues për produktet e ngjashme apo prodhuesit vendas ndaj atyre të vendeve të treta, anëtare të OBT. (GATT)
[21] Traktati që themeloi Komunitetin Ekonomik Evropian, 1957, Romë.
[22] Krijuar në përputhje me nenin 110 të traktatit KEE, aktualisht neni 206 i traktatit të TFBE.

Në krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (KEE) politika e përbashkët tregtare nuk përfshinte tregtinë e shërbimeve, pjesën tregtare të së drejtës së pronësisë intelektuale dhe investimet e huaja direkte. Deri para Traktatit të Lisbonës, Komisioni dhe Këshilli ishin institucionet drejtuese të PPT ndërsa me traktatin e vitit 2009 (Traktati i Lisbonës) Parlamenti Evropian është bashkë-legjislator në fushën e PPT (Piet Eeckhout, 2011).

Politika e Përbashkët Tregtare është kompetencë ekskluzive e Komisionit Evropian që nga traktati i Romës, konfirmuar në nenin 3, pika 1 të Traktatit të Funksionimit të BE-së (TFBE), duke mos lënë autoritet dhe fuqi tek vendet anëtare për hartimin dhe miratimin e saj, edhe pse duhet analizuar se deri në ç'masë është e zbatueshme mungesa e fuqisë dhe autoritetit të vendeve anëtare të BE-së në këtë drejtim. PPT mbështetet në parime uniforme në lidhje me ndryshimet tarifore, arritjen e marrëveshjeve mbi tarifat dhe tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, aspektet tregtare të pronësisë intelektuale, investimet e huaja direkte, arritjen e uniformitetit në masat e liberalizimit, politikat e eksportit dhe masat e mbrojtjes së tregut (d.m.th çështjet dumping dhe subvencionet)

PPT përbën pjesën kryesore të politikës me jashtë të BE-së. Pothuaj të gjitha marrëveshjet bilaterale trajtojnë tregtinë në një kapitull kryesor të tyre, dhe në pjesën më të madhe këto marrëveshje, dypalëshe ose shumëpalëshe, ofrojnë preferenca tregtare për vendet e treta. Kjo politikë ka një dimension ligjor shumë të gjerë pasi zbatohet prej rreth 50 vjetësh dhe si e tillë ka në përdorim të saj instrumenta të ndryshëm ligjorë. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, kjo e drejtë është vënë në diskutim herë pas here. Opinioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (GJED) 1/75 në lidhje me rastin "Local Cost Standard" i mohoi të drejtën vendeve anëtare të hyjnë në marrëveshje ndërkombëtare për çështjet e politikës tregtare.

Në marrëveshjet ndërkombëtare, BE përfaqësohet nga Komisioni që është më shumë se një palë, gjë e cila nënkupton se ai merr pjesë në negociata, nënshkruan marrëveshje dhe nëse është e nevojshme merr pjesë në menaxhimin e tyre. Në fushat ku BE ka përgjegjësi eskluzive (bujqësi, tregti, peshkim), shtetet anëtare nuk kanë më një rol parësor pasi Komisioni Evropian negocion dhe menaxhon marrëveshjet në bazë të mandatit të përcaktuar nga Këshilli. Sipas Nenit 351 të TFBE të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara nga shtetet anëtare para anëtarësimit të tyre në Union nuk preken nga dispozitat e Traktateve. Megjithatë, në rastin e zgjerimit të Unionit nëse marrëveshjet ekzistuese nuk

përputhen me Traktatet, shtetet anëtare të përfshira në këtë situatë duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshme për të eliminuar mospajtueshmëritë.

Bashkimi Evropian vepron mbi bazën e kompetencave të përcaktuara nga traktatet. Tri janë kompetencat kryesore në piramidën hierarkike të Bashkimit Evropian:

- Kompetenca eskluzive[23], sipas të cilës Bashkimi Evropian rregullon fushën e tregtisë. Kjo nënkupton që Komisioni Evropian vepron në emër të vendeve anëtare, p.sh. politika e përbashkët tregtare, politika e përbashkët bujqësore. Në përputhje me nenin 216 të TFBE Bashkimi Evropian ushtron këtë lloj kompetence në rastet kur: (i) përcaktohet kështu nga traktati, (ii) përfundimi i një marrëveshjeje është i nevojshëm për të arritur një objektiv të traktatit, (iii) përfundimi i një marrëveshjeje është përcaktuar në një akt ligjor përkatës, (iv) përfundimi i një marrëveshjeje ka gjasa të ndikojë apo ndryshojë rregulla të përbashkëta[24].

- Kompetenca të ndara midis Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare[25], sipas të cilës vendet anëtare dhe Komisioni Evropian rregullojnë fusha, si p.sh. politikat e transportit, arsimit, shëndetësisë, etj. Sipas këtij parimi, vendet anëtare rregullojnë fushën për sa kohë Bashkimi Evropian nuk ndërmerr asnjë veprim për rregullimin e saj.

- Kompetenca të vendeve anëtare, sipas të cilës vendet anëtare rregullojnë fushën ndërsa Bashkimi Evropian ndërmerr vetëm veprime ndihmëse të natyrës koordinuese.

[23] Neni 3 i traktatit të TFBE,
[24] http://europa.eu/legislation_summaries/glossary/external_responsibilities_en.htm
[25] Neni 4 i traktatit të TFBE

Grafik 4.10 Paraqitja e kompetencave në politikë-bërje në Bashkimin Evropian



Burimi: Informacioni i marrë nga faqja zyrtare e Komisionit Evropian, http://ec.europa.eu/index_en.htm, përpunuar në grafikë nga autori

Gjithsesi, këto kompetenca mund të zgjerohen në përputhje me nenin 352 të TFBE, i cili krijon fleksibilitet brenda kuadrit të politikave të përcaktuara nga traktatet, në mënyrë që Komisioni Evropian, me propozim të vendeve anëtare dhe në unanimitet të plotë, të ndërmarrë masat e duhura pa kërkuar nga vendet anëtare të ndërmarrin hapa konkretë në drejtim të harmonizimit të legjislacionit, nëse traktatet e përjashtojnë këtë[26].

Koncepti i PPT-së dhe kompetencës së Bashkimit Evropian për të, është zgjeruar falë gjykimeve dhe vendimeve të GJED në vite. GJED ka deklaruar se neni 113 i traktatit të KEE (neni 207 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (TFBE)) nuk mund të interpretohet në një mënyrë e cila tenton të kufizojë PPT vetëm në aspektet tradicionale të tregëtisë me jashtë, duke përjashtuar në këtë mënyrë mekanizma të tjerë shumë të zhvilluar të PPT-së. Në rastin e gjykuar nga GJED për juridiksionin e Bashkimit Evropian dhe të anëtarëve në përfundimin e Raundit të Uruguajit të OBT, GJED vendosi që Bashkimi Evropian të ketë kompetenca eskluzive në drejtim të tregtisë së mallrave dhe ofrimit të shërbimeve ndërkufitare. Gjithsesi, GJED vendosi edhe që për çështje të tregtisë së shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale Bashkimi Evropian dhe vendet anëtare të kenë kompetenca të ndara midis tyre (Nicholas Moussis, 2011).

[26] Pika 1 dhe 3, neni 352 i TFBE

4.4.2 Parimet e politikës së përbashkët tregtare

PPT ndjek parimet e përgjithshme të OBT-së përsa i takon tregtisë së saj me vendet e treta. Kutia 4.1 më poshtë jep një përmbledhje të parimeve bazë të OBT-së. Ndërkohë, PPT ndjek edhe parime të tjera të cilat i shërbejnë anëtarëve të Bashkimit Evropian, si pjesë e bashkimit doganor.

a) Parimi i uniformitetit

Parimi i uniformitetit kërkon që të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian të trajtojnë në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtat rregulla importet nga vendet e treta. Kjo kërkon që të njëjtat tarifa doganore, kuota importi dhe masa të tjera kufizuese të zbatohen nga të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian pavarësisht se në cilin vend importohen mallrat. Zbatimi i këtij parimi kërkon që Bashkimi Evropian të zbatojë tarifën e përbashkët doganore me të gjitha vendet e treta. Zbatimi i parimit të uniformitetit, i cili pas përfundimit të periudhës tranzitore në 1 janar 1970, duhet të gjente zbatim të plotë sa i takon regjimit tregtar të vendeve të Bashkimit Evropian, pati probleme të cilat u bënë pjesë e gjykimit të GJED në vitet në vijim. Ky parim arriti të zbatohet plotësisht vetëm pas krijimit të tregut të përbashkët në vitin 1992. Krijimi i tregut të përbashkët garanton zbatim uniform të PPT duke eliminuar edhe kuotat e mbetura të importit (p.sh. tekstile dhe veshje, makinat japoneze dhe bananet, Piet Eeckhout, 2011), në fuqi deri përpara vitit 1992.

Kutia 4.1 Parimet kryesore të OBT-së

Parimet kryesore të Organizatës Botërore të Tregtisë synojnë krijimin e një kuadri të përgjithshëm të tregtisë ndërkombëtare. Këto parime përmbledhin:

i. Parimi i mos-diskriminimit:

- *Parimi i Kombit më t*ë *Favorizuar (MFN)*

Vendet anëtare të OBT-së nuk mund të bëjnë dallime ndërmjet partnerëve të tyre tregtarë. Nëse një anëtari i bëhet një favor i veçantë, (p.sh. tarifë e ulët doganore për një produkt, procedurë lehtësuese importi, etj.) i njëjti trajtim duhet t'i ofrohet të gjithë anëtarëve të tjerë të OBT-së. Ky parim është universal dhe zbatohet si për mallrat ashtu edhe për shërbimet. Gjithësesi, sipas nenit XXIV të GATT lejohen disa përjashtime si p.sh: bashkimet doganore, marrëveshjet e tregtisë së lirë, masat autonome preferenciale (SPP).

- *Parimi i Trajtimit Kombëtar*

Produktet e prodhuara në vend dhe ato të importuara duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, të paktën, pasi mallrat e huaja të kenë hyrë në treg. Ky parim zbatohet në tregtinë e mallrave, për produktet e ngjashme, ndërsa tregtia e shërbimeve është e rregulluar në përputhje me angazhimet e skedulin e angazhimeve specifike të çdo vendi anëtar.

ii. Parimi i Proporcionalitetit

Vendet anëtare lejohen që në përputhje me parashikimet e marrëveshjeve të OBT-së të ndërmarrin masa shtrënguese, të cilat i shërbejnë mbrojtjes së interesave publike, mbrojtjes së jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, mbrojtjes së mjedisit, moralit dhe sigurisë publike. Por, këto masa duhet të jenë shtrënguese deri në nivelin që garantojnë arritjen e qëllimit pa u kthyer në një masë shtrënguese të panevojshme për tregtinë midis vendeve. Vendet anëtare duhet të provojnë se nuk ka një masë tjetër më pak shtrënguese që t'i shërbejë qëllimit të rregullatorit.

iii. Transparenca

Vendet anëtare duhet të garantojnë që të informojnë në kohë dhe me mjete të përshtatshme të gjitha vendet e tjera anëtare të OBT-së për ndryshimet në politikat që prekin tregtinë.

Në përputhje me këto parime, politika tregtare e një vendi anëtar duhet të jetë: (i) jo diskriminuese, (ii) më e lirë dhe pa barriera të panevojshme, (iii) e parashikueshme, (iv) më konkurruese duke eliminuar praktikat "e pa drejta", dhe (v) më transparente.

Burimi: Informacioni marrë nga https://www.wto.org/ dhe përpunuar nga autori

Opinioni 1/75 i GJED është mbështetur pjesërisht në parimin e uniformitetit sipas të cilit kompetencat e politikës tregtare janë kompetenca ekskluzive të Bashkimit Evropian, të zbatuara si të tilla nga Komisioni Evropian. Parimi i uniformitetit arriti të zbatohej plotësisht brenda vitit 1968 si një kërkesë strikte e bashkimit doganor për të zbatuar tarifën e përbashkët tarifore të bashkimit doganor me vendet e treta. Pavarësisht kësaj, vendet anëtare vazhduan mbajtjen në fuqi të kufizimeve sasiore për disa produkte sensitive për sa kohë Bashkimi Evropian nuk arriti të krijonte një sistem unik të kufizimeve sasiore të zbatueshme për bashkimin doganor (Piet Eeckhout, 2011). Neni 115 i KEE i lejon vendeve anëtare të kontrollojnë në mënyrë indirekte importet nga vendet e treta, për më tepër kjo në kushtet e kuotave të ndryshme të zbatuara nga vendet anëtare edhe pas përfundimit të periudhës

tranzitore. Rasti Donckerwolcke shqyrtuar nga GJED, testoi ligjshmërinë e sistemit për të drejtat e vendeve anëtare në drejtim të PPT-së. Me përfundimin e periudhës tranzitore parimi i uniformitetit zbatohet plotësisht në PPT. Gjithashtu, në rastin Donckerwolcke GJED vendosi që vendet anëtare nuk mund të marrin masa legjislative për fushat e kompetencës ekskluzive (d.m.th PPT në rastin tonë), me përjashtim të rasteve kur Bashkimi Evropian jep autorizimin përkatës, konfirmuar në nenin 2, pika 1 të traktatit TFBE.

Megjithatë, pavarësisht sa është paraqitur më lart për parimin e uniformitetit të gjitha rregulloret bazë për importin dhe eksportin kanë dispozita që lejojnë vendet anëtare të marrin masa mbi baza jo-ekonomike në mbrojtje të politikave publike, moralit dhe sigurisë publike si dhe mbrojtjes së shëndetit.

b) Parimi i asimilimit

Parimi i asimilimit duhet parë dhe analizuar ngushtësisht me parimin e uniformitetit. Sipas parimit të asimilimit produktet që importohen nga vendet e treta, në përputhje me përcaktimet e nenit 29 të traktatit të TFBE[27], konsiderohen si të jenë përfundimisht ose tërësisht të asimiluara si produkte që kanë origjinën në një vend të Bashkimit Evropian, pasi ato kanë hyrë në territorin e një prej vendeve anëtare të BE-së. Rasti Donckerwolcke trajtuar më lart testoi ligjshmërinë e dy parimeve njëkohësisht atë të uniformitetit dhe të asimilimit. Sipas këtij rasti, në zbatim të nenit 115 të traktatit të KEE vendet anëtare mund të devijojnë nga parimi i qarkullimit të lirë dhe të marrin masa kufizuese në import, masa të cilat, siç shpjegohet më lart u zhdukën me krijimin e tregut të përbashkët. Me krijimin e këtij të fundit hapësira e vendeve anëtare për të devijuar nga parimi i uniformitetit dhe qarkullimit të lirë të produkteve është eliminuar.

c) Parimi i mos-diskriminimit në PPT

Baza kryesore e parimit të mos-diskriminimit derivon nga GATT, parim i cili përbën bazën kryesore mbi të cilën mbështetet PPT-ja. Sipas këtij parimi, Bashkimi Evropian nuk mund të diskriminojë asnjë vend të tretë nëpërmjet masave dhe dispozitave të legjislacionit kombëtar. Edhe pse, sipas të drejtës ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare mbizotërojnë ndaj

[27] Produktet që vijnë nga një vend i tretë konsiderohen se janë në qarkullim të lirë nëse plotësojnë të gjitha kërkesat dokumentare të importit dhe paguajnë detyrimet doganore në një vend anëtar të BE-së.

legjislacionit kombëtar, parimet e marrëveshjeve ndërkombëtare (parimi i mos-diskriminimit në këtë rast) duhet të bëhen pjesë e legjislacionit kombëtar në mënyrë që ato të bëhen të zbatueshme në një vend të caktuar. Në SHBA, Bashkimin Evropian dhe përgjithësisht në të gjitha vendet anëtare të OBT-së gjykatat zbatojnë doktrinën e interpretimit të legjislacionit në përputhje me traktatet ndërkombëtare. GJED në 1996 në çështjen "Komisioni kundër Gjermanisë për marrëveshjen ndërkombëtare të bulmetrave" vendosi që në të gjitha rastet në të cilat legjislacioni i Bashkimit Evropian lë vend për interpretime, përparësi do t'i jepet dispozitave që janë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare (Van den Bossche, 2008). Gjithsesi, pavarësisht këtij gjykimi në jurisprudencën ndërkombëtare dhe atë të OBT-së përcaktohet se dispozitat e GATT 1947 dhe të të gjitha marrëveshjeve të tjera të OBT-së nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë. Efekti i drejtpërdrejtë nënkupton mundësinë që një palë e prekur të ngrejë padi në gjykatë në rastin kur legjislacioni kombëtar nuk është në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare (Piet Eeckhout, 2011), duke bërë referencë të drejtpërdrejtë në parashikimet dhe dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare, të OBT-së në rastin e tregtisë.

Pjesa më e madhe e vendeve anëtare të OBT-së nuk lejojnë zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të OBT-së. Bashkimi Evropian, SHBA, Kina, Japonia, Kanadaja, etj., refuzojnë t'i japin efekt të drejtpëdrejtë dispozitave të OBT-së në hierarkinë legjislative kombëtare. Kështu, p.sh. mos zbatimi i parimit të mos-diskriminimit, edhe pse parim universal i OBT-së, i detyrueshëm për t'u zbatuar nga çdo anëtar i saj, nuk mund të përdoret si argument ligjor gjatë ankimimit të një çështjeje në gjykatën e shkallës së parë nga një palë e prekur, individ apo biznes privat, nëse ky parim nuk është pjesë e përbërëse e legjislacionit të Bashkimit Evropian (Van den Bossche, 2008). Ka studjues të së drejtës ndërkombëtare që ofrojnë një qasje më pak radikale për zbatimin e efektit të drejtpërdrejtë të dispozitave të marrëveshjeve të OBT-së, (Piet Eeckhout, 20011) duke propozuar që në rastet kur organi i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të OBT-së të ketë marrë një vendim lidhur me mos-përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar me atë të OBT-së atëherë efekti i drejtpërdrejtë mund të zbatohet.

Shkalla e zbatimit të parimit të mos-diskriminimit në Bashkimin Evropian, në rastin "Faust kundër Komisionit", vendimi i GJED tregoi se për sa kohë në legjislacionin e Bashkimit Evropian nuk ka dispozita që detyrojnë zbatimin e parimit të mos-diskriminimit në të gjitha llojet e aspekteve tregtare, ekziston mundësia e mos-zbatimit të parimit të kombit më të favorizuar dhe të trajtimit kombëtar.

4.4.3 Instrumentat e Politikës së Përbashkët Tregtare

PPT-ja e Bashkimit Evropian ka dy instrumenta ligjorë bazë:

1. Instrumentat dypalëshe ose shumëpalëshe. Kjo i referohet marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe si MTL-të apo të tjera si dhe marrëveshjet e OBT-së, dhe

2. Instrumentat autonomë, të cilët në momentin e anëtarësimit në BE kanë zbatim automatik pa iu nënshtruar një procesi legjislativ rregullativ. Kjo i referohet legjislacionit të brendshëm të Bashkimit Evropian, i cili do të trajtohet në përgjithësi në këtë seksion dhe përmbledh rregullat e përgjithshme të importit dhe të eksportit. Legjislacioni i Bashkimit Evropian për importin dhe eksportin përbën bazën kryesore ligjore nga e cila ka devijime, të cilat përcaktohen vetëm me marrëveshjet përkatëse dypalëshe.

Më shumë se 60 përqind e tregtisë së BE-së është intra-BE dhe si e tillë ajo varet krejtësisht nga instrumentat e tregut të vetëm, i cili ndalon çdo lloj proteksioni tregtar midis vendeve anëtare apo nxitje tregtare që shtrembëron konkurrencën midis vendeve anëtare të BE. Ndërkohë, për pjesën e mbetur, 40 përqind, instrumentat kryesorë janë ato të PPT-së, d.m.th. tarifa doganore e përbashkët, rregullat e përbashkëta për importin, rregullat e përbashkëta mbrojtëse, instrumenti për barrierat tregtare dhe rregullat e përbashkëta të eksportit (Nicholas Moussis, 2011).

Tarifa doganore e përbashkët (TDP), është krijuar në 1968 (Piet Eeckhout , 2011), më shumë se një vit përpara përfundimit të periudhës tranzitore të përcaktuar nga Traktati i Romës. TDP përcakton që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian të aplikojnë të njëjtën tarifë doganore për vendet e treta, pavarësisht se në cilin vend anëtar të BE importohet produkti. TDP përmban nivelet autonome tarifore të përcaktuara që në vitin 1968 dhe ato konvencionale të negociuara në GATT (bound rate), të cilat janë të aplikueshme për të gjitha importet edhe për vendet jo anëtare të OBT-së.

Tre janë devijimet kryesore ndaj TDP:

1. Marrëveshjet e tregtisë së lirë me vende të treta për të cilat aplikohen tarifa doganore sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse,

2. Marrëveshja me vendet e ACP (African, Caribbean and Pacific Countries) për të cilat aplikohen tarifa doganore sipas përcaktimeve në marrëveshjen përkatëse,

3. Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave (SPP), në mbështetje të "enabling clause" të GATT. "Enabling clause" është paraqitur për herë të parë në vitin 1979 në GATT si "Vendimi për trajtimin më të favorshëm dhe të diferencuar, reciprocitetit dhe pjesëmarrjes së plotë të vendeve në zhvillim (Decision on Differential and More Favourable Treatment, Reciprocity and Fuller Participation of Developing Countries), vendim i cili lejon vendet e zhvilluara të japin trajtime të diferencuara tarifore dhe më të favorshme për vendet në zhvillim. Ky vendim është zgjeruar në vitin 2004 duke lejuar që edhe vendet në zhvillim të mund të ofrojnë trajtime të diferencuara tarifore për vendet më pak të zhvilluara (WT/COMTD/W/135, 5 October 2004), por ky vendim nuk e ndikon PTT e Bashkimit Evropian.

Duhet thënë gjithsesi, se pavarësisht se skeduli i tarifave është uniform për të gjitha vendet e BE-së, përfitueshmëria e vendeve anëtare prej TPD është e ndryshme dhe si rezultat edhe sjelljet e vendeve sa i takon tarifës doganore janë të ndryshme. Struktura e importit të vendeve anëtare është e ndryshme, rezultat kjo edhe i shkallës së zhvillimit të një vendi anëtar, duke sjellë si rezultat që tarifa mesatare e ponderuar të jetë e ndryshme në vende të ndryshme. Gjithashtu, në kushtet kur disa vende anëtare importojnë produkte me tarifë të lartë doganore bëjnë që një vend anëtar të jetë i prirur që për produktet që importon në sasi më të mëdha të kërkojë mbajtjen e tarifave të larta të përbashkëta. Kjo sjellje e vendeve anëtare çon në një variacion potencial të tarifave të cilat janë të orientuara nga mbrojtja e tregut dhe jo tregu i lirë.

Rregullat e përbashkëta për importin, mbështeten në rregulloren 260/2009 dhe aplikohen si të tilla për të gjitha importet nga vendet e treta. Rregullorja përmban parimin bazë rregullues për importin, sipas të cilit importi është i lirë dhe nuk është subjekt i kufizimeve sasiore. Rregullorja nuk aplikohet për produkte me origjinë nga disa vende të treta si Rusia, Korea e Veriut dhe Kina (Rregullorja e Këshillit 265/2009), si dhe pjesën më të madhe të produkteve të tekstilit (Rregullorja e Këshillit 3030/1993).

Rregullat e përbashkëta mbrojtëse, ndërmerren në rastin kur importi nga një vend i tretë apo grupim vendesh të treta krijon probleme për prodhuesit evropianë. Masat mbrojtëse

përfshijnë masat anti-dumping dhe kundërbalancuese. Masat anti-dumping merren në rastin kur çmimi i një produkti në eksport[28] është më i ulët se sa vlera normale[29] e çmimit të një produkti të ngjashëm. Rregullat për masat anti-dumping përcaktohen në rregulloren e Këshillit 1225/2009. Në të gjitha rastet, përpara marrjes së një mase anti-dumping duhet të vlerësohet dëmi apo rreziku që produkti në fjalë shkakton apo mund të shkaktojë dëm në tregun vendas.

Masat për produktet e subvencionuara[30] nga vendet e treta rregullohen nga Rregullorja e Këshillit 597/2009 sipas së cilës një masë kundërbalancuese synon të kompensojë efektin direkt ose indirekt të subvensionit[31]. Subvencionet e lejuara janë ato që i jepen gjithë industrisë, apo një rajoni të pazhvilluar, për kërkim-zhvillim dhe nxitje të politikave për mbrojtjen e mjedisit (Van den Bossche, 2008). Masat kundërbalancuese ndërmerren nga një vend në të gjitha rastet kur vërtetohet se një produkt është subvencionuar dhe më tej është eksportuar (importuar në vendin i cili po merr një masë kundërbalancuese) duke shkaktuar apo kërcënuar të shkaktojë një dëm në vendin importues ndaj produkteve të ngjashme të prodhuara nga industria vendase.

Instrumenti për barrierat tregtare rregullohet nga Rregullorja e Këshillit 3286/94, e cila përcakton proçedurat e ushtruara në mbrojtje të të drejtave të Bashkimit Evropian për tregtinë ndërkombëtare, në përputhje me kërkesat e OBT-së. Nëpërmjet kësaj rregulloreje, Bashkimi Evropian i përgjigjet pengesave në tregti të krijuara nga vendet e treta duke parashikuar proçedurat për marrjen e masave përkatëse.

Rregullat e përbashkëta të eksportit, janë pjesë e PPT dhe në përputhje me përcaktimet e TFBE qaset nga parimi i uniformitetit. Si e tillë, politika e eksportit duhet të ndjekë të njëjtin parim sa i takon regjimit me vendet e treta. Gjithsesi, neni 207 i TFBE nuk përcakton në mënyrë eksplicite këtë parim për politikat e eksportit. Eksporti i Bashkimit Evropian për

[28] Sipas on-line Business Dictionary: çmimi i eksportit është çmimi që një prodhues merr ose pret të marrë kur eksportohet i barabartë me çmimin f.o.b. price minus kostot e transportit fabrika në kufi.
[29] Sipas on-line Business Dictionary: çmimi/vlera normale është çmimi i pritshëm i një produkti në kushte normale tregu.
[30] Sipas Ligjit, nr.9796, datë 23.7.2007 "Për masat antidumping dhe kundërbalancuese", subvencion është kontributi financiar, i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i dhënë nga Qeveria në vendin eksportues ose të origjinës, i cili jep një përfitim, siç parashikohet në nenin XVI të GATT-it, 1994.
[31] Sipas nenit 1 të marrëveshjes së OBT për subvencionet dhe masat kundërbalancuese subvensioni është (i) një kontribut financiar, (ii) dhënë nga një organ publik, qëndror ose lokal, (iii) që garanton një përfitim ekonomik.

analogji me regjimin e importit është përgjithësisht i lirë dhe nuk ka kufizime sasiore, me përjashtim të disa produkteve të naftës dhe të gazit (Rregullorja e Këshillit 1061/2009).

4.4.4 Traktati i Lisbonës 2009 dhe ndryshimet e politikës së përbashkët tregtare

Nënshkrimi i Traktatit të Lisbonës dhe ndikimet që solli në PPT të Bashkimit Evropian janë analizuar nga shumë autorë dhe në këndvështrime të shumta. Ka autorë që besojnë se Traktati i Lisbonës erdhi si një nevojë kushtetuese dhe e problemeve që po haste Bashkimi Evropian (Wouters dhe Ramopoulos, 2013) apo nevojë për ndryshime të mëdha tek njërëzit, institucionet dhe tendencat e zhvillimeve botërore (Van Seters dhe Klavert, 2011, Pernice, 2008).

Traktati i Lisbonës është një përgjigje ndaj Traktatit Kushtetues të Bashkimit Evropian të refuzuar në vitin 2005 nga francezët dhe hollandezët[32]. Ky traktat e ndryshoi PPT në përmbajtje dhe në procesin e vendim-marrjes (Piet Eeckhout, 2011). Kështu, sipas parashikimeve të tij, politika tregtare e Bashkimit Evropian do të trajtojë edhe investimet e huaja direkte si dhe marrëveshjet dypalëshe për trajtimin e investimeve. Në mënyrë të veçantë për marrëveshjet e investimeve të huaja vendim-marrja bëhet e përbashkët, me pjesëmarrjen e Komisionit Evropian dhe vendit anëtar të BE-së, që synon të ketë një marrëveshje të re për trajtimin e investimeve të huaja me një vend të tretë[33]. Sipas Traktatit të Lisbonës, Bashkimit Evropian i është dhënë personalitet juridik (Sterbova, 2010), si dhe janë ndryshuar proçedurat e vendim-marrjes. Personaliteti juridik duhet kuptuar si një e drejtë e Bashkimit Evropian për të nënshkruar një kontratë/marrëveshje në emër të vendeve anëtare, kryesisht konventat ndërkombëtare apo organizatat ndërkombëtare (Schuman, 2009). Nuk ka dyshim që Traktati i Lisbonës solli transformime të mëdha për PPT në Bashkimin Evropian (Pech 2011, Woolcock 2010, Falkner 2008) dhe këto transformime ndihen edhe në proceset integruese të vendeve aspiruese për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ky Traktat rikonfirmon të drejtat ekskluzive të Bashkimit Evropian në lidhje me PPT-në (neni 3, 1 (e) i TFBE). Dispozitat e PPT janë në Pjesën V të TFBE, Titulli 1, veprimet me jashtë, specifikisht nenet 206 dhe 207 (nenet 131 dhe 133 të Traktatit të Bashkimit Evropian, TBE). Përfshirja e PPT-së në titullin "veprimet me jashtë" dhe konfirmimi i të drejtës ekskluzive të Bashkimit Evropian lidhur me PPT ka ngritur pikëpyetje lidhur me përdorimin

[32] Versioni i konsoliduar i Trakteteve të BE-së dhe kartës së të drejtave themelore.
[33] Shiko për më shumë nenin 207 të TFBE.

e mundshëm të politikës së jashtme dhe asaj të sigurisë si një instrument për arritjen e objektivave të politikës tregtare Sterbova (2010). Rasti i fundit i Rusisë dhe vendimit të BE-së për embargo ekonomike dhe tregtare në 2014 janë një rast tipik kur PPT-ja përdoret si një instrument për arritjen e objektivave të politikës së jashtme të BE-së. Gjithashtu, Sterbova (2010) ilustron këtë karakteristikë të PPT me kushtet e vendosura nga BE-ja në negociatat tregtare për një marrëveshje të tregtisë së lirë me Indinë duke përfshirë në marrëveshje dispozita që lidhen me të drejtat e njeriut dhe për mos-përhapjen e armëve nukleare.

Përcaktimet e Traktatit të Lisbonës për Politikën e Përbashkët Tregtare të Bashkimit Evropian paraqiten në kutinë 4.3.

Kutia 4.3 Përcaktimet e PPT sipas Traktatit të Lisbonës

1. Qëllimet e PPT-së, plotësuar edhe nga vendimet e GJED përcaktohen në nenin 207(1). Ato përfshijnë:
   - Ndryshimet e nivelit të tarifës bazë,
   - Përfundimin e marrëveshjeve për tarifat dhe tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe aspektet tregtare të IPR,
   - Përfundimi i marrëveshjeve për trajtimin e investimeve të huaja direkte në nivel Komisioni Evropian.
   - Arritja e masave uniforme për liberalizimin, politikën e eksportit dhe masat mbrojtëse. (d.mth. anti-dumping dhe masat kundërbalancuese)
2. Rregullore të ndryshme sipas nenit 207(2) (p.sh. skemat preferenciale autonome dhe SPP)
3. "Komiteti i nenit 133", ndryshuar në nenin 207(3), përgjegjës për PPT në nivelin e Komisionit Evropian me përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare,
4. Marrëveshjet ndërkombëtare, sipas neneve 207(3-5), 216, 218

Burimi: Informacioni marrë nga http://europa.eu/index_en.htm dhe përpunuar nga autori

Objektivat e PPT-së qëndrojnë të pandryshueshme, me përjashtim të përfshirjes së IHD në nenin 206. Më shumë rreth kësaj kompetence dhe implikimeve që rrjedhin prej saj do të analizohet më poshtë.

Objektivat e Bashkimit Evropian për politikën tregtare (Komisioni Evropian, 2010) orientohen nga: (1) interesi i lartë si lider i tregtisë rajonale dhe botërore në hapjen e tregjeve dhe krijimin e një kuadri të qartë rregullator, (2) përgjegjësia e lartë ndaj qytetarëve të saj dhe të pjesës tjetër të botës, (3) domosdoshmëria për të fuqizuar konkurrueshmërinë e ekonomisë së Bashkimit Evropian në botë.

Ndryshimet në procesin e vendim-marrjes sipas Lisbonës përfshijnë:

1. Roli i ri legjislativ i Parlamentit Evropian lidhur me PPT-në. Kjo e fundit është tashmë pjesë e procesit të zakonshëm legjislativ në Parlamentin Evropian (Eeckhout, 2011). Këshilli i Marrëdhënieve me Jashtë, të cilit i përket edhe PPT, përcakton të gjitha veprimet me jashtë të Bashkimit Evropian në përputhje me qëllimet strategjike të përcaktuara nga Këshilli Evropian, duke garantuar koherencë të plotë të veprimeve të BE-së. Përpara Lisbonës Këshilli vendoste i vetëm mbi PPT, ndërsa, me ndryshimet e bëra, Këshilli dhe Parlamenti Evropian kanë kompetenca të përbashkëta vendimmarrëse, (Sterbova, 2010). Sipas nenit 36, pika 2 të traktatit të BE, Parlamenti Evropian zhvillon një debat mbi ecurinë e zbatimit të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, duke përfshirë edhe PPT. Sipas George-Dian Balan (2008) parlamentet kombëtare nuk kanë më asnjë rol në ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen me tregtinë e mallrave, shërbimeve, pronësinë intelektuale dhe investimet e huaja direkte sepse ato janë konfirmuar nga Traktati i Lisbonës të jenë kompetencë ekskluzive.

2. Bashkimi Evropian do të përfaqësojë, nëpërmjet Komisionit Evropian, të gjitha vendet anëtare në të gjitha institucionet ndërkombëtare që lidhen me tregtinë, përfshirë këtu, përveç tregtisë dhe mallrave dhe shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësinë intelektuale edhe investimet.

3. Saktësimin e formulës vendimmarrëse sipas të cilës Këshilli vendos me mazhorancë të cilësuar për marrëveshjet me një apo disa vende të treta apo me organizata ndërkombëtare (neni 207 TFBE, pika 3), megjithëse në praktikë tentohet vendim-marrje me konsensus (Sterbova, 2010). Unanimiteti (neni 207, paragrafi 3) kërkohet për tregtinë e shërbimeve kulturore, audiovizuale, sociale, arsimore, pronësinë intelektuale dhe investimet e huaja direkte.

Traktati i Lisbonës ka rikonfirmuar të gjitha qëllimet që lidhen me tregtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe bashkimin doganor (neni 206 i TFBE), duke e shtrirë më tej qëllimin e PPT-së tek investimet e huaja direkte. Për këtë të dytën do flitet më poshtë. Ndërkohë, ndryshimet më thelbësore në përmbajtjen dhe qëllimet e PPT-së lidhen me tregtinë e shërbimeve dhe aspektet tregtare të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe investimeve të huaja direkte.

Tregtia e shërbimeve dhe aspektet tregtare të pronësisë intelektuale

Tregtia e shërbimeve dhe aspektet tregtare të pronësisë intelektuale janë konfirmuar si qëllime të PPT-së me Traktatin e Lisbonës (neni 207, pika 1 e traktatit të TFBE). GATT 1994 krijoi një kuadër institucional dhe rregullator multilateral për tregtinë e shërbimeve dhe aspektet tregtare të pronësisë intelektuale. Krijimi i OBT, specifikisht dispozitat e GATS dhe TRIPS, krijuan disa vështirësi në drejtim të tregtisë së shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale. Kjo për faktin se PPT është kompetencë ekskluzive e Bashkimit Evropian dhe si e tillë edhe marrëveshjet ndërkombëtare si OBT janë në kompetencë të saj.

Në këtë situate GJED nëpërmjet opinionit të saj 1/94, edhe pse nuk diskutoi të drejtën ekskluzive të Bashkimit Evropian për PPT-në, u shpreh se të drejtat e Bashkimit Evropian për të përfunduar marrëveshjet e OBT-së prekin vetëm tregtinë e mallrave dhe megjithëse GATS dhe TRIPS janë marrëveshje të OBT, nuk mund të përfundoheshin nga Bashkimi Evropian pasi ato ishin ende pjesë e kompetencave të ndara midis vendeve anëtare dhe Komisionit Evropian.

Por, tregtia e shërbimeve edhe pse pjesë e GATS dhe e traktatit të Nicës (neni 133) sipas opinionin 1/78 të GJED paracakton që vetëm Mënyra 1 (Mode 1)[34] e ofrimit të shërbimit ishte pjesë përbërëse e PPT-së. Ndërkohë, me Traktatin e Lisbonës e drejta e Bashkimit Evropian për tregtinë e shërbimeve shtrihet edhe për Mënyra 2, 3 dhe 4 të ofrimit të shërbimit (Eeckhout, 2011).

Duke iu kthyer analizës së tregtisë së shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale, neni 207, pika 1 e Traktatit të TFBE përcakton se përfundimi i marrëveshjeve në këto fusha nuk ka përcaktuar nëse kjo bëhet nëpërmjet masave të brendshme apo atyre të jashtme si dhe nuk ka përcaktuar se cila prej tyre ka precedencë. Gjithashtu, sipas traktatit tregtia e shërbimeve në fushën e marrëveshjeve të transportit nuk përfshihet në PPT dhe nuk është pjesë e kompetencave ekskluzive të Bashkimit Evropian (neni 207, pika 5 e TFBE).

Sipas Opinionit 1/94 të GJED dhe modifikimeve të traktatit të Nicës disa shërbime janë pjesë e kompetencave të ndara midis vendeve anëtare dhe kjo bën të nevojshëm përfundimin e

[34] Mënyra 1 e ofrimit të shërbimit ose shërbimi ndërkufitar mundësohet atëherë kur ofruesi i shërbimit nuk është në të njëjtin vend me përfituesin e shërbimit.

marrëveshjeve mikse. Traktati i Lisbonës e zgjeroi kompetencën e tregtisë së shërbimeve duke përfshirë të gjitha llojet, përjashtuar shërbimin e transportit. Sipas Bungenberg (2011) kjo solli si rezultat reduktimin e ndjeshëm të nevojës për marrëveshje mikse.

Sa i takon marrëveshjes TRIPS duhet thënë se ajo është një marrëveshje ndërkombëtare e cila tenton të krijojë një kuadër multilateral në lidhje me harmonizimin e legjislacionit për pronësinë intelektuale (Eeckhout, 2011). Megjithatë, pavarësisht se PPT nuk parashikon në vetvete harmonizim legjislacioni të brendshëm, një pjesë e konsiderueshme e dispozitave të TRIPS, që lidhen me zbatimin e parimeve të trajtimit kombëtar dhe kombit më të favorizuar[35] dhe ndarja midis pjesës tregtare të pronësisë intelektuale dhe harmonizimit të legjislacionit, është shumë e vështirë të bëhet.

Investimet e huaja direkte

Nga parashtrimet e mësipërme dhe analizat e bëra për qëllimet dhe kompetencat në fushën e politikës tregtare është e qartë se pavarësisht nga saktësimet e bëra në vite me modifikimet e traktateve të Bashkimit Evropian tregtia e mallrave dhe bashkimi doganor, tregtia e shërbimeve dhe aspektet tregtare të pronësisë intelektuale kanë qënë në një farë mënyre pjesë e PPT-së. Investimet e huaja direkte janë përfshirë për herë të parë në qëllimet e PPT-së me Traktatin e Lisbonës. Neni 207 (ish neni 133 i TKE), pika 1 e Traktatit të Lisbonës përfshin investimet e huaja direkte në PPT[36], ndërkohë që neni 206 i traktatit të Lisbonës (ish neni 131 i TBE) përfshin qëllimin ".... ndalimin progresiv të kufizimeve në tregtinë ndërkombëtare dhe mbi investimet e huaja direkte[37].

Nga analiza e përmbajtjes së neneve dhe mbështetur në analizat e autorëve të cituar në këtë kapitull, dalin disa probleme kryesore:

- Kompetenca ekskluzive e Bashkimit Evropian për PPT shtrihet edhe për IHD duke kufizuar mundësitë dhe fuqitë e vendeve anëtare për të lidhur marrëveshje të reja në këtë fushë;

[35] Neni 3 dhe 4, marrëveshja TRIPS.
[36] Neni 207, pika TFBE: "Politika e përbashkët tregtare bazohet në parimin e uniformitetit, sidomos sa u takon ndryshimeve të normave tarifore, lidhjes së marrëveshjeve për tregtinë e mallrave, shërbimeve dhe aspekteve tregtare të pronësisë intelektuale, investimeve të huajaja direkte, ……"
[37] Neni 206, Traktati i TFBE.

- Parimi i uniformitetit kërkon që të gjitha vendet e Bashkimit Evropian të kenë regjim të njëjtë në lidhje me investimet e huaja direkte sa i takon mbrojtjes së tyre dhe kushteve për hyrjen në treg. Kjo ngre pyetjen e fuqisë ligjore që kanë marrëveshjet e investimeve, në fuqi deri në dhjetor 2009 kur hyri në fuqi Traktati i Lisbonës;

- Përfshirja ose jo në kompetencën e Bashkimit Evropian e të gjitha tipeve të investimeve apo përqasja e një politike të diferencuar mbështetur në vlerësimet paraprake të Komisionit Evropian;

- Konsistenca midis traktateve të Bashkimit Evropian dhe Marrëveshjes TRIMS dhe GATS në OBT dhe marrëveshjeve të tjera që prekin investimet e huaja direkte dhe shërbimet.

Sipas Bungenberg et al. (2011) të gjitha marrëveshjet bilaterale që bien ndesh me të drejtën e BE-së duhet të modifikohen ose shfuqizohen. Nga kërkimi i bërë në faqen zyrtare të Komisionit Evropian, rezulton se pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, nuk ka asnjë rast të ngritur në GJED sa i takon investimeve të huaja direkte dhe në mënyrë eksplicite lidhur me kompetencën ekskluzive të Bashkimit Evropian lidhur me to. Për analogji mund të thuhet se kompetenca ekskluzive e Bashkimit Evropian trajtuar më lart, në përputhje me opinion 1/75 të GJED duhet të shtrihet edhe për investimet e huaja direkte. Për sa kohë nenet 206 dhe 207 të traktatit të Lisbonës i kanë përfshirë në mënyrë eksplicite investimet e huaja direkte në fushën e kompetencës së PPT-së, atëherë e drejta eksluzive e Bashkimit Evropian vepron edhe tek investimet e huaja direkte.

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë përfunduar rreth 1200 marrëveshje bilaterale investimesh me vende të treta, që mbulojnë të gjitha llojet e investimeve dhe përbëjnë pothuajse gjysmën e marrëveshjeve të tilla në fuqi në botë (Komisioni Evropian, 2010). Kjo panoramë bën të qartë faktin se politika e përbashkët në fushën e investimeve nuk mund të arrihet brenda natës. Gjithashtu, përveç konsideratave për uniformitet në regjimin e brendshëm të investimeve, në të njëjtën kohë Bashkimi Evropian kërkon që të sigurojë një nivel të përbashkët dhe të njëjtë mbrojtjeje për të gjitha investimet e anëtarëve të tij në vendet

e treta, duke përqasur kështu filozofinë "rrugë dykalimshe" për investimet.[38] Siç shprehet edhe Karel De Gucht (2010), Komisioneri Evropian për Tregtinë, "politika e jashtme e investimeve të Bashkimit Evropian duhet të shërbejë si një instrument për zhvillimin ekonomik dhe social dhe si e tillë të përcaktojë rregulla për investimet e huaja në Bashkimin Evropian dhe të garantojë të drejtat e investitorëve të huaj" [39].

Marrëveshjet e investimeve përfshijnë të gjitha format e investimeve dhe format e mbrojtjes së tyre, arbitrazhin dhe zgjidhjen e mos-marrëveshjeve në rastin e ndërmarrjeve shtetërore, dhe në disa raste edhe përjashtime sektorësh të ndjeshëm. Kjo krijon një pozicion jo uniform sa i takon mbrojtjes apo edhe dispozitave të tjera që lidhen me investimet pasi i lë hapësirë vendeve që ti trajtojnë ato në përputhje me interesat kombëtare. Ndërkohë, interesat kombëtare në fushën e investimeve të huaja direkte mund të mos konvergojnë në të gjitha rastet me interesat në nivel të Bashkimit Evropian, duke mos lejuar kështu uniformitet midis vendeve.

Komisioni Evropian (2010) nëpërmjet dokumentit "Drejt një politike ndërkombëtare bashkëkohore të investimeve" (Towards a comprehensive European international investment policy: Communication), ka përcaktuar drejtimet kryesore të politikës së përbashkët evropiane në fushën e investimeve. Me rregulloren Nr. 1219/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 12 dhjetor 2012 "Krijimi i rregullimit të përkohshëm për marrëveshjet dypalëshe të investimeve të huaja direkte midis vendeve anëtare dhe vendeve të treta" janë përcaktuar detyrimet e vendeve sa i takon marrëveshjeve të investimeve të huaja direkte me vendet e treta. Kjo rregullore përcakton për një periudhë tranzitore modalitetet për vendet anëtare në lidhje me marrëveshjet e investimeve në fuqi apo marrëveshje të reja potenciale për t'u përfunduar.

Gjithashtu, ndryshimet e kompetencave të PPT-së në lidhje me investimet e huaja direkte kanë hapur debatin edhe në lidhje me faktin nëse e drejta eksluzive e Bashkimit Evropian në lidhje me investimet e huaja direkte prek çdo lloj investimi. Sipas Piet Eeckhout (2011) nocioni "investime të huaja direkte" sipas të drejtës evropiane nuk mbulon të gjitha llojet e formave të investimit që janë të mbuluara nga marrëveshjet bilaterale moderne. Diskutimi

[38] Towards a comprehensive European international investment policy: Communication from the Commission to the Council, the European Parliament, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, com(2010)343, July 2010, faqe 4.
[39] Implications of Lisvon Treaty on EU Commercial Policy;; S&D Seminar on EU Commercial Policy, Oporto, 8 October 2010, faqe 2.

rreth politikës së investimeve të huaja direkte në BE dhe shkallës në të cilën Traktati i Lisbonës e trajton atë në mënyrë ezauruese bëhet i vështirë. Edhe pse ky traktat e ndryshoi thelbësisht PPT-në, duke përfshirë në të edhe investimet e huaja direkte, arritja e harmonizimit të plotë të politikës së investimeve të huaja direkte midis vendeve anëtare të BE-së dhe zbatimi i parimit të uniformitetit për politikën e investimeve të huaja direkte kërkon më shumë kohë.

Së fundi, konsistenca e traktateve të Bashkimit Evropian dhe marrëveshjeve të investimeve të huaja direkte me legjislacionin dhe rregullat e OBT-së janë të diskutueshme. Evolimi i marrëveshjeve tregtare dhe zhvillimet në OBT kanë bërë që investimet të jenë pjesë e marrëveshjeve preferenciale të tregtisë së lirë në një kapitull apo nene të veçanta[40]. Gjithashtu pjesë të investimeve janë të mbuluara nga GATS, Mënyra 3[41] e ofrimit të shërbimit e cila prek investimet direkte të një vendi anëtar në një vend tjetër në fushën e shërbimeve. Kjo nënkupton çdo lloj biznesi apo formë tjetër krijimi profesional[42]. Gjithashtu, investimet kërkojnë personel për të ofruar një shërbim gjë që mbulohet nga Mënyra 4 e ofrimit të shërbimit në GATS[43] dhe në përputhje me dispozitat e TRIMS[44] në rastin e investimeve në prodhim mallrash. Duke (i) vlerësuar detyrimin për zbatimin e parimit universal të kombit më të favorizuar (MFN) në OBT, të zbatueshëm për mallrat dhe shërbimet, (ii) parimin e trajtimit kombëtar, të detyrueshëm për mallrat por jo për shërbimet, (iii) preferencat e dhëna nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale të investimeve për investime të caktuara nga një vend i tretë, dhe (iv) detyrimin e Bashkimit Evropian për zbatimin e parimit të konsistencës në veprimet e tij me jashtë(George-Dian Balan, 2008), unifikimi i politikës së investimeve të huaja direkte në OBT do të kërkojë kohë.

4.4.5 Kordinimi i Politikës së Përbashkët Tregtare

Politika e përbashkët tregtare (PPT) zhvillohet në kuadër të parimeve dhe objektivave të veprimit të jashtëm të Bashkimit (neni 207, pika 1, TFBE). Këto parime dhe objektiva

[40] Marrëveshja CEFTA 2006, kapitulli VI, B: Investime, nenet 30-33; Marrëveshja e Tregtisë së Lirë Shqipëri-EFTA, kapitulli 4, neni 24.
[41] Mode 3 e ofrimit të shërbimit kërkon prezencë tregtare në një vend të caktuar nëpërmjet krijimit të kompanisë, neni 1, pika 2, (c) të marrëveshjes GATS.
[42] Shiko për më shumë neni XXVIII, (d) i marrëveshjes GATS
[43] Mënyra 4 e ofrimi i shërbimit bëhet nëpërmjet një personi fizik profesional të një vendi anëtar në një vend tjetër nëpërmjet pjesëmarrjes së personelit kyç.
[44] Shiko për më shumë nenet 1-5 të marrëveshjes OBT/TRIMS, “Marrëveshje për masat e investimeve që lidhen me tregtinë”.

parashikohen në nenin 21 dhe 22 të TFBE-së. Parlamenti Evropian dhe Këshilli miratojnë rregulloret ku parashikohet kuadri për vënien në zbatim të PPT-së (neni 207, pika 2, TFBE). Vetë marrëveshjet lidhen nga Këshilli dhe në përgjithësi kërkojnë pëlqimin e Parlamentit Evropian (neni 207, pika 3, lidhur me nenin 218, TFBE).

Negocimi i marrëveshjeve me një, shumë vende të treta ose organizata ndërkombëtare kërkon që fillimisht Komisioni t'i rekomandojë Këshillit autorizimin për hapjen e negociatave dhe më tej të vijohet me procesin negociues. Këshilli dhe Komisioni janë përgjegjës për të siguruar që marrëveshjet e negociuara të pajtohen me politikat dhe rregullat e brendshme të Bashkimit Evropian. Komisioni i zhvillon këto negociata duke u konsultuar me një komitet të posaçëm të emëruar nga Këshilli për ta mbështetur Komisionin gjatë negociatave. Ky komitet i posaçëm tani njihet si Komiteti për Tregtinë e Jashtme (KTJ), i njohur më parë si Komiteti i Nenit 133. Funksioni kryesor i këtij komiteti është të japë këshilla për negociatat tregtare dhe për politikën tregtare. Shpesh në programin e punës të KPT-së dalin çështjet e OBT-së për të cilat ky komitet duhet të shprehet dhe t'i rekomandojë Komisionit pozicionin që duhet mbajtur në emër të vendeve anëtare. Shtesat dhe ndryshimet e pësuara nga Traktati i Lisbonës nuk i kanë ndryshuar dispozitat bazë të nenit që rregullon KPT-në. Megjithëse Politika e Përbashkët Tregtare është kompetencë ekskluzive e Komisionit Evropian, ky i fundit merr konsensusin e të gjitha vendeve anëtare për pozicionet tregtare të mbajtura gjatë negociatave. Për këtë, secili vend ka krijuar një mekanizëm konkret, i cili nuk është i unifikuar midis vendeve, por respekton traditën dhe nevojat në secilin vend. Përgjithësisht ministritë që merren me çështjet ekonomike janë ato që drejtojnë KPT-në në çdo vend (p.sh. Austria, Hollanda). Gjithësesi ka edhe raste kur Ministria e Punëve të Jashtme (p.sh. Estonia) merr drejtimin e KPT-së apo ministria që merret me problematikat që lidhen me biznesin (p.sh. Anglia). Aneksi I, Tabela 4 jep eksperienca të mekanizmit të koordinimit të politikës tregtare në disa vende anëtare të Bashkimit Evropian.

4.5 Ndikimi i PPT në politikën tregtare shqiptare

Politika tregtare shqiptare do të ndikohet në mënyrë thelbësore nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian, për t'u përshtatur me parimet dhe qëllimet e PPT-së si dhe zhvillimet e saj sipas dispozitave të Traktatit të Lisbonës (2009). Kërkesat për adoptim të PPT-së nga Shqipëria mbështeten së pari në zbatimin efektiv të parimeve të PPT-së si dhe të përshtatjes së instrumentave zbatues të saj.

Analiza e mësipërme e politikës së përbashkët tregtare të Bashkimit Evropian dhe ndryshimet thelbësore të pësuara nga traktati i Lisbonës, shërbejnë si bazë e mirë për politikë-bërësit për përshtatjen nga Shqipëria të PPT-së. Me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, Shqipëria është e detyruar të zbatojë plotësisht PPT-në duke zbatuar parimet e saj dhe duke humbur në të njëjtën kohë të drejtën për të ndërmarrë apo propozuar politikën tregtare në emër të Shqipërisë. Progres raporti i Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2014 njeh progres të moderuar të politikës tregtare dhe nevojën për ngritje të kapaciteteve administrative. Krijimi i një mekanizmi të ngjashëm koordinimi me KPT duhet të krijohet edhe në Shqipëri ose të përshtaten forma të tjera institucionale për të garantuar koordinimin në kohë të masave dhe iniciativave që prekin politikën tregtare.

Mbështetur në analizën e paraqitur në seksionet 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 dhe 4.4.4 politika tregtare shqiptare duhet të garantojë që nga dita e parë e anëtarësimit në Bashkimin Evropian zbatimin e:

a) Detyrimeve që rrjedhin nga bashkimi doganor:

   i. Zbatimin e tarifës doganore të përbashkët dhe Kodit Doganor të Bashkimit Evropian. Vetëm 17 përqind e linjave tarifore të Shqipërisë do të mbeten të pandryshuara pas anëtarësimit dhe 32 përqind e tarifave që janë aktualisht 0 përqind do të rriten në nivelin e tarifës së Bashkimit Evropian[45].

   ii. Zbatimin e regjimit tregtar të Bashkimit Evropian sa i takon ndalimeve, kufizimeve apo çdo mase tjetër shtrënguese në import dhe eksport si dhe të masave mbrojtëse (masat anti-dumping dhe kundërbalancuese);

   iii. Zbatimin e Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave të Bashkimit Evropian.

b) Detyrimet që rrjedhin nga statusi tregtar në OBT

   i. Rinegocim të nivelit të “bound rate” dhe tarifës bazë për të garantuar njëkohësisht zbatimin e tarifës së përbashkët doganore të Bashkimit Evropian dhe mosprishjen e regjimit tregtar të para anëtarësimit që vendet anëtare të OBT-së kanë me Shqipërinë;

[45] Llogaritje të autorit.

ii. Rinegocim i skedulit të angazhimeve specifike të shërbimeve në GATS për të përshtatur angazhimet e hyrjes në treg dhe të trajtimit kombëtar me Bashkimin Evropian;

iii. Rinegocim të të gjitha angazhimeve të tjera sektoriale që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera të OBT-së, si Marrëveshja e Teknologjisë së Informacionit, etj.

c) Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe

i. Shfuqizimin e të gjitha marrëveshjeve të tregtisë së lirë që Shqipëria ka aktualisht në fuqi dhe njohja dhe zbatimi i të gjitha marrëveshjeve të tregtisë së lirë që ka Bashkimi Evropian;

ii. Rinegocimi i regjimit tregtar të marrëveshjeve të tregtisë së lirë të Shqipërisë përpara anëtarësimit me objektiv përfshirjen e interesave të Shqipërisë në marrëveshjet ekzistuese të Bashkimit Evropian me të njëjtat vende të treta.

iii. Shfuqizimi i të gjitha marrëveshjeve për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar të Shqipërisë;

iv. Rishikimi i marrëveshjeve bilaterale të investimeve të huaja direkte në përputhje me rregulloren No 1219/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të 12 dhjetor 2012 "Krijimi i rregullimeve provizore për marrëveshjet e investimeve bilaterale midis vendeve anëtare dhe vendeve të treta"

v. Zbatimi automatik i legjislacionit tregtar.

Për të gjitha fushat e PPT-së për të cilat Bashkimi Evropian ka legjislacion (rregullore) Shqipëria duhet të shfuqizojë legjislacionin e vet dhe të zbatojë automatikisht legjislacionin e Bashkimit Evropian.

4.6 Përfundime

Në këtë kapitull u diskutua politika tregtare dhe zhvillimet e para dhe pas anëtarësimit të Shqipërisë në OBT. Gjithashtu ky kapitull analizoi edhe PPT të BE-së, instrumentat dhe

parimet e saj dhe transformimin e pësuar pas Traktatit të Lisbonës në qëllimet dhe fushën e mbulimit të PPT. Kapacitetet administrative dhe nevojat për koordinimin e PPT janë analizuar në këtë kapitull, duke paraqitur në të njëtën kohë edhe disa shëmbuj krahasimorë të strukturave koordinuese të politikës tregtare në disa vende të Bashkimit Evropian. Në përfundim, mbështetur në analizën e PPT kapitulli parashtron edhe ndikimin e politikës tregtare shqiptare në momentin e anëtarësimit në BE.

Analiza e tregtisë së jashtme paraqitur në seksionin 4.2 tregon se gjatë viteve 2007-2013 volumi i përgjithshëm i tregtisë është rritur në terma absolutë dhe relativë, rritje e shoqëruar me luhatje gjithësesi. Rritja mesatare vjetore e volumit tregtar për periudhën 2006-2013 është 11 për qind. Viti 2009 tregoi rënie, ndërkohë që gjatë viteve 2010-2011 rritja e volumit tregtar u rikthye në ritmet të konsiderueshme të rritjes. Gjate 2 viteve të fundit, 2012 dhe 2013, ecuria e volumit tregtar dha përsëri shenja dobësie, me nivele rritjeje shumë modeste deri në 3 përqind. Bashkimi Evropian është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë dhe destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare. Në vitin 2013, eksportet me këto vende arritën rreth 76.6 përqind të eksporteve totale në vitin 2013 dhe 62.2 përqind të importeve totale për të njëjtin vit. Partnerët kryesorë tregtarë brenda bllokut të BE-së janë Italia, Greqia, Gjermania dhe Spanja.

Analiza e zhvillimeve të politikës tregtare shqiptare, paraqitur ne seksionin 4.3, përfshirë këtu edhe seksionet, na lejon të arrijmë në përfundime të rëndësishme lidhur me ndikimin e politikës tregtare shqiptare pasi ajo ka vendosur në kontekst të gjithë perspektivën e detyrimeve që rrjedhin pas anëtarësimit. Kjo analizë gjithashtu jep një panoramë të qartë të stadit mbi të cilin fillon harmonizmi i politikës tregtare shqiptare duke paraqitur në të njëjtën kohë edhe se ky detyrim rrjedh nga MSA, e cila është mbështetur në nenin XXIV të GATT dhe nenin V të GATS.

Ndikimi i politikës tregtare shqiptare pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian do të sjellë ndryshime thelbësore sa i takon kompetencave të propozimit të politikës tregtare dhe marrjes së vendimeve lidhur me të. Shqipëria do të ndjekë të gjitha zhvillimet në PPT e Bashkimit Evropian dhe do të veprojë në përputhje me vendimet e marra në Komitetin e Politikës Tregtare.

Shqipëria, pas anëtarësimit në BE, nuk do të mund të propozojë, hartojë apo ndërmarrë asnjë inciativë që prek politikën tregtare me vendet e treta pasi në të gjitha rastet interesat e saj do të artikulohen nëpërmjet Komisionit Evropian. Shqipëria do të jetë e detyruar të ndjekë të gjitha iniciativat e marra nga blloku i vendeve të BE-së në fushën e tregtisë dhe të përshtasë interesat e veta tregtare brenda diskutimeve në KPT.

Politika tregtare e Shqipërisë do të ndryshojë thelbësisht pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian si rezultat i shfuqizimit të të gjitha marrëveshjeve të veta tregtare dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe marrjes përsipër të detyrimeve që aktualisht ka Bashkimi Evropian me vendet e treta. Efekti i politikës së përbashkët tregtare në strukturën e import-eksportit të mallrave jepet në kapitullin V.

Shqipëria është e detyruar të marrë pjesë në Komitetin e Politikës Tregtare. Për të lejuar një pjesëmarrje aktive në këtë komitet, për të paraqitur interesat ekonomikë dhe tregtare të operatorëve vendas, Shqipëria duhet të garantojë një mekanizëm efektiv koordinimi të politikës tregtare që përpara anëtarësimit në BE për të fituar eksperiencën e nevojshme në këtë drejtim.

KAPITULLI V: VLERËSIMI I FLUKSEVE TREGTARE PAS ANËTARËSIMIT NË BE: ANALIZA EMPIRIKE

5.1 Hyrje 101

5.2 Statistika përshkruese 101

5.3 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të eksporteve 106

5.3.1 Vlerësimi i modelit të eksporteve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues 111

5.4 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të eksporteve 113

5.4.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI 113

5.4.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI 118

5.5 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të importeve 124

5.5.1 Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues 129

5.6 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të importeve 130

5.6.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI 130

5.6.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI 134

5.7 Analiza e Avantazhit Krahasues 139

5.7.1 Modeli teorik 140

5.7.2 Qasja e analizës së avantazhit krahasues 142

5.7.3 Rezultatet e indeksit të avantazhit konkurrues (BI): 144

5.8 Përfundime 153

5.1 Hyrje

Në këtë kapitull paraqiten rezultatet e modelit të gravitetit të përdorur për të parashikuar flukset e ardhshme të tregtisë. Kapitulli jep në seksionin 5.2 statistikat përshkruese të përdorura së bashku me variablat e përdorura në model. Në seksionet 5.3, 5.4, 5.5 dhe 5.6 jepet analiza e plotë e modeleve të eksportit dhe të importit së bashku me kontrollin e qëndrueshmërisë së rezultateve. Për secilin nga modelet e testuara kapitulli paraqet dhe analizon rezultatet edhe ndikimin e tyre në flukset tregtare. Seksioni 5.7 jep analizën e detajuar të avantazhit krahasues të Shqipërisë dhe ndikimin e MSA-së në indeksin e matur të avantazhit krahasues. Kapitulli përmbyllet me përfundimet kryesore të gjetjeve nga analiza empirike dhe avantazhi krahasues.

5.2 Statistika përshkruese

Për këtë studim janë marrë në konsideratë 22 vende, Bosnjë-Herzegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Greqia, Italia, Maqedonia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Spanja, Austria, Franca, Anglia, Kina, Malta, Hollanda, Rusia, Zvicra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqia, për periudhën 2001-2013, pra 13 vëzhgime për secilin vend, duke formuar një panel të balancuar prej 286 vëzhgimesh gjithsej. Përveç të dhënave për këto vende, ka të dhëna të pjesshme për Kosovën, të cilat do të përdoren në vlerësime të veçanta për të kontrolluar qëndrueshmërinë e rezultateve.

Të dhënat e përdorura në modelin e gravitetit janë marrë nga disa burime. Kështu, import-eksporti i Shqipërisë me partnerët e marrë në analizë, është marrë nga Instituti i Statistikave të Shqipërisë; PPB e Shqipërisë dhe vendeve partnere dhe popullsia e Shqipërisë dhe vendeve partnere janë marrë nga databaza e Bankës Botërore, distancat midis kryeqyteteve në http//www.mapcrow.info. Të dhënat për llogaritjen e indeksit të komplementaritetit të tregtisë (TCI) për të gjitha vendet janë marrë nga United Nation Statistical Division (UNSD) Commodity Trade (COMTRADE). TCI është llogaritur nga autori sipas Sohn (2005), me formulën (2.18).

Niveli mesatar i eksporteve në total për të gjitha vendet dhe përgjatë gjithë periudhës është 46,441 mijë dollarë me një devijim standard prej 148,550 mijë dollarë, duke kapur minimumin me 10 dollarë dhe maksimumin me 1,080,276 mijë dollarë. Devijimi standard i mesatares së vendeve është 136,175 mijë dollarë dhe vlera minimum e eksporteve është 342

mijë dollarë, ndërsa vlera maksimum është 650,040 mijë dollarë. Devijimi standard mesatar brenda vendeve është 65,612 mijë dollarë, me vlerën e vetë minimum prej -386,538 mijë dollarë dhe atë maksimum 476,677 mijë dollarë. Meqë në modelin empirik, përdorimi i logaritmeve çon në interpretimin e koeficientëve si elasticitete, kjo është një nga arsyet themelore pse në këtë seksion është marrë në shqyrtim, përveç nivelit të variablit, edhe logaritmi i tij. Përsa i përket këtij të fundit, në lidhje me eksportet totale ai është mesatarisht 8.1 me devijim standard 3.6 dhe vlerë minimale -11.5 e atë maksimale prej 13.9. Mesatarja (gjatë periudhës) e logaritmeve të eksporteve të vendeve paraqitet me devijim standard 2.3 dhe vlerë minimum 2.4 e atë maksimum 13.3. Shifrat e logaritmit të eksporteve brenda vendeve kanë një devijim standard prej 2.8, me minimum negativ prej -11.0 dhe maksimum 17.6, gjë e cila konfirmon vetinë e logaritmit për të kompresuar të dhënat dhe për të ulur efektin e vëzhgimeve ekstreme.

Nga ana tjetër flukset e importeve paraqiten me një vlerë mesatare në total prej 141,340 mijë dollarë, me devijim standard 263,724 mijë dollarë, duke kapur vlerën minimum 6.2 mijë dollarë dhe atë maksimale 2,132,905 mijë dollarë. Mesatarja e mesatareve të importeve të çdo vendi shoqërohet me një devijim standard prej 241,367 mijë dollarë, një minimum 1,207.4 mijë dollarë dhe maksimum 1,095,900 mijë dollarë. Ndërsa, vlera mesatare e importeve mes vendeve varion me një devijim standard prej 117,241 mijë dollarë, me minimum -531,252 mijë dollarë dhe maksimum 1,178,351 mijë dollarë. Për të njëjtën arsye si në rastin e eksporteve, në analizën empirike do të përdoret logaritmi i importeve si variabël i varur. Ndërsa, mesatarja e logaritmit të importeve është 10.69 me një devijim standard prej 1.9, vlera minimale e tij është 1.8 dhe ajo maksimale 14.6. Mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 1.653, me minimum 5.8 dhe maksimum 13.804. Mesataret e çdo vendi kanë devijim standard mesatar 0.95, me minimum 6.3 dhe maksimum 13.0. Vërehet se mesatarja e flukseve të importeve në total për gjithë vendet dhe përgjatë gjithë periudhës është më e lartë se mesatarja e flukseve të eksporteve.

Mesatarja e GDP-së së Shqipërisë gjatë periudhës 2001-2013 është 9,642,072 mijë dollarë, me devijim standard 3,220,331 mijë dollarë, me vlerë minimum 4,091,020 mijë dollarë dhe atë maksimum 13,000 milionë dollarë. Mesatarja e GDP-së së vendit destinacion, GDP_j, në total është 1,500 milionë dollarë me devijim standard 3,010,000 miliardë dollarë, vlerë minimale 1,160 milionë dollarë dhe atë maksimale prej 16,800 milionë dollarë. Mesatarja e mesatareve të vendeve ka devijim standard 2,980 milionë dollarë, vlerë minimale 3,149

milionë dollarë dhe atë maksimale 13,800 miliardë dollarë. Ndërsa, vlerat brenda vendeve kanë një devijim standard mesatar (nga mesatarja) 737 miliardë dollarë, me minimum 1,670 miliardë dollarë dhe maksimum 6,510 miliardë dollarë. Mesatarja e logaritmit të GDP-së së vendit destinacion është 19.34 me devijim standard 2.33, vlerë minimale 13.96 dhe atë maksimale prej 23.54. Mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 2.34, me vlerë minimale 14.86 dhe atë maksimale 23.33. Ndërsa, mesatarja individuale e vendeve ka devijim standard 0.38, me minimum 18.19 dhe maksimum 20.33.

Mesatarja e numrit të banorëve të vendit *i*, Shqipërisë, për të gjitha vendet dhe përgjatë gjithë periudhës është 3,123,197 individë, me devijim standard 150,950 me vlerë minimale 2,800,100 dhe atë maksimale 3,286,084. Ndërsa, mesatarja e logaritmit të numrit të popullsisë së vendit është 14.95 me devijim standard 0.04, vlerë minimale 14.84 dhe atë maksimale 15. Sa i përket mesatares së popullsisë së vendit *j*, partner, në total është 103 milion individë me devijim standard 273 milion individë, me vlerë minimale prej 393,028 dhe maksimale 1,360 milionë banorë. Për më tepër, mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 279 milionë banorë, me vlerë minimale 407,698 dhe atë maksimale 144 milionë banorë. Ndërsa, mesatarja e logaritmit të popullsisë së vendit partner është 14.95 me devijim standard 0.04, vlerë minimale 14.84 dhe atë maksimale 15. Mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 0.01 ndërsa mesatarja individuale e vendeve ka devijim standard 0.05.

Mesatarja e distancës mes vendeve në total është 1,603 km, me devijim standard 2,100 km, vlerë minimale 132 km dhe atë maksimale 8,173 km. Mesatarja e mesatareve të vendeve ka devijim standard 2,145 km, me vlerë minimale 132 km dhe atë maksimale 8,173 km. Ndërsa, mesatarja individuale e vendeve ka devijim standard 0.06 km, me vlerë minimale 1,602 km dhe maksimale 1,603 km, një diferencë prej 1 km që vjen për shkak të gabimeve në matje apo raportime, të cilat vijnë më shumë se për shkak të variacionit të variablit. Ky variabël është i pandryshueshëm në kohë, dhe pavarësisht diferencës jo zero (edhe pse shumë pranë) për qëllime statistikore ai konsiderohet si i tillë në analizën empirike. Mesatarja e logaritmit të distancës mes dy vendeve partnere në total për gjithë vendet është 6.8 me devijim standard 1.0, vlerë minimale 4.9 dhe atë maksimale 9.

Indeksi i tregtisë komplementare (plotësuese) për të gjitha vendet dhe përgjatë gjithë periudhës së marrë në konsideratë është mesatarisht 0.27 me një devijim standard 0.2, me vlerë minimale 0.002 dhe atë maksimale 1.3. Vlera vjetore e vendeve e ka devijimin standard

mesatar nga mesatarja 0.15, dhe ka një vlerë minimale 0.005 dhe atë maksimale 0.5. Ndërsa, mesatarja mes çdo dy vendeve partnere ka devijim standard 0.163, minimum negativ prej -0.096 dhe maksimum 1.135.

Variabli dummy CMBR (Common Border ose kufi i përbashkët), merr vlerën 1 nëse vendet partnere në tregti lidhen më anë të një kufiri doganor dhe 0 në të kundërt. Mesatarja për të gjitha vendet është 0.13, që nënkupton që 13 përqind e vendeve, shumë pak prej numrit total të vendeve të marra në analizë, ndajnë midis tyre një kufi tokësor, dhe ka devijim standard 0.3. Mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 0.35 ndërsa, siç mund të merret me mend, mesatarja e çdo vendi ka devijim standard 0.

Variabli dummy Agree[46] merr vlerën 1 nëse vendet kanë nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë midis tyre dhe 0 nëse jo. Mesatarja në total për të gjitha vendet dhe për gjithë periudhën është 0.58, që do të thotë se më shumë se gjysma e vendeve partnere të marra në konsideratë kanë marrëveshje të tregtisë së lirë midis tyre. Ajo shoqërohet me një devijim standard prej 0.49. Mesatarja e mesatareve të çdo vendi ka devijim standard 0.27, pra në periudhën kohore nën konsideratë, mesatarisht në katër prej 13 viteve vendet kanë patur marrëveshje tregtare mes tyre. Mesatarja e periudhës kohore brenda vendeve ka devijim standard mesatar prej 0.41.

[46] Agree i referohet të gjitha marrëveshjeve të tregtisë së lirë të nënshkruara nga Shqipëria.

Tabela 5.1 Statistikat përshkruese

Variabli	Mesatarja		Gabimi St.	Vlera Minimum	Vlera Maksimum
X_{ij}	Total	46441.87	148552.7	0.00001	1080276
	Midis		136175.2	341.9409	650040.1
	Brenda		65612.48	-386538.5	476677.6
LnX_{ij}	Total	8.061444	3.558637	-11.51293	13.89273
	Midis		2.295236	2.401155	13.26676
	Brenda		2.760001	-10.95692	17.62124
M_{ij}	Total	141339.4	263724.9	6.189286	2132905
	Midis		241367.7	1207.371	1095894
	Brenda		117241	-531252.1	1178351
LnM_{ij}	Total	10.69801	1.876829	1.82282	14.573
	Midis		1.653298	5.828085	13.80426
	Brenda		0.950887	6.307712	12.99435
GDP_i	Total	9642072	3220331	4091020	13000000
	Midis		0	9642072	9642072
	Brenda		3220331	4091020	13000000
$LnGDP_i$	Total	16.01092	0.4009241	15.22431	16.37805
	Midis		0	16.01092	16.01092
	Brenda		0.4009241	15.22431	16.37805
GDP_j	Total	1.5e+09	3.01e+09	1159892	1.68e+10
	Midis		2.98e+09	3148517	1.38e+10
	Brenda		7.37e+08	-1.67e+09	6.51e+09
$LnGDP_j$	Total	19.34489	2.331098	13.96384	23.54274
	Midis		2.348223	14.86028	23.33792
	Brenda		0.3841098	18.19465	20.3307
N_i	Total	3123197	150948.7	2800138	3286084
	Midis		16554.02	3049081	3126727
	Brenda		150076.7	2796609	3360200
LnN_i	Total	14.95315	0.04991	14.84514	15.00521
	Midis		0.0054627	14.9287	14.95432
	Brenda		0.0494622	14.84401	15.02966
N_j	Total	1.03e+08	2.73e+08	393028	1.36e+09
	Midis		2.79e+08	407698+07	1.32e+09
	Brenda		6105738	5.85e+07	1.44e+08
LnN_j	Total	14.95315	0.04991	14.84514	15.00521
	Midis		0.0054627	14.9287	14.95432
	Brenda		0.0494622	14.84401	15.02966
D_{ij}	Total	1603.141	2099.98	131.99	8172.89
	Midis		2145.637	131.9908	8172.86
	Brenda		0.0623897	1602.708	1603.594
LnD_{ij}	Total	6.824472	1.026095	4.882726	9.008574
	Midis		1.048404	4.882732	9.008574
	Brenda		0.0001919	6.821881	6.825321
TCI	Total	0.2737701	0.2169997	0.0017579	1.24841
	Midis		0.1456685	0.0055088	0.4547678
	Brenda		0.163594	-0.096624	1.135388
CMBR	Total	0.136363	0.3437758	0	1
	Midis		03512501	0	1
	Brenda		0	0.136363	0.136363
Agree	Total	0.5804196	0.4943553	0	1
	Midis		0.2745187	0	0.9230769
	Brenda		0.4149696	-0.342657	1.272727
N = 268		**T = 13**		**n=22**	

Indeksi i komplementaritetit të tregtisë (TCI) midis vendeve të marra në analizë varion. Gjithashtu, rezulton se ky indeks është rritur në vite. Vendet me të cilat Shqipëria ka marrëveshje të tregtisë së lirë e kanë indeksin TCI më të madh sesa vendet me të cilat Shqipëria nuk ka një marrëveshje të tregtisë së lirë. Gjithashtu, analiza tregon (grafiku 5.1) se pas nënshkrimit të marrëveshjeve të tregtisë ky indeks është rritur. Kjo sugjeron që marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë rritur komplementaritetin midis vendeve partnere, megjithëse ndikimi që struktura e tregtisë me këto vende ka në flukset e ardhshme do të vërtetohet ose jo nga rezultatet e modelit.

Grafik 5.1 Indeksi i komplementaritetit të tregtisë



Burimi: Llogaritur nga autori

5.3 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të eksporteve

Duke qenë se është më e pritshme që variablat tanë të ndryshojnë në përqindje, dhe që nga ana sasiore efektet të intepretohen si elasticitete, variabli i varur dhe variablat e pavarur të vazhdueshëm janë përfshirë në model të logaritmuar. Modeli me efekte fikse përdoret kur interesi qëndron në analizimin e efekteve të variablave që ndryshojnë në kohë, dhe performanca e modelit cënohet sa herë që në të përfshihen të dhëna për të cilat variacioni

brenda grupit është minimal apo për variabla që ndryshojnë pak në kohë. Për këtë arsye, nga lista potenciale e variablave shpjegues është hequr variabli tregues i kufirit të përbashkët dhe ai i distancës mes vendeve. Përdorimi i modelit me efekte fikse rekomandohet në rastet kur interesi qëndron në hulumtimin e shkaqeve të ndryshimit brenda njësisë së studimit, meqë karakteristikat që nuk ndryshojnë në kohë janë konstante për çdo njësi dhe, si të tilla, nuk mund të shkaktojnë ndryshime në variabla të tjerë (Kohler dhe Kreuter, 2009).

Siç mund të shihet nga Tabela 5.2, variablat e pavarur kanë fuqi shpjeguese pasi testi i Fisher e ka vlerën 20.02 dhe probabiliteti për të vëzhguar një vlerë sa kjo për një variabël rasti me shpërndarje Fisheri me 6 dhe 258 shkallë lirie është 0.000. Me përjashtim të logaritmit të prodhimit të brendshëm bruto dhe popullsisë së vendit *j*, të cilët janë të rëndësishëm në nivelet 1 dhe 5 përqind përkatësisht, asnjë prej variablave të tjerë nuk ka efekt statistikisht të rëndësishëm mbi eskportet. Termi i gabimit ka një korrelacion pothuajse perfekt me variablat shpjegues në modelin e vlerësuar me efekte fikse (-0.9966). Në fund të Tabelës, gjendet vlera e "rho", i cili njihet ndryshe edhe si korrelacioni brenda klasës. Kjo vlerë llogaritet si raport i variacionit të u mbi shumën e variacionit të u dhe e, dhe në rastin tonë tregon se pothuajse e gjithë varianca i atribuohet diferencave mes paneleve.

Tabela 5.2. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse[47]

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.3177                         Obs per group: min =        13
       between = 0.0656                                        avg =      13.0
       overall = 0.0332                                        max =        13
                                                F(6,258)           =     20.02
corr(u_i, Xb)  = -0.9966                        Prob > F           =    0.0000
------------------------------------------------------------------------------
         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]
-------------+----------------------------------------------------------------
      lngdpi |   .4725435   1.123631     0.42   0.674    -1.740112    2.685198
      lngdpj |   2.720519   .9331887     2.92   0.004     .8828827    4.558156
        lnni |   -6.21659   4.062857    -1.53   0.127    -14.21717    1.783994
        lnnj |    14.2067   7.160909     1.98   0.048     .1054279    28.30797
         TCI |   .2384891   1.232487     0.19   0.847    -2.188527    2.665505
       agree |  -.1732249   .5481908    -0.32   0.752    -1.252723    .9062732
       _cons |  -197.3412   142.7448    -1.38   0.168    -478.4344    83.75197
-------------+----------------------------------------------------------------
     sigma_u |  32.836304
     sigma_e |  2.3961431
         rho |  .99470324   (fraction of variance due to u_i)
------------------------------------------------------------------------------

F test that all u_i=0:         F(21, 258) =     9.11           Prob > F = 0.0000
```

Autorë të ndryshëm sugjerojnë kontrollin për variabla dummy të kohës kur variabli i varur mund të jetë ndikuar nga ngjarje të ndryshme apo thjesht kur dyshohet që një pjesë e

[47] Aneksi II jep të gjitha testet e kryera nga autori.

variacionit të tij të shpjegohet nga koha (Hamilton, 2013; Torres-Reyna, 2007). Meqë rezultatet e modelit të mësipërm duket se mbartin probleme, u përfshinë në regresion variabla dummy për secilin vit. Rezultatet e regresionit (Tabela 5.3) kanë ndryshuar pak. Ka humbur rëndësinë statistikore variabli i popullsisë, ndërsa prodhimi i brendshëm bruto i vendit *j* vazhdon të mbetet i rëndësishëm në nivelin 5 përqind. Megjithëse njëri prej treguesve të viteve, ai i vitit 2002, individualisht rezulton i rëndësishëm statistikisht, testi i rëndësisë së përbashkët statistikore të variablave indikatorë të viteve sugjeron se këta variabla janë së bashku statistikisht të parëndësishëm dhe se mund të përjashtohen nga modeli (Aneksi II, Tabela A.1).

Tabela 5.3 Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse dhe tregues të viteve

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.3619                         Obs per group: min =        13
       between = 0.0632                                        avg =      13.0
       overall = 0.0352                                        max =        13

                                                F(17,247)          =      8.24
corr(u_i, Xb)  = -0.9945                        Prob > F           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.547349   1.812624     1.41   0.161    -1.022822      6.117521
      lngdpj |    2.33846   .9571427     2.44   0.015     .4532572      4.223662
        lnni |  -12.37966   13.57287    -0.91   0.363    -39.11298      14.35366
        lnnj |    11.2944   7.196013     1.57   0.118    -2.878974      25.46777
         TCI |  -1.833841   1.541031    -1.19   0.235    -4.869077      1.201396
       agree |   -.089269   .5838321    -0.15   0.879    -1.239193      1.060655
             |
       vitet |
       2002  |   1.848866   .6912369     2.67   0.008     .4873954      3.210336
       2003  |    .655081   .6617029     0.99   0.323    -.6482189      1.958381
       2004  |   .0770889   .7407036     0.10   0.917    -1.381812       1.53599
       2005  |  -1.013161   .8082124    -1.25   0.211    -2.605028      .5787064
       2006  |  -1.197369   .8303972    -1.44   0.151    -2.832932      .4381934
       2007  |  -.8897329   .8930335    -1.00   0.320    -2.648665      .8691991
       2008  |  -.9757101   1.029759    -0.95   0.344    -3.003939      1.052519
       2009  |  -.9908892   .9380988    -1.06   0.292    -2.838582      .8568041
       2010  |  -.1352859   .8669253    -0.16   0.876    -1.842795      1.572223
       2011  |  -1.660042   1.258083    -1.32   0.188    -4.137981      .8178966
       2012  |  -1.375327   1.181596    -1.16   0.246    -3.702616      .9519613
       2013  |          0  (omitted)
             |
       _cons |  -81.22877    253.469    -0.32   0.749    -580.4651      418.0075
     sigma_u |  26.451397
     sigma_e |  2.3682241
         rho |  .99204792   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(21, 247) =     9.39          Prob > F = 0.0000
```

Modelet me efekte të rastit përdoren kur kërkuesi ka arsye për të besuar se variabli i varur ndikohet nga ndryshimet mes njësive nën investigim. Këto modele kanë si avantazh faktin që

në to mund të kontrollohet për variabla që nuk ndryshojnë në kohë, siç janë në rastin tonë treguesi i kufirit të përbashkët dhe distanca. Fillimisht, për të pasur një bazë "të drejtë" krahasimore është vlerësuar modeli me të njëjtat variabla shpjegues si në rastin e modelit me efekte fikse, e më pas janë shtuar variablat e pandryshueshëm në kohë.

Rezultatet e vlerësimit të parë janë paraqitur në Tabelën 5.4 dhe tregojnë se ky model performon më mirë në bazë të kriterit teorik të origjinës së modelit bazë të gravitetit. Prodhimet e brendshme bruto të vendit *i* dhe atij *j* janë të rëndësishëm statistikisht në nivelin 5 përqind dhe koeficientët e tyre kanë shenjë pozitive, ndërsa variablat e tjerë janë të parëndësishëm statistikisht.

Tabela 5.4 Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       286
Group variable: A                               Number of groups      =        22

R-sq:  within  = 0.2938                         Obs per group: min    =        13
       between = 0.1704                                        avg    =      13.0
       overall = 0.2445                                        max    =        13
                                                Wald chi2(6)          =    110.17
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.201162    .744919     2.95   0.003      .741148      3.661177
      lngdpj |    .712281   .3545528     2.01   0.045     .0173702      1.407192
        lnni |  -5.010507   4.110384    -1.22   0.223    -13.06671      3.045697
        lnnj |  -.4716257   .4335929    -1.09   0.277    -1.321452      .3782007
         TCI |   1.754551   1.168823     1.50   0.133    -.5363004      4.045403
       agree |  -.0494721   .5361485    -0.09   0.926    -1.100304       1.00136
       _cons | 41.41872     66.33451     0.62   0.532    -88.59453       171.432

     sigma_u |  1.6235445
     sigma_e |  2.3961431
         rho |  .31464381   (fraction of variance due to u_i)
```

Proçedura vijon me kryerjen e testit të Hausman për të vendosur mes modelit të efekteve fikse dhe atyre të rastit. Hipoteza zero e testit është se modeli i preferuar është modeli me efekte të rastit, ndërsa ajo alternative favorizon modelin me efekte fikse. Në parim, testi është një test korrelacioni i termit të gabimit idiosinkratik (u_i) me variablat shpjegues, dhe nën hipotezën zero ky korrelacion është zero. Rezultatet e testit në Tabelën 5.5 sugjerojnë se ka evidencë në favor ***të modelit me efekte fikse***, edhe pse siç u pa më lart ky model kishte disa probleme, të cilat duhen identifikuar e korrigjuar në vijim.

Tabela 5.5 Rezultatet e testit të Hausman për përzgjedhjen mes modelit me efekte fikse dhe të rastit

```
                             ---- Coefficients ----
             |      (b)          (B)            (b-B)     sqrt(diag(V_b-V_B))
             |       fe           re         Difference          S.E.
-------------+----------------------------------------------------------------
      lngdpi |    .4725435     2.201162       -1.728619        .8412143
      lngdpj |    2.720519      .712281        2.008238        .8632111
        lnni |    -6.21659    -5.010507       -1.206083               .
        lnnj |     14.2067    -.4716257        14.67833         7.14777
         TCI |    .2384891     1.754551       -1.516062        .3909952
       agree |   -.1732249    -.0494721       -.1237528        .1142713
------------------------------------------------------------------------------
                           b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
            B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg
            Test:  Ho:  difference in coefficients not systematic
                   chi2(6) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
                           =       19.19
                 Prob>chi2 =      0.0038
                 (V_b-V_B is not positive definite)
```

Siç u theksua më lart, në modelin me efekte të rastit mund të përfshihen edhe variablat që janë të pandryshueshëm ose pak të ndryshueshëm në kohë. Në një vlerësim të ri, u përfshinë variabli tregues i kufirit të përbashkët dhe ai i distancës mes vendeve (Aneksi II, Tabela A.2). Rezultatet e modelit duken më optimiste: distanca është e rëndësishme statistikisht, dhe ka shenjën e pritur negative. Variablat e masës, prodhimi i brendshëm bruto i vendit *i* dhe ai i vendit *j* janë përsëri të rëndësishëm statistikisht në nivelin 1 përqind. Variabli dummy për kufirin e përbashkët nuk është i rëndësishëm në nivelin 5 përqind, por është i rëndësishëm në nivelin 10 përqind dhe ka shenjën e duhur. Për më tepër, rezultati i testit Hausman i kryer pas këtij vlerësimi, jep evidencë në favor të modelit me efekte të rastit. Një tjetër test që përforcon këtë rezultat është ai i Breusch dhe Pagan, që është një test LM (Lagrangian multiplier) për efektet e rastit. Hipoteza zero e këtij testi është se variacioni mes njësive studimore është zero, pra nuk ka diferenca mes tyre. Në rast se hipoteza zero nuk hidhet poshtë, kjo interpretohet si evidencë se nuk ka efekt panel, dhe një regresion me të dhëna ndërseksionale do të ishte i vlefshëm.

Një nga shqetësimet e modelit me efekte fikse është varësia ndërseksionale. Ka disa teste për të testuar për pavarësi (kjo e fundit specifikohet në të gjithë ata nën hipotezën zero), por ata kanë kërkesa të ndryshme. Më i përshtatshëm për bazën e të dhënave të këtij modeli u gjet testi i Pesaran. Vlera e statistikës së testit ishte 5.879, dhe probabiliteti i vëzhgimit të kësaj vlere për një variabël rasti me shpërndarje të njëjtë është 0.000. Pra, hipoteza zero e pavarësisë ndërseksionale hidhet poshtë me siguri të plotë. Kjo do të thotë që modeli ynë vuan nga varësia ndërseksionale, dhe vlerësimi me efekte fikse në këto kushte është problematik. Testi i modifikuar i Waldit për heteroskedastisticitetin në modelin me efekte

fikse, gjithashtu tregoi se modeli vuan nga heteroskedasticiteti, pra gabimet standarte duhen korrigjuar në mënyrë që të mund të përdoren për inferencë statistikore të vlefshme.

Një tjetër test që duhet kryer, si pjesë e diagnozave të modelit, është ai i mungesës së korrelacionit serial të termit të gabimit idiosinkratik. Ky test për rastin e paneleve lineare, propozuar nga Wooldridge (2002) dhe me pas Drukker (2003), konfirmoi veçoritë statistikore të tij në zgjedhje me përmasa të mira. Testi bazohet në supozimin se, nën hipotezën zero të mungesës së korrelacionit serial, mbetjet e regresionit të variablave në diferencë të parë duhet të kenë një vlerë të autokorrelacionit të rendit të parë prej -0.5. Rezultatet e këtij testi për modelin me efekte fikse (Aneksin II, Tabela A.6), japin evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë hipotezën zero. Pra, modeli me efekte fikse vuan edhe nga autokorrelacioni i termit të gabimit.

Ka disa mënyra për të korrigjuar secilin prej këtyre problemeve në veçanti, por metodat që i korrigjojnë ato në të njëtën kohë janë të limituara në numër. Hoechle (2007) listoi, veç të tjerash, dy metoda që korrigjojnë këto probleme. Në mungesë të preferencës specifike mbi ndonjë prej tyre, në vijim do të përdorim të dy metodat e listuara nga Hoechle (2007) të cilat korrigjojnë për varësi ndërseksionale, autokorrelacion dhe heteroskedasticitet, njëkohësisht.

5.3.1 Vlerësimi i modelit të eksporteve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues

Metoda e parë është ajo e regresionit linear me gabime standarde të korrigjuara në panel (panel-corrected standard error (PCSE)). Kjo metodë korrigjon vlerësuesit e gabimeve standarde ku parametrat vlerësohen me OLS ose me regresionin Prais-Winsten që korrigjon për autokorrelacion. Metoda supozon se termi i gabimit është heteroskedastik dhe i korreluar mes paneleve dhe i kryen llogaritjet e gabimeve standarde dhe të vlerësuesve të variancë-kovariancës bazuar në këtë supozim.

Metoda e dytë jep gabimet standarde të Driscoll and Kraay (1998) për koeficientët e vlerësuar me të dhënat e bashkuara OLS/WLS ose me efekte fikse. Struktura e gabimit supozohet të jetë heteroskedastike, e autokorreluar deri në disa vonesa, dhe me korrelacion mes paneleve. Gabimet standarde të Driscoll-Kraay korrigjojnë për forma të ndryshme të varësisë ndërseksionale dhe kohore. Metoda e vlerësimit të gabimeve standarde është joparametrike dhe nuk vendos kufizime mbi përmasën e panelit, por gjithsesi është një vlerësues T-

asimptotikisht i vlefshëm, që vlen si për panel të balancuar edhe jo të balancuar. Duke qenë se kjo metodë e dytë është përsëri një vlerësim efektesh fikse, janë përjashtuar variablat e pandryshueshëm në kohë. Rezultatet e të dy modeleve paraqiten në Tabelën 5.6.

Tabela 5.6. Rezultatet e vlerësimeve me korrigjim të gabimeve standarde

Variable	pcse1	pcse2	scc1
lngdpi	3.2800087**	2.5915754*	.47254345
lngdpj	.83633988*	1.6406625**	2.7205192**
lnni	.22173764	-.06210928	-6.2165895*
lnnj	-.47885975	.04870994	14.2067**
TCI	4.2012568*	.72145693	.2384891
agree	-.12006309	-.45709086	-.17322489
lnd		-3.3752524*	
CMBR		1.707211***	
_cons	-57.873381	-42.199426	-197.34121*
N	286	286	286
r2	.26339877	.15655486	

legend: * p<0.05; ** p<0.01; *** p<0.001

Modelet në kolonën e parë dhe të dytë përdorin gabimet standarte të vlerësuar me PCSE, ndërsa ai në të tretën, përdor vlerësimin e tyre me anë të metodës së Driscoll dhe Kraay. Në modelin e paraqitur në kolonën e dytë janë përfshirë edhe variablat distancë dhe treguesi i kufirit të përbashkët, meqë ndryshe nga modeli me efekte fikse, kjo është e mundur në këtë vlerësim. Rezultatet e modelit në kolonën e parë tregojnë se prodhimi i brendshëm bruto i Shqipërisë është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 1 përqind dhe një rritje me një përqind e tij shoqërohet me një rritje mesatare të eksporteve prej 3.3 përqind, ceteris paribus. Prodhimi i brendshëm bruto i vendit partner është i rëndësishëm në nivelin 5 përqind, dhe një rritje e tij me 1 përqind, shkakton një rritje të nivelit të eksporteve mesatarisht 0.84 përqind, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshueshëm. Në të njëjtat kushte, rritja e indeksit të komplementaritetit të tregtisë me një devijim standard shkakton një rritje të eksporteve me afërsisht 91[48] përqind dhe ky efekt është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 përqind.

Me përfshirjen e dy variablave të pandryshueshëm në kohë në modelin e mësipërm, rezultati që bie më shumë në sy është humbja e rëndësisë statistikore të variablit TCI. Të dy masat ekonomike janë përsëri të rëndësishme statistikisht. Një rritje me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë çon në një rritje mesatare të eksporteve me 2.6 përqind, ceteris

[48] $4.2*(0.2169997)^2 = 0.91139874$ (91 përqind).

paribus. Rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit partner shkakton një rritje prej rreth 1.6 përqind në volumin e eksporteve. Të dy variablat e rinj janë të rëndësishëm statistikisht dhe kanë shenjat e duhura: distanca ndikon negativisht, ndërsa të paturit e një kufiri të përbashkët ndikon pozitivisht. Më konkretisht, modeli sugjeron se Shqipëria eksporton mesatarisht 170 përqind më shumë me vendet fqinje krahasuar me ato jofqinje.

Efektet e vlerësuara në modelin e tretë janë të ndryshme. Efekti i prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë nuk është i rëndësishëm statistikisht, ndërsa ai i vendit partner është i tillë në nivelin 1 përqind. Një rritje me 1 përqind e këtij të fundit rrit volumin e eksporteve të Shqipërisë mesatarisht 2.7 përqind, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar. Popullatat e të dy vendeve janë të rëndësishme statistikisht dhe efektet e tyre kanë shenja të kundërta. Rritja me një përqind e popullsisë së Shqipërisë shoqërohet me ulje drastike të volumit të eksporteve, një rezultat surprizë, ndërsa rritja e popullsisë së vendit partner do të shoqërohet me rritje të volumit të eksporteve shqiptare, gjë që mund të shpjegohet me rritjen e kërkesës së përgjithshme për mallra që shoqërojnë rritjen e popullsisë. Bazuar në rezultatet e mësipërme, duket se ***modeli i dytë*** është ai që përputhet më mirë me pritshmëritë tona.

5.4 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të eksporteve

5.4.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI

Në vazhdim vlerësohet modeli i gravitetit duke shtuar në të dhënat panel edhe Kosovën, por meqë për Kosovën mungojnë të dhënat për llogaritjen e TCI, në vlerësimin që paraqitet në këtë seksion është përjashtuar nga modeli variabli i indeksit të komplementaritetit të tregtisë, TCI. Pjesa tjetër e variablave, nën të njëjtin arsyetim, është përfshirë në model në të njëjtën formë. Në tabelën 5.7 paraqiten rezultatet e modelit me efekte fikse. Duke qenë se probabiliteti i shpërndarjes së statistikës Fisher me 5 dhe 269 shkallë lirie është 0.000, më e vogël se 0.05, variablat e pavarur në model shpjegojnë në mënyrë statistikisht të rëndësishme flukset e eksporteve. Produkti i brendshëm bruto dhe popullsia e vendit partner kanë efekt shpjegues në nivelin 5 përqind. Ndërsa popullsia e vendit origjinë (Shqipërisë) ka efekt të rëndësishëm në flukset e eskporteve në nivelin 10 përqind. Ashtu si në panelin pa Kosovën edhe në këtë rast termi i gabimit ka korrelacion të lartë (0.996) me variablat shpjegues të

modelit. Po kështu, vlera e "rho" tregon se pothuaj gjithë varianca vjen prej diferencave në panele.

Tabela 5.7. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse me Kosovën në panel

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       297
Group variable: A                               Number of groups   =        23

R-sq:  within  = 0.3198                         Obs per group: min =        11
       between = 0.0270                                        avg =      12.9
       overall = 0.0181                                        max =        13
                                                F(5,269)           =     25.29
corr(u_i, Xb)  = -0.9962                        Prob > F           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   .5446908   1.084181     0.50   0.616    -1.589868       2.67925
      lngdpj |    2.67446   .9071722     2.95   0.003     .8883997      4.460521
        lnni |  -6.165623   3.625538    -1.70   0.090    -13.30366      .9724158
        lnnj |   13.43589   6.880297     1.95   0.052    -.1101894      26.98197
       agree |  -.1242419   .5286436    -0.24   0.814    -1.165047      .9165633
       _cons |  -183.7214   135.0671    -1.36   0.175    -449.6445      82.20172

     sigma_u |  31.971729
     sigma_e |  2.3492294
         rho |  .99462993   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(22, 269) =    12.08           Prob > F = 0.0000
```

Në tabelën 5.8 është vlerësuar modeli me efekte fikse, por duke shtuar edhe variablat dummy që kapin efektin mbi flukset e eksporteve e ndryshimeve që ndodhin në kohë. Ashtu si edhe në modelin pa Kosovën, viti 2002 vihet re të ketë efekt individual statistikisht të rëndësishëm. Megjithatë, testi i rëndësisë së përbashkët statistikore për përfshirjen në model të variablave dummy për vitet (Aneksi II, Tabela A.7), tregon se këta variabla së bashku nuk kanë efekt të rëndësishëm statistikisht, duke qënë se probabiliteti i vëzhgimit të statistikës së vlerësuar të Fisher me 11 dhe 258 shkallë lirie është 0.146, më i madh se 0.05.

Tabela 5.8. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse dhe tregues të viteve me Kosovën në panel

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       297
Group variable: A                               Number of groups   =        23

R-sq:  within  = 0.3596                         Obs per group: min =        11
       between = 0.0269                                        avg =      12.9
       overall = 0.0198                                        max =        13
                                                F(16,258)          =      9.05
corr(u_i, Xb)  = -0.9948                        Prob > F           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.803931   1.666047     1.08   0.280    -1.476852      5.084714
      lngdpj |   2.350675   .9323498     2.52   0.012     .5146909       4.18666
        lnni |  -12.88671     13.322    -0.97   0.334    -39.12042      13.34699
        lnnj |   11.60533   6.890313     1.68   0.093    -1.963079      25.17375
       agree |  -.0723691   .5624426    -0.13   0.898    -1.179932      1.035194
             |
       vitet |
       2002  |   1.898642   .6782596     2.80   0.006     .5630124      3.234272
       2003  |    .846304   .6200378     1.36   0.173    -.3746753      2.067283
       2004  |   .4772737   .6528488     0.73   0.465     -.808317      1.762864
       2005  |  -.5110373   .6991005    -0.73   0.465    -1.887707      .8656324
       2006  |  -.6733799   .7042265    -0.96   0.340    -2.060144       .713384
       2007  |  -.3876403   .7761617    -0.50   0.618    -1.916059      1.140778
       2008  |  -.4525915   .9138862    -0.50   0.621    -2.252217      1.347034
       2009  |  -.5487726   .8427361    -0.65   0.516     -2.20829      1.110745
       2010  |   .1074444   .8158955     0.13   0.895    -1.499218      1.714107
       2011  |  -1.480231   1.216499    -1.22   0.225    -3.875762      .9152994
       2012  |  -1.267298    1.14701    -1.10   0.270    -3.525992      .9913965
       2013  |          0  (omitted)
             |
       _cons |  -66.51271    247.699    -0.27   0.789    -554.2819      421.2565

     sigma_u |  27.674904
     sigma_e |   2.327536
         rho |   .9929764   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(22, 258) =    11.88           Prob > F = 0.0000
```

Modeli me efekte të rastit, vlerësuar në tabelën 5.9, kontrollon edhe për efektin e variablave të cilët janë të pandryshueshëm në kohë, të tillë si distanca. Modeli paraqitet përgjithësisht më mirë se në rastin me efekte fikse. Të gjithë variablat shpjegues, përveç popullsisë së vendit partner dhe variablit dummy të marrëveshjeve të tregtisë së lirë, paraqiten statistikisht të rëndësishëm në nivelin 5 përqind të rëndësisë statistikore. Për më tepër, variablat e produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë dhe vendit partner paraqiten me shenjën e duhur, atë pozitive. Masa e popullsisë së vendit origjinë është statistikisht e rëndësishme në nivelin 10 përqind të rëndësisë statistikore. Variabli i distancës vlerësohet të ketë efekt negativ, një rezultat ky që është konsistent me teorinë.

Tabela 5.9. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit me Kosovën në panel

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs      =       297
Group variable: A                               Number of groups   =        23

R-sq:  within  = 0.3074                         Obs per group: min =        11
       between = 0.7010                                        avg =      12.9
       overall = 0.4699                                        max =        13
                                                Wald chi2(7)       =    176.87
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2        =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.175157   .6507631     3.34   0.001     .8996851      3.450629
      lngdpj |   1.317041   .2639628     4.99   0.000     .7996834      1.834399
        lnni |  -6.358717   3.650209    -1.74   0.082    -13.51299      .7955607
        lnnj |   .3415996   .3027217     1.13   0.259     -.251724      .9349232
         lnd |  -3.081373   .5385102    -5.72   0.000    -4.136834     -2.025913
        CMBR |   2.275975   .8344705     2.73   0.006      .640443      3.911507
       agree |  -.2429982   .5007503    -0.49   0.627    -1.224451      .7384543
       _cons |   58.04574   60.06298     0.97   0.334    -59.67554       175.767

     sigma_u |  .95451952
     sigma_e |  2.3530458
         rho |  .14130228   (fraction of variance due to u_i)
```

Për të identifikuar modelin më të mirë midis atij me efekte fikse dhe atij me efekte të rastit përdoret testi Hausman, rezultatet e të cilit paraqiten në tabelën 5.10. Në këtë rast nuk ka evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë hipotezën bazë (prob=0.5247>0.05), nën të cilën përcaktohet se modeli i favorizuar është ai me efekte të rastit. Kështu modeli i favorizuar nga testi Hausman është modeli me efekte të rastit.

Tabela 5.10. Rezultatet e testit të Hausman për përzgjedhjen mes modelit me efekte fikse dhe të rastit

```
                          ---- Coefficients ----
             |      (b)          (B)            (b-B)     sqrt(diag(V_b-V_B))
             |       fe          re1         Difference          S.E.

      lngdpi |    .5446908     2.175157       -1.630466        .8671535
      lngdpj |     2.67446     1.317041        1.357419        .8679199
        lnni |   -6.165623    -6.358717        .1930934               .
        lnnj |    13.43589     .3415996        13.09429        6.873634
       agree |   -.1242419    -.2429982        .1187563        .1694498

                           b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
            B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg
           Test:  Ho:  difference in coefficients not systematic

                 chi2(5) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
                         =        4.17
               Prob>chi2 =      0.5247
               (V_b-V_B is not positive definite)
```

Pas përzgjedhjes së modelit më të përshtatshëm realizohen testet e diagnozës. Testi Pesaran për pavarësinë ndërseksionale (Aneksi II, Tabela A.8), sugjeron se modeli vuan nga varësia

ndërseksionale. Vlera e statistikës së testit Pesaran është 7.797 me probabilitet 0.000, gjë që tregon se hipoteza bazë për pavarësinë ndërseksionale hidhet poshtë. Ndërsa testi për evidentimin e korrelacionit serial të mbetjeve (Aneksi II, Tabela A.9) sugjeron se kemi të bëjmë me autokorrelacion serial të mbetjeve. Pra modeli me efektet e rastit vuan nga autokorrelacioni serial i mbetjeve.

Duke patur parasysh këto teste, u përzgjodhën përsëri dy metodat e korrigjimit të varësisë ndërseksionale, autokorrelacionit dhe heteroskedasticitetit të termit të gabimit, PCSE dhe gabimet standard të Driscoll and Kraay (1998). Vlerësimet e modelit me gabime të korrigjuara janë paraqitur në tabelën 5.11. Në dy kolonat e para jepet vlerësimi me PCSE, pa dhe me variablat që nuk ndryshojnë në kohë. Meqë modeli më i përshtatshëm doli ai me efekte të rastit, u pa me vend përfshirja e këtyre variablave. Ndërsa në kolonën e tretë paraqiten rezultatet me korrigjimin e Driscoll and Kraay, që ka si kufizimin faktin që ky vlerësim mund të merret vetëm për efektet fikse.

Tabela 5.11. Vlerësimi i korrigjuar për varësinë ndërseksionale, autokorrelacionin dhe heteroskedasticitetin

Variable	pcse_1	pcse_2	scc1
lngdpi	4.0286277***	**2.8161188*** **	.54469079
lngdpj	.71496076***	**1.5863735*** **	2.6744602**
lnni	-.43786085	.08349572	-6.1656233*
lnnj	-.34891311	.13630618	13.43589**
agree	.01456714	-.39186239	-.1242419
lnd		**-3.4675525*** **	
CMBR		**2.219091*** **	
_cons	-58.934473	-47.583055	-183.72139
N	297	297	297
r2	.27015084	.1483206	

legend: * p<0.05; ** p<0.01; *** p<0.001

Në dy kolonat e para vihet re se nga vlerësimi PCSE prodhimet e brendshme bruto të të dy vendeve partnere janë të rëndësishëm statistikisht në të dy specifikimet. Popullatat e të dy vendeve dhe marrëveshjet tregtare nuk janë të rëndësishme statistikisht. Me përfshirjen e distancës dhe variablit dummy për kufirin e përbashkët, rëndësia statistikore e variablave ekzistues nuk ndryshon, gjë që tregon për qëndrueshmëri të rezultateve. Rezultatet e modelit të dytë tregojnë se rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto rrit eksportet mesatarisht me 2.8 përqind, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar. Rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit importues shkakton një rritje rreth 1.6

përqind të eksporteve, ceteris paribus. Distanca ka shenjë negative, dhe një rritje e saj me 1 përqind, ul eksportet me 3.7 përqind, ndërsa drejt vendeve me kufi të përbashkët eksportohet 2.22 përqind më shumë se drejt vendeve të tjera, kur faktorët e tjerë mbahen konstantë.

Është interesante të theksohet se rezultatet e vlerësimit të të tre modeleve janë të qëndrueshme sipas specifikimit dhe të dhënave. Krahasuar me rezultatet e modelit pa përfshirjen e Kosovës, dhe me praninë e TCI në model, rëndësia statistikore ka ndryshuar shumë pak në dy modelet e para, është përmirësuar, gjë që tregon se futja e të dhënave të Kosovës ka përmirësuar eficiencën e modelit. Përsëri, janë prodhimi i brendshëm bruto i të dy vendeve, distanca mes partnerëve dhe treguesi i kufirit të përbashkët që janë të rëndësishëm statistikisht. Në modelin e fundit rëndësia statistikore e variablave nuk ka ndryshuar dhe drejtimi i efekteve është i njëjtë. Rezultatet më të arsyeshme duket të arrihen në ***modelin e dytë***, njësoj si në rastin e vlerësimit pa Kosovën dhe me variablin TCI në model.

5.4.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI

Në vazhdim merret në konsideratë vlerësimi i modelit të gravitetit me Kosovën në panel, por në të njëjtën kohë edhe me variablin e indeksit të komplementaritetit të tregtisë, TCI. Duke ndjekur të njëjtën rrjedhë si në seksionet e mësipërme, fillimisht vlerësohet modeli me efekte fikse. Nga tabela 5.12 vihet re se variablat shpjegojnë në mënyrë statistikisht të rëndësishme flukset e eksporteve. Statistika Fisher me 6 dhe 258 shkallë lirie është 20.02 dhe me probabilitet të vëzhgimit të kësaj shifre 0.000, që do të thotë se hipoteza bazë e parëndësisë së përbashkët të variablave shpjegues në model hidhet poshtë me siguri të plotë. Ashtu si në modelin me efekte fikse kur nuk përfshihej Kosova në panel, por edhe në rastin kur përfshihej Kosova, koefiçenti i korrelacionit mes variablave të pavarur dhe termit të gabimit është pothuaj perfekt (0.9966). Vetëm variablat e produktit të brendshëm bruto dhe masës së popullsisë së vendit partner rezultojnë të rëndësishëm statistikisht në nivelin 5 përqind. Edhe në këtë rast pjesa më e madhe e variancës i përket diferencave mes paneleve (rho = 0.994).

Tabela 5.12. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse me Kosovën në panel

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.3177                         Obs per group: min =        13
       between = 0.0656                                        avg =      13.0
       overall = 0.0332                                        max =        13
                                                F(6,258)           =     20.02
corr(u_i, Xb)  = -0.9966                        Prob > F           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   .4725435   1.123631     0.42   0.674    -1.740111      2.685198
      lngdpj |   2.720519   .9331887     2.92   0.004     .8828827      4.558156
        lnni |  -6.216589   4.062857    -1.53   0.127    -14.21717      1.783994
        lnnj |    14.2067   7.160909     1.98   0.048     .1054287      28.30797
         TCI |   .2384891   1.232487     0.19   0.847    -2.188527      2.665505
       agree |  -.1732249   .5481908    -0.32   0.752    -1.252723      .9062732
       _cons |  -197.3412   142.7448    -1.38   0.168    -478.4344      83.75195

     sigma_u |  32.836305
     sigma_e |  2.3961431
         rho |  .99470324   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(21, 258) =     9.11             Prob > F = 0.0000
```

Për të identifikuar nëse një pjesë e variacionit të flukseve të eksporteve vjen si pasojë e ngjarjeve/ndryshimeve që mund të kenë ndodhur në kohë përfshihen në model variablat dummy për secilin vit, vlerësim i cili paraqitet në Tabelën 5.13. Fuqia e modelit duket të mos jetë përmirësuar dhe vetëm produkti i brendshëm bruto i vendit partner është statistikisht i rëndësishëm. Ndër variablat dummy për vitet, njësoj si në vlerësimin e parë pa Kosovën, në këtë model vetëm viti 2002 rezulton të ketë efekt individualisht të rëndësishëm në model. Gjithsesi, variablat dummy që kapin efektet e ndryshimeve në kohë rezultojnë të mos kenë efekt të përbashkët statistikisht të rëndësishëm, duke qenë se dështohet të hidhet poshtë hipoteza bazë e parëndësisë statistikore, (p=0.1124>0.05) (Aneksi II, Tabela A.10). Rrjedhimisht, ka evidencë të mjaftueshme për t'i përjashtuar nga modeli.

Tabela 5.13. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse dhe tregues të viteve me Kosovën në panel

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.3619                         Obs per group: min =        13
       between = 0.0632                                        avg =      13.0
       overall = 0.0352                                        max =        13
                                                F(17,247)          =      8.24
corr(u_i, Xb)  = -0.9945                        Prob > F           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.547349   1.812624     1.41   0.161    -1.022822      6.117521
      lngdpj |    2.33846   .9571427     2.44   0.015     .4532572      4.223662
        lnni |  -12.37966   13.57287    -0.91   0.363    -39.11297      14.35366
        lnnj |    11.2944   7.196013     1.57   0.118    -2.878973      25.46777
         TCI |  -1.833841   1.541031    -1.19   0.235    -4.869077      1.201396
       agree |  -.0892691   .5838321    -0.15   0.879    -1.239193      1.060655

       vitet |
       2002  |   1.848866   .6912369     2.67   0.008     .4873954      3.210336
       2003  |    .655081   .6617029     0.99   0.323    -.6482189      1.958381
       2004  |   .0770889   .7407036     0.10   0.917    -1.381812       1.53599
       2005  |  -1.013161   .8082124    -1.25   0.211    -2.605028      .5787064
       2006  |  -1.197369   .8303972    -1.44   0.151    -2.832932      .4381935
       2007  |  -.8897329   .8930335    -1.00   0.320    -2.648665      .8691991
       2008  |    -.97571   1.029759    -0.95   0.344    -3.003939      1.052519
       2009  |  -.9908892   .9380988    -1.06   0.292    -2.838582       .856804
       2010  |  -.1352859   .8669253    -0.16   0.876    -1.842795      1.572223
       2011  |  -1.660042   1.258083    -1.32   0.188    -4.137981      .8178966
       2012  |  -1.375327   1.181596    -1.16   0.246    -3.702616      .9519613
             |
       _cons |  -81.22879    253.469    -0.32   0.749    -580.4651      418.0075

     sigma_u |  26.451399
     sigma_e |  2.3682241
         rho |  .99204792   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(21, 247) =     9.39             Prob > F = 0.0000
```

Modeli me efekte të rastit me Kosovën në panel dhe TCI paraqitet në tabelën 5.14. Vërehet se modeli është statistikisht i rëndësishëm. Vetëm produkti i brendshëm bruto i vendit partner dhe produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë kanë fuqi shpjeguese në nivelin 5 përqind. Gjithë variablat e tjerë paraqiten statistikisht të parëndësishëm.

Tabela 5.14. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit me Kosovën në panel

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.2938                         Obs per group: min =        13
       between = 0.1704                                        avg =      13.0
       overall = 0.2445                                        max =        13
                                                Wald chi2(6)       =    110.17
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2        =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.201163    .744919     2.95   0.003     .7411481      3.661177
      lngdpj |    .712281   .3545528     2.01   0.045     .0173702      1.407192
        lnni |  -5.010507   4.110384    -1.22   0.223    -13.06671      3.045697
        lnnj |  -.4716257   .4335929    -1.09   0.277    -1.321452      .3782007
         TCI |   1.754551   1.168823     1.50   0.133    -.5363004      4.045403
       agree |  -.0494721   .5361485    -0.09   0.926    -1.100304       1.00136
       _cons |   41.41872   66.33451     0.62   0.532    -88.59454       171.432

     sigma_u |  1.6235445
     sigma_e |  2.3961431
         rho |  .31464381   (fraction of variance due to u_i)
```

Testi Hausman na ndihmon sërish për të përzgjedhur modelin më të mirë të mundshëm mes atij me efekte fikse dhe efekte të rastit, dhe rezultatet e tij paraqiten në tabelën 5.15. Hipoteza bazë, e cila shtrohet në favor të modelit me efekte të rastit, hidhet poshtë (prob=0.0038<0.05), që do të thotë se modeli i përzgjedhur prej testit Hausman është modeli me efekte fikse, një gjetje kjo që është në linjë me argumentin e Egger (2000) diskutuar në kapitullin II.

Tabela 5.15. Rezultatet e testit Hausman për përzgjedhjen mes modelit me efekte fikse dhe të rastit

```
                         ---- Coefficients ----
             |      (b)          (B)            (b-B)     sqrt(diag(V_b-V_B))
             |       fe           re         Difference          S.E.

      lngdpi |    .4725435     2.201163       -1.728619        .8412143
      lngdpj |    2.720519      .712281        2.008238        .8632111
        lnni |   -6.216589    -5.010507       -1.206083               .
        lnnj |     14.2067    -.4716257        14.67833         7.14777
         TCI |    .2384891     1.754551       -1.516062        .3909952
       agree |   -.1732249    -.0494721       -.1237528        .1142713

                     b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
         B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg
         Test:  Ho:  difference in coefficients not systematic
                 chi2(6) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
                         =       19.19
               Prob>chi2 =      0.0038
               (V_b-V_B is not positive definite)
```

Duke qenë se modeli me efekte të rastit na mundëson marrjen në konsideratë të variablave që ndryshojnë në kohë, ndryshe nga modeli me efekte fikse, shtohet në model dhe variabli i

distancës, paraqitur në tabelën 5.16. Fuqia e modelit vihet re të jetë përmirësuar dhe variablat shpjegues rezultojnë të pakorreluar me termin e gabimit. Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe atij partner rezultojnë statistikisht të rëndësishëm në nivelin 1 dhe 5 përqind të rëndësisë statistikore dhe me shenjën e pritur pozitive. Variabli i distancës është gjithashtu statistikisht i rëndësishëm dhe me shenjën e pritur negative, duke marrë kështu rezultate konsistente me ato të sugjeruara nga teoria. Variabli dummy i kufirit të përbashkët, CMBR, rezulton të jetë statistikisht i rëndësishëm.

Tabela 5.16. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit me Kosovën në panel dhe variablat e pandryshueshëm në kohë

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       286
Group variable: A                               Number of groups      =        22

R-sq:  within  = 0.3049                         Obs per group: min    =        13
       between = 0.7134                                        avg    =      13.0
       overall = 0.4675                                        max    =        13
                                                Wald chi2(8)          =    166.71
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnx |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.043943   .6792126     3.01   0.003     .7127109      3.375176
      lngdpj |   1.398563   .2733822     5.12   0.000     .8627438      1.934382
        lnni |  -6.202783   4.036751    -1.54   0.124    -14.11467      1.709105
        lnnj |   .2670658   .3198603     0.83   0.404    -.3598489      .8939805
         lnd |  -3.095174   .5803853    -5.33   0.000    -4.232708      -1.95764
         TCI |   .3135566   1.143027     0.27   0.784    -1.926736      2.553849
        CMBR |   1.750398   .9063275     1.93   0.053    -.0259715      3.526767
       agree |  -.2709017   .5202648    -0.52   0.603    -1.290602      .7487985
       _cons |   57.50991   65.10512     0.88   0.377    -70.09378      185.1136

     sigma_u |  .97610376
     sigma_e |  2.4001577
         rho |  .14191904   (fraction of variance due to u_i)
```

Performohet sërish testi Hausman për të përzgjedhur modelin më të mirë mes atij me efekte fikse dhe modelit me efekte të rastit që përfshinte variablat që ndryshojnë në kohë. Testi Hausman shkon në favor të modelit me efekte të rastit duke qënë se nuk ka evidencë të mjaftueshmë për të hedhur poshtë hipotezën bazë (prob=0.2886>0.05) (Tabela 5.17). Për më tepër, testi i Breusch dhe Pagan për modelin me efekte të rastit, (Aneksi II, Tabela A.11), jep gjithashtu evidencë në mbështetje të modelit me efekte të rastit.

Tabela 5.17. Rezultatet e testit Hausman për përzgjedhjen mes modelit me efekte fikse dhe të rastit (kur në model përfshihen variablat e pandryshuar në kohë)

	(b) fe	(B) re1	(b-B) Difference	sqrt(diag(V_b-V_B)) S.E.
lngdpi	.4725435	2.043943	-1.5714	.8951067
lngdpj	2.720519	1.398563	1.321956	.8922462
lnni	-6.216589	-6.202783	-.0138067	.4598312
lnnj	14.2067	.2670658	13.93963	7.153762
TCI	.2384891	.3135566	-.0750675	.4609922
agree	-.1732249	-.2709017	.0976768	.172736

```
                    b = consistent under Ho and Ha; obtained from xtreg
     B = inconsistent under Ha, efficient under Ho; obtained from xtreg
    Test:  Ho:  difference in coefficients not systematic

           chi2(6) = (b-B)'[(V_b-V_B)^(-1)](b-B)
                   =        7.39
         Prob>chi2 =      0.2866
         (V_b-V_B is not positive definite)
```

Duke qenë se modeli me efekte të rastit është përzgjedhur si më i përshtatshmi për vlerësimin e modelit të gravitetit, realizohen mbi të testet e diagnozës. Statistika e testit Pesaran për pavarësinë ndërseksionale (Aneksi II, Tabela A.12), rezulton 6.402 me probabilitet për vëzhgimin e këtij variabli rasti është 0.000. Rrjedhimisht, modeli vuan nga varësia ndërseksionale. Ndërsa testi i autokorrelacionit serial të mbetjeve (Aneksi II, Tabela A.13), sugjeron se mbetjet vuajnë nga autokorrelacion serial i rendit të parë, duke qenë se ka evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë hipotezën bazë (prob=0.0008<0.05).

Tabela 5.18. Rezultatet e vlerësimit të panelit me Kosovën dhe me TCI të korrigjuar për varësi ndërseksionale, autokorrelacion dhe heteroskedasticitet.

Variable	pcse_psar1	pcse_psar1_2
lngdpi	3.3946506**	**3.7298144*** **
lngdpj	.90645712*	**1.5479867** **
lnni	-.05832276	-.82902073
lnnj	-.49087917	.1178743
TCI	4.1342419*	-.00266658
agree	-.14654006	-.68514473
CMBR		**2.1882875*** **
lnd		**-3.1997148* **
_cons	-56.865857	-49.25103
N	286	286
r2	.23799444	.38631243

legend: * p<0.05; ** p<0.01; *** p<0.001

Të dy vlerësimet me PCSE të paraqitur në dy kolonat e para të Tabelën 5.18 kanë rezultuar në prodhimet e brendshme bruto të Shqipërisë dhe vendit partner që janë të rëndësishëm

statistikisht, por në modelin e dytë, atë që përfshin variablat konstantë në kohë, rëndësia statistikore është përmirësuar. Ky rezultat është konsistent me gjetjet e vlerësimeve të mëparshëm të modelit të eksporteve. Po kështu, njësoj si në ato vlerësime, popullatat e të dy vendeve dhe marrëveshjet tregtare nuk janë të rëndësishme statistikisht. Indeksi i komplementaritetit të tregtisë është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 përqind dhe ka efekt pozitiv. Megjithatë, rëndësia statistikore e këtij variabli nuk qëndron pas përfshirjes të të dy variablave shtesë, të cilët janë të rëndësishëm statistikisht dhe kanë shenjat e pritura. Ndryshe nga nënseksioni 5.4.1 ku gabimet u korrigjuan me metodën e Driscoll and Kraay në këtë nënseksion nuk është vlerësuar një model tjetër, pasi të dhënat që duhet të përfshihen në model janë të njëjta me ato të rastit pa Kosovën, pra rezultatet janë të njëjta.

Rezultatet më të arsyeshme duket të arrihen në ***modelin e dytë***, njësoj si në rastin e vlerësimit pa Kosovën dhe me variablin TCI në model. Po ashtu, bazuar në kriteret e rëndësisë statistikore modeli i dytë është më i favorizuar. Rezultatet e tij sugjerojnë se, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit tonë rrit eksportet mesatarisht me 3.7 përqind; rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit partner shkakton një rritje rreth 1.6 përqind të eksporteve, një rezultat mjaft i ngjashëm ky me atë të modelit pa TCI. Distanca ka shenjë negative, dhe një rritje e saj me 1 përqind, ul eksportet me 3.1 përqind, ndërsa vendet me kufi të përbashkët eksportojnë 219 përqind më shumë se ato që nuk kanë të tillë. Edhe këto efekte të fundit janë shumë të ngjashme me vlerësimet e efekteve të marra nga dy vlerësimet e mëparshme të modelit, ato pa Kosovën dhe me Kosovën e me TCI në model, që intepretohen si rezultate robuste ndaj ndryshimeve në specifikimin e modelit, pra si vlerësime të qëndrueshme.

5.5 Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të importeve

Njësoj si në proçedurën e ndjekur në seksionin e mësipërm për eksportet, vlerësimi i ekuacionit të gravitetit për importet do të fillojë me vlerësimin e efekteve fikse dhe atyre të rastit, si dhe testin e përzgjedhjes së njërit prej tyre. Rezultatet e testeve të diagnozave të regresionit të përzgjedhur nga testi Hausman do të përcaktojnë hapat që duhen ndjekur në vijim. Për të njëjtën arsye, atë të mungesës së të dhënave për variablin TCI në rastin e Kosovës, do të vlerësohen tri modele: i pari nuk do të përfshijë Kosovën, i dyti do të përfshijë Kosovën dhe do të përjashtojë nga modeli variablin TCI, ndërsa i treti do të përdorë listën e plotë të variablave shpjegues dhe gjithë të dhënat e disponueshme.

Lista e variablave shpjegues është e njëjtë dhe përsëri është marrë vendimi që këta variabla të futen në regresion të logaritmuar, pra koeficientët e këtyre variablave intepretohen si elasticitete. Në modelin e vlerësuar të efekteve fikse (njësoj si në rastin e eksporteve) nuk përfshihen variabli tregues i kufirit të përbashkët dhe ai i distancës mes vendeve, meqë janë konstantë në kohë dhe modeli nuk lejon përfshirjen e variablave të tillë.

Rezultatet e vlerësimit të modelit të ngopur, pra atë në të cilin janë përfshirë edhe variablat dummy që marrin vlerën njësi për çdo vit të përfshirë në bazën e të dhënave janë paraqitur në Tabelën 5.19. Ndryshe nga modeli me efekte fikse për rastin e eksporteve, në modelin e mëposhtëm variablat e viteve rezultuan së bashku statistikisht të rëndësishëm ndaj edhe nuk u përjashtuan nga modeli (Aneksi II, Tabela A.14). Në modelin e vlerësuar janë përfshirë 286 vëzhgime dhe modeli është i rëndësishëm statistikisht ($F(17, 247) = 23.83$; $Prob > F = 0.000$). Përveç variablave kohorë, edhe prodhimi i brendshëm bruto dhe indeksi i komplementaritetit të tregtisë së Shqipërisë janë statistikisht të rëndësishëm në nivelin 1 përqind, ndërsa popullata e vendit *j* është e rëndësishme në nivelin 10 përqind. Vlen të theksohet se variablat kohorë janë të rëndësishëm individualisht për vitet 2004 – 2009 dhe kanë shenjë negative gjatë gjithë kësaj periudhe.

Në ngjashmëri me modelin e eksporteve, termi i gabimit idiosinkratik ka një korrelacion pothuajse perfekt me variablat shpjegues (-0.98), gjë që tregon se modeli i efekteve fikse mund të jetë më i përshatshëm. Vlera e korrelacionit brenda klasës tregon përsëri se pothuajse e gjithë varianca i atribuohet diferencave mes paneleve.

Tabela 5.19. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte fikse

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.6213                         Obs per group: min =        13
       between = 0.4123                                        avg =      13.0
       overall = 0.2515                                        max =        13
                                                F(17,247)          =     23.83
corr(u_i, Xb)  = -0.9784                        Prob > F           =    0.0000
```

lnm	Coef.	Std. Err.	t	P>|t|	[95% Conf.	Interval]
lngdpi	2.753408	.4811284	5.72	**0.000**	1.805771	3.701046
lngdpj	.2629572	.2540562	1.04	0.302	-.2374357	.7633502
lnni	4.362512	3.602672	1.21	0.227	-2.733365	11.45839
lnnj	-3.582694	1.910052	-1.88	0.062	-7.34476	.1793717
TCI	-1.58531	.4090387	-3.88	**0.000**	-2.390959	-.7796611
agree	-.2209999	.1549677	-1.43	0.155	-.5262266	.0842267
vitet						
2002	.1857771	.1834763	1.01	0.312	-.1756006	.5471548
2003	-.2430054	.1756371	-1.38	0.168	-.5889429	.102932
2004	-.8028628	.1966064	-4.08	**0.000**	-1.190102	-.4156239
2005	-.9783572	.2145254	-4.56	**0.000**	-1.40089	-.5558248
2006	-.8510475	.2204139	-3.86	**0.000**	-1.285178	-.416917
2007	-.7353555	.2370396	-3.10	**0.002**	-1.202232	-.2684788
2008	-.8022984	.273331	-2.94	**0.004**	-1.340655	-.2639416
2009	-.6070103	.2490014	-2.44	**0.015**	-1.097447	-.1165735
2010	-.3041443	.2301097	-1.32	0.187	-.7573717	.149083
2011	.1217232	.3339354	0.36	0.716	-.5360009	.7794473
2012	.1095108	.3136333	0.35	0.727	-.5082259	.7272475
2013	0	(omitted)				
_cons	-42.69655	67.27877	-0.63	0.526	-175.2098	89.81671
sigma_u	7.4882579					
sigma_e	.62860231					
rho	.99300254	(fraction of variance due to u_i)				

```
F test that all u_i=0:         F(21, 247) =    46.28            Prob > F = 0.0000
```

Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit duke përdorur të njëjtët variabla si në rastin e modelit me efekte fikse paraqiten në Tabelën 5.20. Ato tregojnë se modeli është statistikisht i rëndësishëm. Përveç disa variablave dummy që kanë rezultuar individualisht të rëndësishëm, faktori i vetëm shpjegues që ka rezultuar statistikisht i rëndësishëm deri në nivelin 5 përqind është prodhimi i brendshëm bruto i Shqipërisë. Në nivelin 10 përqind është i rëndësishëm edhe treguesi i marrëveshjeve tregtare, variabël i cili nuk ka shenjën e pritur. Pavarësisht kësaj inference paraprake, është e nevojshme që të kryhet një test përzgjedhës mes modeleve me efekte fikse dhe të rastit dhe të diagnostikohet modeli i përzgjedhur, përpara se të spekulohet për arsyet që mund të kenë sjellë në këtë rezultat. Testi i rëndësisë së përbashkët statistikore të variablave të kohës jep evidenca të mjaftueshme për hedhjen poshtë

të hipotezës zero në nivelin 5 përqind (Aneksi II, Tabela A.15), kështu që grupi i këtyre variablave nuk duhet përjashtuar nga modeli.

Tabela 5.20. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.5947                         Obs per group: min =        13
       between = 0.3706                                        avg =      13.0
       overall = 0.4278                                        max =        13
                                                Wald chi2(16)      =    375.69
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2        =    0.0000
```

lnm	Coef.	Std. Err.	z	P>|z|	[95% Conf.	Interval]
lngdpi	2.124994	.4105719	5.18	**0.000**	1.320288	2.9297
lngdpj	.2940301	.1821503	1.61	0.106	-.0629779	.6510381
lnni	4.564019	3.701595	1.23	0.218	-2.690974	11.81901
lnnj	.175564	.2415321	0.73	0.467	-.2978301	.6489581
agree	-.2793138	.1559416	-1.79	0.073	-.5849536	.026326
vitet						
2002	.2283959	.189268	1.21	0.228	-.1425626	.5993543
2003	-.0617391	.1753482	-0.35	0.725	-.4054153	.2819372
2004	-.4868508	.1837274	-2.65	**0.008**	-.8469499	-.1267516
2005	-.6123046	.1966798	-3.11	**0.002**	-.9977899	-.2268193
2006	-.4390645	.1988149	-2.21	**0.027**	-.8287346	-.0493945
2007	-.3328468	.2194098	-1.52	0.129	-.7628821	.0971885
2008	-.3815502	.2571578	-1.48	0.138	-.8855703	.1224699
2009	-.2639105	.2373126	-1.11	0.266	-.7290345	.2012136
2010	-.1188238	.23055	-0.52	0.606	-.5706935	.3330459
2011	.3268344	.341074	0.96	0.338	-.3416583	.9953271
2012	.2407735	.3220813	0.75	0.455	-.3904943	.8720413
2013	0	(omitted)				
_cons	-99.89486	60.33694	-1.66	0.098	-218.1531	18.36337
sigma_u	1.2755632					
sigma_e	.64612746					
rho	.79580724	(fraction of variance due to u_i)				

Pas vlerësimit të të dy modeleve u krye testi Hausman për të bërë përzgjedhjen e modelit që u përshtatet më mirë të dhënave, rezultatet e të cilit japin evidenca në favor të modelit ***me efekte të rastit*** (Aneksi II, Tabela A.16). Është me vend që në modelin me efekte të rastit të përfshihen edhe variablat që janë të pandryshueshëm në kohë. Rezultatet e këtij modeli paraqiten në Tabelën 5.21 dhe tregojnë se ka përmirësime të ndjeshme krahasuar me modelin me efekte të rastit pa këta variabla. 63 përqind e variancës i atribuohet diferencave mes paneleve. Përsa i përket efekteve, të dy variablat e prodhimit të brendshëm bruto kanë efekt statistikisht të rëndësishëm në nivelin 1 përqind dhe kanë shenjat e duhura. Në po këtë nivel, janë statistikisht të rëndësishëm popullata e vendit partner, TCI dhe distanca. Dy variablat e fundit kanë efekte negative siç parashikohet nga teoria, ndërkohë që popullata e vendit partner ka efekt pozitiv.

Tabela 5.21. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit përfshirë variablat e pandryshueshëm në kohë

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       286
Group variable: A                               Number of groups      =        22

R-sq:  within  = 0.6124                         Obs per group: min    =        13
       between = 0.8006                                        avg    =      13.0
       overall = 0.7521                                        max    =        13
                                                Wald chi2(19)         =    459.65
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.337095   .4087177     5.72   0.000     1.536023      3.138167
      lngdpj |   .5611977   .1541488     3.64   0.000     .2590717      .8633237
        lnni |   4.698678   3.588726     1.31   0.190    -2.335096      11.73245
        lnnj |   .8474133   .2011518     4.21   0.000      .453163      1.241664
         TCI |  -1.367697   .3973963    -3.44   0.001     -2.14658     -.5888147
       agree |  -.2453028    .150246    -1.63   0.103    -.5397796      .0491741
        CMBR |   .6568777   .6321207     1.04   0.299     -.582056      1.895811
         lnd |  -2.034679   .3694415    -5.51   0.000    -2.758771     -1.310587
             |
       vitet |
       2002  |    .184972   .1845142     1.00   0.316    -.1766691      .5466132
       2003  |  -.2163445   .1761818    -1.23   0.219    -.5616545      .1289656
       2004  |  -.7254527   .1938481    -3.74   0.000    -1.105388     -.3455174
       2005  |  -.8974983   .2108626    -4.26   0.000    -1.310781     -.4842152
       2006  |  -.7709097   .2184966    -3.53   0.000    -1.199155     -.3426642
       2007  |  -.6711911   .2357427    -2.85   0.004    -1.133238     -.2091438
       2008  |   -.726572    .271053    -2.68   0.007    -1.257826     -.1953179
       2009  |   -.546659    .247133    -2.21   0.027    -1.031031     -.0622873
       2010  |  -.2874918   .2301934    -1.25   0.212    -.7386626      .1636789
       2011  |    .174523    .333788     0.52   0.601    -.4796893      .8287354
       2012  |   .1442889   .3139322     0.46   0.646    -.4710068      .7595846
       2013  |          0  (omitted)
             |
       _cons |  -107.3993   58.45641    -1.84   0.066    -221.9717      7.173186

     sigma_u |  .81724617
     sigma_e |  .62987572
         rho |  .62734315   (fraction of variance due to u_i)
```

Përpara se të fillojmë me interpretimin e efekteve të vlerësuara duhet të sigurojmë që inferenca statistikore është e vlefshme, pra të bëhen diagnozat e modelit. Testi i Breusch dhe Pagan për mungesën e efektit panel (Aneksi II, Tabela A.17) tregon se kjo hipotezë zero hidhet poshtë, pra modelimi me efekte të rastit është i përshtatshëm. Në vijim, është kryer testi i homoskedasticitetit (Aneksi II, Tabela A.18), i cili jep evidenca se hipoteza zero hidhet poshtë pothuajse me siguri të plotë, gjë që shtron nevojën që gabimet standarde të vlerësuesve të korrigjohen për variancën jokonstante. Përsa i përket autokorrelacionit, testi i Wooldridge për të dhënat panel sugjeron se ai është i pranishëm në termin e gabimit (Aneksi II, Tabela A.19).

Rezultatet e diagnozave/testeve të kryera deri tani kanë konfirmuar ato të modeleve të eksportit të vlerësuar në seksionin e mëparshëm. Testi i fundit i diagnozave të kryera është ai

i pavarësisë ndërseksionale. Ndryshe nga rezultati i arritur për modelet e eksporteve, testi i Pesaran për pavarësinë ndërseksionale e ka vlerën 0.835, shifër që sugjeron se hipoteza zero e pavarësisë nuk mund të hidhet poshtë (Aneksi II, Tabela A.20)

5.5.1 Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikues

Testet e seksionit të mësipërm tregojnë se ndryshe nga modeli i eksporteve, ai i importeve nuk vuan nga varësia ndërseksionale, por në ngjashmëri me të vuan nga heteroskedasticiteti dhe korrelacioni serial. Modeli që do të vlerësohet në vijim korrigjon këto probleme. Më konkretisht, modeli vlerëson një regresion modeli ndërseksional me seri kohore në të cilin termi i gabimit është autoregresiv i rendit të parë. Vlerësimi i efekteve të rastit merret me anë të vlerësuesit GLS. Modeli mund të shkruhet si:

$$y_{it} = a + x_{it} * b + u_i + e_{it}$$

ku e_{it} = rho * $e_{i,t-1}$ + z_{it}, |rho| < 1 dhe z_{it} është një variabël me shpërndarje identike dhe të pavarur me mesatare zero dhe variancë $\boldsymbol{\sigma_z^2}$. Siç është shpjeguar edhe në kapitullin e metodologjisë së këtij punimi, nëse u_i supozohet të jenë parametra fikse, atëherë modeli është një model me efekte fikse. Përndryshe, nëse u_i supozohet të jetë një variabël rasti me mesatare zero dhe variancë $\boldsymbol{\sigma_z^2}$, kemi të bëjmë me një model me efekte rasti. Në modelin me efekte fikse, supozohet se u_i mund të jetë i korreluar me variablat shpjegues x_{it}, të cilët janë të ndryshueshëm në kohë, ndërsa në modelin me efekte të rastit termi i gabimit idiosinkratik u_i supozohet të jetë i pavarur nga variablat x_{it} dhe variablat konstantë në kohë mund të përfshihen në model. Një paraqitje më e detajuar e metodës së vlerësimit mund të gjendet në Baltagi dhe Wu (1999).

Tabela 5.22. Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar për heteroskedasticitet dhe autokorrelacion

```
RE GLS regression with AR(1) disturbances        Number of obs          =      286
Group variable: A                                Number of groups       =       22

R-sq:  within  = 0.5554                          Obs per group: min     =       13
       between = 0.7993                                         avg     =     13.0
       overall = 0.7365                                         max     =       13
                                                 Wald chi2(9)           =   235.65
corr(u_i, Xb)       = 0 (assumed)                Prob > chi2            =   0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.093148   .2311314     4.73   0.000     .6401391      1.546158
      lngdpj |   .6986769   .1546568     4.52   0.000     .3955551      1.001799
        lnni |  -.0762526   .8575785    -0.09   0.929    -1.757076       1.60457
        lnnj |   .6250813   .1858945     3.36   0.001     .2607348      .9894277
         TCI |   .1552365   .3552541     0.44   0.662    -.5410486      .8515217
       agree |  -.1441156   .1266377    -1.14   0.255     -.392321      .1040898
        CMBR |   .7054454   .5578017     1.26   0.206    -.3878259      1.798717
         lnd |  -1.839502   .3363389    -5.47   0.000    -2.498714      -1.18029
       _cons |  -17.15019   14.32917    -1.20   0.231    -45.23485      10.93448

      rho_ar |  .64692078   (estimated autocorrelation coefficient)
     sigma_u |  .64907542
     sigma_e |   .4792171
     rho_fov |  .64720829   (fraction of variance due to u_i)
       theta |  .54409582
```

Rezultatet e vlerësimit të modelit përfundimtar, paraqitur në tabelën 5.22, përforcojnë vërtetësinë e teorisë së gravitetit për rastin e volumit të importeve. Katër prej variablave shpjegues të modelit janë statistikisht të rëndësishëm: prodhimet e brendshme bruto të Shqipërisë dhe vendit partner, popullata e vendit partner dhe distanca mes tyre; të gjithë të rëndësishëm në nivelin 1 përqind. Rezultatet e modelit sugjerojnë se kur gjithë faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, rritja me një përqind e prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë do të ndikojë në një rritje afërsisht prej 1.1 përqind të volumit total të importeve; një rritje me 1 përqind në prodhimin e brendshëm bruto të vendeve partnere do të ndikojë në një rritje mesatare 0.70 përqind të importeve; rritja me 1 përqind e popullatës së vendit partner shoqërohet me një rritje rreth 0.63 përqind të importeve të Shqipërisë, dhe efekti i një distance 10 përqind më të largët është një ulje mesatare 18.4 përqind në importe.

5.6 Kontrolli i qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të importeve

5.6.1 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe pa variablin TCI

Ashtu si edhe në rastin e vlerësimit të modelit të eksporteve, edhe në modelin e importeve do të vazhdohet me vlerësimin e modelit të gravitetit duke përfshirë në panel Kosovën, por pa

variablin e pavarur TCI. Rezultatet e modelit me efekte fikse paraqiten në Tabelën 5.23, nga ku vihet re se modeli është statistikisht i rëndësishëm. Variablat e pavarur janë të korreluar me termin e gabimit (koefiçenti i korrelacionit midis tyre është 0.359). Në model rezultojnë të rëndësishëm variabli i produktit të brendshëm bruto për Shqipërinë dhe vendin partner deri në nivelin 5 përqind të rëndësisë statistikore. Të gjithë variablat e tjerë vlerësohen të mos kenë fuqi shpjeguese në modelin me efekte fikse. Rreth 88 përqind e variancës në model vjen si pasojë e diferencave në panel.

Tabela 5.23. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte fikse

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       297
Group variable: A                               Number of groups   =        23

R-sq:  within  = 0.5655                         Obs per group: min =        11
       between = 0.0348                                        avg =      12.9
       overall = 0.0297                                        max =        13
                                                F(5,269)           =     70.01
corr(u_i, Xb)  = -0.3589                        Prob > F           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.251038   .3048694     4.10   0.000     .6508046      1.851272
      lngdpj |   .6181635   .2550949     2.42   0.016      .115927        1.1204
        lnni |  -1.320652   1.019494    -1.30   0.196    -3.327854      .6865498
        lnnj |  -.8220347   1.934725    -0.42   0.671    -4.631164      2.987095
       agree |  -.1151862   .1486535    -0.77   0.439    -.4078584      .1774861
       _cons |   12.28874   37.98059     0.32   0.747    -62.48829      87.06576

     sigma_u |  1.8749931
     sigma_e |  .66059843
         rho |  .88957706   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:         F(22, 269) =    46.02            Prob > F = 0.0000
```

Modeli i importeve me efekte të rastit i vlerësuar në tabelën 5.24 rezulton statistikisht i rëndësishëm (prob>chi^2 = 0.000). Ndryshe nga modeli i importeve me efekte fikse variablat shpjegues nuk janë të korreluara me termin e gabimit. Edhe në këtë rast vetëm produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe vendit partner në tregti kanë fuqi shpjeguese në model duke qënë se janë statistikisht të rëndësishëm deri në nivelin 5 përqind të rëndësisë statistikore. Mesatarisht 78 përqind e variancës në model vjen si pasojë e diferencave në panel (rho=0.788).

Tabela 5.24. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       297
Group variable: A                               Number of groups      =        23

R-sq:  within  = 0.5633                         Obs per group: min    =        11
       between = 0.3580                                        avg    =      12.9
       overall = 0.4108                                        max    =        13
                                                Wald chi2(5)          =    358.64
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.444584    .241291     5.99   0.000      .971662      1.917505
      lngdpj |   .3878343   .1770167     2.19   0.028     .0408879      .7347807
        lnni |  -1.288356   1.013092    -1.27   0.203    -3.273981      .6972677
        lnnj |   .0742256   .2403851     0.31   0.757    -.3969206      .5453718
       agree |  -.1328412   .1462183    -0.91   0.364    -.4194238      .1537415
       _cons |   -1.80483   16.98577    -0.11   0.915    -35.09633      31.48667

     sigma_u |  1.2748888
     sigma_e |  .66059843
         rho |  .78833799   (fraction of variance due to u_i)
```

Për të përzgjedhur midis modelit me efekte fikse dhe atij me efekte të rastit është përdorur testi Hausman (Aneksi II, tabela A.21). Hipoteza zero e testit dështon të hidhet poshtë në nivelin 5 përqind (Prob>chi^2=0.0536) e për pasojë modeli më i përshtatshëm për vlerësimin e modelit të importeve është ai ***me efekte të rastit***.

Duke qenë se modeli me efekte të rastit kontrollon edhe për variabla të pandryshuar në kohë, dhe ai është model i përzgjedhur prej testit Hausman shtojmë në model edhe variablat e pandryshueshëm në kohë: variablin e kufirit të përbashkët (CMBR) dhe distancën. Vihet re se modeli, rezultatet e të cilit paraqiten në Tabelën 5.25, është statistikisht i rëndësishëm dhe është përmirësuar ndjeshëm. Variablat e produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë dhe vendit partner vijojnë të kenë efekt pozitiv dhe statistikisht të rëndësishëm në nivelin 1 përqind mbi flukset e importeve. Po kështu, popullata e vendit partner ndikon në mënyrë të rëndësishme në rritjen e volumit të importeve. Ndërsa distanca mes vendeve partnere në tregti ndikon negativisht dhe në mënyrë statistikisht të rëndësishme mbi importet. Mesatarisht 59 përqind e variancës në model vjen si pasojë e diferencave në panel.

Tabela 5.25: Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit përfshirë variablat e pandryshueshëm në kohë

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       297
Group variable: A                               Number of groups      =        23

R-sq:  within  = 0.5644                         Obs per group: min    =        11
       between = 0.8023                                        avg    =      12.9
       overall = 0.7394                                        max    =        13
                                                Wald chi2(7)          =    421.98
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.214514   .2211734     5.49   0.000     .7810221      1.648006
      lngdpj |   .6552049    .150071     4.37   0.000     .3610712      .9493387
        lnni |  -1.181197   1.005415    -1.17   0.240    -3.151774      .7893792
        lnnj |   .7019678   .1944608     3.61   0.000     .3208316      1.083104
       agree |  -.1479158   .1436392    -1.03   0.303    -.4294435      .1336119
        CMBR |   .5881531   .5743464     1.02   0.306    -.5375453      1.713851
         lnd |   -1.87888   .3546343    -5.30   0.000     -2.57395      -1.18381
       _cons |  -2.710303   16.70488    -0.16   0.871    -35.45127      30.03066

     sigma_u |  .80080082
     sigma_e |  .66179784
         rho |  .59418763   (fraction of variance due to u_i)
```

Në vazhdim janë realizuar testet e diagnozës në mënyrë që të mund të arrijmë në modelin përfundimtar të importeve me Kosovën në panel por pa TCI dhe të kryejmë inferencë statistikore të besueshme. Testi Breusch dhe Pagan shkon në mbështetje të testit Hausman duke rifavorizuar modelin me efekte të rastit (Aneksi II, Tabela A.22). Testi Wooldridge për autokorrelacion dëshmon për autokorrelacion serial të mbetjeve duke qenë se Prob> F=0.0003 (Aneksi II, Tabela A.23). Për më tepër, testi i homoskedasticitetit (Aneksi II, Tabela A.25), tregon se hipoteza bazë e homoskedasticitetit hidhet poshtë me nivel të lartë besimi. Ndërsa nga testi Pesaran (Aneksi II, Tabela A.24), rezulton se nuk kemi të bëjmë me varësi ndërseksionale. Rrjedhimisht, modeli vuan nga autokorrelacioni serial i mbetjeve dhe heteroskedasticiteti, për të cilat duhet të korrigjohet modeli final.

Modeli përfundimtar paraqitur në Tabelën 5.26 rezulton globalisht statistikisht i rëndësishëm. Mesatarisht 61 përqind e variancës së modelit shpjegohet prej diferencave në panel. Variablat e produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë dhe vendit partner në tregti rezultojnë statistikisht të rëndësishëm në nivelin 1 përqind të rëndësisë statistikore. Kështu një rritje prej 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të Shqipërisë mundëson një rritje mesatarisht prej 1.11 përqind në volumin e importeve. Ndërkohë që, një rritje me 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të vendit partner në tregti bën të mundur një rritje mesatare prej 0.71 përqind të volumit të importeve. Pra, vihet re se një rritje prej 1 përqind e produktit të

brendshëm bruto të Shqipërisë e rrit proporcionalisht me shumë volumin e importeve se sa një rritje me një përqind e produktit të brendshëm bruto të vendit partner në tregti. Popullata e vendit partner ka gjithashtu fuqi shpjeguese në model. Një rritje me një përqind në popullatën e vendit partner mundëson një rritje mesatare prej 0.61 përqind të volumit të importeve. Ndërsa një rritje prej 10 përqind në distancën midis vendeve partnere në tregti zvogëlon volumin e importeve mesatarisht me 18.6 përqind. Rezultatet janë konsistente me ato të sugjeruara nga literatura dhe konform pritshmërive për rastin e Shqipërisë.

Tabela 5.26. Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar për heteroskedasticitet dhe autokorrelacion

```
RE GLS regression with AR(1) disturbances        Number of obs          =      297
Group variable: A                                Number of groups       =       23

R-sq:  within  = 0.5615                          Obs per group: min     =       11
       between = 0.8002                                        avg     =     12.9
       overall = 0.7366                                        max     =       13
                                                 Wald chi2(8)           =   214.68
corr(u_i, Xb)       = 0  (assumed)               Prob > chi2            =   0.0000

  min       5%        median        95%       max
0.4113   0.4333      0.4333      0.4333    0.4333

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.116529   .2210227     5.05   0.000     .6833326      1.549726
      lngdpj |   .7165382   .1533511     4.67   0.000     .4159756      1.017101
        lnni |   .0691803    .804812     0.09   0.931    -1.508222      1.646583
        lnnj |   .6151393   .1831919     3.36   0.001     .2560898      .9741888
       agree |  -.1370046   .1202251    -1.14   0.254    -.3726414      .0986323
        CMBR |   .6499455   .5169498     1.26   0.209    -.3632576      1.663149
         lnd |  -1.868382   .3263276    -5.73   0.000    -2.507973     -1.228792
       _cons |  -19.63668   13.49299    -1.46   0.146    -46.08245      6.809084

      rho_ar |  .73390488   (estimated autocorrelation coefficient)
     sigma_u |  .59688326
     sigma_e |  .47002364
     rho_fov |  .61724647   (fraction of variance due to u_i)
```

5.6.2 Modelimi i të dhënave përfshirë Kosovën dhe me variablin TCI

Në vijim prezantohen rezultatet e modelit të importeve kur në panel përfshihet Kosova si dhe variabli i pavarur TCI. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte fikse paraqitet në Tabelën 5.27. Modeli rezulton statistikisht i rëndësishëm duke qënë se probabiliteti për të vëzhguar statistikën Fisher me vlerë 55.16 dhe me shpërndarje 6 dhe 258 shkallë lirie është 0.000. Variablat shpjegues janë të korreluar me mbetjet (0.871). Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe vendit partner rezultojnë statistikisht të rëndësishëm deri në nivelin 5 përqind. Gjithë variablat e tjerë të përfshirë në model nuk kanë fuqi shpjeguese në model. Për më tepër 96 përqind e variancës në model vjen si pasojë e diferencave në panel.

Tabela 5.27. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte fikse

```
Fixed-effects (within) regression               Number of obs      =       286
Group variable: A                               Number of groups   =        22

R-sq:  within  = 0.5619                         Obs per group: min =        13
       between = 0.3579                                        avg =      13.0
       overall = 0.1335                                        max =        13
                                                F(6,258)           =     55.16
corr(u_i, Xb)  = -0.8711                        Prob > F           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      t    P>|t|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.298462   .3101828     4.19   0.000     .6876499      1.909275
      lngdpj |   .5888324   .2576105     2.29   0.023     .0815454      1.096119
        lnni |  -1.631257   1.121568    -1.45   0.147     -3.83985      .5773365
        lnnj |   -1.70885   1.976798    -0.86   0.388    -5.601563      2.183863
         TCI |  -.2931793   .3402331    -0.86   0.390    -.9631669      .3768082
       agree |  -.0911115   .1513303    -0.60   0.548    -.3891113      .2068884
       _cons |   31.69514   39.40527     0.80   0.422    -45.90177      109.2921

     sigma_u |  3.3911255
     sigma_e |  .66146502
         rho |  .96334706   (fraction of variance due to u_i)

F test that all u_i=0:        F(21, 258) =    41.22            Prob > F = 0.0000
```

Në vazhdim është vlerësuar modeli me efekte të rastit, i cili në krahasim me modelin me efekte fikse duket i përmirësuar. Rezultatet në Tabelën 5.28 tregojnë se modeli është statistikisht i rëndësishëm dhe variablat e pavarur nuk janë të korreluara me termin e gabimit. Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe i vendit partner rezultojnë të kenë efekte pozitive dhe statistikisht të rëndësishme mbi flukset e importeve. Variabli i popullatës së vendit partner rezulton të ndikojë në mënyrë statistikisht të rëndësishme në rritjen e flukseve të importeve. Për më tepër variabli i distancës rezulton statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 përqind të rëndësisë statistikore dhe me shenjën e pritur negative. Rezultatet e vlerësimit të modelit me efekte të rastit janë konsistente me ato të sugjeruara nga rishikimi i literaturës.

Tabela 5.28. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       286
Group variable: A                               Number of groups      =        22

R-sq:  within  = 0.5594                         Obs per group: min    =        13
       between = 0.8008                                        avg    =      13.0
       overall = 0.7388                                        max    =        13
                                                Wald chi2(8)          =    397.00
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |    1.22122   .2284977     5.34   0.000     .7733725      1.669067
      lngdpj |    .653047   .1541552     4.24   0.000     .3509084      .9551856
        lnni |  -1.407834   1.107289    -1.27   0.204     -3.57808      .7624119
        lnnj |   .7151386   .1993074     3.59   0.000     .3245033      1.105774
         TCI |  -.2558099   .3336724    -0.77   0.443    -.9097957       .398176
       agree |  -.1340514   .1465659    -0.91   0.360    -.4213154      .1532125
         lnd |    -1.9102   .3664932    -5.21   0.000    -2.628514     -1.191887
        CMBR |   .6585171    .627162     1.05   0.294    -.5706978      1.887732
       _cons |   .6671238   17.96881     0.04   0.970     -34.5511      35.88534

     sigma_u |  .81525222
     sigma_e |  .66261595
         rho |  .60219131   (fraction of variance due to u_i)
```

Midis modelit me efekte fikse dhe atij me efekte të rastit, testi Hausman (Aneksi II, Tabela A.26), favorizon modelin me efekte të rastit duke qenë se dështon të hidhet poshtë hipoteza bazë (Prob>chi^2=0.821).

Në vazhdim është vlerësuar modeli i importeve me efekte të rastit, por duke përfshirë edhe variablat që nuk ndryshojnë me kalimin e kohës dhe variablat dummy për vitet, Tabela 5.29. Vihet re se rezultatet e modelit janë përmirësuar. Variablat e pavarur shpjegojnë në mënyrë statistikisht të rëndësishme flukset e importeve (prob>chi^2=0.000). Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe i vendit partner ndikojnë në mënyrë statistikisht të rëndësishme në rritjen e flukseve të importeve. Popullata e vendit partner, ndryshe nga popullata e Shqipërisë, ndikon pozitivisht dhe në mënyrë statistikisht të rëndësishme në flukset e importeve. Indeksi i komplementaritetit të tregtisë rezulton statistikisht i rëndësishëm dhe me efekt negativ në flukset e importeve. Po kështu, distanca mes vendeve partnere në tregti ndikon në mënyrë statistikisht të rëndësishme dhe negativisht në flukset e importeve.

Tabela 5.29. Rezultatet e vlerësimit të modelit të importeve me efekte të rastit përfshirë variablat e pandryshueshëm në kohë dhe variablat dummy për kohën

```
Random-effects GLS regression                   Number of obs         =       286
Group variable: A                               Number of groups      =        22

R-sq:  within  = 0.6124                         Obs per group: min    =        13
       between = 0.8006                                        avg    =      13.0
       overall = 0.7521                                        max    =        13
                                                Wald chi2(19)         =    459.65
corr(u_i, X)   = 0 (assumed)                    Prob > chi2           =    0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|     [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   2.337095   .4087177     5.72   0.000     1.536023      3.138167
      lngdpj |   .5611977   .1541488     3.64   0.000     .2590717      .8633237
        lnni |   4.698679   3.588726     1.31   0.190    -2.335096      11.73245
        lnnj |   .8474133   .2011518     4.21   0.000      .453163      1.241664
         TCI |  -1.367697   .3973963    -3.44   0.001     -2.14658     -.5888147
       agree |  -.2453027    .150246    -1.63   0.103    -.5397796      .0491741
         lnd |  -2.034679   .3694415    -5.51   0.000    -2.758771     -1.310587
        CMBR |   .6568778   .6321207     1.04   0.299     -.582056      1.895811
             |
       vitet |
       2002  |    .184972   .1845142     1.00   0.316    -.1766691      .5466132
       2003  |  -.2163445   .1761818    -1.23   0.219    -.5616545      .1289656
       2004  |  -.7254527   .1938481    -3.74   0.000    -1.105388     -.3455174
       2005  |  -.8974983   .2108626    -4.26   0.000    -1.310781     -.4842152
       2006  |  -.7709098   .2184966    -3.53   0.000    -1.199155     -.3426643
       2007  |  -.6711911   .2357427    -2.85   0.004    -1.133238     -.2091439
       2008  |  -.7265721    .271053    -2.68   0.007    -1.257826     -.1953179
       2009  |  -.5466591    .247133    -2.21   0.027    -1.031031     -.0622873
       2010  |  -.2874919   .2301934    -1.25   0.212    -.7386627      .1636789
       2011  |   .1745231    .333788     0.52   0.601    -.4796893      .8287355
       2012  |   .1442889   .3139321     0.46   0.646    -.4710068      .7595846
       2013  |          0  (omitted)
             |
       _cons |  -107.3993   58.45641    -1.84   0.066    -221.9718      7.173174

     sigma_u |  .81724617
     sigma_e |  .62987571
         rho |  .62734316   (fraction of variance due to u_i)
```

Për më tepër variablat dummy të viteve rezultojnë së bashku të kenë efekt statistikisht të rëndësishëm (Aneksi II, Tabela A.27), duke qenë se ka evidencë të mjaftueshme për të hedhur poshtë hipotezën bazë të mungesës së rëndësisë statistikore (Prob>chi^2=0.0004). Individualisht, vitet nga 2004 deri në 2009 kanë efekt negativ e statistikisht të rëndësishëm deri në nivelin 5 përqind.

Më tej realizohen testet e diagnozës që të mund të interpretojmë në mënyrë të vlefshme efektet e vlerësuara të modelit përfundimtar të importeve.

Testi Breusch dhe Pagan, (Aneksi II, Tabela A.28), nënvizon sërish faktin që modeli më i përshtatshëm është ai i efekteve të rastit duke qenë se ka evidencë të mjaftueshme për t'u hedhur poshtë hipoteza bazë e mungesës së efektit panel. Ndërsa testi për autokorrelacion serial të mbetjeve tregon se mbetjet janë të korreluara midis tyre (Aneksi II, Tabela A.29).

Testi Pesaran, (Aneksi II, Tabela A.30), sugjeron që modeli nuk vuan nga varësia ndërseksionale. Testi i homoskedasticitetit, paraqitur në tabelën 5.30 dështmon se hipoteza bazë për homoskedasticitet hidhet poshtë, gjë që do të thotë se kemi të bëjmë me variancë të ndryshueshme dhe se gabimet standarde duhet të korrigjohen në mënyrë që të marrim vlerësues të besueshëm. Rrjedhimisht, për të vlerësuar modelin përfundimtar duhet fillimisht të korrigjojmë për autokorrelacion serial të mbetjeve dhe heteroskedasticitet.

Tabela 5.30. Vlerësimi i modelit të importeve të korrigjuar për heteroskedasticitet dhe autokorrelacion

```
RE GLS regression with AR(1) disturbances       Number of obs          =      286
Group variable: A                               Number of groups       =       22

R-sq:  within  = 0.5543                         Obs per group: min     =       13
       between = 0.7983                                        avg     =     13.0
       overall = 0.7353                                        max     =       13
                                                Wald chi2(9)           =   201.76
corr(u_i, Xb)       = 0 (assumed)               Prob > chi2            =   0.0000

         lnm |      Coef.   Std. Err.      z    P>|z|    [95% Conf. Interval]

      lngdpi |   1.040098   .2377897     4.37   0.000     .5740389      1.506158
      lngdpj |   .7083914   .1582509     4.48   0.000     .3982253      1.018557
        lnni |   .0029764   .8279939     0.00   0.997    -1.619862      1.625815
        lnnj |   .6017744    .188821     3.19   0.001      .231692      .9718568
         TCI |   .2134245   .3692592     0.58   0.563    -.5103103      .9371593
       agree |  -.1468944     .12352    -1.19   0.234    -.3889891      .0952004
        CMBR |   .7244685   .5631643     1.29   0.198    -.3793134       1.82825
         lnd |   -1.82029   .3414606    -5.33   0.000     -2.48954     -1.151039
       _cons |  -17.43102   13.92978    -1.25   0.211     -44.7329       9.87085

      rho_ar |  .73099921   (estimated autocorrelation coefficient)
     sigma_u |    .612233
     sigma_e |  .47212769
     rho_fov |  .62708391   (fraction of variance due to u_i)
       theta |  .44471636
```

Rezultatet e vlerësimit të modelit përfundimtar të importeve, kur në panel shtohen të dhënat për Kosovën dhe variabli TCI, paraqiten në Tabelën 5.30. Vihet re se modeli është statistikisht i rëndësishëm. Produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe i vendit partner rezultojnë statistikisht të rëndësishëm. Një rritje me 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të Shqipërisë bën të mundur një rritje mesatare prej 1.04 përqind në flukset e importeve. Ndërsa një rritje me 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të vendit partner çon në një rritje mesatarisht prej 0.7 përqind në flukset e importeve. Në nivelin 1 përqind të rëndësisë statistikore, paraqiten të kenë efekt të rëndësishëm edhe popullata e vendit partner si dhe variabli i distancës. Një rritje me 1 përqind në popullatën e vendit partner në tregti mundëson një rritje mesatare prej 0.6 përqind në flukset e importeve. Ndërsa një rritje prej 10 përqind e distancës mes vendeve partnere bën të mundur zvogëlimin e flukseve të importeve me 18.2

përqind. Popullata e Shqipërisë, indeksi i tregtisë komplementare, marrëveshjet e tregtisë së lirë si dhe kufiri i përbashkët rezultojnë të mos kenë efekt të rëndësishëm mbi volumin e importeve Shqiptare.

Si përfundim mund të themi se të tri modelet e importeve të vlerësuar në këtë seksion rezultuan statistikisht të rëndësishme. Në të tri rastet modeli me efekte të rastit ishte i favorizuari nga testi Hausman për përzgjedhjen e modelit më të përshtatshëm, rezultat ky i mbështetur edhe nga testet e Breusch dhe Pagan. Nga testet e diagnozës në secilin prej modeleve të importeve u identifikuan probleme me heteroskedasticitetin dhe autokorrelacionin serial të mbetjeve, për të cilat u korrigjua në vlerësimin e modelit përfundimtar. Ndryshe nga modelet e eksporteve modelet e importeve nuk rezultonin me varësi ndërseksionale. Modelet përfundimtare në secilin rast identifikuan se produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë dhe ai i vendit partner në tregti, popullata e vendit partner dhe distanca kanë efekt statistikisht të rëndësishëm mbi volumin e importeve. Produkti i brendshëm bruto si i Shqipërisë ashtu edhe i vendit partner si dhe popullata e vendit partner ndikojnë në rritjen e volumit të importeve. Ndërsa distanca u vlerësua të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në uljen e volumit të importeve. Rrjedhimisht, ka qëndrueshmëri të rezultateve sipas specifikimit të modelit dhe sipas të dhënave.

5.7 Analiza e Avantazhit Krahasues

Politika tregtare e Shqipërisë, që pas anëtarësimit në OBT, pësoi një transformim rrënjësor. Siç paraqitet në kapitullin IV, politika tregtare shqiptare u plotësua më tej me marrëveshjet e tregtisë së lirë, të cilat kanë krijuar hapësira të konsiderueshme për eksportet tona. Heqja e tarifave doganore për produktet shqiptare në tregun e Bashkimit Evropian që pas viteve 2000[49] dhe plotësimi me parashikimet e MSA kanë krijuar më shumë hapësira për produktet shqiptare të eksportit. Me këtë logjikë, avantazhi krahasues i Shqipërisë në tregun e Bashkimit Evropian duhet të rritet. Rezultati më befasues i aplikimit të modelit të gravitetit në vlerësimin e flukseve tregtare të Shqipërisë lidhet me shkallën e ulët, pothuaj të papërfillshme, që marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë në flukset tregtare të Shqipërisë. Gjithashtu, indeksi i komplementaritet të tregtisë, një variabël që mat strukturën e tregtisë, gjithashtu rezultoi i parëndësishëm në flukset e tregtare të Shqipërisë, analizuar dhe paraqitur

[49] Parashikuar në Rregulloren e Këshillit (EC) 2007/2000; Rregulloren e Këshillit (EC) 1215/2009; Rregulloren e Këshillit (EC EC1336/2011

në seksionet 5.3, 5.4, 5.5 dhe 5.6 të këtij kapitulli. Për të arsyetuar më tej rreth këtyre rezultateve ose gjetur hapësira të reja vlerësuese në këtë seksion do të analizohet avantazhi krahasues shfaqur (revealed) i Shqipërisë për të parë shkallën e ndikimit që MSA ka patur tek eksportet shqiptare. Kjo edhe për faktin që eksportet janë synimi kryesor drejt të cilit përqaset një marrëveshje e tregtisë së lirë.

Avantazhi krahasues i produkteve shqiptare është vlerësuar në nivel kapitulli të Nomenklaturës së Mallrave. Ajo ka 99 kapituj, të cilët numërtohen me dy shifra, dhe ndahen në krerë, që numërtohen në 4 shifra dhe produkte, të cilat numërtohen deri në 8 shifra. Këto të fundit quhen ndryshe linja tarifore dhe Nomenklatura e Kombinuar e mallrave ka 9707 linja të tilla. Për të lejuar një analizë të të gjithë eksporteve shqiptare analiza e avantazhit krahasues do të bëhet në nivel dy shifror. Aneksi III, Tabela 1 jep listën e plotë të kapitujve të Nomenklaturës së Mallrave.

5.7.1 Modeli teorik

Modeli klasik dhe neoklasik i tregtisë tregon se një vend me kushte të tilla ekonomike që i lejon të prodhojë një produkt të caktuar me një kosto relativisht të ulët (d.m.th me avantazh krahasues) e eksporton këtë produkt, ndërkohë që importon produktet me disavantazh krahasues. Bazat teorike të avantazhit krahasues përcaktohen në modelin Rikardian të tregtisë dhe atë të Heckscher-Ohlin (H-O). Parimi qëndror i modelit Rikardian përdor dy mallra, një faktor dhe dy vende. Ndërkohë teoria e H-O e përcakton avantazhin krahasues nëpërmjet faktorëve relative të pamjaftueshmërisë. Dornbusch et. al (1977) e zgjeruan konceptin e avantazhit krahasues në një numër *n* produktesh, por pa e zgjeruar më tej numrin e faktorëve që e ndikojnë atë.

Llogaritja e avantazhit krahasues dhe testimi i teorisë H-O ka vështirësi (Utkulu, U. and Seymen, 2004) sepse çmimet relative të "autarkisë" nuk mund të observohen. Sipas Balassa (1965) është e vështirë që të përfshihen të gjithë faktorët që ndikojnë në avantazhin krahasues kështu që ai sugjeroi llogaritjen e avantazhin krahasues të "shfaqur" (revealed) i cili vëzhgon vetëm strukturën e tregtisë. Avantazhi krahasues vlerëson performancën e eksportit të një vendi krahasuar me botën. Kjo performancë e eksportit mund të jetë rezultat i faktorëve realë ose shtrembërimeve në çmime apo subvencioneve të dhëna nga shtetet.

Sipas Eckhard Siggel (2007) paraqitja e avantazhit krahasues mund të kufizohet (i) në modelin Rikardiand dhe Hechler Ollin pa aplikuar apo konsideruar format e tjera të tregtisë si p.sh. tregtinë midis industrive ose (ii) interpretimin më gjerë në kuptim të avantazhit që vjen nga çmimi më i ulët i prodhuesit në një vend krahasuar me një konkurrent të huaj. Sipas të njëjtit autor, burimet e avantazhit krahasues të një vendi për një produkt mund të vijnë nga sasia e madhe e inputeve primare të lira (HO e zgjeruar), përdorimi i teknologjive të diferencuara midis vendeve (Rikardo), prodhimi në shkallë të gjerë (Krugman) ose kombinimi i të gjitha burimeve (p.sh. modeli i ciklit të produktit sipas Vernon[50])

Përpjekja e parë për të matur avantazhin krahasues të shfaqur ishte ajo e Balassa (1965), i cili krijoi një indeks i cili përdoret sot gjerësisht, megjithëse ai nuk konsiderohet si matësi më i mirë i performancës së eksportit të një vendi. Për shembull, Indeksi Balasa nuk mund të përcaktojë rastin e eksportit zero (Sanidas, E., Shin, E., 2010). Gjithashtu, indeksi nuk tregon se cilët janë faktorët që ndikojnë në të dhe cilët janë shkaqet që e ndikojnë atë në kohë (Siggel, 2007). Kritikat ndaj këtij indeksi bënë që kërkues të ndryshëm të tentojnë të shtojnë variabla të tjerë në llogaritjen e tij, por këto përpjekje/analiza nuk janë pjesë e këtij kërkimi dhe nuk do të trajtohen në detaje. Përdorimi i Indeksit të Balasës është i gjerë dhe ai është përdorur gjerësisht për të përafruar specializimin sektorial midis vendeve (Leromain dhe Orefice, 2013). Po sipas këtyre autorëve modeli i ri i avantazhit krahasues të shfaqur jep të dhëna statistikore më të mira se Indeksi i Balasës, por kjo qasje e re nuk është pjesë e këtij punimi.

Në fillimet e veta Balasa e përdori Indeksin e Balasës për të analizuar industritë prodhuese duke qenë se produktet primare ishin përgjithësisht të subvencionuara. Indeksi klasik i Balasës (BI) është:

$$Bij = \frac{\frac{Xij}{Xi}}{\frac{Xwj}{Xw}} = \frac{\frac{Xij}{Xwj}}{\frac{Xi}{Xw}} \qquad 5.1$$

ku:

X_{ij}, është eksporti i produktit *j* të vendit *i*

X_i, është eksporti total i vendit *i*

[50] Sipas modelit të ciklit të produktit burimet e avantazhit mund të ndryshojnë gjatë jetës së ciklit të produktit.

$Xw_{j,}$ është eksporti botëror i produktit *j*

$Xw_{,}$ është eksporti total botëror

Interpretimi i indeksit është i thjeshtë. Për $BI_{ij}>1$ vendi *i* ka avantazh krahasues për produktin *j* dhe $BI_{ij}<1$ vendi *i* nuk ka avantazh krahasues për produktin *j*. Kur BI është afër 1 atëherë jemi në situatën e avantazhit krahasues neutral (Sanidas, E., Shin, E., 2010).

Indeksi i Balasës është përdorur gjerësisht për vlerësimin e avantazhit konkurrues sipas sektorëve (Muendler, 2007), apo analiza krahasimore midis të mirave dhe avantazheve që sjell llogaritja e këtij indeksi për sektorë të caktuar apo të gjithë tërësinë e Nomenklaturës së Mallrave (Batra dhe Khan, 2005).

5.7.2 Qasja e analizës së avantazhit krahasues

Analiza e avantazhit krahasues bërë në këtë seksion ndjek këto parime të përgjithshme:

1. BI është llogaritur fillimisht për produkte në nivel 2 shifror të nomenklaturës së mallrave.

2. BI është matur për partnerët kryesorë të eksportit me vendet e Bashkimit Evropian. Për këtë në formulën (5.1) në vend të botës (w) është marrë vendi partner për të cilin do të llogaritet Indeksi. Në rastin konkret, është llogaritur indeksi për Bashkimin Evropian (BE 15 dhe BE 27), dhe vendet partnere të marra në analizë Italia, Gjermania, Greqia dhe Spanja. Këto vende kanë qenë në vite partnerët kryesorë të eksportit për Shqipërinë brenda grupit të vendeve të Bashkimit Evropian, përjashtuar Spanjën e cila është treg parësor eksporti për Shqipërinë vetëm në 2-3 vitet e fundit (Tabela 5.31).

Tabela 5.31 partnerët kryesorë të eksportit për Shqipërinë

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Gjermania	2.5%	2.7%	3.4%	3%	2.9%	3.1%	4.4%
Greqia	8.4%	8.9%	7.4%	5.5%	5.1%	4.4%	3.2%
Hollanda	0.1%	1.4%	0.6%	0.7%	0.7%	1.0%	0.6%
Italia	67.9%	61.7%	62.3%	51.0%	53.2%	51.0%	46.6%
Kina	2.6%	2.8%	4.7%	5.5%	2.5%	2.7%	4.8%
Kosova	4.8%	6.5%	6.9%	6.2%	7.6%	8.1%	6.9%
Mal i Zi	0.4%	2.1%	1.3%	0.9%	0.9%	0.8%	1.3%
Malta	0.0%	0.0%	0.0%	0.8%	2.4%	1.8%	5.6%
Maqedonia	2.4%	2.9%	3.0%	1.6%	2.1%	1.9%	1.9%
Spanja	0.2%	0.2%	1.2%	3.5%	3.5%	9.2%	11.1%
Turqia	2.2%	1.9%	0.5%	5.7%	7.6%	6.4%	2.6%

Burimi: INSTAT

I pari I dyti I treti I katerti I pesti

3. BI e llogaritur për (BE 15) dhe (BE 27) bëhet për të vlerësuar rolin e anëtarëve të vjetër dhe atyre të rinj (anëtarët e 2004 dhe 2007) në avantazhin konkurrues. Më tej ky indeks është krahasuar me atë të vendeve anëtare, partnere kryesore të Shqipërisë (tabela 5.31) për të kuptuar rolin e secilit vend partner në avantazhin konkurrues. Këto përgjithësime lejojnë të kuptohen kategoritë e produkteve për të cilat Shqipëria duhet të lobojë me Komisionin Evropian për t'i përfshirë ato në negociatat tregtare që BE do të bëjë më vendet e treta në kohën kur Shqipëria do të jetë anëtare.

4. Analiza vijon më tej me grupimet e produkteve, të ndara në bujqësore (Kapitujt 1-24) dhe industriale (Kapitujt 25-99). Kjo analizë lejon nxjerrjen e përgjithësimeve makro që lidhen me kategoritë e produkteve për të cilat Shqipëria duhet të jetë e ndjeshme në momentin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

5. Grupet e produkteve me BI të lartë janë krahasuar me eksportet reale të Shqipërisë për të përgjithësuar përputhshmëritë dhe lejuar në daljen e përfundimeve.

6. Të dhënat e import-eksportit për të gjitha vendet e marra në analizë janë marrë nga United Nation Statistical Division (UNSD) Commodity Trade (COMTRADE), për të lejuar uniformitet në bazën e të dhënave. Kjo databazë ka të dhëna për eksportin sipas produkteve (deri në nivel 10 shifror) dhe sipas vendeve partnere. [51].

[51] Të gjitha përpunimet janë bërë nga autori.

5.7.3 Rezultatet e indeksit të avantazhit konkurrues (BI):

- **BE (15) dhe BE (27)**

Analiza e indeksit të avantazhit krahasues për BE (15) dhe BE (27), duke paraqitur, ndër të tjera, rolin që kanë anëtarët e rinj (vitet 2004 dhe 2007) dhe ata të anëtarësuar më herët, jep rezultate të rëndësishme për të mbështetur gjetjet e seksioneve të mësipërme të këtij kapitulli lidhur me rolin e vendeve të Bashkimit Evropian dhe MSA-së në tregtinë.e Shqipërisë. Nga krahasimi i bërë për BE (15) dhe BE (27), Aneksi III, Tabela 2 , rezulton se:

1. Shqipëria ka avantazh krahasues të njëjtë për të njëjtat grupe produktesh, si për BE (15) ashtu edhe BE (27)[52]. Kjo tregon që Shqipëria nuk ka patur asnjë ndryshim në lidhje me avantazhin e vet krahasues për vendet e anëtarësuara në vitet 2004 dhe 2007, duke vënë theksin vetëm tek BE (15), vende me të cilat në fakt Shqipëria ka edhe shkëmbimet më të mëdha tregtare. Kjo jep një tregues të qartë për Shqipërinë dhe politikat e saj lobuese pas anëtarësimit, duke i dhënë përparësi vendeve me të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues, në këtë rast BE (15).

   Megjithatë, fakti që anëtarët e rinj të BE-së të anëtarësuar në vitin 2004 dhe 2007, nuk kanë luajtur asnjë rol në avantazhin krahasues të Shqipërisë nuk varet domosdoshmërisht prej interesit të këtyre vendeve ndaj produkteve shqiptare, por edhe problemeve të tranzicionit të kaluara nga Shqipëria. Disa arsye të tjera që mund të shpjegojnë ndikimin e dobët të anëtarëve të rinj janë:

   a. Shqipëria doli menjëherë pas viteve 90 me probleme të mëdha strukturore dhe me mungesa të konsiderueshme në strukturën e prodhimeve konkurruese. Gjithashtu, mungesa e informacionit për tregjet e Bashkimit Evropian bëri që investitorët shqiptarë të ishin më shumë në pozita pritëse. Vendet fqinje, të nxitura kryesisht nga emigracioni i viteve '91 dhe njohjet me shqiptarët, ishin vendet e para që krijuan partneritet me prodhuesit vendas. Kjo shpjegon edhe fluksin e madh të investimeve italiane dhe greke në Shqipëri në fillimet e viteve 90, tendencë e cila ruhet edhe sot.

[52] Vendet e anëtarësuara në vitin 2004: Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Lituani, Letoni, Malta, Poloni, Sllovaki, Slloveni dhe 2007: Bullgaria dhe Rumania.

b. Avantazhet konkurruese prodhuese të Shqipërisë për 2 dekada kanë qenë të lidhura kryesisht me krahun e lirë të fuqisë punëtore, pozitën gjeografike dhe moshën e re të popullsisë. Po të shihen grupet e produkteve me avantazh krahasues të lartë, ato janë "labor intensive" dhe kanë vlerë të ulët të shtuar në produktin final. Ndryshe, këto produkte quhen edhe produkte fason. Në këto kushte, vetëm tregtia me vendet fqinje lejonte që fuqia e lirë punëtore të krijonte avantazh konkurrues për produktet shqiptare.

c. Problemet strukturore të periudhës pas viteve '90, të cilat lidhen kryesisht me (i) mungesën e plotë të industrisë prodhuese, (ii) mungesën e inovacionit dhe teknologjive të përparuara, (iii) mbështetjen në sektorë me vlerë të ulët të shtuar në zinxhirin e vlerës (p.sh. rritja ekonomike deri në vitin 2000 është mbështetur deri në masën 50 përqind nga sektori i bujqësisë), etj.

d. Gjithashtu, mungesa e ndryshimeve sa i takon avantazhit konkurrues për vite me radhë është edhe rezultat i nivelit të produktivitetit dhe shkallës së sofistikimit teknologjik të vendit. Gjithsesi, këta elementë nuk janë pjesë e këtij kërkimi dhe mund të përbëjnë objekt studimesh të mëtejshme.

2. Duke u mbështetur në analizat edhe për periudhën 2001-2006 rezulton se produktet me avantazh krahasues, pas hyrjes në fuqi të MSA, janë të njëjta me ato të para MSA. Kjo tregon se MSA nuk ka dhënë ndonjë ndikim të ndjeshëm në ndryshimin e avantazhit krahasues[53]. Kjo panoramë lidhet, ndër të tjera, edhe me faktin që regjimi tregtar i eksporteve shqiptare në Bashkimin Evropian është me status preferencial pothuaj të pandryshuar që prej vitit 2000[54], vit në të cilin Shqipëria përfitoi regjimin e parë preferencial me Bashkimin Evropian.

3. Nga një analizë më e detajuar e avantazhit krahasues për produktet bujqësore dhe industriale, para dhe pas nënshkrimit të MSA, (grafikët 5.2) vërehet se:

[53] Me arsyetimin se MSA ka ndikuar në rritjen e eksporteve të Shqipërisë drejt vendeve të BE, dhe kjo kryesisht në vendet partnere kryesore, pritej që indirekt edhe indeksi i avantazhit krahasues të rritej.
[54] Rregullorja e Këshillit Nr. 2007/2000 e 18 Shtator 2000.

a. Produktet bujqësore:

i. Asnjë grup-produktesh nuk e ka Indeksin e Balasës më të madh se 15 pas nënshkrimit të MSA, ndërkohë që para nënshkrimit të saj bimët mjekësore kanë patur një avantazh krahasues të konsiderueshëm mbi këtë vlerë,

ii. Produktet si peshku i freskët, erëzat, duhani dhe zëvendësuesit tij, nuk kanë pësuar pothuaj asnjë ndryshim. Peshku i përpunuar, Indeksi i Balasës së të cilit ka patur një kërcim të dukshëm në vitin 2003, vit i cili është para nënshkrimit të MSA, ka pësuar një rënie të vazhdueshme pas nënshkrimit të MSA duke arritur në periudhën 2010-2013 nivelet më të ulta të BI, 4.5. Kjo rënie shpjegohet, kryesisht, me rritjen e standardeve të sigurisë për produktet e peshkut në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, vitet pas nënshkrimit të MSA përkojnë edhe me kohën kur Bashkimi Evropian filloi të kërkojë certifikimin e stabilimenteve prodhuese të peshkut të vendeve importuese. Si rezultat, eksporti i peshkut njohu rënie. Në të njëjtën kohë rritja e konkurrencës nga vendet e tjera të rajonit, kryesisht Kroacia, ka qenë një faktor tjetër i cili ka dhënë luhatje të eksporteve shqiptare në periudha të ndryshme.

b. Produktet industriale:

i. Mineralet janë i vetmi produkt me përmirësim të dukshëm të BI pas nënshkrimit të MSA krahasuar me periudhën para nënshkrimit të saj. Megjithatë, pas vitit 2008 BI e mineraleve ka rënie të dukshme, sepse në vitin 2008 u hartua një ligj i ri për koncensionet i cili vendosi rregulla strikte për kontratat koncensionare me rregulla të forta për respektimin e kushteve të eksportit. Kushtet strikte legjislative, monitorimi dhe kontrolli i fortë i institucioneve përgjegjëse shtetërore, sollën si rezultat uljen e sasisë së mineralit të nxjerrë dhe uljen e eksportit.

ii. Të gjitha produktet industriale me avantazh krahasues, me përjashtim të mineraleve dhe veshjeve, nuk kanë ndryshime të konsiderueshme të këtij indeksi në periudhën pas nënshkrimit të MSA krahasuar me atë para nënshkrimit të saj. Gjithashtu, duhet thënë se veshjet e këmbëve, megjithëse vazhdojnë të jenë në kategorinë e produkteve industriale me BI të lartë, kanë

një ulje të vazhdueshme të këtij indeksi duke arritur në 2013 nivelin më të ulët, 19.

Grafik 5.2 Indeksi i avantazhit krahasues para dhe pas nënshkrimit të MSA-së



Burimi: Llogaritur nga autori

- **Itali-Gjermani-Greqi-Spanjë**

Analiza e indeksit të avantazhit krahasues të partnerëve kryesorë të eksportit të Shqipërisë, specifikisht Itali, Gjermani, Greqi dhe Spanjë (Ankesi III, Tabela 3) përmbledh rezultatet për 4 vitet e fundit. Nga krahasimi i bërë rezulton se:

1. Partnerët kryesorë të eksportit të Shqipërisë kanë ndryshime midis tyre në numrin e produkteve që kanë avantazh krahasues si dhe vlerës konkrete të matur të Indeksit të Balasës. Vetëm kapitulli 26, mineralet, është grupi i produkteve me avantazh krahasues në të katër partnerët kryesorë të eksportit. Megjithatë, duket qartë që ky indeks është konsiderueshëm i lartë për Italinë dhe Greqinë dhe gjendet në nivel të moderuar për Gjermaninë dhe Spanjën.

2. Gjermania është partneri me të cilin Shqipëria ka vetëm një kategori produktesh me avantazh krahasues, dhe këto janë mineralet. Ndërkohë, Gjermania është një ndër pesë partnerët kryesorë të eksportit për Shqipërinë, por kjo nuk pasqyrohet edhe në ekzistencën e avantazhit krahasues. Eksporti real drejt Gjermanisë dhe numri i ulët i produkteve me avantazh krahasues tregojnë që ka një mospërputhje midis potencialeve reale për të eksportuar drejt Gjermanisë dhe avantazhit krahasues të gjetur. Edhe pse eksportet drejt Gjermanisë variojnë nga 2.5 përqind e totalit të eksporteve të Shqipërisë në vitin 2007 në 4.4 përqind të totalit në vitin 2013, me një rritje modeste por rritëse në vite, nuk gjejmë një korrelacion pozitiv midis kësaj rritjeje dhe modifikimit të avantazhit krahasues.

3. Italia është vendi i parë sa i takon numrit të produkteve për të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues. Nga llogaritjet e bëra rezulton se 29 kapituj të Nomenklaturës së Mallrave kanë avantazh krahasues. Gjithashtu, për pjesën më të madhe të produkteve, Indeksi i Balasës është konsiderueshëm më i lartë se sa ai i vendeve të tjera partnere për të njëjtat kategori produktesh. Nga analiza e Italisë është interesant fakti që ka kapituj të Nomenklaturës së Mallrave, për të cilat mundësia reale e eksportit nuk ekziston. Kështu p.sh., kapitulli 1 i Nomenklaturës së Mallrave, kafshë të gjalla dhe nënprodukte prej tyre rezulton të jetë me avantazh krahasues, ndërkohë që eksporti i këtyre produkteve në Bashkimin Evropian nuk është i lejuar si rezultat i kërkesave të larta të sigurisë së produkteve, të cilat Shqipëria akoma nuk i plotëson. Gjithashtu, kapitulli 24, duhan dhe nënprodukte të tij, përfaqëson një kategori produktesh që nuk prodhohen në Shqipëri dhe si të tilla eksporti real i tyre nuk është produkt origjinues shqiptar.

4. Greqia dhe Spanja, edhe pse krahasimisht me Italinë kanë më pak kapituj të Nomenklaturës së Mallrave, 10 kapituj më pak, për të cilat vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues, kanë shumë ngjashmëri midis tyre në llojin e produkteve me avantazh krahasues. Greqia, megjithëse e humbi rëndësinë e vet si destinacioni i dytë më i rëndësishëm i eksporteve shqiptare, gjatë dhe pas krizës ekonomike të vitit 2009, parë nga këndvështrimi i produkteve me avantazh krahasues vazhdon të jetë një treg interesant për Shqipërinë, konsideruar traditën jo shumë të largët me eksportet në këtë vend. Gjithashtu, duke analizuar produktet me avantazh krahasues shihet qartë se produktet e tekstilit dhe veshjeve, të cilat janë kryesisht me produkt porositësi ose

ndryshe siç njihen fason, vazhdojnë ta ruajnë avantazhin krahasues edhe pse eksportet faktike me këtë vend kanë rënë. Gjithsesi, për këtë do të kërkohen analiza të mëtejshme të detajuara, të cilat nuk janë objekt i këtij kërkimi.

5. Analiza e avantazhit krahasues me partnerët e marrë në analizë, para dhe pas nënshkrimit të MSA, ruan përgjithësisht të njëjtat karakteristika të përgjithshme të BE (15) dhe BE (27). Produktet me avantazh krahasues për vendet anëtare të marra në analizë janë të njëjta si para edhe pas anëtarësimit në BE. Gjithsesi, vihet re që indeksi i avantazhit krahasues ka patur ndryshime, është ulur, ngritur ose ka patur fluktacione në vite por pa ndryshime thelbësore, për kapituj të caktuar të Nomenklaturës së Mallrave, sipas vendeve anëtare. Nga një analizë më e detajuar e produkteve me avantazh krahasues para dhe pas nënshkrimit të MSA, për katër vendet anëtare të marra në shqyrtim vihet re se produktet, me avantazh krahasues ose jo, kanë disa sjellje si (i) janë indiferente ndaj ekzistencës së MSA-së, (ii) reagojnë pozitivisht ndaj MSA duke e reflektuar këtë në rritjen e Indeksit të Balasës, (iii) reagojnë negativisht ndaj MSA duke e reflektuar këtë në uljen e Indeksit të Balasës. Tabela 5.32 jep një paraqitje të ndryshimeve që reflektohen në avantazhin krahasues sipas kapitujve para dhe pas nënshkrimit të MSA-së.

Tabela 5.32 Sjellja e kapitujve me avantazh krahasues para dhe pas nënshkrimit të MSA-së

NK	ITALIA	GREQIA	GJERMANIA	SPANJA
1	-			
3	+			
5	+	+		+
6		≈		
12	≈	≈		-
14	+			
16	-	≈		≈
24	-			≈
25	+	+		+
26	+	+	+	+
27	+			+
36	*			+
41	≈	≈		≈
44	≈	≈		≈
48	+	≈		
49	+	+		+
61	+	≈		-
62	≈	≈		-
63	≈	+		≈
64	≈	-		≈
72	≈	≈		≈
74	≈			
76	≈			
78	≈	≈		≈
83	≈	≈		≈
85	+			
93	*	≈		≈
94	≈	≈		≈
95	≈			
97	*	*		*
% e reagimit indiferent	46	65	Për Gjermaninë këto përqindje nuk janë llogaritur pasi ka vetëm 1 kapitull për të cilin vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues	52
% e reagimit pozitiv	34	25		29
% e reagimit negativ	10	5		15
% e kapitujve reagimi i të cilave nuk lidhet fare me ekzistencën e MSA-së	10	5		4

Burimi: Llogaritje të autorit

Shënim: ≈ tregon indiferencë, + rritje të indeksit, - ulje të indeksit dhe * indeks krejtësisht të paqëndrueshëm

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se një numër i madh produktesh, mesatarisht rreth 50 përqind e atyre për të cilët vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues, kanë një reagim krejtësisht indiferent ndaj ekzistencës së MSA-së ose jo. Kjo shpjegohet edhe me faktin që produktet industriale[55] për të cilat vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues që prej vitit 2000 kanë të njëjtin trajtim tarifor kur eksportohen në tregun e BE-së, me atë të ofruar nga MSA. Kjo bën që avantazhi krahasues i eksporteve shqiptare për produktet

[55] Pjesa më e madhe e produkteve për të cilat vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues janë produkte industriale.

industriale të mos ndikohet nga ekzistenca e MSA, dhe të jetë i pandryshuar. Ndërkohë, reagimi pozitiv ndaj MSA është në nivelet 25 përqind (Greqia) deri në 34 përqind (Italia), çka është e ulët për të justifikuar ndikimin e MSA në përmirësimin e avantazhit krahasues.

Për disa kapituj (97 për Greqinë, Italinë dhe Spanjën; 93 dhe 36 për Italinë), për të cilët indeksi i avantazhit krahasues ka rritje dhe ulje gjatë gjithë periudhës së vrojtuar 2001-2013, nuk mund të jepet ndonjë shpjegim specifik nëse MSA ka ndikuar ose jo në sjelljen e avantazhit krahasues. Gjithashtu, ka kapituj (p.sh. 6, 9, 65, 75 për Italinë; 1 dhe 9 për Greqinë dhe 97 për Spanjën), të cilët kanë një ulje të vazhdueshme të indeksit të avantazhit krahasues. Jo vetëm kaq, por këto kapituj nuk konsiderohen të kenë më avantazh krahasues për Shqipërinë[56]. Kjo ulje nuk mund të shpjegohet me regjimin liberal tregtar të eksporteve shqiptare, apo regjimin tarifor preferencial që produktet shqiptare përfitojnë në tregun evropian, por në mënyrë intuitive duhet të shpjegohet, kryesisht, nga faktorë të brendshëm strukturor të ekonomisë së Shqipërisë në këtë periudhë. Gjithësesi, pavarësisht se, mbështetur edhe në kufizimet e teorisë së avantazhit krahasues dhënë në këtë seksion, nuk mund të shpjegojmë zhvillimet në kohë të ndryshimeve të faktorëve të prodhimit që ndikojnë në ndryshueshmërinë e indeksit, rezultatet e këtij seksioni plotësojnë gjetjet kryesore të këtij kapitulli.

- **Krahasimi i produkteve me avantazh krahasues me eksportin faktik**

Nga krahasimi i bërë midis kapitujve të Nomenklaturës së Mallrave, për të cilat është llogaritur avantazhi krahasues, eksportit faktik të Shqipërisë në BE sipas kapitujve të Nomenklaturës së Mallrave, rezulton se produktet me avantazh krahasues janë në pjesën më të madhe të njëjta me eksportet faktike të Shqipërisë drejt vendeve të Bashkimit Evropian. Gjithsesi, ekzistojnë edhe diferenca midis eksportit faktik të një kapitulli të Nomenklaturës së Mallrave dhe vërtetimit ose jo të avantazhit krahasues për këtë kapitull. Diferenca jepen në Tabelën 5.33 më poshtë, ndërkohë, të gjithë kapitujt e tjerë për të cilët avantazhi krahasues ekziston dhe ka eksport faktik nuk përfshihen në këtë tabelë.

[56] Indeksi Balasës është më i vogël se 1

Tabela 5.33 Avantazhi krahasues dhe eksporti faktik

Kodi CN	Avantazhi krahasues sipas kapitujve të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave	Eksporti faktik drejt BE sipas kapitujve të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave
5	Po	-
24	Po	Po
25	Po	Po
36	Po	-
39	-	Po
48	-	Po
74	Po	-
78	Po	-
84	-	Po
85	-	Po
94	-	Po

Burimi: Llogaritje të autorit

Pavarësisht nga diferencat e paraqitura në tabelën 5.33, nisur nga shkalla e lartë e përputhshmërisë së eksportit faktik drejt BE-së i kapitujve për të cilët vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues, mund të thuhet se ky indeks ka qenë udhërrëfyes i rëndësishëm për eksportet faktike drejt Bashkimit Evropian. Tabela 5.34 paraqet raportin e eksportit të kapitujve për të cilët vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues ndaj eksportit total drejt BE-së.

Tabela 5.34 Raporti i eksportit me avantazh krahasues ndaj eksportit total me BE-në

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Eksporti total, në milion USD	786.2	920.8	780.1	1,167.2	1,398.7	1,530.2	1,755.3
Eksporti për kapitujt me BI>1, në milion USD	677.9	800.1	670	1,027.3	1,236.6	1,350,304	1,541.9
Raporti në përqindje	86%	87%	86%	88%	88%	88%	88%

Burimi: Llogaritje të autorit

Eksporti faktik i produkteve për të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues është i nivelit 88 përqind të eksportit total faktik të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Ky raport është i qëndrueshëm që nga viti 2001 dhe tregon qartë shkallën e madhe të përputhjes së eksportit faktik me produktet për të cilat ka avantazh krahasues. Qëndrueshmëria e këtij raporti tregon se nënshkrimi i MSA nuk ka ndikuar aspak në përmirësimin ose jo të avantazhit krahasues por, gjithsesi, lë boshllëk në të kuptuarin e faktorëve që e sjellin këtë avantazh.

Megjithatë, duhet nënvizuar që është krejtësisht e paqartë se nga vjen ky avantazh krahasues për Shqipërinë. Siç është paraqitur në modelin teorik në këtë seksion, kufizimet në shpjegimin e avantazhit krahasues dhe rezultateve të indeksit të Balasës, gjë e cila njihet si kufizim i teorisë së avantazhit krahasues, bëjnë të vështirë dhënien e shpjegimeve në rastin e Shqipërisë, por gjithsesi këto rezultate shërbejnë mjaftueshëm për të përdorur avantazhin krahasues si një tregues të përgjithshëm për orientimin e eksporteve.

5.8 Përfundime

Në këtë kapitull është aplikuar modeli teorik i gravitetit në rastin e Shqipërisë dhe janë llogaritur efektet që marrëveshjet tregtare kanë në flukset tregtare të Shqipërisë. Në seksionin 5.2 është analizuar ecuria e tregtisë së jashtme të Shqipërisë, duke paraqitur tendencat kryesore të tregtisë si dhe partnerët dhe grupet kryesore të importit dhe eksportit. Më tej, në seksionin 5.3 jepen statistikat përshkruese duke u ndalur tek variablat kryesorë që do të përdoren në modelin e gravitetit dhe ecurinë e tyre. Në seksionin 5.3 jepet specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të eksportit si dhe vlerësimi i modelit të eksporteve i korrigjuar sipas rezultateve të testeve diagnostikuese duke vijuar në seksionin 5.4, me kontrollin e qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të eksporteve. Specifikimi dhe diagnostikimi i modelit të importeve prezantohet në seksionin 5.5 duke vijuar më tej në seksionin 5.6, me kontrollin e qëndrueshmërisë së rezultateve të modelit të importeve. Rezultatet e modelit të gravitetit mbështeten në tej në seksionin 5.7, me analizën e avantazhit krahasues dhe ndikimin e MSA-së në eksportet shqiptare. Kapitulli përmbyllet me seksionin 5.8 i cili paraqet edhe përfundimet e kapitullit.

Ky kërkim përfshin në analizë 22 vende, me 13 vëzhgime për secilin vend dhe një panel të balancuar prej 286 vëzhgimesh gjithsej. Të dhënat për Kosovën janë të pjesshme dhe këto të dhëna janë përdorur në vlerësime të veçanta për të kontrolluar qëndrueshmërinë e rezultateve.

Janë përdorur modele me efekte fikse dhe efekte të rastit. Modeli me efekte fikse përdoret kur interesi qëndron në analizimin e efekteve të variablave që ndryshojnë në kohë, dhe performanca e modelit cënohet sa herë që në të përfshihen të dhëna për të cilat variacioni brenda grupit është minimal apo për variabla që ndryshojnë pak në kohë. Për këtë arsye, në model janë hequr variabli tregues i kufirit të përbashkët dhe ai i distancës mes vendeve. Modelet me efekte të rastit përdoren kur kërkuesi ka arsye për të besuar se variabli i varur

ndikohet nga ndryshimet mes njësive nën investigim. Këto modele mund të kontrollojnë variabla që nuk ndryshojnë në kohë, siç janë në rastin tonë treguesi i kufirit të përbashkët dhe distanca. Rezultatet e vlerësimit tregojnë se ky model performon më mirë në bazë të kriterit teorik të origjinës së modelit bazë të gravitetit.

Analiza empirike e të dhënave tregon se marrëveshjet e tregtisë së lirë nuk janë të rëndësishme në tregtinë e Shqipërisë. Ato kanë dhënë efekte të përkohshme nxitëse në vitet e para të nënshkrimit të tyre dhe më tej import-eksporti është dominuar nga të njëjtat tendenca si përpara marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Kjo tregon se faktorët e tjerë si stabiliteti makroekonomik, mirëqeverisja, zhvillimet teknologjike, aftësitë inovative të industrive prodhuese mund të jenë faktorët dhe shtysat kryesore të prodhimit dhe të tregtisë. Nga analiza dhe vlerësimi i rezultateve të paraqitura në seksionet 5.3, 5.4, 5.5 dhe 5.6 marrëveshjet nuk janë statistikisht të rëndësishme si në modelin e eksportit ashtu edhe në atë të importit.

Nga modelimi i flukseve tregtare rezulton se popullsia dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë të Shqipërisë dhe vendeve partnere nuk janë të rëndësishme statistikisht në modelin e eksportit. Ndërkohë, indeksi i komplementaritetit të tregtisë (TCI) është i rëndësishëm statistikisht dhe ndikon pozitivisht në eksport. Gjithashtu, rezultatet e modelit tregojnë se prodhimi i përgjithshëm bruto i Shqipërisë dhe i vendeve partnere është i rëndësishëm statistikisht dhe ndikon pozitivisht tek eksportet. Nga të gjitha modelet e eksportit të vlerësuara, rezultatet tregojnë se, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, rritja e GDP-së të Shqipërisë dhe vendit partner sjell rritjen e eksportit. Pas përfshirjes në modelin e eksportit të variablave konstantë në kohë (distanca dhe kufiri i përbashkët), rëndësia statistikore dhe efekti i GDP-së dhe TCI rritet. Kështu, një rritje me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë çon në një rritje mesatare me 3.7 përqind të eksporteve të saj, dhe rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit partner shkakton një rritje prej rreth 1.6 përqind të eksportit.

Nga vlerësimet e strukturës së importeve rezulton se produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë, ai i vendit partner në tregti, popullata e vendit partner dhe distanca kanë efekt statistikisht të rëndësishëm mbi volumin e importeve. Produkti i Brendshëm Bruto, si i Shqipërisë ashtu edhe i vendit partner si dhe popullata e vendit partner ndikojnë në rritjen e volumit të importeve, ndërsa distanca ndikon në mënyrë të rëndësishme në uljen e volumit të importeve. Kështu, elasticiteti i Produktit të Përgjithshëm Bruto në terma të importit është i barabartë më

1 (ose e thënë ndryshe korrespondencë një më një). Një rritje me 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të vendit partner çon në një rritje mesatarisht prej 0.7 përqind në flukset e importeve. Një rritje me 1 përqind në popullatën e vendit partner në tregti mundëson një rritje mesatare prej 0.6 përqind në flukset e importeve. Ndërsa një rritje prej 10 përqind e distancës mes vendeve partnere bën të mundur zvogëlimin e flukseve të importeve me 18.2 përqind. Popullata e Shqipërisë, indeksi i komplementaritetit të tregtisë, marrëveshjet e tregtisë së lirë si dhe kufiri i përbashkët rezultojnë të mos kenë efekt të rëndësishëm mbi volumin e importeve, edhe pse kanë shenjat e pritura.

Analiza e avantazhit krahasues tregon se MSA ka patur ndikim të vogël në eksportet shqiptare. Produktet me avantazh krahasues pas hyrjes në fuqi të MSA janë të njëjta me ato të para MSA. Kjo tregon se MSA nuk ka dhënë ndonjë ndikim të vlerësueshëm në ndryshimin e avantazhit krahasues. Avantazhi krahasues i produkteve bujqësore dhe atyre industriale, edhe pse ndjek karakteristikat e përgjithshme të avantazhit krahasues për të gjitha kategoritë e produkteve, ka patur sjellje të ndryshme para dhe pas nënshkrimit të MSA sipas llojit të produktit.

Partnerët kryesorë të eksportit të Shqipërisë kanë ndryshime midis tyre sa i takon numrit të produkteve me avantazh krahasues si dhe vlerës konkrete të Indeksit të Balasës së matur. Vetëm kapitulli 26, mineralet, paraqitet me avantazh krahasues në të katër partnerët kryesorë të eksportit, ndërsa për kapitujt e tjerë ekzistenca e avantazhit krahasues varion. Analiza e avantazhit krahasues para dhe pas nënshkrimit të MSA për katër partnerët kryesorë të eksportit ruan të njëjtat karakteristika të përgjithshme të ndeshura për të gjithë bllokun e vendeve të Bashkimit Evropian.

Shqipëria ka avantazh krahasues të njëjtë për të njëjtat grupe produktesh, si për BE (15) ashtu edhe për BE (27). Kjo tregon që vendet e anëtarësuara në Bashkimin Evropian në vitet 2004 dhe 2007 nuk janë të rëndësishme për Shqipërinë. Për këtë, Shqipëria duhet të lobojë me vendet që i përkasin BE (15) për interesat e saj tregtarë pas anëtarësimit. Analiza e avantazhit krahasues për partnerët kryesorë të eksportit në bllokun e vendeve të BE-së e konfirmon këtë përfundim pasi këto vende i përkasin BE (15).

Eksporti faktik drejt Bashkimit Evropian është kryesisht për ato produkte për të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues. Ky eksport përbën 88% të eksportit total faktik të

Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Ky raport është i qëndrueshëm që nga viti 2001 dhe tregon qartë shkallën e madhe të përputhjes të eksportit faktik sipas kapitujve me kapitujt për të cilët ka avantazh krahasues. Qëndrueshmëria e këtij raporti tregon se nënshkrimi i MSA nuk ka ndikuar aspak në përmirësimin ose jo të avantazhit krahasues por gjithsesi lë boshllëk në të kuptuarin e faktorëve që e sjellin këtë avantazh.

KAPITULLI VI: NDIKIMI I ANËTARËSIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN: RRUGË E NJOHUR

6.1 Hyrje.....158
6.2 Përzgjedhja e shteteve të marra në analizë.....158
6.3 Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Rumanisë.....164
6.3.1 Zhvillimi ekonomik.....164
6.3.2 Tregtia e jashtme e Rumanisë.....168
6.3.3 Politika tregtare.....170
6.4. Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Bullgarisë.....172
6.4.1 Zhvillimi ekonomik.....172
6.4.2 Tregtia e jashtme e Bullgarisë.....174
6.4.3 Politika tregtare.....176
6.5 Bullgaria dhe Rumania para dhe pas anëtarësimit, 2002-2013.....177
6.5.1 Karakteristikat e volumit tregtar.....177
6.5.2 Karakteristikat e eksportit.....180
6.5.3 Karakteristikat e importit.....183
6.6 Përfundime.....186

6.1 Hyrje

Zgjerimi i Bashkimit Evropian dhe hyrja në një proçes anëtarësimi dhe negocimi nuk është një rrugë e pashkelur. Ajo që i diferencon shtetet është shpejtësia e bërjes së reformave. Për këtë, në këtë kapitull synohet të bëhet një vlerësim analogjik i procesit të anëtarësimit dhe ndikimit të tij tek vendet të cilat janë anëtarësuar në Bashkimin Evropian përpara Shqipërisë, duke marrë në konsideratë vende të ngjashme me Shqipërinë.

Kapitulli paraqet në seksionin 6.2 vendet që janë përzgjedhur për tu analizuar, duke analizuar zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Rumanisë, Bullgarisë, Polonisë dhe Kroacisë dhe në përfundim të tij jepet edhe arsyeja e përzgjedhjes së Bullgarisë dhe Rumanisë për këtë vlerësim analogjik. Më tej kapitulli vijon në seksioni 6.3 dhe 6.4 me analizën e detajuar të Bullgarisë dhe të Rumanisë. Këto seksione paraqesin edhe procesin e anëtarësimit të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian. Analiza e tregtisë dhe ecuria e tregtisë së jashtme të Rumanisë dhe Bullgarisë, para dhe pas anëtarësimit në BE i paraprin përfundimeve që, për analogji, mund të nxirren edhe për Shqipërinë. Përfundimet e këtij kapitulli synojnë të theksojnë më shumë rezultatet e provuara nga modeli për Shqipërinë apo të ngrenë hipoteza të tjera në lidhje me shkaqet reale të ndikimeve në tregti nga pjesëmarrja në bllokun tregtar të BE-së.

Marrëdhëniet bilaterale të vendeve të rajonit me Bashkimin Evropian janë më të rëndësishme se sa marrëdhëniet midis tyre, madje edhe më të forta se marrëdhëniet e blloqeve rajonale me bllokun e vendeve të BE. Ky koncept është i njohur ndryshe si “hub-and-spoke relationship” (Gligorov, 1997). Sipas këtij autori ky koncept gjendet gjerësisht në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe kjo shpjegon edhe varësinë e madhe tregtare që vendet e Ballkanit Perëndimor kanë nga Bashkimi Evropian. Për arritjen e qëllimeve të këtij kaptulli dhe në mbështetje të gjetjes së Gligorov (1997), analiza e këtij kapitulli fokusohet te flukset tregtare të Bullgarisë dhe Rumanisë me Bashkimin Evropian.

6.2 Përzgjedhja e shteteve të marra në analizë

Bashkimi Evropian ka patur anëtarë të rinj në vitin 2004, 2007 dhe 2013. Shqipëria është duke përshkuar një proçes i cili ka paraardhës dhe mund të nxirren analogji për ndikimet nga anëtarësimi. Shtetet e marra në analizë janë Bullgaria, Rumania, të anëtarësuara në vitin

2007, Polonia, anëtarësuar në vitin 2004 dhe Kroacia e anëtarësuar në vitin 2013. Pyetja e parë që lind është pse janë konsideruar këto shtete për këtë analizë. Përzgjedhja fillestare e këtyre vendeve është bërë duke parë disa ngjashmëri si madhësia gjeografike, popullsia, afërsia gjeografike ndaj Shqipërisë, pjesëmarrja në CEFTA së bashku për disa vite, koha e anëtarësimit në BE, etj. Për të arritur në një përfundim logjik të përzgjedhjes janë marrë në analizë krahasimore të dhënat e përgjithshme ekonomike të shteteve të cituara.

Vlerësim i parë lidhet me Kroacinë. Kroacia do të ishte vendi më i përshtatshëm për të bërë një vlerësim analogjik me Shqipërinë sepse madhësia e Kroacisë është afër me Shqipërinë dhe në parametrat ekonomikë dhe tregtarë, Kroacia do të ishte një zgjedhje shumë e mirë. Por, vlerësimi analogjik me Kroacinë ka një kufizim thelbësor që lidhet me mundësinë e vlerësimit të tregtisë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian sepse Kroacia është anëtare e Bashkimit Evropian që nga 1 Korrik 2013. Gjithsesi, kjo analizë do të paraqesë momentet kryesore të procesit të anëtarësimit të Kroacisë në Bashkimin Evropian për të lejuar nxjerrjen e analogjive për Shqipërinë sa i takon procesit të negociatave. Procesi i negociatave të anëtarësimit të Kroacisë ka filluar menjëherë pas hyrjes në fuqi të MSA (Grafiku 6.1). Në rastin e Shqipërisë duhet thënë se MSA ka hyrë në fuqi prej pesë vjetësh dhe Shqipërisë mori statusin e vendit kandidat pas katër vjetësh nga hyrja në fuqi e MSA-së. Gjithashtu, duhet thënë se rasti i Shqipërisë është i pari që merr opinion pozitiv nga Bashkimi Evropian pas 4 raundesh vlerësimi në Këshill.

Grafik 6.1 Procesi i integrimit të Kroacisë në Bashkimin Evropian

Burimi i të dhënave: Ish Ministria e Tregtisë së Kroacisë
Përgatitur nga autori

Ndërkohë, për Bullgarinë, Rumaninë, Poloninë dhe Shqipërinë janë marrë në analizë krahasimore të dhënat e përgjithshme ekonomike. Të dhënat e marra në analizë janë PBB, PPB për frymë, rritja ekonomike, indeksi i konkurrueshmërisë, perceptimi ndaj korrupsionit, liritë e të bërit biznes, etj. Më poshtë janë paraqitur grafikisht këta indikatorë, duke i paraqitur krahasimisht midis katër shteteve, për të kuptuar ngjashmëritë dhe diferencat midis tyre.

Grafik 6.2 Prodhimi i Përgjithshëm Bruto, (në miliardë USD)



Burimi: Databazë i Bankës Botërore

Prodhimi i brendshëm bruto për të katër shtetet e marra në analizë ka ngjashmëri në ritmin e rritjes deri në vitit 2012 (grafiku 6.2). Pavarësisht së PBB është në vlera absolute të ndryshme midis katër vendeve, vlera të cilat lidhen me madhësinë e vendeve, PBB në këto vende është rritur vazhdimisht, ku, Polonia dhe Rumania, pas vitit 2002, kanë një rritje të dukshme më të shpejtë se Shqipëria dhe Bullgaria. Pas këtij viti, Bullgaria, Rumania dhe Polonia patën një nxitje të madhe për zhvillim e cila vjen nga proçesi i integrimit. Megjithatë, shkalla me të cilën vendet i përgjigjen sfidave të integrimit si dhe ndikohen prej tij varen konsiderueshëm nga karakteristikat, fuqitë dhe dobësitë e një vendi aspirues.

Grafik 6.3 Prodhimi i Brendshëm Bruto për frymë, (në dollarë)



Burimi: Databaza e Bankës Botërore

PPB për frymë (grafiku 6.3) tregon të njëjtën panoramë si edhe PBB (grafiku 6.2), ku Polonia dhe Rumania kanë një performancë më të mirë se Shqipëria dhe Bullgaria. Polonia ka dukshëm PPB për frymë më të lartë se Shqipëria dhe është pak e krahasueshme me Shqipërinë. Ndërkohë, diferenca midis Shqipërisë, Bullgarisë dhe Rumanisë në PBB për frymë është më e vogël.

Grafik 6.4 Rritja ekonomike 2000-2012, (në përqindje)



Burimi: Databaza e Bankës Botërore

Grafiku 6.4 tregon se Polonia nuk ka avantazh ndaj vendeve të tjera të marra në analizë lidhur me rritjen ekonomike vjetore. Nga viti 2000 deri në vitin 2009 të gjitha vendet kanë patur rritje ekonomike, rritje e cila ka qenë mesatarisht rreth 6 përqind për Shqipërinë dhe Bullgarinë dhe me më shumë luhatje për Rumaninë dhe Poloninë. Rumania ka shënuar rritjen më të madhe në periudhën 2004-2008, rreth 8 përqind. Ndërkohë, Polonia ka patur rritje më të moderuar deri në 2004 dhe më tej ka patur rritje të larta. Rumania dhe Bullgaria kanë rënë në recesion në vitin 2009, ndërsa Polonia dhe Shqipëria kanë patur rritje ekonomike, rritje e cila është më e moderuar se para vitit 2009. Nga viti 2010 të gjitha vendet kanë patur rritje por, me luhatje dhe ose rritje të moderuar. Polonia pati rritjen më të madhe midis vendeve në vitet 2010-2011, ndërkohë që, në vitin 2012, me përjashtim të Rumanisë, vendet e tjera treguan vështirësi në rritjen ekonomike.

Tabela 6.1 Renditja sipas Raportit të Konkurrueshmërisë Globale

	2008-2009	2009-2010	2010-2011	2011-2012	2012-2013	2013-2014	2014-2015
Shqipëria	108	96	88	78	89	95	97
Bullgaria	76	76	71	74	62	57	54
Rumania	68	64	67	77	78	76	59
Polonia	53	46	39	41	41	42	43

Shënim: Sa i vogël numri aq më e mirë renditja
Burimi: Forumi Ekonomik Botëror, www.weforum.org/reports

Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore[57] (tabela 6.1) tregon se Shqipëria është larg renditjes së Polonisë por më afër Bullgarisë dhe Rumanisë. Megjithatë, përmirësimi i të katër vendeve në vite është i ngadaltë.

Tabela 6.2 Lehtësia e të bërit biznes

	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Shqipëria	86	82	82	82	82	108	68
Bullgaria	45	44	51	59	57	58	38
Rumania	47	55	56	72	73	73	48
Polonia	76	72	70	62	48	45	32

Shënim: Sa i vogël numri aq më e mirë renditja
Burimi: Banka Botërore, http://www.doingbusiness.org/reports/

[57] Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore vlerëson konkurrueshmërinë e 144 ekonomive të botës duke ofruar perceptime dhe orientime rreth shtysave të produktivitetit dhe prosperitetit.

Në liritë e të bërit biznes (tabela 6.2) Shqipëria është përsëri më larg Polonisë në renditje dhe më afër me Bullgarinë dhe Rumaninë. Përmirësimi i Shqipërisë vitin e fundit është më i larti midis vendeve. Sipas Raportit "Doing Business 2015", Shqipëria ka patur një përmirësim prej 40 vendesh, e ndjekur nga Rumania me 25 vende, Bullgaria me 20 dhe Polonia me 13 vende. Kjo tregon një ngjashmëri në shpejtësinë e reformave të të bërit biznes vitin e fundit në Shqipëri, Rumani dhe Bullgari dhe më pak në Poloni.

Grafik 6.5 Indeksi i lirisë ekonomike

Polonia krahasimisht ndaj Shqipërisë



Bullgaria dhe Rumania krahasimisht ndaj Shqipërisë



Rritja e renditjes tregon indeks më të mirë të hapjes
Burimi: Heritage Foundation; http://www.heritage.org/index/

Në lirinë ekonomike (grafiku 6.5) diferenca midis vendeve është më e vogël, kjo, falë faktit, që të katër vendet janë anëtare të OBT-së dhe hapja e tregut është tashmë një reformë e konsoliduar. Siç tregohet edhe në grafik, në periudhën 2011-2014 të katër vendet kanë pothuaj të njëjtin indeks të lirisë ekonomike.

Tabela 6.3 Indeksi i perceptimit të korrupsionit

	2013	2012	2011	2010
Shqipëria	3.1	3.3	3.1	3.3
Bullgaria	4.1	4.1	3.3	3.6
Rumania	4.4	4.4	3.6	3.7
Polonia	5.8	5.8	5.5	5.3

Shënim: Indeksi nga 1 në 10; Sa më i vogël numri aq më i lartë perceptimi për ekzistencën e korrupsionit
Burimi: Transparency International, http://www.transparency.org/research/cpi/overview

Indikatori i fundit i marrë në analizë është perceptimi i korrupsionit. Tabela 6.3 tregon se perceptimi për korrupsionin në Shqipëri, Bullgari dhe Rumani është pothuaj i njëjtë, ndërkohë që në Poloni ky perceptim është dukshëm më i mirë. Kjo e bën Shqipërinë, Bullgarinë dhe Rumaninë më të krahasueshëm midis tyre, dhe më pak të krahasueshëm me Poloninë.

Konkluzion:

Nga e gjithë analiza e mësipërme është e dukshme që Shqipëria është më afër Bullgarisë dhe Rumanisë në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Gjithashtu, parametrat e marrë në analizë si për shembull indeksi i perceptimit të korrupsionit, lehtësitë e të bërit biznes, indeksi i konkurrueshmërisë globale, tregojnë më shumë ngjashmëri midis Shqipërisë dhe Bullgarisë e Rumanisë. Gjithashtu, duke vlerësuar që Polonia është anëtarësuar në Bashkimin Evropian 10 vjet më parë (2004), si dhe faktin që politika e saj tregtare ka ndryshuar shumë në mënyrë të veçantë pas Traktatit të Lisbonës (2009), analizat e mëtejshme të ndikimit të anëtarësimit nuk janë shumë aktuale. Në këto kushte analiza në seksionet në vijim do të fokusohet tek Bullgaria dhe Rumania.

6.3 Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Rumanisë

6.3.1 Zhvillimi ekonomik

Rumania është një vend me sipërfaqe prej 238,391 km² dhe një popullsi prej më shumë se 21 milion banorësh, prej të cilëve afro 2 milion banojnë dhe jetojnë në Bukuresht. Në BE, Rumania është vendi i 9 më i madh nga sipërfaqja dhe i 7 nga popullsia. Në vitet e fundit Rumania ka bërë një progres të konsiderueshëm (Banka Botërore, prill 2014) për ta kthyer ekonominë e saj në ekonomi të konkurrueshme brenda bllokut të BE. Tranzicioni i

ekonomisë rumune nga një shoqëri e centralizuar në një shoqëri bazuar në ligjet e ekonomisë së tregut ishte një proces kompleks (Paliu-POPA, L., 2009). Hyrja në BE ka qenë një shtysë e rëndësishme për Rumaninë në drejtim të reformave modernizuese[58].

Sipas (Paliu-POPA, L., 2009), ekonomia rumune gjatë viteve të tranzicionit ka qenë nën presionin e disa kufizimeve të rëndësishme që kanë rrjedhur si nga mjedisi i brendshëm dhe ai i jashtëm. Kufizimet e brendshme, të lidhura kryesisht me treguesit e brendshëm makro si nevoja për reduktim të inflacionit, bilancit buxhetor, etj. si dhe ato mikro; si privatizimi, ristrukturimi i sistemit bankar, etj. kanë dhënë ndikimin e vet në periudhën e tranzicionit. Ristrukturimi i ekonomisë dhe proçesi i privatizimit u aplikua në nivel mikro ndërkohë që, inercia e privatizimit në vitet e para të tranzicionit dekurajoi investimet e huaja në vend dhe ngadalësoi procesin e zhvillimit të bazuar në produktivitetin dhe konkurrencën.

Gjatë viteve 1990-1998, ekonomia rumune u karakterizua nga një numër i madh i pengesave të tilla si: struktura industriale shumë dimensionale, shkalla e ulët e përpunimit dhe efikasitetit të industrive kryesore, teknologjitë e vjetra, të krijuara dhe trashëguara nga sistemi i mëparshëm dhe mungesa e strategjisë efektive të zhvillimit në nivel kombëtar.

Periudha pas viteve 90, karakterizuar nga rënia ekonomike, përfundoi në vitin 1999 dhe pati disa elementë pozitivë në rritjen e treguesve të tregtisë së jashtme. Eksportet neto të mallrave dhe shërbimeve u rritën me (3.7 përqind), importet u reduktuan ndërkohë që, konsumi dhe investimet kishin një kontribut negativ prej 6.9 përqind.

Rumania pësoi një tkurrje të madhe ekonomike në vitin 2009 si pasojë e krizës globale financiare. Rritja e PBB ka rënë nga 7.3 përqind në vitin 2008 në -6.6 përqind në vitin 2009. Në vitin 2011, rritja reale e PBB-së u rrit në 2.2 përqind (Tabela 6.4). Rumania mundi të kapërcejë vështirësitë e krizës globale financiare vetëm si rezultat i politikave makroekonomike të kujdesshme dhe shumë të balancuara[59]. Tabela 6.4 më poshtë jep ecurinë e përgjithshme ekonomike të Rumanisë ku duken qartë sinjalet pozitive për zhvillimin ekonomik.

[58] http://www.worldbank.org/en/country/romania/overview
[59] http://www.worldbank.org/en/country/romania/overview#1

Tabela 6.4 Të dhënat e përgjithshme të Rumanisë

	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia (milion)	21.5	21.5	21.4	21.3	21.3
PBB per capita, (EUR)	5,490	5,788	6,129	6,157	6,692
PBB (EUR bn)	117.9	124.1	131.1	131.4	142.5
Rritja ekonomike, ndryshimi vjetor në përqindje	-6.6	-1.2	2.4	0.5	3.5
Konsumi, ndryshimi vjetor në përqindje	-10.7	-0.3	1.7	1.1	1.3
Investimet, ndryshimi vjetor në përqind	-27.8	-2.3	7.7	4.2	-3.4
Prodhimi industrial, ndryshimi vjetor në përqindje	-5.2	5.5	7.8	2.4	7.9
Papunësia, në përqindje	6.8	7.3	7.4	7.1	7.3
Bilanci fiskal, si përqindje e PBB	-9.0	-6.8	-5.5	-3.0	-2.3
Borxhi publik, si përqindje e PBB	23.6	30.5	34.7	38.0	38.4
Inflacioni (CPI, ndryshimi vjetor në përqindje)	4.7	8.0	3.1	5.0	1.6
Llogaria korrente (përqindje e PBB)	-4.2	-4.3	-4.9	-4.2	-1.1
Bilanci i llogarisë korrente (EUR bn)	-4.9	-5.5	-5.9	-5.8	-1.5
Bilanci tregtar (EUR bilion)	-9.9	-9.5	-9.7	-9.6	-5.7
Eksporti, ndryshimi vjetor në përqindje	-13.7	28.5	21.1	-0.4	10.0
Importi ndryshimi vjetor në përqindje	-31.8	20.3	17.1	-0.4	1.1
Borxhi i jashtëm, (përqindje e PBB)	68.9	74.5	75.3	75.9	67.4

Burimi: http://www.focus-economics.com/countries/romania

Rumania ka bërë përpjekje të shumta për rivendosjen e stabilitetit makroekonomik në 2013, duke regjistruar një rritje prej 3.5 përqind, pas shmangies së rënies ekonomike në vitin 2012, vit në të cilin Rumania regjistroi një rritje modeste prej 0.7 përqind (sipas të dhënave të rishikuara, Banka Botërore, 2014).

Grafik 6.6 Rritja ekonomike e Rumanisë krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian



Burimi: Databazë i Bankës Botërore;
http://databank.worldbank.org/data/views/reports/chart.aspx

Mungesa e stabilitetit në rritjen ekonomike në vite është lehtësisht e dallueshme, për më tepër, nëse kjo rritje krahasohet me mesataren e rritjes ekonomike të vendeve të Bashkimit Evropian. Menjëherë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, 2008-2013, rritja ekonomike e Rumanisë, edhe pse në vlera më të ulta se blloku, ka ndjekur të njëjtin ritëm. Vihet re se për

herë të parë pas anëtarësimit në BE, Rumania ka rritje ekonomike më të lartë se sa mesatarja e bllokut të BE në vitet 2011-2012, vite në të cilat kriza në disa vende të BE-së ishte prezente.

Sipas parashikimeve të Bankës Botërore (2014), Rumania do të zërë vendin e katërt brenda bllokut të BE për rritjen ekonomike në 2014, me 2.2 përqind, ndjekur shumë afër nga Bullgaria dhe Polonia me rritje ekonomike respektivisht 2.1 përqind dhe 2 përqind[60]. Sipas Komisionit Evropian parashikimi i rritjes ekonomike të Rumanisë është edhe më optimist dhe do të arrijë 2.5 përqind[61]. Në tetor 2013 Rumania përfitoi nga programi i asistencës financiare prej 4 bilion Euro, të ndara në mënyrë të barabartë midis BE-së dhe FMN-së, program i cili do të jetë i vlefshëm deri në Shtator 2015. Ky program është i treti i akorduar nga BE-ja për Rumaninë. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, Rumania ka bërë në vitet e fundit reforma të rëndësishme strukturore në tatime, sistemin bankar, energji dhe transport (Komisioni Evropian, 2013). Ndërkohë, sa i takon të ardhurave për frymë, Banka Botërore vlerëson se rritja e të ardhurave për frymë (PPP) në Rumani është më e lartë se sa mesatarja e vendeve të bllokut të BE-së.

Grafik 6.7 Rritja e të ardhurave vjetore për frymë, (në përqindje)



Burimi: Country Partnership Strategy (CPS) për Romaninë, 2014-2017, Prill 2014, Banka Botërore

Në Rumani 1/3 e popullsisë është e varfër (Banka Botërore, 2014). Rumania ka boshllëqe zhvillimore, reflektuar në nivelin e ulët të të ardhurave për frymë krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian, vlerësuar në nivelin 46 përqind të mesatares së BE-së (Komisioni Evropian, 2013). Gjithsesi, hyrja në BE nuk kërkon mbajtjen e nivelit mesatar të të ardhurave për frymë të njëjtë me atë të "bllokut" (Daianu, D. & Paslaru, D., 2003), për më tepër parë kjo edhe në kontekstin e vështirësive të Portugalisë dhe Greqisë, por ndryshimi i madh i të

[60] http://www.romania-insider.com
[61] http://ec.europa.eu/economy_finance/eu/countries/romania_en.htm

ardhurave për frymë tregon boshllëkun midis Rumanisë dhe vendeve të tjera të bllokut. Rumania akoma edhe sot është anëtari më i varfër i BE-së (Daianu, D. & Paslaru, D., 2003).

Në vitin 2013 modeli i rritjes ekonomike të Rumanisë është ai i orientuar drejt eksportit (Banka Botërore, 2013), duke bërë që kërkesa në rritje për eksportet rumune të balancojë rënien e konsumit të brendshëm. Ndërkohë, Komisioni Evropian në raportin e vlerësimit për Rumaninë për vitin 2013 vlerëson që rritja e Rumanisë në 2013 është rezultat i konsumit të brendshëm dhe investimeve.

Ekonomia e Rumanisë është e bazuar kryesisht në shërbime, të cilat përbënin 59.5 përqind të PBB-së në vitin 2011. Industria përbënte sektorin e dytë më të madh në rreth 33 përqind të PBB-së. Edhe pse bujqësia zë vetëm 7.5 përqind të PBB-së, rreth 31.6 përqind e fuqisë punëtore të Rumanisë punon në këtë sektor. Politika aktuale e tregtisë së jashtme të Rumanisë ka për qëllim integrimin e vendit në tregjet perëndimore. Rumania shpreson që të miratojë euron në vitin 2015. Megjithatë, për PBB-në aktuale për frymë, Rumania është anëtari më i varfër i BE-së (PALIU-POPA, L., 2009).

6.3.2 Tregtia e jashtme e Rumanisë[62]

Sipas Institutit të Statistikave të Rumanisë volumi tregtar i Rumanisë në vitin 2013 arriti në 104.9 bilion euro, një volum rekord i tregtisë së jashtme, me një rritje 5.1 përqind në krahasim me vitin 2012 dhe me 4.6 përqind në krahasim me vitin 2011. Bilanci tregtar ka një rënie në vitin 2013 si rezultat i rritjes së eksportit në këtë vit. Grafiku 6.8 tregon qartë që importi në tri vitet e fundit, 2011-2013 është pothuaj në të njëjtat nivele, ndërkohë që eksporti është rritur. Megjithëse bilanci tregtar vazhdon të jetë negativ edhe në 2013, thellimi i tij pothuaj është ndalur tri vitet e fundit

[62] Të dhënat e import-eksportit janë marrë nga Instituti i Statistikave të Rumanisë dhe janë përpunuar nga autori, http://www.insse.ro/cms/en

Grafik 6.8 Qarkullimi i mallrave për vitet 2008-2013, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Në volumin tregtar të Rumanisë për vitin 2013 eksporti është 49.6 bilion euro dhe importi 55.3 bilion euro, me një raport 47 përqind eksport dhe 53 përqind import. Krahasuar me vitin 2012, eksportet u rritën me 10 përqind dhe importet me 1 përqind. Niveli i ndryshëm i rritjes së eksportit dhe importit ka reduktuar bilancin tregtar me 40.8 përqind [3.9 bilion euro në 2013, krahasuar 2012 (nga 9.6 euro në 5.7 bilion)]. Në vitin 2013 struktura e eksportit përbëhej nga 42 përqind makineri dhe pajisje transporti, 32.5 përqind prodhime të tjera, karburant, vajra, etj., 5.2 përqind kimikate dhe të ngjashme, 5.6 përqind lëndë e parë, 6.2 përqind 8.5 përqind ushqime, pije dhe duhan.

Struktura e importit (Grafiku 6.9) përbëhet nga makineri dhe pajisje transporti 35 përqind, lëndë e parë 3.4 përqind, ushqime, pije dhe duhan 7.8 përqind, naftë dhe vajra lubrifikant 9.9 përqind**,** kimikate dhe të ngjashme 14.1 përqind si edhe prodhime të tjera 29.8 përqind.

Grafik 6.9 Eksporti dhe importi i Rumanisë, sipas grupmallrave, viti 2013



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Rumania ka tendencë të lartë për të eksportuar në tregje të zhvilluara, BE (15) dhe pjesa tjetër në vendet e OECD, duke kontribuar kështu edhe në një rritje më të madhe të faktorit total të produktivitetit. Rumania ka patur rritje më të shpejtë të faktorit total të produktivitetit në firmat vendase sesa ato të huaja e cila është reflektuar në rritjen e produktivitetit për këtë vend (Damijan, J. P., Sousa, J., and Lamotte, O., 2006). Kjo tendencë e Rumanisë vërehet akoma edhe sot. Destinacionet kryesore të eksportit të Rumanisë në vitin 2012 janë Gjermania (18.6 përqind), Italia (11.8 përqind) dhe Franca (7.0 përqind). Ndërkohë, burimet kryesore të importit ishin Gjermania (17.4 përqind), Itali (10.8 përqind) dhe Hungaria (8.9 përqind).

Volumi tregtar me vendet e Bashkimit Evropian është rritur gjatë vitit 2013, krahasuar me 2012 me 8.8 përqind ndërkohë që eksportet drejt këtyre vendeve vazhdojnë të përbëjnë një pjesë të lartë të eksporteve rumune (69.6 përqind). Evolucioni i eksporteve drejt vendeve jo anëtare të BE vazhdon të jetë dinamik dhe është rritur në vitin 2013 me 12.8 përqind. Katër vendet e para të destinacionit të eksporteve rumune, Gjermania, Italia, Franca dhe Turqia, kanë regjistruar një rritje të konsiderueshme në 2013. Eksporti është forca kryesore lëvizëse e rritjes ekonomike në vitin 2013 (Damijan, J. P., Sousa, J., and Lamotte, O., 2006).

6.3.3 Politika tregtare[63]

Integrimi ekonomik rajonal i Rumanisë me BE-në mori formën e marrëveshjeve të bashkëpunimit në 1993 dhe pastaj të marrëveshjeve që kanë për qëllim krijimin e zonave të tregtisë së lirë (Damijan, J. P., Sousa, J., and Lamotte, O., 2006). Pranimi në BE ka qenë pozitiv për rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë në Rumani. Negociatat për anëtarësimin e Rumanisë në BE filluan më 15 shkurt 2000. Rumania vlerëson marrëdhëniet me Bashkimin Evropian si një mundësi të jashtëzakonshme për të realizuar modernizimin ekonomik (Daianu, D. & Paslaru, D., 2003).

Proçesi i integrimit evropian është një nxitës i madh për zhvillimin. Në shumë vende fillohet me thellim të integrimit rajonal, rasti i vendeve të Ballkanit Perëndimor (CEFTA 2006). Gjithësesi, ka autorë që mbrojnë tezën që mungesa e bashkëpunimit dhe integrimit rajonal mund të rregullohet apo zëvendësohet me përshpejtimin e procesit të integrimit në Bashkimin Evropian (Gligorov, wiiw, WP 4.1).

[63] Të dhënat janë marrë nga "*Tregtia dhe Investimet në Rumani*" (CRPCIS) 2012

Rumania përfundoi kapitujt e lehtë në bisedimet për hyrjen në BE në nëntor 2003 dhe qeveritë e tyre shpresonin për të përfunduar negociatat në 2004, por problemet më të vështira u pasqyruan gjatë këtij viti (2004), dhe BE-ja kërkoi që qeveritë e tyre të luftonin korrupsionin, të realizonin reformën ekonomike dhe të luftonin burokracinë joefikase shtetërore deri sa të ishin gati për hyrje në BE. Rumania dhe Bullgaria i vunë vetes një datë objektiv të vitit 2007 për pranimin përfundimtar (Grabbe, H., 2003).

Rumania si vend anëtar i BE-së ka adoptuar Politikën e Përbashkët Tregtare si dhe ka pranuar Komisionin Evropian si një trup negociator për çështje të rëndësishme të lidhura me tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht për negociatat me OBT-në. Gjithashtu, si BE dhe Rumania, si anëtarë të hershëm të OBT-së, vazhdojnë të mbajnë angazhimet e tyre për një sistem të fortë shumëpalësh tregtar dhe për liberalizimin e tregtisë mbarë botërore.

Në përputhje me PPT, Rumania aplikon të gjitha marrëveshjet tregtare preferenciale të BE-së dhe të gjitha marrëveshjet me vendet e treta si (i) preferencat e njëanshme të dhëna në mënyrë autonome për të hyrë në tregun e BE-së (ii) preferencat reciproke të negociuara me partnerët tregtarë brenda kornizave të marrëveshjes së tregtisë së lirë[64]. Grafiku 6.10 jep shtrirjen kohore të procesit të integrimit të Bullgarisë dhe Rumanisë. Ky proces është i përbashkët pasi edhe procesi i anëtarësimit të tyre është trajtuar si bllok dy vendesh.

Grafik 6.10 Procesi i integrimit të Rumanisë dhe Bullgarisë në Bashkimin Evropian



Burimi: Përgatitur nga autori

[64] Idem.

6.4. Zhvillimet ekonomike dhe tregtare të Bullgarisë

6.4.1 Zhvillimi ekonomik

Republika e Bullgarisë është e vendosur në Gadishulli Ballkanik, përgjatë Detit të Zi me një sipërfaqe totale prej 111,001.9 km ^{2} dhe me një popullsi prej 7.4 milion banorë. Më shumë se një e katërta e popullsisë jeton në kryeqytet, në Sofie. Bullgaria ka bërë një rrugë të gjatë nga tranzicioni i saj i trazuar politik dhe ekonomik në vitet 1990. Sot Bullgaria me 7 milion banorë është një ekonomi me të ardhura mbi nivelin e mesëm (Banka Botërore, 2014). Bullgaria ka patur një rritje ekonomike të qëndrueshme, duke përjashtuar krizën globale financiare të viteve 2008-2009 e cila pati ndikim të konsiderueshëm negativ për vendin. Rritjen më të shpejtë ekonomike, me një mesatare 6 përqind në vit, Bullgaria e pati gjatë viteve 2004–2007. Pas një rënie prej rreth 5 përqind në vitin 2009, ekonomia bullgare filloi ri-ngritjen duke arritur rritje ekonomike 1.8 përqind në 2011 (Banka Botërore, 2014). Pas një dekade me reforma të vështira Bullgaria është zyrtarisht anëtare e Bashkimit Evropian që nga janar 2007.

Bullgaria ka ndjekur politika efektive për të mbështetur stabilitetin makroekonomik dhe atë financiar. Megjithatë, konvergjenca me Bashkimin Evropian në drejtim të të ardhurave ka qenë e ngadaltë (FMN 2014). Viti 2013 ka qenë një vit me pasiguri politike por gjithsesi Bullgaria ka mundur të ruajë stabilitetin makroekonomik.

Si pasojë e këtyre reformave Bullgaria reduktoi borxhin publik mbi 70 përqind të PBB-së në vitin 2000 dhe 18.5 përqind në vitin 2012, vit në të cilin, sipas Bankës Botërore (2014), Bullgaria ishte edhe vendi i dytë me nivelin më të ulët të borxhit në BE. Midis viteve 2000 dhe 2010 rritja mesatare vjetore arriti 4.7 përqind. Gjithashtu në të njëjtën periudhë Bullgaria ka rritur në mënyrë drastike të ardhurat për frymë nga 28 përqind në 44 përqind. Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian, ekonomia e Bullgarisë në 2013 u rrit me vetëm 0.9 përqind ndërkohë që në 2012 PBB u rishikua me -0.6 përqind dhe arriti në 0.9 përqind (Komisioni Evropian, 2013). Sipas vlerësimeve të Komisionit Evropian Bullgaria është akoma nën potencialet e veta të rritjes (Komisioni Evropian, Maj 2014). Inflacioni ra ndjeshëm gjatë 2012, me një mesatare prej 2.4 përqind, dhe sipas parashikimeve të raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian të 2013 do të vijonte uljen deri në 2 përqind (Komisioni

Evropian, 2013). Tabela 6.5 jep një panoramë të përgjithshme të zhvillimeve ekonomike të Bullgarisë për periudhën 2009-2013.

Tabela 6.5 Të dhënat e përgjithshme të Bullgarisë

	2009	2010	2011	2012	2013
Popullsia (milion)	7.6	7.5	7.3	7.3	7.3
PBB per capita, (EUR)	4,618	4,804	5,255	5,483	5,512
PBB (EUR bn)	34.9	36.1	38.5	39.9	39.9
Rritja ekonomike, ndryshimi vjetor në përqindje	-5.5	0.4	1.8	0.6	0.9
Konsumi, ndryshimi vjetor në përqindje	-7.5	0.0	1.5	3.7	-2.3
Investimet, ndryshimi vjetor në përqindje	-17.6	-18.3	-6.5	4.0	-0.3
Prodhimi industrial, ndryshimi vjetor në përqindje	-18.3	2.0	6.0	-0.2	0.0
Papunësia, në përqindje	7.6	9.5	10.4	11.5	11.8
Bilanci fiskal, si përqindje e PBB	-4.3	-3.1	-2.0	-0.8	-1.5
Borxhi publik, si përqindje e PBB	14.6	16.2	16.3	18.4	18.9
Inflacioni (CPI, ndryshimi vjetor në përqindje)	0.6	4.5	2.8	4.3	-1.6
Llogaria korrente (përqindje e PBB)	-9.0	-1.4	0.1	-0.8	1.9
Bilanci i llogarisë korrente (EUR bn)	-3.1	-0.5	0.0	-0.3	0.8
Bilanci tregtar (EUR bilion)	-4.2	-2.8	-2.2	-3.5	-2.4
Eksporti, ndryshimi vjetor në përqindje	-23.0	33.3	30.1	2.5	6.7
Importi ndryshimi vjetor në përqindje	-33.2	15.1	30.1	2.5	6.7
Borxhi i jashtëm, (përqindje e PBB)	108.2	102.6	94.3	94.7	93.4

Burimi: http://www.focus-economics.com/countries/bulgaria

Ekonomistët parashikojnë që Bullgaria do zgjerohet me 1.6 përqind në 2014 ndërkohë që presin një rritje prej 2.4 përqind në 2015[65]. Sipas FMN (Qershor 2014) pritet një rritje modeste e ekonomisë, e shtyrë nga një kërkesë e brendshme e fortë dhe një absorbim më i mirë i fondeve të BE-së. Rritja e kredisë është e ulët, e cila momentalisht mund të ndikohet negativisht nga kriza bankare më e keqe e 16 viteve të fundit[66]. Edhe parashikimet e Bashkimit Evropian janë po kaq optimiste sa i takon rritjes në 2014 (1.7 përqind), pas rënies së lehtë që pësoi ekonomia në 2012, por me parashikime jo shumë optimiste për vitin 2015 (2 përqind). Megjithë parashikimet për përshpejtimet në rritjen ekonomike në Bullgari, rreziqet për rënie vazhdojnë të ekzistojnë.

[65] http://www.focus-economics.com
[66] Idem.

Grafik 6.11 Rritja ekonomike e Bullgarisë krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian



Burimi: Databazë i Bankës Botërore;
http://databank.worldbank.org/data/views/reports/chart.aspx

Ashtu si edhe në Rumani, edhe rritja ekonomike e Bullgarisë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian ndjek trendin e rritjes ekonomike mesatare të vendeve të BE-së. Viti 2012 është viti i parë që rritja ekonomike e Bullgarisë e tejkalon mesataren e vendeve të BE-së. Megjithëse Bullgaria ka patur rritje të qëndrueshme dhe është anëtare e BE-së që nga vitit 2007, është një nga vendet me të ardhurat për frymë më të ulta se sa mesatarja e gjysmës së BE-së (FMN, Janar 2014).

Grafik 6.12 Rritja e të ardhurave vjetore për frymë, në përqind



Burimi: Databazë i Bankës Botërore: http://databank.worldbank.org/data/view s/reports/chart.aspx

6.4.2 Tregtia e jashtme e Bullgarisë[67]

Sipas Institutit të Statistikave të Bullgarisë volumi tregtar i Bullgarisë për vitin 2013 ka qenë 48 bilion euro, me një rritje prej 4 përqind në krahasim me vitin 2012 edhe me një rritje prej 10 përqind në krahasim me vitin 2011, ndërkohë që deficiti tregtar ka një rënie prej 24 përqind krahasuar me një vit më parë.

[67] Të dhënat janë marrë nga Instituti i statistikave të Bullgarisë dhe nga Banka Boterore edhe janë përpunuar nga autori.

Grafik 6.13 Qarkullimi i mallrave për vitet 2008-2013, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Në volumin tregtar të Bullgarisë për vitin 2013 eksporti zë 46 përqind të volumit të përgjithshëm tregtar edhe importi 54 përqind të tij. Krahasuar me vitin 2012, eksportet u rritën me 7 përqind dhe importet me rreth 1.4 përqind. Niveli i ndryshëm i rritjes së eksportit dhe importit ka reduktuar bilancin tregtar me rreth 24 përqind. Sipas të dhënave të tabelës 6.5 eksporti në vitin 2013 ka një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2009, e cila shkon rreth 45 përqind, ndërkohë që importi ka qëndruar në të njëjtat nivele. Bilanci tregtar është reduktuar ndjeshëm në krahasim me vitin 2009, në nivelin e 2.8 herë më pak.

Eksportet neto kanë kontribuar për të përmirësuar rritjen ekonomike në vitin 2013 dhe parashikimet tregojnë për një rritje me një ritëm të moderuar në vitin 2014 dhe 2015. Megjithatë, kontributi i eksporteve neto në rritjen e përgjithshme ekonomike parashikohej me ulje në vitin 2014, për arsye të rritjes së kërkesës së brendshme, që shkakton rritje të importeve (Komisioni Evropian, Maj 2014).

Gjithsesi, eksportet kanë tendencë të rriten me shpejtësi për arsye të kërkesës së fortë për lëndë të para dhe për makineri e pajisje, sidomos nga partnerët kryesorë tregtarë të Bullgarisë Gjermania, Italia, dhe Greqia (Banka Botërore, 2014). Në vitin 2013 struktura e eksportit përbëhej nga ushqime, pije, duhan në masën 13.7 përqind, lëndë djegëse, vajra lubrifikantë 23.7 përqind, mallra të prodhuara 22.2 përqind, kimikate edhe të ngjashme 8.1 përqind, etj. Struktura e importit për vitin 2013 dominohet nga lëndët djegëse dhe vajrat lubrifikante me 32.3 përqind si dhe makineri dhe pajisje transporti në masën 23.6 përqind.

Grafiku 6.14 Eksporti dhe importi i Rumanisë, sipas grup-mallrave, viti 2013



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Pesë partnerët kryesore të Bullgarisë janë Gjermania, Turqia, Italia, Rumania dhe Greqia. Destinacionet kryesore të eksportit të Bullgarisë janë vendet e BE-së, mesatarisht rreth 60 përqind e eksportit total, përkatësisht 60 përqind në 2010, 62 përqind në 2011, 58 përqind në 2012 dhe 60 përqind në 2013. Partneri kryesor i eksporteve bullgare është Gjermania, me 12 përqind të totalit të eksportit të Bullgarisë për vitin 2013. Ndërsa, partnerët më të rëndësishëm për importin për vitin 2013 janë Federata Ruse me 19 përqind, Gjermania me 11 përqind, Italia dhe Rumania me 10 përqind.

6.4.3 Politika tregtare

Bullgaria nënshkroi marrëveshjen e parë të bashkëpunimit ekonomik me Bashkimin Evropian në vitin 1990 dhe më tej vijoi me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, e cila synoi krijimin e zonës së tregtisë së lirë midis Bullgarisë dhe Bashkimit Evropian (Damijan, J. P., Sousa, J., and Lamotte, O., 2006). Bullgaria është anëtare e OBT-së që nga viti 1996. Në vitin 1993 Bullgaria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, marrëveshje që hyri në fuqi në 1995. Kjo marrëveshje rregullonte të gjitha marrëdhëniet tregtare midis Bullgarisë dhe BE-së deri në momentin e anëtarësimit.

Bullgaria si vend anëtar i BE-së ka adoptuar Politikën e Përbashkët Tregtare si dhe ka pranuar Komisionin Evropian si një trup negociator për çështje të rëndësishme të lidhura me tregtinë ndërkombëtare, veçanërisht për negociatat me OBT-në. Gjithashtu si BE dhe Bullgaria, si anëtarë të hershëm të OBT-së, vazhdojnë të mbajnë angazhimet e tyre për një sistem të fortë shumëpalësh të tregtisë dhe për liberalizimin e tregtisë mbarë botërore.

6.5 Bullgaria dhe Rumania para dhe pas anëtarësimit, 2002-2013

6.5.1 Karakteristikat e volumit tregtar

Volumi tregtar i Rumanisë dhe Bullgarisë ka një rritje të ndjeshme duke filluar që nga viti 2002 dhe duke kulmuar në vitin 2008. Me përjashtim të vitit 2009, vit i cili përkon me krizën ekonomike botërore, volumi tregtar i Bullgarisë dhe Rumanisë ka njohur rritje. Në vitin 2013 volumi tregtar i Rumanisë është rritur me 3.12 herë në krahasim me vitin 2002, ose një rritje prej 71,348 milion euro. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2006 rritja është më e ulët, 1.97 herë ose 38,477 milion euro. Pothuaj e njëjta situatë është edhe për Bullgarinë. Në vitin 2013 volumi tregtar i Bullgarisë është rritur me 3.3 herë në krahasim me vitin 2002, ose një rritje prej 33,479 milion euro. Ndërkohë, rritja në krahasim me vitin 2006 është 1.6 herë, ose 17,456 milion euro.

Rritja mesatare vjetore e volumit tregtar të Bullgarisë dhe Rumanisë para dhe pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian ka ngjashmëri si në tendencat e rritjes ashtu edhe në filozofi. Kështu, rritja mesatare për Bullgarinë para dhe pas anëtarësimit është respektivisht 21 përqind dhe 8 përqind. Ndërkohë për Rumaninë këto shifra janë 19 përqind dhe 8 përqind. Ritmet e rritjes së volumit tregtar para anëtarësimit në BE janë më të larta sesa ato pas anëtarësimit. Edhe nëse do të përjashtojmë nga analiza vitin 2009 si vit krize, (grafiku 6.15) vit në të cilin vërehet një rënie e dukshme e volumit tregtar për të dyja vendet, përsëri rritja mesatare pas anëtarësimit për të dyja vendet e marra në analizë është më e ulët se para anëtarësimit. Gjithashtu, rritja relative e volumit tregtar për Bullgarinë dhe Rumaninë në vitin 2013 krahasuar me vitin 2006 është 1.5 herë.

Proçeset integruese janë një nxitje dhe shtysë për zhvillim për të gjitha vendet aspiruese (OECD, Banka Botërore, FMN) dhe kjo shpjegon edhe rritjen e shpejtë ekonomike në periudhën e para anëtarësimit në këto vende. Gjithsesi, kjo teori nuk vazhdon më të jetë aktuale pas anëtarësimit.

Grafik 6.15 Volumi tregtar i Bullgarisë dhe Rumanisë 2002-2013, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Nga ecuria e import-eksportit është interesante analiza e ecurisë së bilancit tregtar. Të dy vendet kanë bilanc tregtar negativ. Bilanci tregtar i Bullgarisë ka një përkeqësim të përvitshëm nga viti 2002 deri në vitin 2006, nga -2,366 milion euro në -6,501 milion euro. Ndërkohë, pas vitit 2006 vihet re një përmirësim i tij. Edhe pse një vit pas anëtarësimit (viti 2007) dhe bilanci tregtar vijoi të thellohej (-8,397 milion euro), vitet në vijim tregojnë një përmirësim të tij. Kështu, në vitin 2013 bilanci tregtar arriti në nivelin e -3,617 milion, nivel i cili është gjithsesi më i lartë se një vit para anëtarësimit (viti 2006). Bilanci tregtar i Bullgarisë ka patur luhatje në periudhën 2007-2013, duke arritur nivelin më të ulët të kësaj periudhe në vitin 2011, –3,131 milion euro.

Bilanci tregtar i Rumanisë ka një përkeqësim më të madh në periudhën 2002-2006 krahasuar me Bullgarinë, duke variuar nga -4,214 milion euro në vitin 2002 në -14,942 milion euro në vitin 2006. Ndërkohë, duke filluar nga viti 2007 ka një përmirësim të konsiderueshëm të bilancit tregtar. Rumania ndryshe nga Bullgaria ka rënie të bilancit tregtar për çdo vit gjatë viteve 2007-2013. Në shifra, bilanci tregtar i Rumanisë në vitin 2007 ka qenë -21,654 milion euro dhe ka arritur në vitin 2013 në -5,700 milion euro. Grafiku 6.16 jep ecurinë e qarkullimit të mallrave (import, eksport, volum tregtar dhe bilanc tregtar) për Bullgarinë dhe Rumaninë në periudhën 2002-2013.

Parë nga analiza e volumit tregtar dhe bilancit tregtar mund të thuhet se anëtarësimi ka ndikuar në shkallë të ndryshme tek Bullgaria dhe Rumania dhe kjo situatë, së bashku me faktorët e tjerë që ndikojnë në këtë performancë, mund të mos kenë lidhje të drejtpërdrejtë me efektin që krijon anëtarësimi në union.

Grafik 6.16 Qarkullimi i mallrave për Bullgarinë dhe Rumaninë, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Gjithashtu, nëse shohim raportin e import-eksportit ndaj volumit tregtar të Rumanisë dhe Bullgarisë vërejmë se ky raport përmirësohet në mënyrë të qëndrueshme në favor të eksportit për periudhën 2002-2013, me përmirësim të përvitshëm dhe pa luhatje. Për Rumaninë pjesa e eksportit dhe importit në totalin e volumit tregtar lëviz nga 37 përqind deri 45 përqind për eksportin dhe 53 përqind deri 65 përqind për importin. Për Bullgarinë, pjesa e eksportit dhe importit ndaj totalit të volumit tregtar është 38 përqind deri 46 përqind për eksportin dhe 54 përqind deri 62 përqind për importin. Përmirësimi pa luhatje i këtij raporti tregon se pavarësisht anëtarësimit të të dy vendeve në BE, rritja tregtare mund të ketë ndodhur për faktorë të tjerë që nuk lidhen me unionin.

Shkalla e hapjes, si raport i volumit tregtar ndaj PBB, ndjek të njëjtën tendencë me volumin tregtar për periudhën 2002-2013 (grafiku 6.17). Hapja e Bullgarisë dhe Rumanisë është ndikuar nga kriza e vitit 2009, krizë e cila nuk ka asnjë korrelacion të drejtpërdrejtë me anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Ndërkohë, po të përjashtojmë nga analiza vitin 2009 dhe efektin zinxhir që ai ka dhënë në dy vitet në vijim, shkalla e hapjes për të dyja vendet tregon nivel pothuaj të pandryshuar në vite. Në mënyrë jo të drejtpërdrejtë kjo të çon në përfundimin se ekonomia, përfshirë tregtinë, nuk është ndikuar, ose është ndikuar në mënyrë marxhinale, nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

Grafik 6.17 Shkalla e hapjes së Bullgarisë dhe Rumanisë në vite



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

6.5.2 Karakteristikat e eksportit

Eksporti i Rumanisë dhe Bullgarisë është rritur vazhdimisht nga viti 2002 deri në vitin 2013, duke përjashtuar vitin 2009 i cili është viti i krizës globale ekonomike. Trendi i rritjes së eksportit për Rumaninë ka qenë në nivelet e 10-12 përqind në vit për të gjithë periudhën 2002-2013. Rritja e eksportit në vitin 2006 krahasuar me vitin 2002 është 1.75 herë ndërsa, në vitin 2013 krahasuar me vitin 2007 kjo rritje është 1.53 herë, duke sugjeruar një rritje më të vogël pas anëtarësimit të Rumanisë në BE.

Të dhënat e Bullgarisë tregojnë që edhe për këtë vend eksporti ka patur rritje për çdo vit, me përjashtim të vitit 2009. Niveli i rritjes nga viti në vit për periudhën 2002-2013 për Bullgarinë është pothuaj i njëjtë me Rumaninë, në nivelet 10-13 përqind. Rritja e eksportit në vitin 2006 krahasuar me vitin 2002 është 2 herë, ndërsa për vitin 2013 krahasuar me vitin 2007 kjo rritje është 1.49 herë. Njësoj si për Rumaninë rritja e importit është më e ulët pas anëtarësimit të Bullgarisë në BE.

Grafik 6.18 Ecuria e eksportit të Bullgarisë dhe Rumanisë, (në mijë euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Ritmet e rritjes së eksportit për Bullgarinë dhe Rumaninë tregojnë se ritmet e rritjes kanë qenë shumë të paqëndrueshme si përpara ashtu edhe pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian (grafiku 6.19). Rumania ka dukshëm ritme rritjeje më të larta se Bullgaria në të gjithë periudhën e marrë në shqyrtim, por në të njëjtën kohë edhe rënien më të madhe në vitin e krizës botërore. I vetmi vit në të cilin mund të thuhet se vendet barazojnë njëri-tjetrin në kuptim të ritmeve të rritjes së eksportit është vitit 2012, por kjo ndryshon menjëherë në vitin 2013, ku Rumania tregon përsëri qëndrueshmëri më të madhe se Bullgaria. Kjo ri-forcon edhe njëherë konkluzionin e arritur në seksionin 6.5.1 se anëtarësimi në BE ka ndikuar në shkallë të ndryshme tek Bullgaria dhe Rumania.

Grafik 6.19 Ritmet e rritjet së eksportit të Bullgarisë dhe Rumanisë



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Po të shohim ecurinë e eksportit të Bullgarisë dhe Rumanisë, ndarë në dy grupime të mëdha, eksporti drejt vendeve të BE-së dhe eksporti drejt vendeve të tjera jashtë bllokut, vëmë re se ecuria e eksportit për të dy grupimet e vendeve ruan pothuaj të njëjtat karakteristika me eksportin total të Bullgarisë dhe të Rumanisë. Ngjashmëria midis grafikëve 6.15. 6.18 dhe 6.20 është e dukshme.

Grafik 6.20 Eksporti i Bullgarisë dhe Rumanisë, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian duket se nuk ka dhënë ndonjë shtysë të konsiderueshme për eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë për të rritur prezencën e tyre në vendet e bllokut të BE dhe ulur eksportin ndaj vendeve të tjera. Pavarësisht se roli i vendeve të bllokut të BE-së për eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë është i ndryshëm, raporti që vendet e bllokut të BE-së zënë në eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë ka përkeqësim pas anëtarësimit. Grafiku 6.20 tregon se pas një periudhe më të qëndrueshme (2004-2007), pesha që vendet e BE-së zënë në eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë bie. Raporti i vendeve të bllokut të BE në vite ka rënë nga 74 përqind në 70 përqind për Rumaninë dhe nga 62 përqind në 60 përqind për Bullgarinë.

Grafik 6.21 Roli i vendeve të BE për eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë, (në përqindje)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Ndërkohë, po të analizojmë eksportin brenda bllokut të BE-së si për Rumaninë ashtu edhe për Bullgarinë vërejmë se vendet kanë ruajtur pozicionet e tyre të rëndësisë për destinacionet e eksportit për të dyja vendet e marra në analizë. Një karakteristikë interesante për të dyja vendet është roli që ka Turqia në eksportet e Bullgarisë dhe të Rumanisë. Megjithëse Turqia nuk është një vend anëtar i Bashkimit Evropian, duke qenë se ajo është bashkim doganor me Bashkimin Evropian vetëm për produktet industriale, bën që Turqia të zërë një vend të rëndësishëm për eksportet industriale të Bullgarisë dhe Rumanisë[68].

Vendi kryesor i eksportit të Bullgarisë është Gjermania, pozitë të cilën e ka ruajtur gjatë gjithë periudhës së analizuar. Pas Gjermanisë vjen Italia, Rumania dhe Greqia. Gjithashtu, vërehet se ritmi i rritjes së eksporteve me këto vende është më i lartë në periudhën 2007-2013 krahasuar me 2002-2006. Sa i takon Rumanisë, vendet kryesore janë Gjermania, Italia, Franca. Edhe për Rumaninë vëmë re se ritmi i rritjes së eksporteve me këto vende është më i lartë në periudhën 2007-2013 krahasuar me 2002-2006.

[68] Tregtia për produktet industriale është pa tarifa doganore, rregulli bazë i bashkimit doganor.

Në përfundim të këtij seksioni mund të thuhet se anëtarësimi në Bashkimin Evropian për eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë ka ndikim jo thelbësor. Roli i vendeve të BE-së ka rënë pas anëtarësimit, duke ruajtur edhe raportet që disa nga vendet anëtare të bllokut kanë për eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë. Cilat janë arsyet e këtij ndikimi jo thelbësor për Bullgarinë dhe Rumaninë mund të analizohen më tej, por nuk është objekt i këtij punimi.

6.5.3 Karakteristikat e importit

Panorama e ecurisë së importit të Rumanisë dhe Bullgarisë është shumë e ngjashme me atë të eksportit, parë në këndvështrimin e veçorive dhe karakteristikave kryesore. Nga të dhënat shikojmë që importi i Rumanisë dhe Bullgarisë është rritur nga viti 2002 deri në vitin 2013, duke përjashtuar vitin 2009 i cili është viti i krizës globale ekonomike. Trendi i rritjes për Rumaninë ka qenë më i madh krahasuar me Bullgarinë por, në të njëjtën kohë me paqëndrueshmëri gjatë tri viteve të fundit. Rritja e importit për Bullgarinë dhe Rumaninë ka patur ritme më të larta përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian se sa pas anëtarësimit.

Grafik 6.22 Ecuria e importit të Bullgarisë dhe Rumanisë (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Trendi i rritjes së importit për Rumaninë ka qenë shumë i paqëndrueshëm duke njohur rritje minimale 1 përqind (vitit 2013), dhe maksimale (2005-2006) 25 përqind gjatë viteve 2002-2013. Rritja e importit në vitin 2006 krahasuar me vitin 2002 është 2.1 herë ndërsa, në vitin 2013 krahasuar me vitin 2007 kjo rritje është 1.08 herë. Rritja e importit është më e vogël pas anëtarësimit të Rumanisë në BE. Të dhënat e Bullgarisë tregojnë të njëjtën ecuri për importet si Rumania, duke njohur rritje minimale 1 përqind (vitit 2013) dhe maksimale (2007) 27 përqind gjatë viteve 2002-2013. Rritja e importit në vitin 2006 krahasuar me vitin 2002 është 2.1 herë ndërsa, për vitin 2013 krahasuar me vitin 2007 kjo rritje është 1.1 herë. Njësoj si për Rumaninë rritja e importit është më e ulët pas anëtarësimit të Bullgarisë në BE.

Ritmet e rritjes së importit janë të ngjashme me ato të eksportit vetëm se ngjashmëria e ritmeve të rritjes midis Bullgarisë dhe Rumanisë është më e madhe. Duke analizuar ritmet e rritjes së importit dhe duke i krahasuar në mënyrë analogjike ato më ritmet e rritjes së eksportit, mund të themi se ndikimi i anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Evropian në import është i ngjashëm me eksportin. Paqëndrueshmëria në ritmet e rritjes së importit tregon qartë se anëtarësimi në BE nuk është faktor përcaktues në përmirësimin e performancës së importit.

Grafik 6.23 Ritmet e rritjet së importit të Bullgarisë dhe Rumanisë, (në përqindje)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Importi i Bullgarisë, i ndarë midis dy grupimeve kryesore BE dhe të tjera, ka ruajtur një trend rritës pothuaj të njëjtë. Nga të dhënat rezulton se deri në vitin 2008 ritmet e rritjes së importit me këto dy grupime kanë qenë të njëjta. Pas vitit 2009 shohim që vendet e BE-së kanë rol më të madh në importet e Bullgarisë duke bërë që raporti midis tyre të përmirësohet në favor të vendeve të BE-së. Në vitin 2002 raporti midis vendeve të BE-së dhe atyre jashtë BE në importin e Bullgarisë ka qenë 58 përqind me 42 përqind. Në vitin 2013 ky raport arriti 61 përqind me 39 përqind.

Edhe importi i Rumanisë me vendet e BE-së krahasuar me importin e vendeve të tjera ka ruajtur pothuaj të njëjtin trend rritës. Ajo që vihet re tek Rumania është ndryshimi i këtij raporti para dhe pas anëtarësimit në BE. Nga vitet 2002-2006 raporti i importit nga vendet e BE-së ndaj importit nga vendet e tjera të botës është 68 përqind me 32 përqind. Pas anëtarësimit ky raport ka një ndryshim të ndjeshëm, duke arritur në 75 përqind ndaj 25 përqind. Ky ndryshim tregon se anëtarësimi në Bashkimin Evropian ka patur ndikim më të ndjeshëm në import se sa në eksport.

Grafik 6.24 Importi Bullgarisë dhe Rumanisë, (në milion euro)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Rritja e peshës së vendeve të BE-së në importin e Bullgarisë dhe Rumanisë shpjegohet me faktin që produktet e bllokut janë më konkurruese ndërkohë që trajtohen në Rumani dhe Bullgari njëlloj si në vendet e tyre si rezultat i PPT-së.

Grafik 6.25 Roli i vendeve të BE për importet e Bullgarisë dhe Rumanisë, (në përqindje)



Burimi: UNCOMTRADE, përpunuar në grafik nga autori

Grafiku 6.25 tregon se raporti i importit të vendeve të BE-së dhe atyre jashtë BE ka qenë i paqëndrueshëm dhe në rënie të vazhdueshme gjatë viteve 2004-2008. Në vitin 2009 vendet e BE-së janë rritur, më shumë për Bullgarinë se për Rumaninë dhe nga 2010 raporti i importit prej këtyre vendeve është pothuaj i pandryshuar. Raporti në import i vendeve të bllokut të BE ka njohur nivelin më të ulët për Bullgarinë në vitin 2006 me 51 përqind dhe Rumaninë në vitet 2005-2006 me 64 përqind. Niveli më i lartë është në vitin 2013 me 76 përqind dhe 60 përqind respektivisht për Rumaninë dhe Bullgarinë.

Një ndryshim tjetër midis Bullgarisë dhe Rumanisë lidhet me partnerët kryesorë të importit. Për Bullgarinë vendi kryesor i importit është Federata Ruse, e cila ka qenë e tillë para dhe pas

anëtarësimit në BE. Ndërsa për Rumaninë vendi kryesor i importit është Gjermania, e ndjekur nga Italia, Hungaria dhe Franca.

Në përfundim mund të thuhet që importi i Bullgarisë dhe Rumanisë është ndikuar më shumë se eksporti nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

6.6 Përfundime

Në këtë kapitull dhe seksionet e tij u analizua eksperienca e dy prej anëtarëve të rinj të Bashkimit Evropian, Bullgarisë dhe Rumanisë. Proçesi i anëtarësimit të tyre në BE lejon në daljen e përfundimeve analogjike për Shqipërinë. Pas një analize për përzgjedhjen e Rumanisë dhe Bullgarisë për arritjen e qëllimeve të këtij kapitulli, të parashtruar në seksionin 6.2, kapitulli vijon me analizën e zhvillimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të Bullgarisë dhe Rumanisë për periudhën 2007-2013. Seksionet 6.4 dhe 6.5 vijojnë me analizën e detajuar të tregtisë së Bullgarisë dhe të Rumanisë për periudhën 2002-2013 duke u ndalur në karakteristikat kryesore të volumit tregtar, importit dhe eksportit para dhe pas anëtarësimit të këtyre vendeve në BE. Disa përfundime që mund të nxirren nga analiza e mësipërme janë përmbledhur në paragrafët më poshtë.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian me anëtarë të rinj është një proçes i njohur dhe rrugë e shkelur nga vendet të tjera aspiruese. Nga kjo analizë krahasimore mund të nxirren përfundime analogjike për Shqipërinë lidhur me proçesin e anëtarësimit, përfitimet dhe ndikimin afat-shkurtër nga anëtarësimi. Kroacia si vendi më i ri anëtar i BE-së do të ishte vendi më përfaqësues për këtë analizë analogjike, për më tepër që ngjashmëritë midis Kroacisë dhe Shqipërisë janë të gjithanshme, por mungesa e analizave të detajuara për periudhën e pas anëtarësimit nuk lejojnë në daljen e konkluzioneve të dëshiruara.

Shqipëria është më afër Bullgarisë dhe Rumanisë në tendencat e përgjithshme të zhvillimit ekonomik si dhe të parametrave ekonomikë konkretë, si për shembull indeksi i perceptimit të korrupsionit, lehtësitë e të bërit biznes, indeksi i konkurrueshmërisë globale, etj. të marrë në analizë në këtë kapitull. Polonia është anëtarësuar në Bashkimin Evropian 10 vjet më parë (2004), ndërkohë që politika tregtare e saj ka ndryshuar rrënjësisht pas traktatit të Lisbonës në 2009, duke bërë analizën krahasimore të saj më Shqipërinë jo aktuale.

Proçesi i anëtarësimit për Kroacinë, Bullgarinë dhe Rumaninë zgjati pothuaj njësoj, 13 vjet ose 14 vjet, duke filluar nga nënshkrimi i marrëveshjeve tregtare respektive për të tri vendet (detajet jepen në grafikët 6.1 dhe 6.19 të këtij kapitulli). Kjo sugjeron që proçesi i anëtarësimit të Shqipërisë të jetë brenda të njëjtit hark kohor. Me këtë arsyetim Shqipëria mund të përfundojë proçesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian brenda vitit 2020, parashikimi i cili nuk është më real pasi Bashkimi Evropian e ka deklaruar se deri në 2020 nuk do të ketë anëtarësime të reja.

Anëtarësimi ka ndikuar në shkallë të ndryshme tek Bullgaria dhe Rumania dhe performanca ekonomike dhe tregtare mund të mos jetë rezultat vetëm i anëtarësimit në union. Ecuria e shkëmbimeve tregtare të Rumanisë dhe Bullgarisë ofron rezultate kundërshtuese të njëra-tjetrës në lidhje me rolin që ka anëtarësimi në BE në zhvillimet tregtare, specifikisht në ecurinë e eksportit dhe të importit. Gjithashtu, viti 2009 nuk lejon bërjen e përgjithësimeve të qëndrueshme për ndikimin e anëtarësimit në zhvillimet tregtare pasi ka shumë zhvillime pas vitit 2009 që janë rezultat i masave kundër-krizë të ndërmarra nga Bullgaria dhe Rumania dhe nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me anëtarësimin në BE.

Volumi tregtar është rritur në mënyrë konstante, me përjashtim të vitit 2009, duke shfaqur ritme rritje më të ulëta pas anëtarësimit se para anëtarësimit në Bashkimin Evropian, për të dyja vendet. Përmirësimi i qëndrueshëm i raportit të import-eksportit ndaj volumit tregtar, në favor të eksportit si para ashtu edhe pas anëtarësimit në BE, tregon se rritja tregtare mund të ketë ndodhur për faktorë të tjerë që nuk lidhen me hyrjen në union. Gjithashtu, shkalla e hapjes për të dyja vendet tregon nivel pothuaj të pandryshuar në vite, duke ofruar një panoramë të ngjashme para dhe pas anëtarësimit.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian ka ndikim jo thelbësor në eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë. Roli i vendeve të BE-së në eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë ka rënë pas anëtarësimit. Partnerët kryesorë tregtarë në eksport për Bullgarinë dhe Rumaninë kanë ruajtur të njëjtat pozicione edhe pas anëtarësimit.

Importi i Bullgarisë dhe Rumanisë është ndikuar më shumë se eksporti nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, roli i vendeve të BE-së në importet e Bullgarisë dhe Rumanisë është përmirësuar pas anëtarësimit. Kjo shpjegohet me faktin që produktet e bllokut janë më konkurruese ndërkohë që trajtohen në Rumani dhe Bullgari njëlloj si në vendet e tyre si rezultat i PPT-së.

KAPITULLI VII: PËRFUNDIME

7.1 Hyrje.....189
7.2 Gjetjet kryesore 190
7.3 Kontributet kryesore në njohuritë e fushës 197
7.4 Rekomandime.....199
7.5 Mundësi për kërkime të mëtejshme 202

7.1 Hyrje

Ekonomia shqiptare ka treguar stabilitet makro-ekonomik pas viteve 90', stabilitet i cili u lëkund për herë të parë në periudhën e krizës financiare dhe ekonomike të vitit 2009. Gjithsesi, ekonomia shqiptare, ndryshe nga të gjitha vendet e tjera të rajonit apo edhe të Evropës, ishte nga të paktat vende që nuk hyri në recesion, edhe pse rritja ekonomike pati ngadalësim të konsiderueshëm dhe flukset e import-eksportit pësuan rënie. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT që nga viti 2009 rritja ekonomike ka patur vetëm rënie, duke shënuar respektivisht shifrat prej 3.3 përqind, 3.8 përqind, 3.1 përqind, 1.3 përqind dhe 0.7 përqind në 2013. Parashikimet e FMN (Deklarata FMN, 2014) konfirmojnë rritjen ekonomike për vitin 2014 në nivelin 2.1 përqind.

Gjatë viteve 2007-2013 volumi i përgjithshëm i tregtisë është rritur në terma absolutë dhe relativë, megjithëse kjo rritje është shoqëruar me luhatje. Rritja mesatare vjetore e volumit tregtar për periudhën 2006-2013 është 11 përqind. Eksportet janë rritur me ritme më të shpejta se importet, mesatarisht 19 përqind dhe 9 përqind, respektivisht. Rritja e eksporteve ka qenë e qëndrueshme gjatë gjithë periudhës së marrë në analizë ndërsa importet kanë patur luhatje gjatë gjithë periudhës. Vendet e Bashkimit Evropian janë destinacioni kryesor i eksporteve shqiptare. Eksportet me to përbëjnë rreth 76.6 përqind e eksporteve totale në vitin 2013 dhe 62.2 përqind të importeve totale për të njëjtin vit.

Bashkimi Evropian vazhdon të mbetet partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, por blloku e ka humbur peshën që ka patur një dekadë më parë. Kjo, edhe si rezultat i marrëveshjeve të tregtisë së lirë me vendet e tjera si CEFTA, EFTA dhe Turqia, të cilat krijuan mundësi të reja eksporti për prodhuesit shqiptarë. Shkalla e përfitimit (llogaritur si raporti i importit/eksportit preferencial ndaj atij total) nga marrëveshjet e tregtisë së lirë është e nivelit 39 - 42 përqind në eksport dhe rreth 49 përqind në import.

Ky punim ka analizuar ndikimin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian në politikën tregtare shqiptare dhe në strukturën e import-eksportit. Më tej vlerësime dhe analiza të tjera janë paraqitur në përgjigje të pyetjeve kërkimore të ngritura në kapitullin e parë. Analizat cilësore janë kombinuar më tej me ato empirike, të mbështetura në modelin e gravitetit dhe në analiza të tjera si avantazhi krahasues dhe vlerësimi cilësor analog me anë të krahasimit me vende të anëtarësuara, së fundmi, në Bashkimin Evropian.

Në këtë kapitull jepen gjetjet kryesore të këtij punimi, në seksionin 7.2, të cilat japin sintezën e të gjitha gjetjeve në kapitujt e këtij punimi. Më tej, dilet me disa rekomandime për politikë-bërjen dhe për hapat e tjerë që mund të ndërmerren, të cilët janë prezantuar në seksionin 7.4. Ky punim, pa dyshim, ka tentuar të japë kontributin e vet në kërkimet dhe studimet e bëra deri tani në këtë fushë, analizuar këto në kontekstin shqiptar. Seksioni 7.3 paraqet kontributet kryesore të këtij punimi në kërkimet e deritanishme, ndërsa ky kapitull përmbyllet në seksionin 7.5 me kufizimet që është ndeshur autori gjatë analizave cilësore dhe ato empirike si dhe disa rekomandime për studime që do të ishin me interes në të ardhmen.

7.2 Gjetjet kryesore

Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një proçes i cili ndërthur njëherësh vullnetin politik, aspiratat e një kombi të izoluar për më shumë se gjysmë shekulli për lëvizje të lirë dhe për më shumë prosperitet, si dhe potencialet reale të ekonomisë për t'iu përgjigjur konkurrencës në rritje. Plotësimi i kritereve të Kopenhagenit kërkon nga çdo vend aspirues (i) forcimin e institucioneve demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut, (ii) ekzistencën e një ekonomie tregu funksional, (iii) marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve dhe qëllimeve të *acquis* të Bashkimit Evropian.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është nxitës për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe tregtar të çdo ekonomie aspiruese. Megjithatë, koha nga nënshkrimi i marrëveshjes së asociimit deri në përfundimin e negociatave është relativisht e gjatë dhe ndikimi i anëtarësimit nuk është më i dukshëm, përfundim i cili mund të kërkojë analiza të mëtejshme për ta mbështetur me rezultate emprike dhe përbën një pyetje kërkimore për kërkues dhe studiues të tjerë. Ndryshimi i procedurave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian e ka bërë proçesin jo vetëm më të gjatë, por edhe më të lodhshëm për vendet aspiruese. Lodhja e vendeve të bllokut të BE-së për të pritur anëtarë të rinj po ndihet edhe pse jo e shprehur në mënyrë të hapur. Strategjia 2020 e BE ((COM (2010) 2020) nuk parashikon asnjë proçes zgjerimi deri në vitin 2020 duke konfirmuar kështu tërheqjen e vendeve të bllokut nga anëtarësimet e reja. Pozicionimi politik i Bashkimit Evropian për të mos patur anëtarësime të reja deri në vitin 2020 është një tregues i qartë i lodhjes dhe rezistencës së përgjithshme që vihet re brenda bllokut për anëtarë të rinj. Gjithashtu, problemet e hasura nga Bashkimi Evropian me anëtarësimin e Rumanisë dhe Bullgarisë e shtynë Komisionin Evropian të propozojë instrumentë të rinj për vlerësimin e performancës së vendeve aspiruese si

“benchmark” për njoftimin e hapjes së negociatave, “benchmark” për hapjen dhe mbylljen e negociatave të një kapitulli, etj.

Vlerësimi i potencialeve tregtare, sidomos mes vendeve të Evropës Qëndrore e Lindore (CEE) me atë Perëndimore, anëtarësimeve të vazhdueshme në Bashkimin Evropian, mes vendeve të EFTA-s dhe vendeve Balltike, etj. kanë qenë në fokus të shumë studimeve gjatë dy dekadave të fundit. Një numër i madh autorësh kanë përdorur modelin e gravitetit për të vlerësuar potencialin tregtar midis vendeve. Siç është theksuar në Kapitullin II, autorë të shumtë e kanë përdorur modelin e gravitetit si Wang dhe Winters (1991), Iversen (1998), Paas (1998, 2000), Chen dhe Wall (1999), Egger (2000), van Beers dhe Biessen (1996), Baldwin (1994), Christie (2002), Martínez-Zarzoso dhe Nowak-Lehmann (2003), Adams et al. (2003), Sohn (2005), Papazoglou et al. (2006), Camarero et al. (2013), Chan et al. (2014), Gomez-Herrera (2012), etj. Gjithashtu, nga rishikimi i literaturës është gjetur se modeli i gravitetit është përdorur edhe nga kërkues shqiptarë (Xhepa dhe Agolli, 2003; Pllaha, 2011; Kraja dhe Sejdini, 2014) për të matur flukset tregtare të Shqipërisë.

Nga rishikimi i literaturës ka rezultuar se në modelin e gravitetit, përgjithësisht, autorë të ndryshëm kanë përdorur si variabla të varur eksportet, importet apo edhe flukset tregtare totale mes vendeve partnere. Ndërsa, ndër variablat e pavarur, janë përdorur disa prej faktorëve kryesorë që ndikojnë në kërkesën dhe ofertën e vendeve tregtuese, si madhësia tregut dhe ekonomisë, niveli i të ardhurave, popullsia, të ardhurat për frymë, volumi i importeve/eksporteve në vitet paraardhëse, etj. Gjithashtu, modeli përdor faktorë që përfaqësojnë rezistencën që vendet bëjnë ndaj tregtisë, si kostot e transportit, tarifat dhe cilësinë e transportit, distancën midis qendrave tregtare të dy vendeve ose largësinë gjeografike e vendeve ndaj tregjeve, kursin e këmbimit, performancën dhe cilësinë e shërbimeve të pikave kufitare, etj. Më pak studime kanë përdorur indekse të ngjashmërisë mes vendeve në terma të madhësisë ekonomike dhe fuqisë prodhuese, indeksin e komplementaritetit të tregtisë që shpreh strukturën e tregtisë së një vendi, apo ngjashmërinë midis dy ekonomive. Pothuaj të gjitha kërkimet e dekadave të fundit tregojnë se vendet që janë të pasura, flasin të njëjtën gjuhë, lidhen me kufij doganorë, kanë histori të ngjashme kolonizimi, bëjnë pjesë në blloqe tregtare, janë pjesë e bashkimeve monetare, kanë nënshkruar marrëveshje të tregtisë së lirë, etj. priren të tregtojnë më shumë me njëri-tjetrin. Vlerësimi i modelit të gravitetit është i rëndësishëm në rastin e Shqipërisë duke qenë se një

ndër sfidat për krijimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme është edhe diversifikimi i eksporteve.

Në analizë empirike kanë përdorur të dhëna panel të balancuara, përdorimi i të cilave ka përparësi ndaj përdorimit të të dhënave ndër-seksionale, pasi të dhënat panel shfrytëzojnë informacionin e të dhënave në periudha të ndryshme kohore, duke e konsideruar këtë informacion si të tillë, ndryshe nga vlerësimi me OLS i të dhënave ndërseksionale i cili injoron varësinë e të dhënave të një vendi në kohë të ndryshme. Gjithashtu, pavarësisht kompleksitetit në trajtimin ekonometrik të tyre, të dhënat panel japin rezultate më konsistente për vlerësimin e modelit të gravitetit se sa OLS. Vlerësimi i flukseve tregtare është bërë me metodat e efekteve fikse dhe atyre të rastit, të përdorura gjithashtu gjerësisht në vlerësimin e modelit të gravitetit. Përdorimi i njërës apo tjetrës metodë është zgjedhur me anë të testeve statistikore, që marrin në konsideratë kufizimet dhe përparësitë e secilës në lidhje më konsistencën dhe efiçencën e vlerësuesve.

Anëtarësimi i Shqipërisë në OBT shënon kthesën e parë historike për politikën tregtare shqiptare. Përshtatja e politikës tregtare shqiptare me rregullat dhe parimet e OBT-së vendosi bazat e një ekonomie të hapur tregtare, me rregulla transparente, të parashikueshme dhe të njëjta me ato të çdo vendi anëtar të OBT-së. Kjo krijoi një ambient të sigurtë për investitorët e huaj dhe krijoi bazat për rritje të vazhdueshme ekonomike. Transformimi i politikës tregtare pas anëtarësimit në OBT u konfirmua në rishikimin e parë të politikës tregtare në vitin 2010 në fjalët përmbyllëse të sesionit 3 ditor për Shqipërinë. H.E. Mr. Bozkurt Aran (2010, përkthimi im) deklaroi ".....kaq shumë është arritur për një periudhë kaq të shkurtër; sigurisht që Shqipëria e sotme nuk i ngjan aspak Shqipërisë së një dekade më parë. Dëshiroj të nënvizoj vendosmërinë e Shqipërisë në vijimin e reformave ekonomike, politike dhe institucionale dhe arritjet e jashtëzakonshme të deritanishme".

Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit shënoi një fazë të re transformimi për ekonominë në përgjithësi. Për tregtinë, MSA krijoi një marrëdhënie të re për politikën tregtare. Ndjekja e rregullave dhe parimeve të OBT-së, edhe pse është baza e përcaktimeve të pjesës tregtare, konsiderohet standard minimal për tu ndjekur nga Shqipëria pas dhjetorit 2006, kohë në të cilën hyri në fuqi pjesa tregtare e MSA. Procesi i përshtatjes me Politikën e Përbashkët Tregtare të BE-së e thelloi ndërvarësinë e politikës tregtare shqiptare me zhvillimet në Bashkimin Evropian. Traktati i Lisbonës, pas transformimeve thelbësore në

fushën e zbatimit të PPT-së si dhe marrjes së vendimeve për të, ka sjellë domosdoshmërinë e ndryshimit të qasjes ndaj saj jo vetëm brenda blokkut të por edhe për vendet aspiruese.

Ndikimi i politikës tregtare shqiptare pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian do të sjellë ndryshime thelbësore në lidhje me kompetencat, propozimin e politikës tregtare dhe marrjen e vendimeve. Shqipëria do të ndjekë të gjitha zhvillimet në PPT e Bashkimit Evropian dhe do të veprojë në përputhje me parashikimet e traktateve të Bashkimit Evropian. Shqipëria nuk do të mund të propozojë, hartojë apo ndërmarrë asnjë iniciativë që prek politikën tregtare me vendet e treta pasi në të gjitha rastet interesat e saj do të artikulohen nëpërmjet Komisionit Evropian. Shqipëria do të jetë e detyruar të ndjekë të gjitha iniciativat e marra nga blloku i vendeve të BE-së në fushën e tregtisë, nga momenti i anëtarësimit. Ky proçes do të shoqërohet me humbjen e sovranitetit për politikën tregtare dhe rritjen e nevojës për kapacitete koordinuese, lobuese dhe argumentuese për interesat ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian do të kërkojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga bashkimi doganor, përshtatjen e të gjitha angazhimeve të marra në OBT, zbatimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë të Bashkimit Evropian dhe shfuqizimin e menjëhershëm të të gjitha marrëveshjeve të tregtisë së lirë që do të jenë në fuqi deri në momentin e anëtarësimit, zbatimin e regjimit tregtar të Bashkimit Evropian dhe harmonizimin e të gjithë legjislacionit tregtar. Ndryshimi i tarifave doganore dhe zbatimi automatik i marrëveshjeve të tregtisë së lirë do të jenë aspektet e para më të dukshme pas anëtarësimit. Kështu, vetëm 17 përqind e linjave tarifore të Shqipërisë do të mbeten të pandryshuara pas anëtarësimit dhe 32 përqind e tarifave bazë që janë aktualisht zero përqind do të rriten në nivelin e tarifës bazë të Bashkimit Evropian[69].

Politikë-bërja tregtare pas anëtarësimit do të ndikohet thellësisht. Iniciativa e propozimit të një politike tregtare do të jetë kompetencë ekskluzive e Komisionit Evropian dhe institucionet shqiptare përgjegjëse për politikën tregtare do të kenë një rol krejtësisht të tjetërsuar. Ato do të duhet të transformohen nga propozues të një politike tregtare në institucione që mbrojnë interesat ekonomike të vendit. Kjo do të kërkojë një ndryshim jo vetëm të mentalitetit të institucioneve përgjegjëse për politikën tregtare, por edhe të komunitetit të biznesit si dhe grupeve të interesit. Institucionet shqiptare duhet të lobojnë pranë strukturave përgjegjëse të

[69] Ky ndryshim i tarifës bazë do të notifikohet edhe në OBT

Komisionit Evropian përgjegjëse për politikën e përbashkët tregtare për të argumentuar ndërmarrjen e një politike të caktuar, e cila mund të mos jetë domosdoshmërisht njësoj e rëndësishme për vendet më të zhvilluara të bllokut. Interesat ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë duhet të konvertohen në interes ekonomik dhe tregtar të bllokut, në mënyrë që ato të bëhen pjesë e programeve dhe politikave zhvillimore në fushën tregtare.

Analiza e statistikave të tregtisë së jashtme të Shqipërisë tregon se marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë patur efekt të përkohshëm në diversifikimin e eksporteve. Ecuria e importeve dhe eksporteve me vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje të tregtisë së lirë ka ndjekur tendencat normale të zhvillimit dhe konsolidimit tregtar, duke ruajtur tendenca rritëse, si para nënshkrimit të marrëveshjeve dhe pas nënshkrimit të tyre. Bashkimi Evropian është partneri tregtar kryesor i Shqipërisë pas viteve ’90, por roli i tij në tregtinë e Shqipërisë vitet e fundit, vite të cilat përkojnë me periudhën e pas nënshkrimit të MSA, ka rënë.

Avantazhi krahasues i produkteve, matur me Indeksin e Balasës për të gjithë kapitujt e Nomenklaturës së Mallrave, përbën një udhërrëfyes të mirë për orientimin e eksporteve shqiptare. Pavarësisht se nëpërmjet teorisë së avantazhit krahasues është e vështirë të kuptohet se nga vjen avantazhi krahasues dhe cilët faktorë e kanë ndikuar atë në kohë, ai është një tregues i përgjithshëm pozitiv i orientimit të eksporteve. Kjo vërtetohet edhe nga përputhshmëria midis eksportit faktik dhe atij me avantazh krahasues të shfaqur, për kapitujt e Nomenklaturës së Mallrave. Produktet për të cilat vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues përbëjnë 88 përqind të eksportit total faktik të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. E rëndësishme është edhe qëndrueshmëria në vite e kësaj përputhshmërie, e cila ruan këtë fizionomi që nga viti 2001, duke treguar për rolin e ulët që marrëveshjet e tregtisë së lirë kanë patur në orientimin e ekeporteve.

Analiza e avantazhit krahasues tregon se MSA ka patur ndikim të vogël në eksportet shqiptare. Produktet me avantazh krahasues pas hyrjes në fuqi të MSA janë të njëjta me ato të para MSA. Ky përfundim vërtetohet në llogaritjet për BE (15), BE (27) dhe katër partnerët kryesorë të BE-së të marrë në analizë. Kjo tregon se MSA nuk ka dhënë ndonjë ndikim të vlerësueshëm në ndryshimin e avantazhit krahasues.

Vendet e Bashkimit Evropian nuk janë njësoj të rëndësishme për avantazhin krahasues të Shqipërisë. Zgjerimi i Bashkimit Evropian në vitet 2004 dhe 2007 nuk e ka ndikuar

avantazhin krahasues të Shqipërisë, duke mos sjellë pothuaj asnjë ndryshim në Indeksin e Balasës llogaritur për BE (15)[70] dhe BE (27). Si rezultat, Shqipëria duhet të lobojë me vendet që i përkasin BE (15) për mbrojtjen e interesave të saj tregtare pas anëtarësimit. Nga katër partnerët kryesorë të marrë në analizë, Italia është vendi i parë në terma të numrit të produkteve për të cilat Shqipëria ka avantazh krahasues. Nga llogaritjet rezulton se 29 kapituj të nomenklaturës së mallrave kanë avantazh krahasues dhe për pjesën më të madhe të produkteve, Indeksi i Balasës është konsiderueshëm më i lartë se sa ai i vendeve të tjera partnere për të njëjtat kategori produktesh. Greqia dhe Spanja, edhe pse krahasimisht me Italinë, kanë më pak produkte, 10 kapituj më pak, për të cilat vërtetohet ekzistenca e avantazhit krahasues, kanë shumë ngjashmëri midis tyre lidhur me llojin e produkteve me avantazh krahasues. Greqia, megjithëse e humbi rëndësinë e vet si destinacioni i dytë më i rëndësishëm i eksporteve shqiptare, gjatë dhe pas krizës ekonomike të vitit 2009, parë nga këndvështrimi i produkteve me avantazh krahasues të shfaqur, vazhdon të jetë një treg interesant për Shqipërinë. Kjo edhe për faktin se tregu i Greqisë ka qenë tregu i dytë më i rëndësishëm për eksportet tona për pothuaj 20 vjet dhe kjo traditë është e freskët për eksportuesit shqiptarë.

Zgjerimi i Bashkimit Evropian me anëtarë të rinj është një proces i njohur dhe rrugë e shkelur nga vendet aspiruese. Shqipëria mund të nxjerrë mësime nga anëtarët e rinj të Bashkimit Evropian (Bullgari dhe Rumani në vitin 2007 dhe Kroaci në vitin 2013). Procesi i anëtarësimit për Kroacinë, Bullgarinë dhe Rumaninë zgjati pothuaj njësoj, 13 vjet ose 14 vjet, duke filluar nga nënshkrimi i marrëveshjeve tregtare respektive për të tri vendet. Kjo sugjeron që procesi i anëtarësimit të Shqipërisë të jetë brenda të njëjtit hark kohor. Me këtë arsyetim, Shqipëria mund të përfundojë procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian brenda vitit 2020, duke patur parasysh se MSA është nënshkruar në vitin 2006. Megjithatë, ky parashikim nuk është më real pasi Bashkimi Evropian e ka deklaruar se deri në 2020 nuk do të ketë anëtarësime të reja.

Analiza e anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Evropian përforcon rezultatet e analizës së ecurisë së import eksportit prezantuar në Kapitullin IV. Anëtarësimi i Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Evropian ka ndikuar në mënyra të ndryshme importet dhe eksportet respektive. Eksportet e Bullgarisë dhe Rumanisë nuk janë ndikuar thellësisht

[70] Në (BE, 15) bëjnë pjesë edhe vendet kryesore me të cilat Shqipëria tregton si Itali, Gjermani, Greqi, Spanjë, etj.

dhe në mënyrë pozitive nga anëtarësimi dhe roli i vendeve të BE-së në eksportet totale të Bullgarisë dhe Rumanisë nuk ka pësuar përmirësim. Importi ndërkohë është ndikuar më shumë se eksporti dhe roli i vendeve të BE-së përmirësohet pas anëtarësimit. Ky përmirësim nuk është domosdoshmërisht një ndikim pozitiv që lidhet me anëtarësimin, por një shfrytëzim më i mirë që vendet e bllokut i bëjnë tregut të një anëtari të ri, si rezultat i trajtimit të njëjtë që ofrohet nga parimet e PPT-së. Duke e parë këtë përfundim në një vlerësim analog me atë të avantazhit krahasues të paraqitur në kapitullin V, në të cilin u vu re se nënshkrimi i MSA nuk dha ndikim në përmirësimin e avantazhit krahasues për kapituj të caktuar të Nomenklaturës së Mallrave, dhe rezultateve të modelimit të flukseve tregtare, mund të arrihet në përfundimin që edhe anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian nuk do të jetë thelbësor në lidhje me strukturën e import-eksportit.

Analiza empirike e të dhënave tregon se marrëveshjet e tregtisë së lirë nuk janë të rëndësishme në tregtinë e Shqipërisë. Ato kanë dhënë efekte të përkohshme nxitëse në vitet e para të nënshkrimit të tyre dhe më tej import-eksporti është dominuar nga të njëjtat tendenca si përpara marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Kjo tregon se faktorët e tjerë si stabiliteti makroekonomik, mirëqeverisja, zhvillimet teknologjike, aftësitë inovative të industrive prodhuese mund të jenë faktorët dhe shtysat kryesore të prodhimit dhe të tregtisë. Nga analiza dhe vlerësimi i rezultateve të paraqitura në kapitullin V marrëveshjet e tregtisë së lirë nuk janë statistikisht të rëndësishme si në modelin e eksportit ashtu edhe në atë të importit.

Nga modelimi i flukseve tregtare të një paneli prej 22 partnerësh tregtare të Shqipërisë në një periudhë 13 vjeçare, 2001-2013 rezulton se popullsia dhe marrëveshjet e tregtisë së lirë të Shqipërisë dhe vendeve partnere nuk janë të rëndësishme statistikisht në modelin e eksportit. Ndërkohë, Indeksi i komplementaritetit të tregtisë është i rëndësishëm statistikisht dhe ndikon pozitivisht në eksport. Gjithashtu, rezultatet e modelit tregojnë se prodhimi i përgjithshëm bruto i Shqipërisë dhe i vendeve partnere është i rëndësishëm statiskisht dhe ndikon pozitivisht tek eksportet. Ky rezultat mbështet gjetjen e paragrafit të mësipërm, se faktorët që ndikojnë në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto janë ato që ndikojnë edhe në rritjen e tregtisë.

Nga modelimi flukseve të eksportit, rezultatet tregojnë se, në kushtet kur faktorët e tjerë mbahen të pandryshuar, rritja e GDP-së të Shqipërisë dhe vendit partner sjell rritjen e eksportit. Duke përfshirë në modelin e eksportit edhe variablat konstantë në kohë (distanca dhe kufiri i përbashkët), rëndësia statistikore dhe efekti i GDP-së dhe TCI rritet. Kështu, një

rritje me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të Shqipërisë çon në një rritje mesatare të eksporteve me 3.7 përqind të eksporteve të saj, dhe rritja me 1 përqind e prodhimit të brendshëm bruto të vendit partner shkakton një rritje prej rreth 1.6 përqind të eksportit.

Nga modelimi i importeve rezulton se produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë, ai i vendit partner në tregti, popullata e vendit partner dhe distanca kanë efekt statistikisht të rëndësishëm mbi volumin e importeve. Produkti i Brendshëm Bruto, si i Shqipërisë ashtu edhe i vendit partner si dhe popullata e vendit partner ndikojnë në rritjen e volumit të importeve. Ndërsa distanca ndikon në mënyrë të rëndësishme në uljen e volumit të importeve. Një rritje me 1 përqind në produktin e brendshëm bruto të vendit partner çon në një rritje mesatarisht prej 0.7 përqind në flukset e importeve. Një rritje me 1 përqind në popullatën e vendit partner në tregti mundëson një rritje mesatare prej 0.6 përqind në flukset e importeve. Ndërsa një rritje prej 10 përqind e distancës mes vendeve partnere bën të mundur zvogëlimin e flukseve të importeve me 18.2 përqind. Popullata e Shqipërisë, indeksi i komplementaritetit të tregtisë, marrëveshjet e tregtisë së lirë si dhe kufiri i përbashkët rezultojnë të mos kenë efekt të rëndësishëm mbi volumin e importeve, edhe pse kanë shenjat e pritura.

7.3 Kontributet kryesore në njohuritë e fushës

Modeli i gravitetit është përdorur gjerësisht në dekadat e fundit në vlerësimin e flukseve tregtare. Punimi përbën një përpjekje për të kontribuar në njohuritë rreth strukturës dhe ecurisë së tregtisë ndërkombëtare në rastin e Shqipërisë dhe zbatimit të modelit të gravitetit për të përforcuar gjetjet cilësore e statistikore. Përmasa e zgjedhjes së përfshirë në modelin empirik është e madhe, gjë që e bën inferencën statistikore më të besueshme. Për këtë studim janë marrë në konsideratë 22 partnerë: Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Gjermania, Greqia, Italia, Maqedoni, Mal i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Spanja, Austria, Franca, Anglia, Kina, Malta, Hollanda, Rusia, Zvicra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Turqia, për periudhën 2001-2013, pra 13 vëzhgime për secilin vend, duke formuar një panel të balancuar prej 286 vëzhgimesh gjithsej. Përveç të dhënave për këto vende, ka të dhëna të pjesëshme për Kosovën, të cilat janë përdorur për vlerësime të veçanta, për të kontrolluar qëndrueshmërinë e rezultateve.

Kërkimi fillimisht u përqendrua në partnerët kryesorë tregtarë brenda bllokut të Bashkimit Evropian dhe vendeve të rajonit. Kjo qasje përbënte një kufizim në arritjen e rezultateve më afër realitetit. Siç është paraqitur në kapitullin IV, Politika e Përbashkët Tregtare e BE-së do të ketë ndikim thelbësor në politikën tregtare shqiptare. Nga analiza del qartë se me anëtarësimin në BE do të rritet numri i vendeve partnere me të cilat Shqipëria do të ketë një një regjim tregtar të ndryshëm nga ai aktual, pasi ajo do të bëhet pjesë e marrëveshjeve të tregtisë së lirë që Bashkimi Evropian ka në fuqi dhe ekziston mundësia që tregtia me partnerë të caktuar si Kina, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Rusia të ndikohet, sepse regjimi tregtar i Shqipërisë ndaj këtyre vendeve do të ndryshojë. Aktualisht, Shqipëria ka një regjim tregtar më të hapur ndaj vendeve të sipërcituara dhe me anëtarësimin në BE, si rezultat i politikave të bashkimit doganor, regjimi tregtar i Shqipërisë do të bëhet më shtrëngues duke ndikuar potencialisht në reduktimin e importeve. Kjo mund të sjellë ndryshimin e flukseve tregtare me këto vende dhe bilancin tregtar respektiv. Parë në këtë kontekst përfshirja në kërkim edhe e partnerëve të tillë si Kina, Rusia e SHBA bëhet e rëndësishme.

Metoda e vlerësimit të regresioneve është e avancuar dhe përfshin vlerësimin me efekte fikse dhe të rastit. Ndërkaq, për diagnostikimin dhe korrigjimin përkatës të tyre janë përdorur testet dhe metodat më të avancuara, të vëna në përdorim vitet e fundit. Megjithë përpjekjet që ka patur për vlerësimin e modeleve të tregtisë me të dhëna panel në kushtet e Shqipërisë, në dijeninë tonë, nuk është aplikuar asnjëherë një vlerësim që të ndjekë rigorozisht procedurën e vlerësimit, testimit dhe korrigjimit, gjë që ngre dyshime për inflacion akademik. Ky studim përbën përpjekjen e parë serioze për vlerësimin e këtyre modeleve për rastin e Shqipërisë.

Për më tepër, përfshirja e TCI në modelet e regresionit është diçka e re që nuk është bërë në vlerësimet e mëparshme për vendet e rajonit, e më pak kështu për rastin e Shqipërisë. Në përpjekjet modeste të vlerësimit të modelit të gravitetit për Shqipërinë është përdorur variabli i ngjashmërisë në termat e masës ekonomike të Shqipërisë dhe vendeve partnere të marrë në analizë (Xhepa dhe Agolli, 2003) dhe metodat e vlerësimit të të dhënave panel, por pa evidentuar problematikat e modelimit; modeli klasik i gravitetit (Pllaha, 2011) me cilësi të dobët të të dhënave dhe përveç një zgjedhjeje me përmasë të kufizuar edhe me mungesë të të dhënave; modeli klasik i gravitetit i vlerësuar me OLS, që nuk merr parasysh dimensionin hapsinor e kohor të të dhënave (Kraja dhe Sejdini, 2014). Ky punim sjell një risi e cila është përfshirja e variablit të strukturës së tregtisë i matur me anë të indeksit të konformitetit të tregtisë (TCI), që mat shkallën e komplementaritetit të tregtisë mes dy vendeve. Siç është

prezantuar në kapitullin II, matja e TCI tregon marrëdhënien midis eksportit të një produkti të caktuar me importin nga vendet e botës të të njëjtit produkt me vendin partner për të cilin po matet ky indeks. Vlerat e tij 0 përfaqësojnë një strukturë tregtie në kushtet e konkurencës perfekte mes dy vendeve, ndërsa 1 përfaqëson një strukturë tregtie me komplementaritet perfekt. Gjithashtu, ky indeks është llogaritur nga autori për të gjithë partnerët e marrë në analizë dhe për të gjithë periudhën. Punimi nuk merr përsipër të bëjë vetëm analizat empirike por shihet në një këndvështrim shkencor më të gjerë. Kombinimi midis këndvështrimit shkencor, empirik dhe praktik si dhe këndvështrimit të politikave jep kontributin e vet në përqasjen e rezultateve empirike me ato politike. Ky punim, ndër të tjera, jep rekomandime për politikën tregtare shqiptare dhe rolin e ri që marrin institucionet politikë-bërëse pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përpjekje për të mbushur sadopak hendekun e krijuar mes kërkimit shkencor dhe politikëbërjes prej kohësh.

7.4 Rekomandime

E tërë analiza e bërë në këtë punim paraqet një hartë të detajuar të situatës së politikës tregtare në Shqipëri dhe ndikimit që do të sjellë anëtarësimi në Bashkimin Evropian. E plotësuar kjo edhe me analizën e procesit të integrimit dhe ndikimit të saj tek Bullgaria dhe Rumania, prezantuar në kapitullin VI mund të dilet në disa rekomandime.

Politikëbërja duhet të përshtatë mendësinë e politikë-bërjes tregtare, që me fillimin e procesit të negociatave. Shqipëria duhet të garantojë plotësimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga bashkimi doganor që në ditën e parë të anëtarësimit. Megjithëse mund të ketë disa përjashtime lidhur me shkallën e zbatimit të rregullave të BE-së, përjashtime për të cilat do të zbatohet periudhë tranzitore që të garantohet zbatueshmëria e plotë, detyrimi i Shqipërisë për të treguar se mund të zbatojë, si çdo vend tjetër anëtar, të gjitha rregullat e përbashkëta, është thelbësor. Kjo kërkon që deri atëherë e gjithë politikë-bërja në fushën e politikës tregtare duhet, jo vetëm të ndjekë zhvillimet në Bashkimin Evropian, por edhe të garantojë përputhshmëri të plotë të të gjitha angazhimeve të saj, sidomos në marrëveshjet ndërkombëtare. Shqipëria nuk duhet të ndërmarrë angazhime tregtare ndërkombëtare që shkojnë në drejtim të kundërt me ato të Bashkimit Evropian, por edhe nëse merr angazhime të tilla, ato duhet të jenë në përputhje me filozofinë dhe shkallën e angazhimit të zbatuar nga BE. Humbja e sovranitetit për të propozuar një politikë të re tregtare me vendet e treta duhet

të shoqërohet me një proces ndërgjegjësimi për ndryshimin e roleve që institucionet shqiptare përgjegjëse për politikën tregtare do të marrin pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Siç është analizuar në Kapitullin IV, përputhja e plotë me PPT do të kërkojë përshtatjen e të gjitha angazhimeve të marra në OBT. Kjo do të kërkojë ndërmarrjen e një analize të detajuar krahasimore midis angazhimeve të Shqipërisë dhe atyre të Bashkimit Evropian, kryesisht në fushën e tregtisë së mallrave, tregtisë së shërbimeve, të drejtës së pronësisë intelektuale. Kjo analizë duhet bërë përpara negociatave për kapitullin 30 të *acquis* "Marrëdhëniet me jashtë" për të lejuar negociata të suksesshme. Duke qenë se Bashkimi Evropian do të negociojë në emër të Shqipërisë me të gjitha vendet e OBT-së për të përshtatur regjimin tonë tregtar me atë të Bashkimit Evropian, barra e argumentimit është e Komisionit Evropian. Kjo përshtatje, sipas praktikës së OBT-së, zakonisht shoqërohet me dhënien e koncesioneve të reja tregtare nga blloku. Duke qenë se BE nuk do të jetë e gatshme të japë koncesione të reja tregtare për partnerët e vetë tregtarë (p.sh. SH.B.A, Japoni,Brazil, Kinë, etj.) Komisioni Evropian mund ti kërkojë Shqipërisë të tërhiqet nga disa prej angazhimeve të saj përpara anëtarësimit në BE (BE, raporti analitik, 2010, faqe 115). Kështu që do të ishte e rekomandueshme që kjo analizë të bëhet paraprakisht.

Ndryshimet që solli traktati i Lisbonës për PPT do të sjellin ndryshime të rëndësishme për politikën e investimeve të huaja direkte si dhe marrëveshjet për mbrojtjen dhe nxitjen e IHD-ve me vendet e treta. IHD-të dhe marrëveshjet për mbrojtjen dhe nxitjen e IHD-ve midis palëve janë konsideruar pas viteve 90' politikë ekonomike me interes strategjik për Shqipërinë. Që pas Traktatit të Lisbonës, IHD-të në Bashkimin Evropian janë në fushën e mbulimit të Politikës së Përbashkët Tregtare dhe si të tillë, edhe nëse politika e IHD-ve konsiderohet si politikë ekonomike në Shqipëri, politikë-bërja duhet të ndryshojë qasje dhe ta konsiderojë atë si politikë tregtare. Kjo kërkon që ajo të shihet njësoj si aspektet e tjera të politikës tregtare kompetencë e Komisionit Evropian. Rregullorja nr. 1219/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, kërkon nga të gjitha vendet anëtare rishikimin e marrëveshjeve bilaterale të investimeve të huaja direkte me vendet e treta dhe njoftimin paraprak dhe marrjen e mandatit për të negociuar në marrëveshje të re tek Komisioni Evropian. Ky është detyrim i pas-anëtarësimit për Shqipërinë, por me fillimin e negociatave Shqipëria duhet të paraqesë shkallën e përputhjes së marrëveshjeve të veta bilaterale të IHD-ve më kërkesat e *acquis* dhe parashikimet e rregullores 1219/2012. Do të ishte e

rekomandueshme që Shqipëria ta bëjë paraprakisht këtë analizë në mënyrë që ndihmojë në përshpejtimin e negocimit të kapitullit 30.

Siç analizohet në kapitullin IV, PPT diskutohet dhe koordinohet në nivel të BE nëpërmjet Komitetit për Tregtinë e Jashtme (KTJ), i njohur më parë si Komiteti i Nenit 133. Shqipëria do të jetë pjesë e këtij komiteti menjëherë sapo të përfundojë negociatat e kapitulli 30 të *acquis*. Për t'iu përgjigjur intensitetit të diskutimeve në këtë komitet si dhe për të mbrojtur interesat ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë duhet që të fillojë përgatitja sa më shpejt. Për këtë do të ishte e rekomandueshme që Shqipëria të krijojë Komitetin Kombëtar për Politikën Tregtare i cili do të jetë pasqyrimi i këtij komiteti të BE-së. Nëpërmjet këtij komiteti do të bëhet e mundur që institucionet publike shqiptare të diskutojnë paraprakisht të gjitha çështjet dhe aspektet e politikës tregtare. Krijimi i këtij komiteti duhet të shoqërohet edhe me fuqizimin e administratës publike, rritjen e njohurive dhe dijeve rreth PPT-së, si dhe krijimi i një mendësie dhe mentaliteti të ri në bërjen e politikës tregtare.

Siç është analizuar në kapitullin V, vendet e reja të bllokut të BE-së, të anëtarësuara në vitet 2004 dhe 2007, nuk kanë patur ndikim në ndryshimin e avantazhit krahasues të shfaqur të Shqipërisë, rezultat ky i shpjeguar në Kapitullin V. Edhe pse analiza në këtë kapitull i referohet avantazhit krahasues ajo është një tregues i rëndësishëm për politikë-bërjen dhe strategjinë e bashkëpunimit midis vendeve që duhet të ndjekë Shqipëria. Do të ishte e rekomandueshme që të fuqizohen më tej Komisionet e Përbashkëta me vendet e BE (15) për të konsoliduar komunikimin dhe bashkëveprimin me këto shtete që përpara anëtarësimit në mënyrë që panorama ekonomike dhe interesat ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë të jenë të njohura mirë prej tyre. Vendimmarrja në nivelin e Komisionit Evropian ndikohet dukshëm nga rëndësia që një vend anëtar ka brenda bllokut. Duke krijuar një mekanizëm lobimi, koordinimi dhe bashkërendimi me vendet e BE (15), që përpara anëtarësimit, mundësia e ruajtjes së interesave tona ekonomike në diskutimet e Komisionit Evropian me vendet e treta do të jetë më e madhe.

Strategjia 2020 e Bashkimit Evropian nuk ka parashikuar zgjerim të BE-së me anëtarë të rinj deri në vitin 2020. Siç u analizua në Kapitullin VI, eksperienca e Kroacisë, Rumanisë dhe Bullgarisë tregojnë se procesi i anëtarësimit të tyre zgjati 13-14 vjet. Duke qenë se për Shqipërinë kjo periudhë do të jetë më e gjatë si rezultat i vendimit të Bashkimit Evropian për të mos patur anëtarë të rinj deri në vititn 2020, periudha 2015-2020 duhet të përdoret me

zgjuarsi dhe me objektivitet nga Shqipëria për t'u përgatitur për negociatat në mënyrë strategjike. Për këtë, do të ishte e rekomandueshme që të bëhen analizat e boshllëqeve të legjislacionit në mënyrë periodike për të kuptuar (i) nevojat për harmonizim të legjislacionit sa herë që ndodhin ndryshime në legjislacionin evropian, (ii) përditësuar inventarin e legjislacionit shqiptar, (iii) evidentuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, apo dispozita të caktuara brenda legjislacionit sektorial të cilat shfuqizohen në momentin e anëtarësimit. Kjo qasje është shumë e rëndësishme në fushat e kompetencës ekskluzive si PPT, PPB, etj. sidomos në rastet kur dispozitat institucionale[71] të një ligji apo akti tjetër ligjor nuk shfuqizohen pasi janë të domosdoshme edhe pas anëtarësimit për të garantuar zbatimin e rregullave me efekt të drejtpërdrejtë në nivel të Bashkimit Evropian (p.sh. rregulloret).

7.5 Mundësi për kërkime të mëtejshme

Kapacitetet administrative të Shqipërisë përgjegjëse për politikën tregtare janë konsideruar jo të përshtatshme për t'iu përgjigjur zhvillimeve të Politikës së Përbashkët Tregtare të BE-së nga të gjitha raportet e progresit të Bashkimit Evropian që pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Siç u nënvizua në Kapitullin IV Shqipëria duhet të jetë pjesë aktive e ish-Komitetit 133 që merret me koordinimin dhe diskutimin e politikës tregtare në nivel të Komisionit Evropian. Aftësitë e administratës publike në koordinimin dhe mbajtjen e qëndrimeve të unifikuara në mbrojtje të interesave ekonomike të vendit janë thelbësore. Ndikimi i aftësive të administratës publike pas anëtarësimit në BE nuk janë vlerësuar dhe nuk janë përfshirë në modelin e paraqitur në kapitullin V. Vlerësimi i ndikimit të këtyre aftësive në flukset tregtare dhe politikën tregtare mund të përbëjë një fushë për studime dhe kërkime të mëvonshme.

Procesi i integrimit evropian dhe zbatimi i angazhimeve të marra në MSA, përveç liberalizimit të thellë tregtar, parashikon edhe një proces të gjatë të përafrimit të legjislacionit. Procesi i përafrimit është një proces i cili shoqërohet edhe me shumë ndryshime teknologjike të detyruara nga kërkesat themelore për sigurinë dhe cilësinë e produkteve. Këto të fundit janë të derivuara nga *aqcuis* të BE-së dhe janë kërkesa të detyrueshme për një produkt që qarkullon në tregun e vetëm të BE-së. Ndryshimet në teknologji ndikojnë në mënyrë direkte në rritjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, duke ndikuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në flukset tregtare. Ndryshimet në teknologji nuk janë

[71] Dispozitat institucionale i refrehohen parashikimeve për krijimin e strukturave të caktuara për zbatimin e ligjit.

marrë në analizë në vlerësimin e flukseve tregtare të ardhshme dhe kjo mund të jetë një tjetër mundësi kërkimi.

Nga këndvështrimi i analizës empirike, do të ishte me interes që analizat e flukseve të kryhen sipas sektorëve strategjikë dhe të shihet efekti i marrëveshjes me BE për secilin prej tyre. Analiza empirike i ka konsideruar të gjitha produktet dhe sektorët njësoj të rëndësishëm në flukset tregtare. Analiza e detajuar e strukturës së tregtisë, sipas grupimeve në një marrëveshje të tregtisë së lirë tregon se ka diversitet midis sektorëve dhe vendeve. Parë në këtë këndvështrim studime të mëvonshme mund të konsiderojnë vlerësimin e ndikimit të marrëveshjeve të tregtisë së lirë që Bashkimi Evropian ka me vendet e treta në terma të sektorëve tanë strategjikë.

Së fundi, Shqipëria do të bëhet pjesë e 37 marrëveshjeve të tregtisë së lirë që Bashkimi Evropian ka në fuqi[72] si dhe të tjerave, që janë në proces. Aktualisht, Komisioni Evropian ka 10 marrëveshje në proces negocimi dhe deri në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE numri i tyre do të rritet duke rritur edhe shkallën e ndikimit të anëtarësimit në BE në lidhje më flukset tregtare. Kjo për faktin se numri i partnerëve me te cilët Shqipëria do të ketë një regjim tregtar të ndryshëm nga ai që ka aktualisht është i madh. Ky kërkim nuk i ka përfshirë të gjitha vendet me të cilat BE ka një marrëveshje të tregtisë së lirë në analizën empirike. Shkalla e ndikimit të tyre në strukturën e importeve dhe eksporteve ka nevojë për analiza të tjera dhe mund të shërbejë si pyetje kërkimore për studiues të tjerë.

[72] Faqja zyrtare e Komisionit Evropian; http://ec.europa.eu/enterprise/policies/international/files/existing-trade-negotiations_en.pdf

BIBLIOGRAFIA

Adams, R., Dee, P., Goli, J., and McGuire, G., 2003. "The Trade and Investment Effects of Preferential Trading Arrangement-Old and New Evidence" Staff Working Paper. Canberra: Australia Productivity Commission.

Alam, M., Uddin, G. and Taufique K., 2009. "Import Inflows of Bangladesh: the Gravity Model Approach". *International Journal of Economics and Finance*. Vol.1, No.1, pp.131-140.

Anderson, J. E., 1979. "A theoretical foundation for the gravity equation", *American Economic Review*, Vol. 69, pp. 106-116.

Anderson, J. E., and van Wincoop (2004). "Trade Costs", *Journal of Economic Literature*, Vol. 42, No. 3, pp. 691-751.

Anderson, J. E., and van Wincoop, E., 2001. "Borders, Trade and Welfare" Prepared for the Brookings Trade Forum 2001 on Globalization: Issues and Implications.

Anderson, J. E., and van Wincoop, E., 2003. "Gravity with Gravitas", *American Economic Review*, Vol. 93, pp. 170-92.

Apostolov, M. and Josheski, D., 2013. "Macedonia's exports and the gravity model". MPRA Paper No. 48180.

Bai, J., C. Kao and S. Ng, 2009. "Panel Cointegration with Global Stochastic Trends", *Journal of Econometrics*, Vol. 149, No. 1, pp. 82–99.

Balassa, B., 1965. "Trade Liberalisation and "Revealed" Comparative Advantage". The Manchester School, 33: 99–123. doi: 10.1111/j.1467-9957.1965.tb00050.x

Baldwin, R., 1994. "*Towards an integrated Europe*". Centre for Economic Policy Research, London.

Baltagi, B. H., and Wu, P. X., 1999. "Unequally spaced panel data regressions with AR(1) disturbances". *Econometric Theory*, Vol. 15, pp. 814–823.

Banka e Shqipërisë, 2010. *Buletini Ekonomik 2010.*

Batra, A., and Khan, Z., 2005. "Revealed Comparative Advantage: An analysis for India and China". Indian Council for Research on International Economic Relations, Working Paper No. 168

Bergstrand, J. H., 1985. "The Gravity Equation in International Trade: Some Microeconomic Foundations and Empirical Evidence", *The Review of Economics and Statistics*, 67, 474-481.

Bergstrand, J. H., 1989. "The Generalized Gravity Equation, Monopolistic Competition and the Factor-Proportions Theory in International Trade", *Review of Economics and Statistics*, Vol. 71, pp. 143–153.

Brun, J-F., Carrere, C., Guillaumont, P., and de Melo, J., 2005. "Has Distance Died? Evidence from a Panel Gravity Model" Published by Oxford University Press on behalf of the International Bank for Reconstruction and Development.

Bungenberg, M., 2011. "The Division of Competences between the EU and its Member States in the Area of Investment Politics", in Bungenberg, M., Griebel, J., Hindelang, S., eds. "*International Investment Law and EU Law*", Springer-Verlag Berlin Heidelberg: Berlin.

Camarero, M., Gómez, E. and Tamarit, C., 2013. "EMU and Trade Revisited: Long-Run Evidence Using Gravity Equations". *World Economy*, Vol. 36, pp. 1146–1164. doi: 10.1111/twec.12090.

